monumentet

DO NOT COPY



17, 1979

DO NOT COPY

Kopertina e parë: **Bastioni jugor në qytetin në Persqop (rrethi i Tiranës) shek. III p.e.s.**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

17, 1979

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Artikulli

Apollon BAÇE

Vështrim mbi arkitekturën e fortifikimeve antike në vëndin tonë 5

Gjerak KARAISKAJ

Fortifikimet në Shqipëri gjatë periudhës së herëshme të sundimit romak 47

Sotir KOSTA

Restaurimi i mozaikëve të Mesopotamit dhe Bylisit. 59

Stilian ADHAMI

Marrëdhëniet ekonomike, shoqërore dhe kulturore midis Vithkuqit dhe Voskopojës 71

Valter SHTYLLA

Restaurimi i dy banjove mesjetare në vendin tonë 83

Emin RIZA

Arkitektura e vëndbanimit-rrënojë të Kardhiqit 97

Leonard SULI

Puset çisternë të vjetër në fshatrat Dhrovjan i sipërm dhe Dhrovjan i poshtëm 121

Shpresa PRIFTI

Restaurimi i një banese me çardak në Shkodrën e vjetër. 133

Aleksandër MEKSI, Leonard SULI

Punimet konservuese dhe arkitektura e xhamisë së Allajbegisë në Burim të Dibrës. .....

DO NOT COPY

TABLES DE MATIERES

Page

Articles

Apollon BAÇE

Aperçu sur l'architecture des fortifications antiques dans notre pays 5

Gjerak KARAISKAJ

Les fortifications en Albanie pendant la première période de la domination romaine 47

Sotir KOSTA

Restauration des mosaïques de Mésopotam et de Bylis 59

Stilian ADHAMI

Les rapports économiques, sociaux et culturels entre Vithkuq et Voskopojë pendant la période de leur épanouissement 71

Valter SHTYLLA

Restauration de deux hammams moyénageux 83

Emin RIZA

L'architecture de l'agglomération urbaine en ruine de Kardhiq 97

Leonard SULI

Les puits – réservoirs anciens dans les villages du haut et du bas Dhrovjan 121

Shpresa PRIFTI

Restauration d'une habitation a tchardak dans la vieille Shkodër. 133

Aleksandër MEKSI, Leonard SULI

Les travaux de conservation et l'architecture de la mosquée d'Allajbegi dans le village de Burim, district de Dibër 147

DO NOT COPY

Apollon BAÇE

DO NOT COPY

VËSHTRIM MBI ARKITEKTURËN E FORTIFIKIMEVE ANTIKE NË VENDIN TONË

Arkitektura e fortifikimeve ka një vend të rëndësishëm në tërësinë e ndërtimeve të hershme në vendin tonë, si për nga gjerësia ashtu dhe zgjidhjet, më se e kuptueshme kjo nga që «popullit tonë i është dashur ta çajë rrugën e historisë me shpatë në dorë». Në këtë artiktekturë një vend të veçantë zenë fortifikimet e periudhës antike, të cilat pasqyrojnë mjaft mirë nivelin e lartë teknik, mendimin krijues dhe luftën e të parëve tanë për liri.

Artikulli paraqet një sprovë për një vështrim tërësor të arkitekturës së fortifikimeve në vendin tonë i mundësuar ky prej rezultateve të gjurmimeve dhe studimeve të pasçlirimit.[1] Në artikull trajtohen si fortifikimet në veri të Vjosës, që përkojnë mirë me territorin e «Ilirisë së mirfilltë» ku pati zhvillim më të plotë diferencimi shoqëror dhe përparimi ekonomik, i cili solli proçesin e urbanizimit masiv dhe lindjes së shtetit[2], ashtu dhe ato në territorin në jug të Vjosës. Ndonse ky i fundit përkon me një formacion tjetër shoqëror, atë të Epirit, baza e përbashkët etniko-kulturore, kushtet e ngjashëm ekonomikë, shoqërorë, gjeografikë dhe përfshirja në të njëjtën sferë shkëmbimi dhe ngjarjesh politike, sollën një formulim të njëjtë të arkitekturës, veçanërisht asaj të fortifikimeve[3]. Rrjedhimisht arkitekturën e fortifikimeve të tyre do ta trajtojmë së bashku me ato të fortifikimeve Ilirie.

Në truallin tonë si pasojë e zhvillimit ekonomik të prapatokës Ilire dhe veprimtarisë kolonizuese, u themeluan qytetet koloni: Dyrrahu (627 p.e.s), Apolonia (588 p.e.s) dhe Oriku. Në shek. e V këto qendra u kthyen në njësi të pavarura nga qytetet mëmë duke u lidhur gjithnjë e më tepër me mjedisin ilir, ndërsa në v. 312 mb to shtrihet sovraniteti i shtetit ilir, i dëshmuar dhe në shek. e III p.e.s. nga monedhat me emrat e mbretërve ilirë[4]. Pikërisht kësaj periudhe i përket dhe fortifikimi i Apolonisë, rrjedhimisht kjo veprimtari nuk mund të merret e shkëputur nga mjedisi ilir. Nga ana tjetër nuk mund të mohohet roli i qyteteve koloni si bartës të arritjeve të përparuara bashkëkohëse në fushën e fortifikimeve dhe huazimi prej qendrave ilire i këtyre arritjeve. Por duke e pranuar këtë fenomen duhet vënë në dukje se faktori kryesor i çili e çoj përpara këtë arkitekturë ishte proçesi dialektik i zhvillimit të brendshëm.

Fortifikimet e periudhës antike në vendin tonë karakterizohen nga zgjedhja e tereneve me mbrojtje të fuqishme natyrale, kërkesë e cila më qartë spikat në ato të ndërtuara rishmë. Fortifikimet gjenden kryesisht në kodra shkëmbore rreth 100 m të larta, shpatet e të cilave ulen me pjerësi të madhe ose bien thikë (fig. 1), zgjidhje kjo që jepte mundësi për një shfrytëzim të plotë të vetive mbrojtëse të terrenit: Nëpërmjet saj shmangej ose paksohej së tepërmi mundësia e vendosjes së makinave të rrethimit dhe vështirësohej sulmi. Për më tepër në disa prej tyre, veçanërisht tek kështjellat, kjo jepte mundësi që të mos rrethohej i tëri perimetrik, por në vendet e thikta mbrojtja t'i lihej vetë terrenit (fig. 2). Të dy

1) Në artikull janë shfrytëzuar planimetritë e botuara prej N. Cekës (Amantia, Matohasanaj, Çuka e Ajtoit), S. Islamit (Zgërdheshi), L. Papajanit (Klosi), Dh. Budinës (Malathrea), G. Panit (Butrinti), F. Prendit – K. Zhekut (Lisi).

2) A. Buda Ilirët e jugut si problem i historiografisë, **Kuvendi I i studimeve Ilire,** Tiranë, 1974, I, 51.

3) F. Prendi, Urbanizimi i Ilirisë së jugut, **Kuvendi I i studimeve Ilire,** Tiranë, 1974, 108.

4) Diod XIX 78, 1; XIX 89, 1 H. Ceka, **Probleme të numismatikës ilire,** Tiranë, 1956, 42-45.

DO NOT COPY



Fig. 1

komponentet, terreni i paafrueshëm dhe ndërtimet mbrojtëse të kombinuara me mjeshtëri me njera tjetrën, krijuan një sërë fortifikimesh të fuqishme. Historianët bashkëkohës ndërmjet tyre përmendin Dimalin (Krotina e rr. Beratit) «qytet që s'mendohej se e merte dot dora e armikut», Skodrën «qytet i vështirë për tu afruar» dhe Antipatrean (Beratin), qytet që nuk pranoi të dorëzohet nga besimi që kishin mbrojtësit «tek madhësia e qytetit, muret dhe pozita e tij»[5]. Duke shfrytëzuar një pozitë të tillë mbrojtësit e qytetit ilir të Dalmacisë, Dalminiumit, sipas Dion Kasit, «qëllonin kundër romakëve me gurë të shumtë; një pjesë e hidhnin me hobe, një pjesë i rrokullisnin, të tjerët lëshonin rrota e karoca plot me gurë, të tjerët kosha të rrumbullakët të bërë në vend. Të gjitha këto lëshoheshin me shpejtësi të madhe duke i përçarë në mes romakët dhe duke i dëmtuar»[6]. Kjo mënyrë mbrojtjeje aktive, e trashëguar në shekuj, më vonë u njoh me emërin «ledhi Shqiptar».



Fig. 2

Klasifikimi i fortifikimeve. Sipas funksionit fortifikimet ndahen në qytete, kështjella, kulla dhe mure barjerë (Tab. I). Prej tyre qytete pa dyshim nuk janë tërë qëndrat e rrethuara me mure, por qëndrat me një bashkësi të organizuar dhe diferencuar, që dallon nga fshati kryesisht prej pranisë së qëndrës së përhershme të prodhimit dhe shkëmbimit dhe të institucioneve shoqërore. Lidhur me kohën e lindjes së qytetit ilir përkatësisht fortifikimeve me blloqe të latuar mendimet janë të ndryshme. Kështu F. Prendi e sheh qytetin si themelim të gjysmës së I të shek. V p.e.s., ndërsa prof. S. Islami të fundit të këtij shekulli[7]. Në

5) Dimali Polyb, III, 18, 1 Shkodra Liv. XLIV 31, 2 Antipatrea Liv XXXI 127, 2.

6) Cass. Dio LVI 14, 1-2

7) F. Prendi, **Urbanizmi...**, 110. S. Islami (shteti Ilir, vendi dhe roli i tij në botën mesdhetare, **Kuvendi I i studimeve Ilire,** Tiranë, 1974, 91).

fakt njoftimi i parë për qytetin ilir, Sesarethin e Taulantëve, i përket fundit të shek. VI. Edhe në se nuk pranohet kjo e dhënë, si e ritransmetuar nga një autor i dytë[8], njoftimi i Pausanies në gjysmën e I të shek. V p.e.s., për qytetin e Abantise (Amantisë) Thronin, i vërtetuar dhe nga një mbishkrim i gjetur në Olymp,[9] është jashtë çdo dyshimi. Preja e shumtë e grabitur prej këtij qyteti që i dha mundësi Apoloniatëve për ngritjen e një monumenti të madh skulptural e dëshmon mjaft mirë qënien e qyteteve ilirë të zhvilluar ekonomikisht në këtë kohë. Ky zhvillim që përkon me hopin cilësor që shënon kalimin nga periudha e I në atë të II të hekurit krijoi dhe mundësitë që në sajë të perfeksionimit të veglave të punës dhe punës së skllevërve, qytetet të fortifikoheshin më mirë me mure prej blloqesh të latuar. Këto të dhëna mbështeten dhe nga vetë arkitektura e tyre. Kështu ndërtuesit e qytetit në Klos të rrethit të Fierit (Nikoia)[10] në kontakt ekonomik dhe kultural me qytetet antike bashkëkohës, nuk kishte pse të huazonin një skemë të vjetëruar me kulla të pazhvilluara mirë dhe mjaft të rralla (fig. 3) që i përket shek. VI fillimit të shek. V. p.e.s.[11].

Shpërndarja e qëndrave urbane, në kohë dhe hapësirë nuk ka qënë e njejtë për shkak të zhvillimit të diferencuar fillestar të krahinave. Në shek. e V p.e.s. qytetet gjinden në krahinat e jugut, veçanërisht në bregdet dhe prapatokën e afërt që patën një zhvillim më të vrullshëm. Më tej, në shek. e IV p.e.s. si pasojë e zhvillimit ekonomik dhe konsolidimit të formacioneve shtetërore qytetet shtrihen më në veri e brendi. Ndërmjet tyre Ariani përmend Pelionin (Selca e poshtëme e Pogradecit?), qytetin më të fortë ndërmjet qyteteve të Dasaretisë, ndërsa të dhënat numizmatike dhe burimet flasin për një qytet tjetër të brendëshëm, Damastionin[12]. Nga ana tjetër krahas qyteteve (polis) prej Diodorit mësojmë praninë e një sërë qytetesh të vegjël (polisma)[13]. Fuqizimi i shtetit Ilir dhe Epirot dhe periudha e gjatë pa luftra të jashtme solli shpeshtimin e kësaj veprimtarie në gjysmën e parë të shek. III p.e.s. Krahas ndërtimit në rajonet e mëparshëm vërehet një shtrirje e gjerë në zonat që bënin pjesë në shtetin ilir por që kishin mbetur jashtë këtij proçesi,



Fig. 3

në Shqipërinë e mesme dhe atë të Veriut. Po në këtë periudhë lindin dhe një varg kështjellash në ndërtimin e të cilave shihet qartë veprimtaria e centralizuar e lidhjeve, dhe shtetit Ilir e Epirot.

Qytetet. Rrugët e lindjes së qytetit në vendin tonë kanë qënë dy: qytete që lindën nga hopi cilësor që pësuan disa prej qëndrave paraurbane të periudhës së parë të hekurit dhe krijime të reja. Gjetjet dhe traktet e ruajtura të mureve, tregojnë se shumica e qëndrave të studjuara janë ndërtuar mbi një substrat të vjetër paraurban[14]. Kjo vazhdimësi ndikoj drejtpërsëdrejti në arkitekturën e fortifikimeve, veçanërisht në trajtimin planimetrik, ndërsa zhvillimi i tyre i mëtejshëm, punimi i mureve me teknikë më të qëndrueshme dhe estetike si dhe paisja me elemente të rinj,

8) S. Islami Lindja dhe zhvillimi i jetës qytetare në Iliri, **Iliria,** 2, Tiranë, 1972; 10.

9) Paus. V, 22, 2-4 E. Kunze **Bericht uber die Ausgrabungen in olympia,** 1956, 149.

10) L. Papajani, Qyteti Ilir në Klos **Kuvendi I i studimeve Ilire,** Tiranë, 1974, 518, e daton Klosin në fund të shek. V. Identifikimi me Nikaien kryhet prej L. Robertit dhe L. Papajanit nga dy mbishkrime të ndryshme (L. Robert, **Bulletin de Corespondance hellenique,** 1928, 433, L. Papajani. **Po aty** 517).

11) F. Winter, **Greck fortificationes,** London, 1971. Ndërtimi në fund të shek. V p.e.s. i Klosit përderisa problemi teknikisht është i zgjidhur dhe mundi e shpenzimet të njëjta do tregonte një inerci të pamundëshme njëshekullore.

12) Arrian Anab. I, 5,5, Identifikimi i Selcës poshtme me Pelionin tek N. Ceka, L. Papajani Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike, **Monumentet** 1, Tiranë, 1971, 48, Për Damastionin J. May, **The coinage of Damastion,** London 1939, Strab. VII, 7.7.

13) Diod, XVI 69, 7

14) S. Islami, **Shteti...,** 97, F. Prendi, **Urbanizimi...,** 111-112.

PO FOTOCOPY



Fig. 4

kulla, hyrje etj. në përshtatje me kërkesat e kohës, ka një karakter evolutiv që mund të ndiqet etapë pas etape. Pa dyshim që në qytete nuk u kthyen tërë qëndrat e vjetra paraurbane, një pjesë e të cilave vazhdoi të mbijetojë krahas qyteteve, por vetëm ato qëndra të cilat i plotësonin kushtet për këtë zhvillim[15].

Qytetet, veçanërisht kryeqendrat, gjënden në zona të zhvilluara ekonomikisht, në mes njësish të pasura bujqësore e blegtorale në afërsi të rrugëve të rëndësishme[16]. Kjo vendosje jepte mundësi për një tregëti të volitëshme, dërgimin e ndihmave ushtarake në tërë zonën, moskapjen në befasi si dhe një administrim të mirë të teritorit të varur. Kërkesë tjetër me rëndësi ishte ngulimi në zona të shëndetëshme, që kuptohet nga fakti se asnjë prej qyteteve nuk gjendet në zona të pa përshtatëshme higjenike, moçalore ose që nuk kapen nga dielli.

Deri më sot burimet dhe gjurmimet në terren na njohin me 27 qëndra qytetare (Tab. I), sipërfaqja e të cilave luhatet nga 3,5 ha (Kanina) deri në 130 hektarë (qyteti koloni i Apolonisë). Duke u nisur nga kjo madhësi qytetet ndahen në të mëdhenj, të mesëm e të vegjël (polisma)[17]. Një e treta e këtyre qyteteve është e lidhur me detin. Ata gjenden drejtpërdrejt



Fig. 5

15) S. Islami, **Po aty.**
16) S. Islami, **Po aty.**
17) Për ndarjen e qyteteve në grupe sipas madhësisë na duket i drejtë mendimi i prof. S. Islamit (Lindja dhe zhvillimi i jetës qytetare në Iliri, **Iliria,** 2, 1972, 15) i cili grupimin e tyre në të mëdhenj, të mesëm e të vegjël, e kryen duke u nisur nga vendi që ata zinin brenda Ilirisë dhe jo në mënyrë absolute në botën antike. Por duhet vënë në dukje se sipërfaqja që zinte qyteti ndonse është një tregues mjaft i mirë nuk mund të meret si tregues absolut për rëndësinë e qytetit. Kështu Buthroti 4, 5 hektarësh ka një jetë mjaft më intensive se shumë prej qyteteve me sipërfaqe më të madhe. Duke u nisur nga sipërfaqja në grupin e parë krahas dy qyteteve koloni, Apolonisë: 130 hektarëshe, sipërfaqe kjo jo më e vogël se e mjaft qyteteve kryesore të botës antike, dhe Epidamnit, spikasin Foinikia me 55 ha, Antigonea (Jermë e rr. Gjirokastrës) me 65 hektarë dhe dyqytetëshi Bylis-Nikaia (Hekali dhe Klosi i rr. Fierit) me 46 ha së bashku. Më tej vinë Lisi me 20 ha, Dimali (Krotina e rr. Fierit) me 16 hektarë dhe Amantia e cila krahas akropolit 13 hektarësh ka dhe qytetin e jashtëm të parrethuar. Më tej janë qytetet e mesëm rreth 10 hektarësh Antipatrea (Berati), Olympia (Mavrova), Skodra, qyteti në Zgërdhesh etj..

DO NOT COPY



Fig. 6

në buzë të tij (qytetet koloni Epidamn e Orik dhe Aulona) (fig. 4), në kodra të larta 1-2 km larg bregut (Himara, Kanina, Borshi) (fig. 5) dhe në lidhje të tërthortë me të nëpërmjet lumenjsh (Apolonia, Lisi) (fig. 6), ose liqejsh e lumenjsh (Skodra, Buthroti) (fig. 1).

Një nga tiparet kryesore që e dallon qytetin e ngritur mbi qëndrat paraurbane nga qyteti i lindur rishmë është prania e akropolit. Në të kundërt ai mungon në qëndrat e reja që kryesisht shtrihen në pllaja të rafshta, të përshtatëshme për një zhvillim të rregullt urbanistik, por jo për ndërtimin e akropolit. Tërthorazi kjo dëshmon dhe për një sistem demokracie skllavopronare dhe jo oligarqik. Në qytetet me vazhdimësi, si akropol, shërben rrethimi i trashëguar në të cilin shtohen elementë të rinj mbrojtës. Akropoli në këtë rast nuk është i mirëfilltë, për veçimin e parisë, por një mbrojtje rezervë e trashëguar, e nevojshme kjo pasi shpesh vetitë mbrojtëse të qëndrave me vazhdimësi nuk janë të përkryera si ato të qëndrave të reja.

Nga fillimi i shek. III p.e.s. shihet dhe prirja për lindjen e qytetit të jashtëm të parrethuar me mur. Kështu zhvillimi ekonomiko-shoqëror i Amanties solli domosdoshmërinë e rritjes së tij, por këtë rritje nuk e lejonte sipërfaqja e kufizuar e pllajës së qytetit. Si pasojë e kësaj kërkese dhe qetësisë relative që vërehet në këtë kohë, jashtë mureve ndërtohen stadjumi, gjimnazi, tempulli, si dhe një sërë banesash (fig. 7). Po kështu dhe në Zgërdhesh, Selcë dhe qën-



Fig. 7

DO NOT COPY

dra të tjera, jashtë mureve, janë gjetur tempuj dhe varre monumentale.[18]

Sipas terenit që zenë qytetet dallojmë dy tipa kryesore me shtrirje në terene të pjerrët, qytetet e shpatit, dhe me shtrirje majë kodrash ose rrafshesh shkëmbore, qytetet e pllajës[19]. Krahas shembujve të pastër, në disa raste të pakët ata shtrihen njëkohësisht në pjesën e sipërme të rrafshët dhe në shpatet e kodrave. Po ky kategorizim vlen dhe për kështjellat. Përjashtuar Epidamnin, ndoshta dhe Aulonën, në te-

e mbrojtjes kalon dhe në teren të rrafshët. Por me përjashtim të Orikut të planizuar që në fillim si i tillë, kjo ndodh vetëm në qendrat me vazhdimësi dhe kushtëzohet nga kufizimi i terenit. Në të kundërt në fortifikimet e ndërtuar rishmë si dhe në fortifikimet e trashëguara, ku tereni është i gjerë (Foinike) (fig. 8), kjo linjë kalon në mes të shpatit, duke shfrytëzuar vetitë mbrojtëse të terrenit të pjerrët. Në rastet kur qëndra e vjetër zinte majën e një kodre me rënie të njëtrajtshme në çdo anë, qyteti u shtri dhe u forti-



Fig. 8

rritorin tonë mungojnë qendrat e fortifikuara me shtrirje në terrene fushorë, karakteristikë për një sërë qytetesh të Greqisë[20]. Ky fenomen dëshmon për vlerësimin e cilësive të terrenit si faktor kryesor për mbrojtje.

Brenda tipit të qytetit të shpatit dallojmë nëntipin pa akropol, me akropol në mes dhe akropol në anë.

Në qytetin e shpatit vihet re se linja e poshtme

fikua duke e pasur akropolin në mes, ndërsa kur qëndra e vjetër zinte majën e një shpati malor qyteti u shtri poshtë shpatit, duke e pasur akropolin në anë. Prej tyre nëntipi i parë i përket vetëm qëndrave të ndërtuara rrishmë si Çuka e Ajtoit (rr. Sarandës) (fig. 9). Fortifikimi i ndërtuar në shek. e V p.e.s. ka një sipërfaqe prej 5 ha. Nga ana veriore ai shfrytëzon rënien e thikët e të paafrueshme të shkëmbit duke e lënë këtë anë të parrethuar, ndërsa në jugë ndjek

18) S. Anamali, Amantia, **Iliria,** 2, 1972, 61-134, N. Ceka, Qendrat e fortifikuara të Amantëve, **Monumentet** 10, 1975, 21-52.

19) C. Praschniker (**Muzakhia und Malakastra,** Wien, 1920) i mbështetur në skemën e Noack dallon 3 tipe qytetesh. Prof. Islami (**Lindja...** 12) klasifikimin e kryen sipas vendosjes së akropolit. Në akropol në majë, në akropol në mes dhe pa akropol. Mendojmë se përcaktues në këtë klasifikim është terreni që zenë qytetet. Kombinimi terenit me akropolin krijon nëntipat e mësipërm planimetrike por ato janë të pa paramenduar, derivatë, me qenë se akropoli me përjashtime mjaft të rralla paraqet një vazhdimësi të rrethimit paraurban.

20) Winter **Vep. cit.**

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10

vijën rrushkulluese të mesit të shpatit, duke rrethuar një syprinë mjaft të pjerrët, 500 m. të gjatë dhe 100 m të gjerë. Rrethimi karakterizohet nga mungesa e kullave dhe nga prania e traseve të dhëmbëzuara[21]. Karakteristik për nëntipin e dytë është Buthroti, i cili gjendet në skajin jugperëndimor të gadishullit të Heksamilit, në një platformë të kufizuar prej ujrave të liqenit dhe kanalit të Vivarit (fig. 10). Mesin e saj e ze një kodër e veçuar prej guri gëlqeror e cila bie me pjerësi të madhe drejt platformës, me përjashtim të një qafe të butë në anën përëndimore. Në shek. e VII-VI p.e.s. jeta përqëndrohet në pjesën e sipërme të kodrës, ku një mur me gurë të mëdhenj të pa latuar rrethon një syprinë prej 0,4 ha. Më tej në shekujt e V p.e.s, me zgjerimin e mëtejshëm të qytetit, kodra qarkohet në rrëzën e saj me një trase dhëmbë sharre, duke arritur një sipërfaqe prej 4,5 ha[22]. Në këtë mënyrë, ashtu si dhe në Orik, krijohet një sistem mbrojtës me akropolin në mes, i cili haset edhe në fortifikimet e periudhës tranzitore (Mbolani i rr. Beratit).

Nëntipi i tretë (Zgërdhesh, Lis, Foinike etj.) përfaqësohet mirë prej qytetit në Zgërdhesh (fig. 11). Shpati i kodrës në të cilën shtrihet qyteti në Zgërdhesh ka trajtën e një trekëndëshi dybrinjësh që ulet me pjerësi të pakët drejt fushës. Kulmi i saj ndodhet në pikën më të lartë, ku gjendet dhe një qafë që lidh me kodrat përreth, ndërsa dy brinjët e gjata rrëzohen me shkëmbinj të thepisur duke siguruar një mbrojtje të mirë anësore. Në periudhën e parë të hekurit majën e kodrës e zë një fortifikim i vogël 1 hektarësh, ndërsa më tej në kapërcyellin e shek. IV-III p.e.s., kjo qëndër zgjerohet duke arritur një sipërfaqe prej 10 ha. Në këtë periudhë rrethohet deri poshtë dhe paiset me kulla i tërë perimetri i shpatit të kodrës, ndërsa muri i rrethimit të trashëguar i cili tashmë lot rolin e akropolit, çahet për tu bërë vend një vargu kullash të tjera. Lind kështu një sistem i ri mbrojtës me shtrirje në shpatin e kodrës, akropoli i të cilit gjendet në anë, në pikën më të lartë[23]. Afërsisht këtë zhvillim ka dhe Lisi, (fig. 12) por në të krahas akropolit, gjinden dhe mure të tjerë të tërthortë që krijonin zona të njëpasnjëshme mbrojtjeje, koncept ky që njihet dhe në fortifikimet e periudhës së I të hekurit (kalaja e Trajanit).

Në tipin e dytë, qytetin e pllajës dallojmë qytete që zënë kupola kodrash të pjerëta dhe qytete që

21) Dh. Budina Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës, **Iliria**, 1, 1971, 317-319, N. Ceka, Fortifikimi antik i Butrintit dhe i territorit të prasaibëve, **Monumentet** 12, 1976, 33-35.

22) L.M. Ugolini, **L'Acropoli di Butrinto**, Roma, 1942, 26-44, N. Ceka, **po aty**, 27-33.

23) S. Islami, Qyteti Ilir në Zgërdhesh, **Monumentet**, 1, 1971, 23-33. Në këtë nëntip që është dhe më i madhi në numër hyjnë Foinika, Lisi, qytetet në Cakran, Zgërdhesh, dhe fortifikimet në Sarag – rrethi Elbasanit dhe Limar – rrethi i Përmetit.



Fig. 11 a

zenë pllaja të sheshta buzët e të cilave bien në pjerësi të madhe.

Nëntipi i parë është më karakteristik për qytetet e ngritur mbi qëndrat paraurbane. Tipik ndër ta është Skodra, e ndërtuar në një kodër të thepisur shkëmbore (fig. 1) e cila përshkruhet prej Livit si «vendi më i fortë i labeateve, i vështirë për tu afruar, që Genti e kish zgjedhur fortesë të tërë mbretërisë»[24]. Muret e saja ndiqnin vijën rrushkulluese të pjesës së sipërme të kodrës, ndërsa hyrja kryesore gjëndej nga perëndimi ku një qafë e butë e lidhte me terenin përreth.

Nëntipi tjetër në platforma shkëmbore që ngrihen të shkëputura nga tereni përreth është karakteristik për qëndrat e ndërtuara rishmë. Karakteristik për qytetet e hershëm, të shek. V p.e.s. është Nikaia (Klosi) e cila gjëndet në një kodër gëlqerore, me lartësi relative 80 m (fig. 3). Nga tre anë ajo bie me pjerësi të madhe mbi luginat e dy prenjve të vegjël, dhe vetëm nga perëndimi lidhet me një qafë me terrenin përreth. Qyteti, i cili shtrihej në pjesën e sipërme të kodrës, në një sipërfaqe prej 18 ha, rrethohej i tëri me mure, të cilat i përshtaten terrenit duke e ndjekur me mjaft besnikëri vijën rrushkulluese. Muret në anët e pjerëta vijojnë të drejtë deri në 400 m. gjatësi, ose përforcohen me dhëmbëzime të rrallë. Tre kulla shihen vetëm në anën nga qafa, ku sulmi është më i lehtë dhe po në këtë anë gjëndet dhe hyrja e vetme[25]. Zhvillimi i vrullshëm i këtij qyteti në shek. e IV-III p.e.s. solli domosdoshmërinë e zgjerimit të tij. Në këtë rast, për shkak të një sigurie më të mirë, nuk lindi qyteti i hapur, por në kodrën fqinje, veç 1400 m më larg, lind një qytet i ri, Bylisi (fig. 13) i cili jeton në simbiozë me Nikaien duke krijuar kështu rastin e dyqytetëshit. Bylisi që paraqet shembullin e qytetit të fillimit shek. III p.e.s të paraplanizuar dhe të pakushtëzuar nga ndërtimet e vjetra zë rrafshin e një pllaje 28 hektarëshe të një kodre të veçuar shkëmbore, e cila bie me pjerësi të madhe, ose rrëzohet me shkëmbinj të thikët. Muret rrethues ndjekin



Fig. 11 b

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15

vijën rrushkulluese duke i dhënë fortifikimit një trajtë trekëndëshe, por në ndryshim me muret e Nikaies, ato përforcohen nga kulla dhe dhëmbëzime më të shpeshta[26].

Në drejtim të simbiozës midis dy qëndrave rast i mësipërm nuk është i vetmi. Përshkrimi i Polibit për rrethimin e Lisit, ku del se qyteti nuk mund të merej dot pa u marrë Akrolisi dhe se «një sy të vetëm të hidhte njeriu mbi të e do ta kuptonte menjëherë që pushtimi i tij ish një gjë e pamundur[27]» tregon qartë për simbiozën e këtyre dy qendrave, ku Lisi kryente funksionin kryesor, ndërsa Akrolisi i shërbente atij si akropol dhe mbrojtje e sigurt (fig. 14).

Kështjellat. Një mbishkrim i gjetur në fortifikimin e Rabijes në rrethin e Tepelenës i emërton kështjellat peripolje[28] dhe e bën të qartë funksionin e tyre për mbrojtjen e qafave dhe rrugëve të kalimit për në teritorin e fisit. Këto fortifikime që përbëjnë sisteme komplekse për mbrojtjen e vijave të komunikimit, dhe mbrojtjen rrethore të teritoreve, vihen re jo vetëm tek njësitë e mëdha si Amantët ose Bylinët, por edhe në nënnjësitë si Prasaibët ose Argyrinët (fig. 15). Kështu në trevën e Gjirokastrës kryeqendra qarkohet prej një sistemi qytetesh dhe kështjellash, shtojca të mbrojtjes natyrale prej maleve, të cilat kontrollonin rrugët e kalimit në luginë. Krahas mbrojtjes periferike në të vërehet dhe një linjë e brendëshme për kontrollin e rrugës[29]. Përveç tyre një sërë fortifikimesh të ci-

24) Liv. XLIV 31, 2.
25) L. Papajani, **Vep. cit,** 507-519.
26) C. Praschniker, **Muzakhia und Malakastra,** Wien, 1920, 71
27) Polyb. VIII, 13, 3.
28) F. Prendi, **Urbanizimi** 121
29) A. Baçe, Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos, «**Monumentet**» 4, 1972, 106.

DO NOT COPY

Fig. 16 b





Fig. 16 a



Fig. 17



Fig. 18

lat kontrollojnë rrugët dhe krahinat në njësi më të mëdha se ato fisnore, duhen parë si ndërtime të shtetit Ilir.

Kështjellat e reja të kësaj periudhe kanë një sipërfaqe 0,5 – 1.5 hektar. Prej tyre më të voglat janë të destinuara kryesisht për qëndrime garnizonesh, ndërsa të mëdhatë kanë dhe funksion ekonomik. Me përjashtime shumë të rralla (Dorzi rr. e Tiranës) kështjellat nuk paraqesin vazhdimësi si qytetet, por janë ndërtime të reja.

Një tip tjetër, të përfaqësuar dobët në këtë periudhë, por që gjen përhapje të madhe në antikitetin e vonë, paraqet fortifikimi i Malathresë (fig. 16). Fortifikimi me sipërfaqe rreth 0.12 ha ka trajtë kuadratike me dy skaje të mbrojtur prej kullash drejtkëndëshe[30].

Roli i kështjellave si pjesë plotësuese të qyteteve të fortifikuar del i qartë në rastin e simbiozës së Antipatreas (Berati) me kështjellën përballë, atë të Goricës. Të dy fortifikimet gjënden në të dy anët e grykës së fundit e të ngushtë që kalon Osumi para se të dalë në fushën e Gylakut (Myzeqesë). Në të djathtë gjëndet qyteti i Antipatreas që kurorëzon një kodër 187 m të lartë e cila bie thikë në lumë, ndërsa në të majtë në një kodër po kaq të lartë gjendet kështjella e Goricës. Kështjella ka një sipërfaqe rreth 1 hektarëshe dhe trajtë trapezoidale, nga që muret i përshtaten terrenit me brinjë të drejta (fig. 17). Në anën veriore dhe lindore ata i mbështeten shkëmbit duke ja lënë mbrojtjen terenit të thikët. Në anët e tjera muret, të punuar me gjerësi dhe teknikë të njëjtë me atë të Antipatreas, përforcohen dhe prej dy



Fig. 19

DO NOT COPY



Fig. 20

kullash kuadratike, po të njëjta me ato të Antipatreas, ndërsa në mes të anës jugore gjendet hyrja e tipit tangencial. Siç shihet të dy fortifikimet janë të njëkohshëm dhe i përkasin një sistemi të dyfishtë të paraplanizuar, i cili e mbyll plotësisht kalimin nga lugina për në fushë dhe anasjelltas (fig. 18).

Muret barjerë. Muret barjerë të njohur që në prehistori (Zvezdë rr. i Korçës)[31], përfaqësohen vetëm prej murit të Demës (fig. 19). Muri e ndërpret gadishullin e Heksamilit në fillim të tij, në vendin më të ngushtë. Në këtë mënyrë veçohej një sipërfaqe prej 13 km^2 që i përkiste teritorit bujqësor në varsi të drejtpërdrejtë nga qyteti. Gadishulli në veri mbrohej prej murit, ndërsa në anët e tjera qarkohej prej ujrave të detit, liqenit dhe kanalit të Vivarit. Muri 650 m i gjatë niste buzë liqenit dhe përfundonte në anën tjetër rreth 20 m larg buzës së detit duke e shmangur goditjen e drejtpërdrejtë nga anijet. Muri përbëhet prej dy këmishësh dhe mbushjes së mesit me dhe e gurë të vegjël, që përshkohet nga lidhjet e tërthorta. Në këtë mënyrë ai arrinte një gjerësi prej 9,50 metrash që lejonte si kalimin e shpejtë të reparteve ashtu dhe vendosjen e baterive me makina gurëhedhëse[32]. Muri ka një strukturë mjaft të fortë e cila ja kalon mjaft ndërtimeve të tjera bashkëkohëse.

Kullat e veçuara. Prej kullave të veçuara njihet kulla e Vagalatit (rr. Sarandës)[33] (fig. 20, 37), e cila përbëhet prej një muri 24 m të gjatë që përfundon me një kullë drejtkëndëshe 9,50 x 6,50 m. Kulla ka mure 1.20 m të gjerë, të përshkuar në katin e saj të parë prej 3 frëngjish. Në të të fut nga pas një hyrje e vogël. Afër saj, në mur, gjëndet një shkallë e cila të shpinte në shtegun e kalimit të murit dhe në katin e dytë të kullës. Kulla e sipërme shërbente për vrojtimin e luginës së Pavllës duke qënë në funksion të sistemit mbrojtës të Prasaibëve[34].

Teknika e ndërtimit. Muratura me gurë të bashkuar në të thatë mund të ndahet në tre grupe kryesore: me gurë të thyer, me blloqe të latuar në vend dhe me blloqe të parapregatitur. Prej kalimeve nga një grup në tjetrin pa dyshim që rëndësi më të madhe ka kalimi prej muraturës me gurë të thyer në atë me blloqe të latuar. Ky kalim që paraqitet evolutiv dhe jo i prerë dëshmon se faktori i brendëshëm, zhvillimi ekonomiko-shoqëror i pasqyruar në zhvillimin teknik, është faktori kryesor në këtë proces. Më qartë ai kapet në fortifikimet e periudhës tranzitore. Kështu tek muret e fortifikimet të Pepelit shihet synimi për një lidhje më të mirë të gurëve që shprehet nëpërmjet këmbimit të rreshtave me gurë të lartë e të ngushtë me rreshta pllakash të holla e të gjëra (1,5 x 1,2 x x 0,4 m) si dhe synimi për një rrjeshtim horizontal[35]. Në Labovën e Kryqit muret janë ndërtuar me rrasa të mëdha guri gëlqeror (rreth 3 x 2 x 0,3 m) të thyera drejt në anën e jashtme. Në saje të shtresëzimit dhe pjerësisë së terenit rrasat janë nxjerë dhe rrëshqitur lehtë në trasenë e murit, që përbëhet vetëm prej paretit të jashtëm të niveluar nga brenda me dhe (fig. 21). Veç rritjes së stabilitetit mbushja e mësipërme lejonte rrëshqitjen e rrasave drejt e në lartësinë e kër-

30) Dh. Budina, **Harta** ..., 322-323.
31) Gj. Karaiskaj, Fortifikimet prehistorike në Shqipëri, **Monumentet**, 14, 1977, 25.
32) N. Ceka, **Fortifikimi**..., 36.
33) N. Ceka, **Po aty**, 37
34) N. Ceka, **Po aty**, 37
35) A. Baçe, **Vështrim**...., 106-107

DO NOT COPY

INST. MON. KULTURES
BIBLIOTEKA
Nr. INV. 8671



Fig. 21



Fig. 23

kuar si dhe krijimin e një tarace të gjerë në vend të shtegut të kalimit[36]. Në Kalivo dhe Karalibe muret përbëhen prej pareteve prej gurësh të mëdhenj[37] ku vihet re synimi për një lidhje më të mirë të murit dhe bërthamës me gurë më të vegjël (fig. 22).

Në periudhën e dytë të hekurit në sajë të zhvillimit të arritur u bë e mundur heqja dorë nga teknika me gurë të thyer, e cila nuk siguronte një qëndrueshmëri të mirë dhe paraqitje estetike, si pasojë dhe fortifikimet në zonat e thella si në Rosujë (rr. Tro-



Fig. 22

pojës) dhe Symizë (rr. i Korçës) si dhe shtesat e rejasado të vogla në fortifikimet ekzistuese (Ganjollë rr. Shkodrës, faza e III e fortifikimit në Dorz) kryhen me blloqe të latuar. Por kjo nuk përjashton mundësinë që në zonat që mbeten jashtë formacioneve shtetërore, si ajo në rrjedhjen e sipërme të Drinit të Zi, të ketë vazhduar ndërtimi i fortifikimeve me gurë të thyer.

Në grupin e dytë, ate me blloqe të latuar në vend, nxjerja e blloqeve nga kavoja kryhej duke i thyer shkëmbinjtë në masa të çrregullta, pa i kushtuar ndonjë vëmëndje të veçantë formës. Nxjerrja e tyre kryhej në pikat më të larta të rrethimit që ndihmonte në rrafshimin e truallit dhe njëkohësisht lejonte transportimin në drejtim të pjerësisë. Kjo teknikë jepte mundësinë e përdorimit të blloqeve me përmasa mjaft të mëdha deri në 3 x 2,60 m (Foinike) (fig. 23).

Në këtë grup dallohen muret me fuga gjatësore horizontale, me blloqe katërkëndëshe, drejtkëndësh ose trapeze. Tipike në ta janë muret e fortifikimit të Borshit (fig. 24) ku shihet përdorimi i pykave, dhëmbëzimi i fugave horizontale dhe mos shoqërimi me teknikë poligonale edhe në vendet ku terreni është mjaft i thyer. Më tej vijnë muret me fuga gjatësore të çrregullta, me blloqe me trajta të ndryshme rombike, trapezoidale dhe shumëkëndësh që njihet me termin teknika poligonale (Çuka e Ajtoit rr. Sarandës, Seloja rr. Gjirokastrës, Lisi etj.) (fig. 25). Ndërsa nëngrupi i parë ka një kufizim në kohë, i dyti ka një jetë më të

36) A. Baçe, **Po aty,** 106
37) Dh. Budina, **Harta** ..., 325, 303

DO NOT COPY

DO NOT COPY


24


27


25


28


26


29

DO NOT COPY



Fig. 30



Fig. 31

gjatë. Madje kjo muraturë bashkëjeton, ndonse në formë rudimentare, me teknikën izodomike, duke shërbyer kryesisht për kalimin e terreneve të thyer[38] (fig. 29). Muratura e këtij nëngrupi nuk paraqitet e njëjtë në çdo qëndër dhe ndryshon së tepërmi për nga rregullsia dhe mbizotërimi në fasadë i njerës ose tjetrës formë gjeometrike. Një nëngrup tjetër, të përfaqësuar dobët vetëm në Amantie[39], përbën muratura e quajtur lesbike (fig. 26). Muret e sipërm janë punuar me blloqe shumëkëndësh, që në ndryshim prej të tjerëve i kanë faqet të rrafshta. Karakteristikë e kësaj murature që i jep mjaft bukuri ndërtimit, por njëkohësisht kërkon përpikmëri dhe mund më të madh, është punimi i fugave të bashkimit në trajtë të lakuar.

Muratura izodomike paraqet një koncept mjaft më të përparuar: parapregatitjen dhe standartizimin e përpunimit të gurit, proces ky që kërkon dhe profilizimin e ngushtë të specialistëve. Muret e punuar me teknikën izodomike kanë lartësi rreth 0,5 m dhe gjatësi 1-1,5 m. (fig. 28). Në sajë të këtyre përmasave dhe peshës së kufizuar, 0,5 – 1 Ton, transporti i tyre është i mundëshëm dhe kundër pjerësisë së terenit, kështu që gurroret e tyre gjënden dhe në vende larg fortifikimeve. Gurore të tilla janë ajo në shkallë të Konispolit, 3 Km, larg fortifikimit të Mallathresë, dhe e Selcës[40].

Latimi i faqes së jashtëme të blloqeve kryhej me mënyra të ndryshme që në kombinim me formën e tyre gjeometrike krijon një numur të madh varjacionesh. Së pari vjen trajtimi i bymuar i sipërfaqes së jashtëme, i cili krijon një kontrast nëpërmjet efektit dritëhije dhe të ngjall ndjenjën e ashpërsisë e të forcës (fig. 25). Në muraturën izodomike si rregull hasen faqet e rrafshta, që të krijojnë më tepër ndjenjën e qetësisë dhe ekuilibrit (fig. 28). Punimet e mësipërme nganjëherë shoqërohen me një shirit anësor, fillimisht teknollogjik, por që më tej kthehet në element zbukurimi (fig. 27). Në rastet kur ky shoqëron muraturën me faqe të rrafshta, pjesa e mesit shpesh çukitet duke krijuar një kontrast estetik.

Muret e kullave dhe kurtinave në terenet shkëmbore mbështeten mbi shkëmb, i cili në se gjendet në sipërfaqe rrafshohet në pjesën e sipërme. Në rastet kur shkëmbi gjëndet nën nivelin e tabanit ose tabani është i butë, për mbështetjen e pareteve anësorë të mureve ndërtohen themele (fig. 30), ndërsa bërthama lihet e lirë. Themelet kanë thellësi 0.90 – 1.30 m dhe zakonisht janë 0,10 – 0,30 m më të gjerë se muri. Rregullisht mbi themelin vazhdon muri por ka dhe raste kur muri vijon mbi xokolin, i tërhequr pak më në thellësi[41] (fig. 31).

Kurtinat (muret midis kullave). Në shumicën e fortifikimeve kurtinat kanë një gjerësi prej 3,20 – 3,50 m

DO NOT COPY



Fig. 32



Fig. 33

si në fortifikimet e shek. V p.e.s., ashtu dhe në fortifikimet e kapërcyellit shek. IV-III. Rrallë herë kjo gjerësi zbret deri në 2,40 m (Apolloni, Irmaj, Karoq). Në rastet kur muret vijojnë mbi shkëmb shpesh ky i fundit pritet drejt ose me një pjerësi të lehtë. Në këtë mënyrë shkëmbi luan njëkohësisht rolin e bazamentit dhe të kurtinës, duke arritur në Amantie deri në 6 m lartësi (fig. 32)[42]. Muret vijojnë me faqe vertikale, por si përjashtim, në raste të rralla, ata mund të pjerën lehtë ose të shkallëzohen përbrenda (Amantie, Demë)[43] (fig. 19).

Mbushja midis dy pareteve, emplektoni, në muraturën izodomike ku bllokët vijnë të parapregatitura që më parë, përbëhet kryesisht prej dheu (fig. 33), ndërsa në muraturat e tjera në të cilat përpunimi i bllokeve kryhet në vend, ajo përbëhet prej gurësh të thyer të madhësive të ndryshme, të dalë nga përpunimi i bllokeve. Mbushja zakonisht përshkohet prej lidhjeve të tërthorta që i bashkojnë paretet me njeri tjetrin (fig. 34). Synimi për një lidhje të tillë vihet re që në fortifikimet e hershme (Nikae, Çukë e Ajtojt) por ajo është më e qartë në ndërtimet me muraturë izodomike ku krijohen ndarje të zbrazta kuadratike (Zgërdhesh, Antigone, Lekël rr. Gjirokastër, Persqop rr. Tiranës etj.). Kjo strukturë ka një rezistencë të madhe, duke u paraqitur mjaft e qëndrushme ndaj lëkundjeve sizmike dhe goditjeve të makinave. Në një sërë fortifikimesh për arritjen e një qëndrueshmërie më të mirë, ndarjet e tërthorta vazhdojnë jashtë në formë pilastrash (fig. 35) (Amantie, Buthrot, Persqop). Për më tepër në disa fortifikime të punuar me muraturë izodomike muret janë të plotë, me sërë blloqesh (Peshtan rr. Beratit, Lekël etj.).

Në drejtim të materialit të përdorur muret e fortifikimeve ndahen në mure guri dhe mure tulle mbi



Fig. 34

38) A. Baçe, **Vështrim** ... 104
39) S. Anamali, Amantia..., N. Ceka, **Qendrat** ... 24-25.
40) Veçanti e kësaj teknike është se atë e gjejmë me tipare të njëjta në territore që lidhen me një veprimtari të përbashkët ndërtimore si në trevën e Gjirokastrës (A. Baçe **Vështrim** .... 108-9), atë të Amanteve (A. Baçe **Qëndrat** ... 11) etj. Për guroret K. Zheku, Zbulimi i një gurore antike në shkallë të Konispolit **B.U.SH.T.** seria shkenc. shoq. Nr. 1, 1963, 228-231 N. Ceka, qyteti Ilir në Selcën e poshtëme, **Iliria** 2, Tiranë 1972, 198.
41) A. Baçe, Qyteti i fortifikuar në Kaninë, **Monumentet**, 7-8, 1974, 27.
42) N. Ceka, **Qendrat** ... 25
43) N. Ceka, **Qendrat** ... 28, N. Ceka, **Fortifikimi** ..., 36-37.

DO NOT COPY



Fig. 35

xokol guri. Gurët e përdorur janë kryesisht gëlqerorë të Paleogjenit, ranore të triasit dhe brekçe shpati. Prej tyre së pari parapëlqehen gurët gëlqerorë të cilët në saje të shtresëzimit mund të nxiren lehtë dhe kanë rezistencë të madhe, si ndaj goditjeve ashtu dhe agjenteve atmosferikë dhe më tej ata prej formacioni ranor, të cilët nxirren dhe punohen lehtë.

Ruajtja në lartësi të pakët e mureve, dhe në vendet ku nuk ka afërsi nonjë qëndër të banuar, ruajtja e shpeshtë e linjës së drejtë të murit në pjesën e sipërme si dhe përdorimi i qerpiçit në muret e Apolonisë[44] e bën mjaft të mundur praninë e mureve prej qerpiçi mbi xokola guri. Murin me tulla e gjejmë në qytetin Koloni të Apolonisë, me dyshim në Kaninë dhe në ndërtimet e shek. I p.e.s. në Lis[45]. Muri i Apolonisë përbëhet prej xokolit të gurtë 1,90 – 3,20 m të lartë, i cili vijon me shkallëzime sipas terenit, dhe mbistrukturës prej tullash (fig. 36). Muri 2,35 metra i gjerë ka qënë rreth 10 m i lartë. Tullat e përdorura me përmasa 0,46 x 0,46 x 0,08 dhe 0,38 x 0,08 m lidhen me llaç prej argjili të verdhë. Në vendosjen e tyre vihet re ndjekja me rigorozitet e linjave horizontale dhe shkëmbimi i rregullt i fugave vertikale.[46]. Ndonse në fortifikimet greke qerpiçi pati një përdorim të gjerë, në të kundërt përdorimi i tullës njihet vetëm në një qytet, në Olynth për më tepër i kombinuar me mure qerpiçi[47]. Në këtë drejtim përdorimi masiv i tullës së ndërtimit mbrojtëse në Apoloni, përbën një rast unik për tërë botën antike. Kjo tregon pa dyshim për një potencial të lartë ekonomik dhe teknik të Apolonisë dhe se Apolonia e futi në mënyrë masive tullën në ndërtimet mbrojtëse, koncept ky që gjeti përdorim të gjerë në ndërtimet e mëvonshme në perandorinë romake.

Muret e fortifikimeve nuk ruhen të plotë, kështu që përcaktimi i lartësisë së tyre është i vështirë. Të vetmet raste ku dhe mund të nxiren lartësitë janë Buthroti, Lisi dhe fortifikimi në Vagalat (fig. 37, 20). Në Buthrot ruhet shtegu i kalimit 7 m. mbi nivelin e tabanit, duke i shtuar atij dhe 2 metrat e parapetit rezulton se muri në këtë qëndër ka pasur 9 m lartësi. Po kështu duke u nisur nga gjatësia e shkallëve dhe fakti se ato vijojnë me një kënd prej 45°, muret



Fig. 36

44) C. Praschniker – A. Schober, **Archaologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien, 1919.

45) H. Ceka, Muri rrethues i Apolonisë, **B.U.SH.T.** seri shk. shoq. 3, 1963, 117-156, K. Zheku, Restaurimi i portës së brendëshme në qytetin Ilir të Lisit, **Monumentet,** 7-8, 1974, 19.

46) H. Ceka, **Po aty.**

47) Jahrb. d.d. arch. Inst. LIII, 1938, 567.



Fig. 37

e Vagalatit rezultojnë rreth 8 m të lartë. Së fundi për peshimin me plumç muret paiseshin me vija dhe kanale peshimi (fig. 38, 39).

Kullat. Në kapërcyellin e periudhës së parë dhe të dytë të hekurit, për t'ju kundërpërgjigjur teknikës më të përparuar të rrethimit muret mbrojtës fillojnë të paisen me kulla. Ky element i ri paraqet një përfundim llogjik, zbatimi i të cilit kushtëzohej nga teknika e punimit të mureve. Kështu kullat, të cilat mungojnë në fortifikimet e periudhës së parë të hekurit, gjenden në një serë qëndrash të periudhës tranzitore (kështjella në Pepel, në Labovën e Kryqit, fazën e parë të qytetit në Zgërdhesh, fazën e II të Dorzit dhe në Bllacë)[48]. Muret e tyre janë punuar me gurë të mëdhenj dhe një teknikë që jep mundësi për kthesa këndrejta dhe qëndrushmëri mjaft më të mirë se muret e periudhës së parë të hekurit. Megjithëkëtë kjo teknikë nuk siguronte ende qëndrueshmërinë e duhur vertikale, si pasojë kullat duhet të kenë pasur lartësi të njëjtë me kurtinat. Funksionin e vërtetë mbrojtës kullat nuk e fituan as në shekullin e V p.es. Kështu në Nikae në tërë perimetrin prej



Fig. 38



Fig. 39

48) Pepeli A. Baçe **Vështrim** 1... 107, Labova A. Baçe **Po aty** 106, Zgërdheshi S. Islami, **Qyteti** ....27, 31. Bllaca N. Ceka — A. Baçe Vrojtime arkeologjike në rrethin e Pogradecit, luginën e Devollit dhe Shkumbinit, **Monumentet** 3, 1972, 205.

DO NOT COPY



Fig. 40



Fig. 41

1800 metrash të murit rrethues gjënden vetëm 3 kulla, mbi 200 m larg njëra tjetrës (fig. 3). Këto tipare vihen re dhe në Foinike, Çukën e Ajtojt, ku kullat mungojnë tërësisht, dhe në fazën e I të Amanties[49] (fig. 8, 9, 7).

Elemente më me rëndësi se kullat për mbrojtjen anësore të kurtinave në to janë thyerja e linjës së murit dhe traseja dhëmbë-sharre. Nëpërmjet thyerjes linja e murit coptohet në gjij të futur dhe thepa të dalë, veçori që kapen mirë në Foinike (fig. 8). Traseja dhëmbësharre ndiqet mjaft qartë në fortifikimet e shek. të V p.e.s. – fillimit të shek. IV p.e.s. ku ka një përdorim të gjerë. Në Buthrot ajo haset dhe në teren të rrafshët, ku luan rolin kryesor për mbrojtjen anësore të kurtinave (fig. 10), ndërsa në Nikae traseja dhëmbësharre kalon buzë rrëpirës duke lënë para vetes një shteg të ngushtë. Dhëmbëzimet e saja vijojnë çdo 120 metra duke i kundërvënë kalimit të mundëshëm gjatë shtegut ballin e tyre (fig. 3). Rregullsi vihet re dhe në Foinike, ku traseja i kundërvihet pjerësisë duke krijuar çdo 20-30 m ballë rreth 4 m të gjerë (fig. 8). Ky element mbijeton dhe në fortifikimet e fundit shek. IV fillimet e shek. III. p.e.s. (Bylis, Lis, kështjella në Cerie), ku përdoret krahas kullave, por tashmë në një rol të dorës së dytë.

Kthimi i kullave në elementë organike të fortifikimit vihet re në ndërtimet mbrojtëse të shek. IV p.e.s. Në Antipatrea vërehen si në skajet ashtu dhe gjatë linjës së murit kulla të zhvilluara drejtkëndëshe. Zhvi-

49) L. Papajani Vep. cit. fig. 2, L.M. Ugolini, **L'acropoli di Fenice,** Roma, 1932 tab. I, N. Ceka, **Fortifikimi ...** 33-35, N. Ceka **Qendrat ...** 25-27.

DO NOT COPY



Fig. 42

Ilim më të plotë fortifikimi me kulla fiton në ndërtimet mbrojtëse të kapërcyellit shek. IV – shek. III p.e.s. Kështu në Zgërdhesh kullat janë të rreshtuara në dy linja të drejta që ndjekin vijën rrushkulluese në akropol dhe në qytetin e poshtëm (fig. 11). Në linjën e fundit, që shtrihet në teren të rrafshët kullat gjënden 29,5 m larg njera tjetrës (fig. 40), distancë kjo që lejon mbulimin e dyanshëm me goditje anësore ndërsa në akropol ku mbrojtja paraqitet më kompakte kullat gjënden veç 20 m larg njëra tjetrës[50]. Në Lis rrethimi i qytetit të sipërm përforcohet të paktën prej 16 kullash, pa llogaritur kullat e akropolit dhe mbrojtjen prej trasesë dhëmbësharre (fig. 12)[51]. Karakteristike në Lis është mbrojtja e hyrjeve nëpërmjet kullash të jashtëme, të shpërndara në mënyrë që këto të fundit përveç mbrojtjes së hyrjes të mbulonin nga anët dhe kurtinat. Kullat gjënden në thepat e dalë dhe në meset e kurtinave të gjata, 45-70 m larg njera tjetrës. Kjo largësi që nuk lejon mbulimin e dyanshëm të kurtinës si në Zgërdhesh, shpjegohet me pjerësinë e terenit që nuk lejon përdorimin e lirë të makinave të rrethimit. Një tipar, që nuk haset në fortifikimet e tjera, është mbrojtja në Lis me kulla e gjijve të futur, që tregon se flankimi i kurtinave i besohej kullave dhe jo më thepave të vetë kurtinave, koncept ky mjaft i avancuar.

Kullat e fortifikimeve antike në vendin tonë kanë planimetri katërkëndëshe, rrethore, dhe në formë patkoi. Prej tyre shumica ka formë drejtkëndëshe, por në se në fortifikimet e hershme ato nuk janë krejtësisht funksionale, të cekta dhe të pazhvilluara mirë, (në Nikae 7,5 x 2,5 m) (fig. 3). Në fortifikimet e fundit shek. IV, fillimit të shek. III ato marin trajta afërsisht katrore (Lis, qyteti në Zgërdhesh etj.) dhe zhvillohen në dy ose më shumë kate lartësi. Ballët e këtyre kullave në fortifikimet e vogla kanë një gjerësi prej 5 metrash (Malathre), kurse në qëndrat e tjera arrinë deri në 10,5 m (Lis, qyteti në Zgërdhesh) (fig. 40). Dalja nga kurtina në to luhatet në funksion të pjerësisë së terrenit nga 5 në 7 m duke krijuar në brendi ambiente kuadratike. Ambientet e katit të parë janë ose të mbushur për të rritur qëndrushmërinë ndaj goditjeve (Apolloni, Lis), ose të zbrazët për të shërbyer si lokale roje ose magazina (Antipatrea, Zgërdheshi) kështjellat në Hadëraj, Vagalat Mallathre) (fig. 20, 16). Në kullat me ambient në katin e I, muret e tija përshkohen prej frëngjish (Buthrot, Vagalat, Matohasanaj) (fig. 20, 37) ose janë të verbër ndaj anës së jashtëme (Malathre). Frengjitë e kullave kanë



Fig. 43

50) S. Islami, **Qyteti** .... 28.
51) F. Prendi, K. Zheku, Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike, **Monumentet**, 2, 1971, fig. 4.

DO NOT COPY



Fig. 44



Fig. 45

formë pyke me përmasa të jashtme rreth 0,10 x 1 — — 1,5 m dhe të brendëshme 1 x 1 — 1,5 m dhe faqe vertikale (fig. 41).

Tipike për kullat me ambient të zbrazët të katit I, janë kullat e qytetit të poshtëm në Zgërdhesh. Kullat lidhen organikisht me kurtinën e cila shërben dhe si mur i pasëm. Ato kanë balle rreth 9-10 m të gjerë, faqe anësore 7 m të gjata, dhe mure 1,80 metrash, ndërsa ambienti i zbrazët i katit të I të kullës ka përmasa rreth 5 x 5 m[52]. E këtij tipi është dhe kulla në Vagalat (fig. 42).

Në krahasim me kullat drejtkëndëshe, ato me planimetri rrethore kanë një përdorim më të pakët (Apolloni, Lis, Matohasanaj, Zgërdhesh, fig. 43, Cerie). Karakteristike e tyre është se ato gjinden në terrene të rrafshët ose në thyerjen e linjës së murit, duke paraprirë thepa të ngushtë. Kështu në Apoloni dhe fortifikimin në Matohasanaj, në vendet ku thyerja e vijës së murit krijon këndë nën ose rreth 90 gradë, kullat kanë kryesisht planimetri rrethore, ndërsa në meset e kurtinave ose në vendet ku thyerjet kanë kënd të gjerë, planimetri kënddrejtë.

Tipin e kullës në trajtë patkoi e gjejmë në Buthrot në portën me kulla[53]. Kulla 15.50 m e gjatë dhe 8.20 m e gjërë ndahet prej një muri të tërthortë në pjesën e pasme kuadratike dhe në të përparshmen me ballë në formë gjysëm rrethi (fig. 44, 45). Muret e kullës 1 m të gjerë, përshkohen në katin e I prej 5 frëngjish, nga dy në çdo anë dhe një në ballë. Këtë kat e përshkojnë dhe dy hyrje të mbuluara me arkitrarë, e para në murin e pasëm, ndërsa tjetra në murin e tërthortë. Një trajtim i tillë kombinon anët pozitive të kullës drejtkëndëshe dhe rrethore: siguron një mbrojtje anësore të mirë të kullës dhe njëkohësisht, nepërmjet ballit të lakuar, rikosheton goditjet nga makinat gurhedhëse. Këtë tip kulle, thuajse me të njëjtat përmasa e gjejmë dhe në antikitetin e vonë, në kastron fushore të Skampinit[54].

Les courtines (les murs entre les bastions). Dans la plupart des fortifications du Ve av. n.è., comme dans celles concernant la période allant du IVe au IIIe siècle av. n.è., les courtines ont une largeur de 3,20 à 3,50 m. Quand les murs se prolongent au-dessus d'une roche, souvent celle-ci est interrompue directement ou présente une inclinaison légère. De la sorte la roche accomplit à la fois le rôle d'un soubassement et de la courtine, en atteignant de la sorte une hauteur jusqu'à 6 m à Amantie (Fig. 32). Les murs se prolongent à faces verticales, rarement ils sont légèrement inclinés ou échelonnés à l'intérieur (Fig. 19).

Dans les maçonneries isodomiques, où les blocs de pierre sont des éléments préfabriqués, le remplissage du noyau entre les deux parements se fait principalement avec de la terre; tandis que dans les autres murs, où les blocs ont été travaillés sur place, le remplissage se fait avec des petites pierres soit les débris du ciselage des blocs (Fig. 34). En général le remplage est traversé par des liaisons transversales reliant les parements les uns aux autres (Fig. 34). Cette structure offre une grande résistance soit envers les secousses sismiques que les projectiles des angins de guerre. Dans certaines fortifications, afin de leur assurer une stabilité meilleure, les sections transversales se prolongent à l'extérieur sous forme de pilastres (Fig. 35). Par ailleurs, il y a aussi des fortifications en maçonnerie isodomique dont les murs sont pleins, du fait qu'ils comportent une série de blocs.

Le fait que les murs ne sont conservés actuellement qu'à une petite hauteur, et cela à des endroits qui ne sont pas proches d'agglomérations urbaines, le fait aussi que le rectiligne du mur n'est conservé que dans sa partie supérieure ainsi que l'usage du pisé dans les murs d'Apollonie, sont autant d'éléments qui rendent possible l'existence de murs en pisé s'appuyant sur un socle de pierres. Le mur de briques nous l'avons dans la ville colonie d'Apollonie, sa présence n'est pas certaine à Kanine et dans les constructions du Ier siècle av. n.è. à Lis. Le mur d'Apollonie comporte un socle de pierres échelonné selon le terrain et une superstructure de briques (Fig. 37). Large de 2,35 m, il a dû avoir une hauteur d'environ 10 m. Les briques d'une dimension de 0,46 x 0,46 x 0,08 et de 0,38 x x 0,08 m sont liées avec du mortier d'argile jaune. L'usage massif de la brique dans les ouvrages défensifs nous le retrouvons

DO NOT COPY

pour la première fois à Apollonie, ce qui montre que cette ville disposait d'un potentiel économique et technique d'un niveau élevé; par la suite cette technique a connu une large diffusion dans tout l'empire romain.

Les murs des fortifications ne sont pas conservés entièrement, aussi est-il difficile de déterminer leur hauteur. Les seuls cas où il est possible de la faire sont les murs de Buthrot (9 m de hauteur), ceux de Lis et la fortification de Vagalat (6 m) (Figs. 38, 20). Pour mettre à plomb les murs, ceux-ci étaient garnis de lignes et de cannelures. (Fig. 39).

Le tours. – Afin de contrecarrer la technique plus avancée d'encerclement, pendant la première et la deuxième période du fer les murs d'enceinte sont flanqués de tours. Alors que celles-ci manquent dans les fortifications de la première période du fer, nous les retrouvons dans une série de centres de la période transitoire. Leurs murs sont travaillés avec de grosses pierres et selon une technique qui permet de mettre en place des tournants à angle droit et de leur conférer une solidité de beaucoup supérieure à celle des murs de la première période du fer. Malgré cela, cette technique n'était pas encore en mesure de leur assurer la stabilité verticale requise, aussi les tours ont une hauteur égale à celle des courtines. Les tours ne constituent pas de véritables ouvrages défensifs même pendant le Ve siècle av. n.è. Ainsi à Nikae le périmètre de 1800 m du mur d'enceinte ne comporte que 3 tours, à une distance de plus de 200 m l'une de l'autre (Fig. 3). Ces mêmes traits nous les retrouvons à Foinike et à Cukaj e Atoit, où les tours manquent absolument; il en est de même pour la Ière phase à Amantie (Figs. 8, 9, 7).

Dans ces fortifications, en tant qu'éléments plus importants que les tours pour la défense latérale des courtines, nous avons la ligne brisée du mur et son tracé à dents de scie. La brisure de la ligne du mur crée des anses et des saillies, ce sont là des caractéristiques qui sautent à l'oeil à Foinike (Fig. 8). On peut observer clairement la tracé à dents de scie dans les fortifications appartenant au Ve siècle av. n.è. – commencement du IVe, où cette caractéristique est largement présente. A Buthrot ce type de tracé nous le retrouvons même dans la zone plate, où il joue un rôle de premier plan dans le défense latérale des courtines (Fig. 10); à Nikae le tracé à dents de scie longe l'escarpement en laissant devant lui un sentier étroit. Les dentelures se dressent à 120 m de distance l'une de l'autre, en opposant leur face à l'éventuel passage à travers le sentier (Fig. 13). On relève la même régularité à Folnike, où le tracé longe l'escarpement en y créant à chaque 20-30 m des dents d'une largeur de 4 cm. environ (Fig. 8). Cet élément nous le retrouvons même dans les fortifications du IVe siècle-commencement du IIIe s. av. n.è. à Lis, Bylis, dans la forteresse de Ceri^e^, où il est employé de pair aux tours, mais désormais dans un rôle de deuxième ordre.

La conversion des tours en éléments organiques de la fortification s'observe dans les ouvrages défensifs du IVe siècle av.n.è. A Antipatra, aux extrémités comme le long de la ligne du mur il y a des tours à angle droit. La fortification flanquée de tours connait un développement plus complet dans les ouvrages défensifs relevant du IVe-IIIe siècle av. n.è. Ainsi, à Zgerdhesh les tours sont alignées selon deux rectilignes suivant l'isohypse de l'acropole et de la ville basse (Fig. 11). Dans la dernière ligne qui s'étend dans la zone plate, les tours se dressent à une distance de 29,5 m l'une de l'autre (Fig. 40), distance qui garantit une protection bilatérale à l'encontre des attaques latérales. A l'acropole, où la défense se présente plus complète, les tours se dressent à 20 m de distance l'une de l'autre. A Lis l'enceinte de la ville haute est flanquée au moins de 16 tours, sans compter les tours de l'acropole et la défense assurée par le tracé à dents de scie (Fig. 12). Lis se caractérise par le fait que la défense de ses entrées est assurée par des tours extérieures, dont la répartition est faite de façon à protéger latéralement les courtines aussi. Les tours se dressent sur les saillies et au milieu des courtines longues, elles se trouvent à une distance de 45 à 70 m les unes des autres. Cette distance, qui ne garantit pas la protection bilatérale comme à Zgerdhesh, s'explique par l'escarpement du terrain qui empêche l'usage des machines d'encerclement. Un trait que l'ont ne rencontre pas dans les autres fortifications est le fait que les anses sont protégées par des tours, ce qui montre que le flanquement des courtines est confié aux tours et non pas aux saillies des courtines elles-mêmes; c'est là une conception relativement avancée pour l'époque.

Les tours des fortification anciennes ont une planimétrie quadrangulaire, circulaire ou à fer à cheval. La plupart d'entre elles sont de forme quadrangulaire. Et si dans les fortifications les plus anciennes les tours sont encore peu hautes, non bien développées et non pas entièrement fonctionnelles, vers la fin du IVe siècle et le commencement du IIIe elles deviennent quasi quadrangulaires et son édifiées à une hauteur double et même plus grande. Dans les petites fortifications, leur partie frontale est large de 5 m, mais dans certains centres cette largeur atteint 10,5 m (Fig. 40). Le passage de la courtine aux bastions varie de 5 à 7 m en fonction de la déclivité du terrain, en créant de la sorte une pièce quadratique à l'intérieur. Les pièces du premier étage sont ou remplies, afin d'en accroitre la résistance aux attaques de assaillants, ou vides et dans ce cas elles font fonction de salle des sentinelles ou de dépôts (Figs. 20, 6). Dans les tours ayant des pièces au Ier étage, les murs sont pourvus de meurtrières (Fig. 20) ou fermés de l'extérieur.

Par rapport aux tours angulaires, celles à planimétrie circulaire connaissent une plus grande diffusion. Caractéristique est le fait qu'elles sont édifiées dans des zones plates ou sur la brisure de la ligne du mur, en devançant de la sorte les parties en pointe du terrain. C'est ainsi qu'à Apollonie aux endroits où la brisure de la ligne du mur crée des angles de moins du presque de 90°, les tours ont principalement une planimétrie circulaire; tandis qu'au milieu des courtines, ou aux endroits où les brisures constituent un angle plus grand, les tours sont de forme angulaire (Fig. 44).

Le type de la tour à fer de cheval nous le retrouvons à

POKOTOK

Buthrot, dans la Porte des tours. Longue de 15.50 m et large de 8.20 m, celle-ci est divisée par un mur dans sa partie postérieure quadratique et dans sa partie antérieure qui a une façade semicriculaire (Fig. 45). Un traitement semblable réunit les aspects positifs de la tour angulaire et circulaire: il assure une bonne défense latérale à la tour et, dans le même temps, grâce à sa partie frontale courbée, fait ricocher les projectiles des machines de guerre.

Les exemples susmentionnées montrent que la tour circulaire et celle en forme à fer de cheval ne sont pas devenues sur notre territoire un type prévalent comme cela s'est produisit dans plusieurs fortifications contemporaines. Ce phénomène s'explique par le fait que la tour circulaire offre de plus grands avantages dans les parties en saillie et les zones plates, où les machines d'encerclement peuvent s'approcher plus facilement; par contre, dans les terrains escarpés, caractéristique des fortifications anciennes de notre pays, les tours circulaires sont plus appropriées. En effet les tours circulaires font bien ricocher les projectiles des assaillants et créent une défense circulaire complète. Par ailleurs, ayant une largeur égale à celle des tours angulaires, elles ont un périmètre plus petit et une surface encore plus petite, ce qui limite l'intensité du feu des assaillants. En raison de ces qualités, les tours circulaires se dressent principalement par devant les endroits en saillie faisant angle droit, soit précisément aux endroits exigeant une défense circulaire, sans permettre la création de zones mortes et que l'on peut attaquer d'habitude plus facilement avec des projectiles ou des machines d'encerclement.

On rencontre rarement des tours trapézoïdales, qui ne sont qu'une déformation des tours angulaires et des tours triangulaires créées par la dentelure du tracé en dents de scie (Figs. 10, 8).

Enfin les bastions sont représentés par la fortification de Persqop (Fig. 46). Longue de 58 m et large de 7 m, on pouvait installer dans sa partie supérieure une puissante batterie de machines à lancer des pierres pour défendre son côté méridional, qui se prête mieux à l'attaque des assaillants. Tout le bastion haut de 9 m se projette de 7 à 9 m loin de la courtine, alors que dans sa partie orientale se trouve son entré de type tangentiel. Elle comporte deux parois reliées transversalement à 6 m de distance l'une de l'autre, en créant de la sorte des espaces vides de 5 x 6.25 m remplis de terre et de pierres. Afin d'en accroître la résistance et d'assurer une distribution meilleure des charges dynamiques de la batterie, ses sections transversales arrivent jusqu'aux pilastres.

La maçonnerie des tours est analogue à celle des courtines, ou bien une attention moindre est accordée à celle-ci dans les premières par rapport aux secondes. La largeur de leurs murs varie de 1.20 à 1.90 m, donc elle est inférieure à celle des courtines. Par ailleurs, dans la majorité des cas les murs des tours chevauchent les murs des courtines. Ce qui montre que les bâtisseurs avaient en vue le fait que l'écroulement de la courtine aurait entraîné des conséquences graves, permettant à l'ennemi d'entrer à l'intérieur de la fortification; alors que l'écroulement des murs de la tour n'entraîne pas de telles conséquences, du fait que sont entrée est étroite et on peut la fermer facilement. De la sorte les tours font fonction d'amortisseurs aussi, en atténuant la violence du choc quant celui-ci dépasse la limite de résistance, sans toutefois endommager la courtine. Par ailleurs, la section circulaire des tours garantit une résistance plus grande que la section rectiligne des courtines. A la différence des tours mentionnées plus haut en blocs de pierre, celles d'Apollonie sont construites de briques s'appuyant sur un plinthe de pierres. Les parois des murs de briques, qui ont une largeur de 1 m, sont reliées à deux murs de refend de briques qui traversent en s'entrecroisant le remplissage en terre du Ier étage (Fig. 47).

Lorsque le terrain qui s'étend par devant les tours est en pente, celles-ci sont édifiées sur des soubassements qui, à Antipatrea, sont construits avec des blocs de pierre travaillés et échelonnés selon le terrain, et atteignent une hauteur de 1,5 à 2,5 m.

Les étages sont séparés l'un de l'autre par un plancher reposant sur des poutres; tandis qu'à Buthrot, où l'ouverture de la lumière est grande, la poutre longitudinale du plancher s'appuie sur une colonne de pierre (Fig. 46).

Les entrées de cette période sont construites avec un soin de beaucoup supérieur à celui des entrées de la première période du fer. Par suite de l'essor économique qu'ont connu particulièrement les villes, les entrées gagnent en dimension pour permettre le passage des véhicules à roues. Par ailleurs, par suite de l'extension des villes et de la vie intense qui y était menée, on assiste à un accroissement continu des entrées.

Dans les villes les entrées sont aménagées aux endroits les plus propices au passage des personnes et des véhicules, mais qui de ce fait même se prêtent mieux aux attaques des assaillants. Par suite de cette disposition, de leur accroissement en nombre et du perfectionnement continu des machines d'encerclement, les entrées en tant que point plus névralgique de la fortification ont connu une évolution constante afin d'en accroître la capicité de défense. Aussi ont-elles été pourvues d'un couloir intérieur. En général nous les retrouvons en deux types: entrée frontale et entrée tangentielle, mais toujours flanquées de tours extérieures. En ce qui concerne le type frontal, nous pouvons en suivre l'évolution depuis les fortifications préhistoriques; et pour le type tangentiel au moins depuis les fortifications de la période transitoire.

Au début, dans les fortifications de la période du bronze et de la première période du fer (Marshej, Gajtan, Ventrok, etc), les entrées sont constituées par l'interruption de la ligne du mur sur une longeur de 1 à 1,5 m et sur une largeur égale à celle du mur lui-même. Dans les fortifications de la période transitoire de l'âge du fer, les entrées ont connu une évolution plus poussée. Ainsi à Kalivo les entrées sont toujours frontales, mais larges de 2,50 m et pourvues de murs en forme de couloir intérieur dont la largeur est de 7 m (Fig. 50). L'escalier aménagé à leur proximité indique qu'on se servait de ces murs pour attaquer d'en haut les assaillants. Ce même type, de pair aux

DOCTORAT

autres entrées plus évoluées, nous les retrouvons à Foinike (Fig. 51). Les blocs du palier sont placés à environ 3 m de la partie frontale, ce qui montre que les portes d'accès se trouvaient quelque part au milieu du couloir, en laissant ouverte la partie initiale. Les variantes les plus évoluées de l'entrée frontale nous les avons dans les fortifications du IVe siècle, dans la deuxième phase d'Amantie et à Antipatrea où celle-ci acquiert sa forme la plus perfectionnée (Fig. 52). L'entrée principale d'Antipatrea a été aménagée dans un col en pente douce, le seul endroit par où peuvent passer les carrosses. La façade de l'entrée est renfoncée et de ce fait crée par devant elle une cour ouverte. Cette brisure inconditionnée du terrain, plus prononcée sur l'aile droit non protégée des assaillants, met à l'abri la partie frontale de l'entrée des projectiles et permet d'attaquer l'ennemi d'en haut. Cette entrée, à planimétrie quadratique, est traversée au milieu par un couloir. Sa première partie limitait le nombre des assaillants et évitait l'attaque de la porte par les machines d'encerclement; dans la deuxième partie, par contre, il y avait deux portes à deux battants. L'aménagement d'une troisième porte indique que les constructeurs ont renoncé au principe du couloir ouvert et adopté à cet égard une nouvelle conception, consistant à placer face à l'ennemi trois portes consécutives à défoncer pendant qu'il était attaqué d'en haut .

De pair aux entrées frontales, pendant l'antiquité les entrées tangentielles sont assez répandues mais c'est à partir du Ve siècle qu'elles connaissent leur plus grande diffusion. Elles sont construites de façon à ne pas fermer la ceinture des murs, soit en prolongeant leurs côtés parallèlement l'un avec l'autre. De la sorte se crée une espèce de couloir ouvert vers le haut, qui diminue le nombre des assaillants et se trouve sous la surveillance de la courtine intérieure (Figs. 53, 54). En plus ce couloir et la porte sont protégés des attaques de l'ennemi par l'aile du mur extérieur. Le fait d'avoir mis au jour, au milieu du couloir, des éléments du palier à Cuka e Atoit, indique que ce type de fortification avait un couloir divisé en deux parties, dont la première servait à limiter le nombre des assaillants et à défendre la porte des attaques éventuelles de l'ennemi.

Les entrées tangentielles sont aménagées dans des versants escarpés sur le prolongement des isohypses (Figs. 8, 9, 13); à Buthrot, par contre, nous les retrouvons dans la bande de terrain étroite formée par les murs d'enceinte et les eaux du lac (Fig. 10). Ces types d'entrée se trouvent sur le prolongement de la route, entre des courtines longues (Figs. 8, 9, 10), de manière à ce que pour attaquer la porte les machines d'encerclement et les assaillants devaient se porter près de la courtine en étant attaqués d'en haut. Ce type d'entrée, notamment dans les fortifications de la fin du IVe siècle av. n.è., se caractérise par le fait que les constructeurs mettent à profit la défense naturelle du terrain. (Fig. 57).

Ces deux types d'entrée que nous venons d'examiner, ont existé en symbiose l'une avec l'autre et nous les retrouvons même dans les fortifications de la basse antiquité. Le type frontal s'adapte particulièrement aux terrains relativement plats; quant au type latéral, nous le retrouvons dans des terrains où l'assaillant est obligé de longer la courtine. De ces deux types d'entrée une plus grande diffusion a connu l'entrée latérale, du fait que chez nous pendant l'antiquité les fortifications étaient édifiées sur des terrains escarpés.

Pendant les siècles successifs les entrées sont flanquées de tours extérieures, en créant de la sorte un type nouveau. Celui-ci acquiert plus de clarté et devient un élément organique dans les fortifications mises en place au commencement du IIIe siècle av. n.è., ainsi que dans les petites forteresses et les villes de l'époque. Dans les types d'entrée plus avancés, à de rares exceptions près, les tours se dressent sur le côté droit non protégé de l'assaillant et leurs faces font aussi fonction de paroi latérale du couloir. A Lis les entrées ne se ramènent pas à des stéréotypes, mais tout en conservant l'exigence fondamentale, soit le passage à travers des couloirs contrôlés par les tours, elles sont construites de manière à s'adapter au terrain. En conséquence, nous avons à la fois les entrées de type frontal et les entrées de type tangentiel. Typique pour les entrées tangentielles est la Porte ouest (Fig. 58) de Lis, qui est identique à l'entrée nord-est de Bylis (Fig. 59). Le flanc en saillie de sa courtine est devancé par une tour quadratique qui contrôle l'accès à l'entrée, le couloir de celle-ci et, dans le même temps, le flanc extérieur de la courtine. Ces même éléments nous les retrouvons dans sa porte intérieure attribuée au Ier siècle av. n.è., ce qui montre la continuité typologique de cette entrée même à cette époque.

Un type à soi parmi les entrées flanquées de tours est la Porte à tours (Porta me kulla) de Buthrot, édifiée sur un terrain plat (Fig. 45). Ce complexe comporte une tour en forme de fer à cheval, une tour quadratique et un couloir muni de deux portes entre les deux tours. Dans sa partie frontale, il y a une porte coulissante qui se ferme immédiatement, pour empêcher l'entrée des assaillants et les prendre au dépourvu. La deuxième porte, celle située dans la partie postérieure du couloir, était assuré de l'intérieur grâce au mécanisme commandé par la tour en forme de fer à cheval. Quant au couloir, il était commandé aussi bien d'en haut qu'à travers les meurtrières du premier étage des tours.

Outre ces types principaux, on relève aussi une série d'autres solutions comme les entrées dont les parties frontales sont en dentelure (Fig. 60) et les entrées sont pourvues d'un couloir arqué (Fig. 61).

Les traces d'un mur frontal dans l'entrée sud-ouest à Butrint, dans la zone plate de la ville, indiquent qu'au IIIe siècle av.n.è. celle-ci était pourvue d'une cour fortifiée. Cette cour comportait un mur supérieur, dont l'entrée se trouvait à son extrémité et d'autres murs, constituant dans leur ensemble une fortification que l'on ne pouvait attaquer de l'extérieur, mais seulement de l'intérieur (Fig. 10).

A part les entrées grandes, les fortifications sont dotées aussi d'entrées petites servant à la sortie rapide des défenseurs pendant le combat et au déclenchement d'attaques imprévues.

de leur part. Nous retrouvons de telles entrées dans la petite forteresse de Pepel, attribuée à la phase transitoire, ainsi que dans celle de Çuka e Atoit, toutes deux se trouvant l'une à côté de l'autre. Les entrées, couvertes d'architraves de pierre, traversent la largeur du mur en constituant une espèce de couloir ayant la forme de la lettre «Z» (Fig. 68). Cette solution spécifique est rationnelle, du fait que le couloir étroit ne peut être traversé que par une rangée de combattants et sa porte ne peut être attaquée par les assaillants. Généralement les petites entrées sont couvertes d'une architrave de pierre simple. Quant aux deux entrées septentrionales de Butrint, elles se caractérisent par une couverture plus avancée. Celle nord-est est couverte d'un architrave de pierre s'appuyant sur une console arquée (Fig. 53). Dans l'autre entrée, la Porte du Lion, les détails de la couverture sont plus évidents (Fig. 54). Pour une distribution uniforme de la charge, dans les extrémités des architraves ont été placées transversalement deux poutres longitudinales supportant la rangée des poutres transversales. De le sorte au milieu se crée un espace vide qui évite le surchargement du plafond.

En considération de la grande largeur des couloirs des entrées principales, des traces récupérées et et du fait que leur avantage principal consistait dans l'attaque d'en haut de la part de l'ennemi réduit en nombre à cause des dimensions du couloir, il ressort que la plupart des entrées étaient couvertes. Au début la couverture ne concernait que les parties frontales de portes à travers un faux arx (Fig. 64). Dans les dernières fortification du IVe-IIIe siècles av. n.è., le faux arc est remplacé par un arc circulaire authentique (Fig. 65). Au cours de cette période on relève aussi la tendance aux effets esthétiques. C'est ainsi que la partie frontale de la Porte du Lion à Buthrot est surmontée par un architrave large, d'où tire aussi son nom cette entrée (Fig. 66). Il représente un lion en train de dévorer un boeuf, une scène probablement inspirée à quelque relief antique. Il est travaillé seulement sur deux plans, sans passages intermédiaires. Malgré son schématisme, à travers l'effet de lumière et d'ombre cette porte gagne en volume et expression sans perdre son caractère massif et la tranquillité qui se conforme à sa fonction militaire.

Les grandes portes sont généralement dotées d'encadrements massifs de bois, qui sont fixés au palier de pierre où se trouvent les battants de la porte. Dans une série de portes l'encadrement comporte deux parties. A proximité de celles-ci se trouvent les nids où tournent les axes des battants de la porte (Fig. 67). Dans la position fermée, la porte est assurée de dehors à travers un mur dont la partie frontale est arquée ou un bloc massif fixé au milieu de la porte (Fig. 68).

Comme il ressort de l'examen que nous venons de faire, les fortifications anciennes de notre pays occupent une place importante dans le cadre de notre héritage architectonique. S'appuyant sur la traditions des fortifications de la première période du fer, au cours de ces siècles l'art de la fortification a développé davantage cet héritage, sur le plan dialectique sans se détacher cependant des grandes acquisitions contemporaines. C'est précisément sur cette base que s'est développée ultérieurement l'architecture des fortifications mises en place dans les périodes plus récentes.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

FORTIFIKIMET NË SHQIPËRI GJATË PERIUDHËS SË HERSHME TË SUNDIMIT ROMAK

Në prag të pushtimit të Ilirisë nga Roma, Iliria dhe teritori i sotëm i Shqipërisë që përbënte pjesën jugore të saj ishin mbushur me kështjella dhe qytete të fortifikuara në bregdet dhe në brendësi të vendit. Por pas luftës së tretë iliro-romake që përfundoi me rënien e mbretërisë Ardiane dhe pushtimin e Epirit, romakët shkatërruan shumë prej tyre.

Shkatërrimi dhe grabitja vazhduan edhe në shekujt që pasuan për shkak të kryengritjeve dhe revoltave të shumta e të pa ndërprera të fiseve Ilire. Me ngjyra të gjalla na i përshkruan këtë gjendje gjeografi grek i shek. I p.e. sonë Straboni. Ai shkruan ndër të tjera se «gjithë Epiri dhe Iliria ishin të pasura, kurse tani një pjesë e tyre është shkretuar dhe vendet e banuara janë fshatra dhe gërmadha të braktisura»[1]

Shpërngulja e popullsisë nga vendet malore në ato fushore dhe kodrinore që ishte një nga parimet e politikës romake, është dëshmuar edhe nga rezultatet e gërmimeve arkeologjike si dhe nga të dhënat e përfituara nga ekspeditat informative nëpër qëndrat e banuara antike[2]. Disa qendra të fortifikuara pas pushtimit romak, rezultojnë të pa mbrojtura nga mure rrethuese. Kështu p.sh. në Irmaj, në gjysmën e dytë të shek. II p.e.r., kur qyteti kishte hyrë në mvartësinë politike të Romës, duke u përfshirë në provincën Maqedonase, muret mbrojtës të tij nuk kryejnë më funksionin e parë por kthehen në mure perimetrale të një godine[3]. Por rënia në masë e qyteteve antike të fortifikuara dhe degradimi i sistemeve mbrojtës së tyre siç dëshmohet dhe nga Straboni arrihet në mënyrë graduale deri në kapërcyell të erës sonë, pasi edhe mbas disfatës së Gentit dhe Maqedonëve më 168 p.e. sonë, qytetet ilire ruajtën një farë autonomije «që i përgjigjet faktit se romakët nuk ishin akoma në gjendje në atë kohë për të kaluar drejtpërdrejt në një qeverisje të trevës ilire bashkë me gjithë qytetet dhe kështjellat e saj»[4]. Nga ana tjetër në disa qytete kryesore të bregdetit të cilat më vonë u kolonizuan dhe u shndruan në qëndra administrativo-ushtarake të krahinave të caktuara, romakët i ruajtën sistemet mbrojtëse dhe që herët vendosën garnizone në to, me kalimin e kohës u ndërmorën punime plotësuese fortifikimi ose u riparuan muret e vjetër. Gjatë shekullit I të e.sonë në bregdetin shqiptar kishte katër qytete koloni si Buthroti (Butrinti), Bylis (Hekali), Dyrrahu (Durrësi), Skodra (Shkodra) dhe municipiumi i Lisit (Lezha). Në rrethin e interesave strategjike të Romës përfshihej dhe qyteti i vogël i Orikut (Pashaliman) si dhe Apollonia.

Pikërisht në disa nga këto qytete takojmë gjurmë ndërtimesh mbrojtëse që datohen në shekujt e parë të periudhës së pushtimit romak. Kryesisht rreth gjysmës së dytë të shek. I p.e.r. dhe gjysmës së parë të shek. I të e.sonë.

Kjo ishte një periudhë kur teritori i Shqipërisë u bë shesh lufte midis pretendentëve romakë për pu-

---

1) Strab. **VII, 7, 10.**

2) Shih për këtë Gj. Karaiskaj, **Një varrezë e shek. III-IV në qytetin Ilir të Zgërdheshit,** Iliria 7 (në shtyp) dhe literaturën e cituar në të për këtë problem.

3) F. Prendi – Dh. Budina, **Kalaja e Irmajt,** Iliria II, 1972, 29,

4) F. Condurachi, **Disa aspekte të politikës romake në trevën ilire në shek. I të e.sonë,** Kuvendi I, i studimeve ilire II Tiranë 1972 (1974) 157.

DO NOT COPY



Fig. 1

shtet Cezarit dhe Pompeut dhe kur kryengritje të mëdha tronditën rëndë pushtetin romak dhe e detyruan atë të marë masa vendimtare për të ruajtur sundimin në këto treva. Ndër këto masa sigurisht ka qenë dhe kujdesi për mbrojtjen e garnizoneve dhe qyteteve koloni.

Në Butrint janë hetuar gjurmë të konsiderueshme ndërtimesh mbrojtëse të këtyre periudhave[5]. (Fig. 1).

Në tërësinë e sistemit mbrojtës të Butrintit, të krijuar e të plotësuar në periudha të ndryshme historike, muret e periudhës së hershme të pushtimit romak duke gjykuar nga traktet dhe gjurmët e ruajtura, zinin pjesën e lartë të qytetit që mund ta quajmë dhe qytet i sipërm. Ato ndiqnin linjën jugore të këtij rrethimi të ndërtuar mbi një terren shkëmbor të aksidentuar, murin që zbriste prej tij nga verilindja deri tek Porta e Liqenit si dhe linjën e murit antik verior nga Porta e Liqenit në drejtim të Portës së «Luanit».

Nga qyteti i poshtëm i periudhës antike, që zinte një rrip të ngushtë nga ana jugore rrëzë qytetit të si-

5) Gj. Karaiskaj, **Fortifikimet e Butrintit nga shek. I p.e. deri në shek. VI të e.sonë,** Kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor me rastin e 30 vjetorit të themelimit të Muzeut Arkeologjik, Tetor 1977.



Fig. 2

përm u veçuan pjesa verilindore e tij nga një mur që zbriste prej këtij të fundit dhe bashkohej me murin ekzistues në perëndim të portës me kulla (Fig. 1).

Në muret mbrojtës të kësaj periudhe dallohen disa teknika ndërtimi. Muri rrethues i qytetti të poshtëm i cili shtrihet në anën jugore të qytetit dhe përshkohet nga «Porta me kulla» në kohën romake ka qenë përdorur në gjendjen e parë dhe vende vende është riparuar me teknikën egzistuese. Nga gërmimet e kryera gjatë dy viteve të fundit (1976-1977) prej Dh. Budinës[6] është vërtetuar se muri rrethues i qytetit të poshtëm nuk rrethonte po atë sipërfaqe të periudhës helenistike por ndërpritej në skajin jugperëndimor duke u mbyllur me një kullë katërkëndëshe në dy të tretat e gjatësisë së tij. (Fig. 1, M).

Kulla me përmasa 7 x 5 m është ndërtuar me blloqe guri të ripërdorur të mara nga ndonjë ndërtim tjetër. Blloqet janë vendosur mbi njeri tjetrin pa përdorur ndonjë mjet lidhës duke ruajtur të njejtën teknikë të mureve të periudhës helenistike. Por ajo që e daton këtë kullë në periudhën e pushtimit romak janë disa mbishkrime të gdhendura në gurët që formojnë paretet e saj. Mbishkrimet përfaqësojnë dekrete lirimi skllevërish dhe datohen në shek. II-I p.e.s. në anë tjetër gurët në të cilët ato janë egzekutuar duken qartë se nuk i përkasin kullës para gdhëndjes së mbishkrimeve, por një ndërtimi tjetër i cili është prishur për të përdorur materialin për ndërtimin e kësaj kulle[7]. Ky fakt e afron më tepër datimin e kullës pasi nuk mund të mendohet që ndërtesa u prish menjëherë pas egzekutimit të mbishkrimeve gdhendja e të cilëve ka vazhduar dhe ajo për një kohë relativisht të gjatë.

Një teknikë tjetër e njohur me emrin «Opus quadratum» është përdorur në murin jugor të qytetit të sipërm. Faqet e jashtëme të mureve në këtë rast janë veshur me gurë të mëdhenj të prerë në forma drejtkëndëshe të vendosura në rreshta horizontale, ndërsa brendësija e murit është ndërtuar nga gurë të vegjël të thyer të përzjerë me llaç të bollshëm. Kjo teknikë është përdorur dhe në Romë e në krahinat rreth saj që nga fundi shek. II p.e.s. deri në periudhën e parë të sundimit të Augustit[8].

Përveç teknikës «Opus quadratum» (punim kuadratik) e cila në pamjen e jashtëme të krijon përshty-



Fig. 3

6) Dh. Budina, **Raport mbi gërmimet e viteve 1976-1977** në arkivin e Qendrës së Kërkimeve Arkeologjike, Tiranë.

7) F. Drini–Dh. Budina, **Vështrim mbi disa mbishkrime të reja të zbuluara në Butrint,** Sesion shkencor i Q.K.A, 24-26 Nëntor 1978.

8) G. Lugli, **La tecnica edilizia romana,** Roma 1957, 315.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

pjen e një muri antik me blloqe guri të latuar të vendosur në të thatë, në Butrint në këtë periudhë janë përdorur edhe teknika të tjera që zënë në mure një vëllim të konsiderueshëm. Teknika më e përhapur është ajo e realizuar në faqet e jashtëme të mureve me pllaka guri me gjatësi 40-50 cm. dhe lartësi 10-14 cm të vendosura në rreshta paralele e të lidhur me shtresa të gjëra llaçi (opus vitatum) (fig. 2, 3). Shpesh herë këtë teknikë e takojmë të kombinuar me mure të veshur në faqet e jashtëme me gurë të vegjël kubikë të vendosur sipas një aksi diagonal (opus reticulatum) (fig. 4). Muret e ndërtuar me teknikën e mësipërme arrijnë në një lartësi prej 10 m. Të kësaj kohe janë edhe dy bastione drejtkëndëshe të cekta pranë «Portës së Luanit» që kanë një faqe ballore të gjerë (fig. 5). Duke gjykuar nga teknika e ndërtimit dhe rrethanat historike muret mbrojtëse të periudhës së pushtimit romak në Butrint, të para në tërësi datohen nga mesi i shek. I p.e.r. deri nga mesi i shek. I të e.sonë, duke patur ndryshime kronologjike nga më të hershmet tek më të vonat sipas radhës së përshkrimit të mësipërm. Gjatë periudhës së fundit të sundimit të Cezarit, kur për herë të parë vendosen në Butrint kolonë ushtarakë (viti 45-44 p.e.sonë) duhet të jenë ndërmarë punimet në muret rrethuese të qytetit të poshtëm dhe më vonë riparimet dhe rindërtimet kanë vazhduar gjatë periudhës së sundimit të Augustit. Nga gjithë sa u thanë mbi ndërtimet mbrojtëse të Butrintit për periudhën në shqyrtim, kuptohet se ishte treguar një kujdes i veçantë për mbrojtjen e këtij qyteti dhe se ai ishte një qendër e rëndësishme ushtarake dhe ekonomike për krahinat bregdetare jugore të Shqipërisë. Kjo mund të dëshmohet me fakte të sigurta së paku për periudhën e zhvillimit luftrave civile të Romës në teritorin e Shqipërisë. Vetë Cezari në veprën e tij «Luftat civile» shkruan se «kishte shkuar për të shtënë në dorë me një legjion, disa qytete të largëta dhe për të rregulluar furnizimin e ushtrisë, sepse ishte ngushtë me ushqime pasi këto ndodheshin në Buthrot»[9]. Cezari duke parashikuar se lufta me Pompeun do të zgjatej dhe duke mos shpresuar në furnizimet nga Italia kish dërguar gjithashtu dy nga komandantët e tij në Epir për të marë drithra[10]. Dhe me të vërtetë në një fshat pranë Butrintiti i cili me emrin e tij Qesarat, të kujton Cezarin, janë zbuluar kohët e fundit hambare të kohës romake që shërbenin për depozitimin e drithit. Hambaret paraqiteshin në trajtën e Pitosave (qypa) të mëdhenj të gdhendur në

9) Caes. Bell. civ. III, 16
10) Caes. Bell. civ. III, 40, 4.

DO NOT COPY

shkëmbin natyral nën nivelin e sipërfaqes së tokës[11]. Gjatë luftës midis Cezarit dhe Pompeut përveç qyteteve të fortifikuara të bregdetit si Apolonia, Orikumi, Durrësi etj. gjeti përdorim edhe ndonjë kështjellë në brendësi të vendit e cila kishte rëndësi strategjike si p.sh. «Opidum Parthinorum», ku Pompeu kishte vendosur një garnizon dhe Cezari e pushtoi në rrugë e sipër duke shkuar për në Asparag[12].

Gjurmë ndërtimesh fortifikuese të periudhës romake ruheshin deri në dekadat e para të shekullit tonë edhe në Orik, i fundit që i pa ato ishte arkeologu L.M. Ugolini. Gjatë vizitës së tij në këtë qytet antik ai thotë se pa «aty këtu trakte të shkëputura muresh me tulla të një epoke romake të pa përcaktuar mirë[13].

Por gati një gjysmë shekulli më parë arkeologu francez L. Hezej pati hetuar gjurmë mjaft më të rëndësishme fortifikimi në këtë qytet. Ai thotë se qyteti ishte ndërtuar dhe fortifikuar më shumë shije. Traseja e rrethimit kishte një formë ovale ku muri helenik më i vjetër ishte rindërtuar më vonë me tulla e llaç. Një rrethim të veçantë krijonte gjithashtu akropoli, i cili ndodhej në majë të kodrës dhe ndahej në dy pjesë nga një mur i brendshëm[14].

Siç del nga përshkrimi i Hezejt, Oriku ka qenë mbrojtur nga një mur rrethues me tulla të vendosura mbi një xokol gurësh të punuar ashtu si në Apoloni dhe në Lis. Po të dhënat që disponojmë nga Hezej për teknikën e ndërtimit të mureve, tani të zhdukur janë të pamjaftueshme për të dhënë një mendim të saktë rreth kohës së ndërtimit të tyre. A. Baçe i daton këto mure në shek. IV-VI të e.s. duke sjellë si argument se në kohën e Cezarit kur ishte i mundshëm ndërtimi i tyre pasi nuk përdorej teknika me tulla e llaç gëlqereje[15], kur ajo është përdorur që nga fundi i shek. II p.e.r.[16]. Në një farë mase do të na ndihmonin në këtë rast burimet historike. Sipas dëshmisë së Tit Livit në verë të vitit 214 kur Filipi V i Maqedonisë sulmoi Orikumin, ai e pushtoi atë me lehtësi, «mbasi qyteti ishte në shesh dhe nuk kishte as mure, as roje dhe as armë të forta»[17]. Por kur Cezari zbarkoi në Iliri, Orikumi ishte plotësisht i fortifikuar. Kjo kuptohet qartë nga shprehja e tij se komandanti i qytetit Luc Torkuati që kishte aty garnizonin e parthinëve «mbylli portat dhe u mat të mbronte qytetin»[18]. Kështu del vetiu koha e ndërtimit të mureve mbrojtës të Orikumit gjatë shek. II deri në mesin e shek. I p.e.r. Por në se janë muret me tulla të kësaj periudhe apo i përkasin një kohe më të vonë, këtë nuk mund ta themi me siguri. Sidoqoftë disa veçori të teknikës së ndërtimit si përdorimi në masë i tullave dhe i llaçit si lidhës nuk i çojnë ato më herët nga shek. I p.e.r.

Lisi ishte një nga qytetet antike të vendit tonë që u rifortifikua me porosi të Cezarit. Në veprën e tij mbi luftat civile Cezari shkruante se «këshilli i qytetarëve romakë që kishte në dorë Lisin, qytet të cilin ua kishte besuar më parë Cezari ..... ishte përkujdesur ta fortifikonte». Kjo e dhënë historike u vërtetua plotësisht nga gërmimet arkeologjike[19] dhe më vonë nga punimet restauruese që u kryen në muret rrethues të këtij qyteti[20]. Këto ndërtime i përkisnin një muri tërthor që ndante pjesën e sipërme të qytetit. Krijimi i një territori të mbrojtur brenda qyteteve të pushtuar për sigurimin e garnizonit ka qënë një praktikë e njohur për romakët. Kështu Apiani na njofton se dhe në qytetin Segesta (Iliria veriore) Cezari ndan një vend të veçantë për garnizonin që përbëhej prej 25 njësish[21]. Muri ndarës i Lisit apo «Muri i brendëshëm» siç e kanë quajtur autorët e gërmimit, kishte një gjerësi prej 1.80 m dhe ishte ndërtuar me blloqe gurësh të latuar të prerë në formë trapezoidalë. Gurët janë vendosur në të thatë pa përdorimin e ndonjë mjeti lidhës duke formuar rreshta deri diku horizontalë (fig. 6). Faqet e murit lidhen me bërthamën nëpërmjet blloqeve të gjata prej guri të vendosura në drejtim tërthor me gjatësinë e murit. I gjithë ky konstruksion që arinte sipas terrenit një lartësi prej 1-3,5 m shërbente vetëm si një bazament për të mbajtur mbi vete një mur tullash. Muri me tulla kishte një gjerësi prej 1,75 duke u futur për arsye estetike pak më brenda bazamentit prej guri. Tullat kishin përmasat rreth 0,48 x 0.48 x x 0.08 m ose sa gjysma e këtij formati dhe lidheshin me shtresa të holla llaçi balte. Krejt muri në anën e jashtëme arrinte një lartësi prej 8,5 – 9 m.

11) K. Zheku **Një zbulim i ri në fshatin Qesarat të Sarandës,** (dorëshkrim).
12) Caes. **Bell. civ.** 41, 1.
13) M. Ugolini, **Albania Antica,** Vol. I Roma – Milano 1927, 105.
14) L. Heyzey – H. Daumet – **Mission archeologique de Macedoine,** 404.
15) A. Baçe, **Qendrat e fortifikuara të gjirit të Vlorës në antikitet,** Monumentet 10, 1975, 7.
16) Shih citimin 25.
17) T. Livi, **Ab Urbe condita,** lib. XXIV, 40, 1.
18) Caes., **Bell. civ.** 11, 2
19) F. Prendi, K. Zheku, **Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike** Monumentet 2, 7-18.
20) K. Zheku, **Restaurimi i portës së brendëshme në qytetin ilir të Lisit,** Monumentet 7-8, 1974, 7-21.
21) Appian, **Illyrike,** 24.

Botuar

DO NOT COPY



Fig. 6

Muri i brendëshëm i Lisit përshkohej edhe prej një porte e cila lidhte qytetin e sipërm me qytetin e poshtëm.

Mure mbrojtës të ndërtuar me tulla mbi një bazament guri, të cilat ngjasojnë së tepërmi me ato të Lisit janë zbuluar edhe në Apoloni. Apolonia vazhdoi të jetë një qytet i madh e me rëndësi edhe gjatë periudhës së pushtimit Romak. Ciceroni e quan atë «magna urbs et gravis» (Cic. phil. XI, 26) (Qytet i madh e hijerëndë) ndërsa në kohën perandorake Apolonia ishte qendër universitare ku studjonin aristokratët e rinj romakë.

Duke u shtrirë në një zonë ku mungonte guri për ndërtim muri rrethues i qytetit i është nënshtruar një grabitje sistematike dhe për një kohë të gjatë, kështu që vetëm pak trakte janë zbuluar prej tij. Një pjesë e murit të zbuluar ndodhet në afërsi të Akropolit dhe është ndërtuar me tulla mbi xokolaturë guri. Këtu arkeologu H. Ceka ka dalluar tre periudha ndërtimi. Në fazën më të hershme tullat lidheshin midis tyre me llaç balte ndërsa në periudhën më të vonë me llaç gëlqereje[22]. Krejt muri është ndërtuar mbi një xokol të ndërtuar me gurë të punuar me forma drejtkëndëshe dhe arrin në një lartësi prej 4-5 radhë gurësh. Xokoli është ndërtuar me shkallëzime që shkojnë sipas linjës së pjerrët të terrenit. Gurët e xokolit kanë një lartësi mesatare prej 0.40 m. Tullat e murit të fazës së parë të lidhur me një shtresë të hollë balte kanë këto përmasa 0,38 x 0,38 x 0,008 m. Në vazhdim të këtij muri dhe mbi të njëjtin xokol vazhdon një fazë tjetër ndërtimi në një gjatësi prej 54 m, formati i tullave ndryshon dhe është 0,46 x 0,46 x 0,08 m duke u lidhur me një llaç të dobët (baltë e verdhë e sterpikur me llaç gëlqereje ku në disa pjesë të murit është përdorur gjerësisht edhe llaçi i gëlqeres). Në këtë pjesë të murit të tërheq vëmëndjen një kanal që mblidhte dhe shkarkonte ujrat e shiut jashtë rrethimit. Kanali përbëhet nga gryka, lugu dhe një hauz ujëmbledhës i ndërtuar me gurë të latuar. Mendohet se kanali i përket një periudhe më të vonë ndërtimi, për ndërtimin e të cilit është prishur një pjesë e murit dhe është rindërtuar me të njëjtin material por duke përdorur si lidhës këtë rradhë shtresa llaçi gëlqereje deri diku të trashë[23].

Me mure tulle të lidhur me llaç është ndërtuar dhe një kullë drejt këndëshe me përmasa 6,10 x x 3,50 m e cila ruhet në një lartësi 4,30 m.

Për të tri fazat e ndërtimit që përmëndëm më lart është dhënë mendimi për një datim respektiv në shek. IV p.e.r. (periudha I) fundi i shek. III ose fillimi i shek. II p.e.r. (periudha e dytë) dhe aty nga shek. I p.er. për periudhën e tretë (kanali)[24]. Dy nga argumentat kryesore teknike që sjell H. Ceka për datimin e murit me tulla të periudhës së parë të ndërtimit në Apoloni në shek. IV p.e.sonë, janë formati i tullave 0,38 x 0,38 x 0,07 – 0,08 tipike helenistike dhe përdorimi i llaçit të baltës për lidhjen e tyre dhe jo ai i gëlqeres. Përsa i përket llaçit të baltës ai është përdorur rëndom në banesa të periudhës romake dhe rasti më kuptim plotë është ai i fortifikimit të Lisit që datohet në mesin e shek. I p.e.s. Edhe në Greqi llaçi i gëlqeres si material lidhës u përdor nga fundi i shek. II p.e.r. fillimi i shek. I p.e.r. në shtëpitë e Delosit dhe të Theras, ndërsa para kësaj kohe, me përjashtim të ndërtimeve në kontakt me ujin, përdoret argjili pa gëlqere për të lidhur gurët e zakonshëm[25]. Tani le të shohim se si qëndron puna me përdorimin e tullave në Apoloni. Tulla të formatit të murit të Apolonisë janë gjetur gjatë gërmimeve arkeologjike edhe në konstruksionin e vareve të kësaj qëndre. Ato i përkasin periudhës helenistike kur vazhdonte të përdorej edhe qerpiçi[26] kjo tregon se tulla e pjekur nuk ishte bërë akoma një material i rëndomtë ndërtimi. Në anë tjetër në Apoloni është zbuluar

22) H. Ceka, **Muri rrethues i Apolonisë,** B.U.SH.T. seria shk. shoq. 1963, 3, 117-156.
23) H. Ceka **Vep. cit.** 131, 140
24) H. Ceka, **Vep. cit.** 151-153
25) A. Orlandos, **Les matériaux de construction et la technique architecturale des anciens Gréece,** vol. I, Paris 1966, 135.
26) A. Mano, **Nekropoli i Apolonisë – Tuma I (Gërmime të viteve 1958-59),** Iliria I, Tiranë 1971, 198.

një mur i ndërtuar me tulla të formatit 0,38 x 0,38 x x 0,07, i cili është datuar nga lënda arkeologjike në shek. II-I p.e.r.[27]. Ky fakt konfirmon mundësinë e përdorimit të këtij tipi tullash edhe në këtë periudhë relativisht të vonë. Edhe në botën antike tulla e pjekur bëhet masive në kohë të vonë. Në Greqi përdorimi i tullës së pjekur u fut nga Mesopotamia ku shembulli më i hershëm i përket fillimit të shek. III, ndërsa në vetë Greqinë nuk gjejmë ndërtime me tulla përpara fundit të epokës helenistike[28]. Gjithashtu në Itali deri në shek. II p.e.r. qenë përdorur vetëm tulla të papjekura, ndërsa tulla e pjekur me gjithëse u përdor në Romë në periudhën e Sulës (138-78 p.e.r.) nuk u bë e zakonshme deri në kohën e Jul Cezarit[29]. Sidoqoftë në Apoloni po ti referohemi konstruksionit të varreve kemi një nga shembujt më të hershëm të përpunimit të tullave por ato nuk mund të jenë më të hershme se fundi i shek. III ose fillimi i shek. II p.e.r.

Duke patur parasysh ngjashmërinë aq të madhe të mureve të Apolonisë me ato të Lisit si dhe shembuj të tjerë të përdorimit të tullave në botën antike dhe brenda vetë Apolonisë do të mendonim për një kohë mjaft më të vonë ndërtimi të mureve rrethuese të këtij qyteti.

Nga burimet historike nuk mund të nxiret diçka me rëndësi që do të na ndihmonte për datimin e këtyre mureve por mund të përmëndim dy fakte që sidoqoftë lidhen drejtpërdrejtë me ndërtimet mbrojtëse.

Në vitin 214 Filipi V tentoi të pushtonte Apoloninë por pasi u fut përpjetë lumit me 120 anije dhe e pa se puna ishte më e vështirë se sa shpresonte, ju drejtua Orikut të cilin e mori me sulmin e parë[30]. Megjithëse Apolonia ishte e mbrojtur me mure, pasi mbahej e rrethuar nga Filipi, Apoloniatët kërkuan ndihmë mbasi nuk do të mund ti qëndronin dot fuqisë Maqedone[31]. Por kur Filipi ndërmori një sulm tjetër kundër Apolonisë rreth vitit 205, pasi shkatëroi tokat përreth, e pa veten të pa fuqishëm përpara mbrotjeve të qytetit dhe u detyrua të tërhiqet[32]. Në qoftë se janë ndërmarë punime mbrojtëse midis këtyre dy datave, ato mund të kenë qënë ndofta ndërtimet me tulla të periudhës së parë. Kjo do të ishte data më e hershme e ndërtimit të tyre.

Nga mesi i shek. I p.e.r. me një herë pas zbarkimit të Cezarit në brigjet e Himarës (Palasë). Apolonia u vu dhe një herë para provës së rrethimit. Sundimtari romak i qytetit Luc Staberi po sa mori vesh se Cezari po afrohej, urdhëroi të sillnin ujë në kështjellë, ta fortifikonin atë dhe njëkohësisht kërkoi pengje nga apoloniatë[33], por këtë radhë apoloniatët nuk pranuan të ipnin pengjet dhe dërguan delegatët tek Cezari për dorëzimin e qytetit. Ky fakt historik është marë si një dëshmi e sigurtë se Apolonia në këtë kohë ishte një qytet i pambrojtur dhe se vetëm akropoli mund të kryente një funksion të tillë[34].

Nuk përjashtohet mundësija që disa pjesë të murreve rrethuese të qytetit të mos ishin në gjendje të mirë, por shkaku kryesor i vendimit të komandantit romak për tu mbrojtur në akropol, ishte mos besimi i tij tek Apoloniatët, se do të rrezikonin për hir të rivalitetit të konsujve romakë. Ky mosbesim u duk qartë në kërkimin e pengjeve tek Apoloniatët.

Gjithashtu ndërtimi i murit të ri ndarës në Lis, pas riparimit të mureve rrethuese të qytetit kishte këtë qëllim. Pas pushtimit të Apolonisë Cezari e bëri atë një nga bazat kryesore ushtarake kundër Pompeut. Gjatë disa veprimeve luftarake kundër këtij të fundit nga repartet që le Cezari për mbrojtjen e qyteteve bregdetare që ia kishte shtënë në dorë ishin 4 kohorta në Apoloni 1 në Lis dhe 3 në Orik[35]. Me këtë rast mund të jenë bërë disa riparime në muret rrethuese të Apolonisë siç mund të jenë ato të periudhës së dytë të mureve mbrojtës me tulla. Kështu do të kishim një datim nga fundi i shek. III deri në mesin e shek. I p.e.r. për periudhën e parë të ndërtimit. Mesin e shek. I p.e.r. për periudhën e II dhe gjysmën e dytë të shek. I p.e.r. deri nga fillimi i shek. I të e.s. për periudhën e III të ndërtimit.

Për periudhën në shqyrtim njohim nga të dhënat historike si dhe nga gjurmët në teren edhe një tip tjetër fortifikimi që u aplikua në teritorin e vendit tonë. «Fortifikimin fushor» apo të «Përkohshëm». Këto ishin kampe të fortifikuar të legjioneve romake të ndërtuara nga të dy palët ndërluftuese, gjatë luftave midis ushtrive të Cezarit dhe Pompeut. Kampet e fortifikuara të romakëve kishin për qëllim të siguronin dislokimet e legjioneve të tyre nga ndonjë sulm i befasishëm kur ato ndodheshin në afërsi të armikut

POROTOMIA

27) S. Islami, **Gërmimet në Apoloni dhe Orik gjatë vitit 1958,** BUSHT, seria shk. shoq. 1, 1960, 63.
28) A. Orlandos, **Vep. cit.,** 67.
29) N. Davey, **A history of building materials,** London 1965
30) T. Livi, **Ab urbe condita,** XXIV, 40, 1
31) T. Livi, **Po aty.**
32) T. Livi, **XXIX, 12**
33) Caes., **Bell. Civ.** 46, III, 2
34) N. Ceka **Muri rrethues...,**
35) Caes., **Bell civ.** III, 78.

sidomos gjatë natës. Ato kishin trajtën e një katërkëndëshi dhe formoheshin nga një hendek dhe një gardh druri.

Ndërtime të tilla mbrojtëse me karakter të përkohëshëm njihen që nga kohë mjaft më të lashta. Ato u përdorën veçanërisht me sukses nga Pirrua i Epirit gjatë luftave në Itali. Për këtë arsye historiani Romak Tit Livi thotë, duke i vënë këto fjalë në gojën e Hanibalit se «ai (Pirrua) ishte i pari që i mësoi të tjerët si të vendosin lëmin»[36].

Vendosja e parë e kampeve të Cezarit dhe Pompeut u bë sipas G. Fajt pranë fshatit Kuç të rrethit të Lushnjës në dy brigjet e lumit Seman[37]. Por gjurmë të fortifikimeve Fajti pati konstatuar kryesisht në kampin e Pompeut në krahun e djathtë të lumit. Kampi kryesor ndodhej në kodrën e Çukës, ku gjurmët e një ledhi ruheshin në gjysmën e lartësisë së saj[38]. Përveç kampit kryesor Fajti konstaton edhe disa fortifikime më të vogla rreth tij si p.sh. mbi kodrën me lartësi 93 në jug të vëndit të quajtur «Kosova e Vogël» ku shihej një ledh i qartë e plotësisht i mbyllur që i korespondonte në çdo pikpamje planit të një kampi. Por ndërtimet më të rëndësishme provizore u realizuan gjatë betejës së madhe rreth Durrësit. Kjo betejë midis Cezarit dhe Pompeut u zhvillua në zonën kodrinore që shtrihet në juglindje të qytetit midis luginës së Erzenit dhe fushës së Kavajës. Gjurmë të sigurta të një kampi të Cezarit, Fajti zbuloi mbi një kodër në veri të rrjedhës së sipërme të Shmilit. Fortifikimi formonte një planimetri ovale të çrregullt me gjatësi rreth 200 m. dhe gjerësi 100 m. Nga ana e veriut nga pritej sulmi ledhi ishte më i lartë[39]. Dy fortifikime të tjera ndodheshin në anën jugore të linjës së mbrojtjes së Cezarit pranë prroit të Gesniqes, njeri në lartësinë 44 dhe tjetri mbi një kodër më në lindje. Ky i fundit kishte formë katërkëndëshe të shtypur pak në mes dhe ndiqte konturin e terenit.

Ledhi dallohej me qartësi të madhe në të gjitha anët e sidomos nga perëndimi. Ky fortifikim, mendon Fajti, shërbente për vendosjen e pjesës kryesore të rezervës. Këtë përfundim të sugjeronte jo vetëm pozicioni i tij në vendin e kalimit nga zona kodrinore në fushë por dhe pamja e gjerë që ai të ofronte[40]. Midis dy fortifikimeve të para, atij të vendosur pranë kodrës së Arapajt nga veriu dhe prroit të Geaniqes nga Jugu, kalonte vija e mbrojtjeve të Cesarit që kapte një gjatësi prej rreth 20 km. Prapa kësaj linje mbrojtjeje Cezari kishte ndërtuar një rrugë qarkullimi për furnizimin dhe manovrimin e forcave. Kufiri jugor i frontit të Cezarit formohej nga një linjë dyfishe. Distanca midis dy ledheve paralele ishte 178 m. Profili i ledhit të brendëshëm ishte veçanërisht i fuqishëm. Gjerësia e kanalit ishte 4,5 m ndërsa gjerësia dhe lartësija e ledhit 3 m. Përmasat e ledhit të jashtëm ishin më të vogla. Nga ana e detit ekstremiteti i kësaj linje dyfishe ledhesh, kish filluar të mbyllej me një ledh tërthor i cili gjatë kohës së betejës së dytë me Pompeun kish mbetur i pa përfunduar[41].

Në vargun e kodrave që shtriheshin rreth 1 km. në perëndim të frontit të Cezarit shtrihej fronti i Pompeut që kishte një gjatësi prej 15 km.

Në majat e kodrave ai kishte vendosur 24 pika mbrojtje në intervale prej çdo 900 m të cilat quheshin «Castellum» ndërsa Cezari për gjatësinë e frontit të tij duhet të kishte 30 pika të tilla.

Nga shqyrtimi i ndërtimeve mbrojtëse të periudhës së hershme të pushtimit romak në Shqipëri, mund të nxiret përfundimi se ato ishin të pakta në krahasim me fortifikimet pararendëse, se konsistojnë në rindërtimin dhe plotësimin e fortifikimeve ekzistuese dhe se tradita vendase çfaqet e fuqishme. Kjo e fundit duket qartë sidomos në xokolaturën e murit ndarës të Lisit e sidomos në formulimin e hyrjes e cila nuk ndryshon nga hyrjet e tjera të qytetit. Por në këtë periudhë u dukën edhe përparime në drejtim të teknikës së ndërtimit. Ndër to kryesorja ishte përdorimi i llaçit për lidhjen e gurëve të mureve si dhe përdorimi masiv i tullave për ndërtimin e mureve mbrojtës, në një shkallë të tillë që ata nuk qëndrojnë më pas ndërtimeve bashkëkohore të botës antike greko-romake.

36) Livi, **XXXV,** 14, 9
37) G. Veith, **Der Feldzug von Dyrrahchium zwischen Caesar un Pompeus,** Wien 1926, 1920, 98 e vazhd.
38) G. Veith, **Vep. cit.** 103.
39) **Po aty,** 148.
40) G. Veith, **Vep. cit.** 155.
41) Po aty, 166.

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

LES FORTIFICATIONS EN ALBANIE PENDANT LA PREMIERE PERIODE DE LA DOMINATION ROMAINE

RESUME

A la veille de l'occupation de l'Illyrie par Rome, l'Illyrie et le territoire de l'Albanie actuelle qui en constituait la partie méridionale étaient parsemés de forteresses et de villes fortifiées soit le long de la côte qu'à l'intérieur du pays. Mais à la suite de la troisième guerre illyro-romaine, qui entraîna le déclin du royaume des Ardiens et l'occupation de l'Epire, les Romains détruisirent plusieurs d'entre elles.

Comme il ressort, certains centres fortifiés ne sont plus protégés par des murs d'enceinte après l'occupation romaine. Ainsi par exemple à Irmaj, dans la deuxième moitié du IIe siècle av.n.è., alors que cette ville était passée sous la dépendance politique de Rome, en devenant partie intégrante de la province de la Macédoine, ses murs d'enceinte ne remplissent plus leur fonction originale et font partie des murs périmétriques d'un édifice. Le déclin en masse des anciennes villes fortifiées et la dégradation de leur système de défense, c'est là un phénomène qui s'est réalisé graduellement jusqu'au commencement de notre ère, car, même après la dfaite de Gent et des Macédoniens en 168 av. n.è., les villes illyriennes continuaient à conserver une certaine autonomie. Par ailleurs, dans les principales villes côtières, successivement colonisées et converties en des centres administratifs-militaires des régions respectives, les Romains conservèrent les système de défense et y installèrent dès le début des garnisons, en effectuant avec le temps des travaux complémentaires de fortification ou en y réparant les murs. Pendant le Ier siècle av. n.è., il y avait sur la côte albanaise quatre villes-colonies, soit Buthroti (Butrint), Bylis (Hekal), Dyrrah (Durrës), Skodra (Shkodra) et le municipium de Lis (Lezha). La petite d'Orik (Pashaliman) ainsi qu'Apollonie aussi rentraient dans la sphère des intérêts stratégiques de Rome.

C'est précisément dans certaines de ces villes que nous relevons des traces de constructions défensives datant les premiers siècles de l'occupation romaine, et notamment la période allant de la deuxième moitié du Ier siècle av. n.è. à la première moitié du Ier siècle de notre ère.

Il s'gait là de la période lorsque le territoire de l'Albanie devint un champ des batailles que César et Pompée se livrèrent pour s'assurer le pouvoir et de grandes insurrections secouèrent gravement le pouvoir romain, en le contraignant à prendre des mesures radicales pour conserver son pouvoir dans ses contrées. Assurément, du nombre de ces mesures fait part aussi le soin montré par Rome à défendre ses garnisons et ses villes-colonies.

A Butrint ont été identifiées plusieurs traces de constructions défensives relatives à ces périodes.

Dans l'ensemble du système des défenses de Butrint, mis en place et complété dans diverses périodes historiques, les murs relevain de la première période de l'occupation romaine, à un juger de leurs tronçons et des traces qui y sont conservés, occupaient la partie haute de la ville que nous pouvons dénommer aussi ville haute. Ils suivaient la ligne méridionale de cette ceinture, construite sur un terrain escarpé, et comportaient le mur descendant de sa partie Nord-Est jusqu'à la Porte du Lac ainsi que l'ancien mur septentrional allant de la Porte du Lac en direction de la Porte du «Lion».

En ce qui concerne la ville basse pendant l'antiquité et qui occupait à l'époque une bande étroite dans la partie méridionale au bas de la ville, on a pu identifié sa partie Nord-Est à travers un mur qui allait rejoindre le mur existant actuellement à l'ouest de la porte flanquée de tours.

Les murs de cette période se caractérisent par diverses techniques de construction. Le mur d'enceinte de la ville basse, qui s'étend dans la partie méridionale de celle-ci et est traversée par la «Porte à tours», était employé pendant l'époque romaine à son état initial bien qu'il ait été réparé par endroits selon la technique existante. Des fouilles effectues ces deux dernières années (1976-1977) par Dh. Budina, il ressort que le mur d'enceinte de la ville basse ne cernait pas la même surface pendant la période hellénistique, mais était interrompue à son extrémité S.–O. par une tour quadrangulaire se dressant sur les deux tiers de sa longueur.

Cette tour d'une dimension de 7 x 5 m. est construite de blocs de pierres prélevés d'une autre construction. Les blocs sont disposés les uns au-dessus des autres ans aucun liant, selon la technique de la période hellénistique. Mais les éléments qui attribuent cette tour à la période de l'occupation romaine sont

DO NOT COPY

les inscriptions gravées sur les pierres constituant son parement. Ces inscriptions représentent des décrets d'affranchissement d'esclaves datant les IIe – Ier s. av. n.è.; par ailleurs, il est évident que les pierres sur lesquelles sont reproduites ces inscriptions n'appartiennent pas à la tour, mais ont été prélevées d'une autre construction. Ce fait rapproche davantage la datation de cette tour, car on ne peut admettre que cet édifice ait été démoli immédiatement après l'exécution des inscriptions, dont la gravure s'est prolongée pendant une période de temps relativement longue.

Une autre technique, connue sous le nom d'«Opus quadratum», nous la retrouvons dans le mur méridional de la ville haute. En l'occurence ses parements sont revêtues de grosses pierres, taillées à angle droit et disposées en rangées horizontales, tandis que sa partie intérieure est rempie de petites pierres cassées et mélangées avec baucoup de mortier. Cette technique a été employée à Rome et dans les contrées qui lui sont voisines depuis la fin du IIe siècle av. n.è. jusqu'à la première période de la domination d'Auguste.

A part la technique «Opus quadratum», qui apparemment donne l'impression d'un mur antique avec des blocs de pierres taillées et mis en place selon la technique dite sèche, pendant cette même période nous relevons à Butrint d'autres techniques qui ont été employées sur une vaste échelle. La technique la plus diffuse est celle réalisée sur les parements des murs à travers des plaques de pierre, ayant une longueur de 40 à 50 cm. et une hauteur de 10 à 14 cm. et qui sont disposes en rangées parallèles et liées avec des couches abondantes de mortier (Opus vitatum). Souvent cette technique nous la retrouvons en combinaison avec des murs dont les parements sont revêtus de petites pierres cubiques disposées selon un axe diagonal (Opus reticulatum). Les murs édifiés selon cette technique ont une hauteur allant jusqu'à 10 m. A cette même époque se rapportent aussi deux bastions à angle droit peu profonds à proximité de la «Porte du Lion». Selon leur technique de construction et vu les circonstances historiques, il ressort que les murs d'enceinte de Butrint, relatives à la période de l'occupation romaine et prises dans leur ensemble, appartiennent à une période de temps allant de la moitié du Ier siècle av. n.è. jusqu'à la moitié du IIe siècle de notre ère, compte tenu évidemment des différences chronologiques depuis les plus anciens aux plus récents selon l'ordre de la description faite plus haut. C'est pendant la dernière période de domination de César, alors que pour la première fois des colons militaires furent établis à Butrint (an 44-45 av. n.è.), qu'ont été effectués des travaux dans les murs d'enceinte de la ville basse; quant aux réparations et aux travaux de reconstruction, ils appartiennent à la période de domination d'Auguste. De tout ce que nous venons de dire sur les défenses de Butrint pendant la période objet de cette étude, il ressort qu'une grande attention a été consacrée à la défense de cette ville et que celle-ci fut à l'époque un important centre militaire et économique pour les régions côtières méridionales de l'Albanie. Cela est attesté par des faits sûrs au moins pour la période concernant les guerres civiles de Rome sur le territoire de l'Albanie. César lui-même, dans son ouvrage «les Luttes civiles», écrit qu'«il était allé avec une légion pour s'emparer de certaines villes lointaines et pour régler le ravitaillement de l'armée, du fait qu'elle manquait de vivres parce que ceux-ci se trouvaient à Buthrot». Et en effet dans un village à proximité de Butrint, dont le nom Qezarat rappelle celui de César, ont été découverts récemment des greniers de l'époque romaine qui servaient à conserver des céréales. Ces greniers, sous formes de grands pythos, sont creusés dans la roche au-dessous du niveau du sol. Pendant la guerre opposant César à pompée, outre les villes fortifées côtières comme Apollonie, Oricum, Dyrrah, etc., les bélligérants se servirent aussi de quelque forteresse à l'intérieur du territoire, qui avait de l'importance stratégique, comme par exemple Opidum Parthinorum, où Pompée tenait une garnison et dont César s'empara chemin faisant vers Asparag.

Des traces de fortifications de la période romaine existaient même à Orik jusqu'aux premières décennies de notre siècle. Le dernier qui eut l'occasion de les voir a été l'archéologue L.M. Ugolini. Après avoir visité cette ancienne ville, il écrit avoir relevé «çi et là des tronçons détachés de murs de briques d'une époque romaine non bien définie».

Mais presque un demi siècle avant Ugolini, l'archéologue français L. Heuzey avait identifié des traces assez importantes de fortifications dans cette ville. Il affirme que la ville avait été construite et fortifiée avec beaucoup de goût. Le tracé de la clôture était de forme ovale, l'ancien mur hellénique ayant été reconstruit plus tard avec des briques et du mortier. Une enceinte à soi constituait aussi l'acropole, qui, surplombant une colline, était séparée en deux par un mur intérieur.

De la description de Heuzey il ressort qu'Orik était protégée par un mur de briques assises sur un socle de pierres travaillées, comme à Apollonie et à Lis. Mais les données qui nous sont fournies par Heuzey quant à la technique de construction des murs, désormais disparus, sont insuffisantes pour avancer une opinion exacte sur leur date de construction. A. Baçe attribue ces murs aux IVe-VIe siècles de notre ère, en partant de la thèse que leur construction ne peut pas se rapporter à l'époque de César en raison du fait qu'on n'y employait pas la technique de construction avec des briques et de la chaux, alors que celle-ci était effectivement en usage dès la fin du IIe siècle av. n.è. En l'occurence référons-nous aux sources historiques. Selon le témoigne de Tite-Live, pendant l'été de l'an 214 Philippe V de Macédoine attaque Oricum et s'empara facilement de cette ville, «du fait que celle-ci se situait sur un terrain plat, manquait de gardes et d'armes puissantes». Mais lorsque César débarqua ses troupes en Illyrie, Oricum était complètement fortifiée. Cela se comprend facilement de ses paroles, quand il écrit que le commandant de la ville, Luc Torquat, qui y tenait une garnison de Parthins, «ferma les portes et essaya de défendre la ville». Il va de soi donc que la période de construction des murs d'enceinte d'Oricum embrasse la période allant du IIe à la moitié du Ier siècle avant n.è. Mais quant à la question de savoir si les murs de briques appar-

tiennent à cette période ou à une période plus récente, cela nous ne pouvons pas l'affirmer avec certitude. Quoi qu'il en soit, certaines particularités de la technique de construction, entre autres l'usage en masse des briques et du mortier en tant que liant, ne font pas remonter la datation de ces murs à une période antérieure au Ier siècle av. n.è.

Lis est une des plus anciennes villes de notre pays, qui a été fortifiée à nouveau sur recommandation de César. Dans son ouvrage sur les guerres civiles, César écrit que «le conseil des citoyens romains qui avait en main Lis, ville qui leur avait été confiée précédemment par César,..., pris soin de la fortifier». Cette donnée historique a été entièrement confirmée par les fouilles archéologiques et plus tard durant les travaux de restauration effectués aux murs d'enceinte de cette ville.

Des murs d'enceinte édifiés avec des briques sur un socle de pierres, très semblables à ceux de Lis, ont été mis au jour à Apollonie aussi. Apollonie continua d'être une grande ville importante même pendant l'occupation romaine. Cicéron l'appelle «magna urbs et gravis» (Cic. phil. XI, 26), alors que pendant la période impériale Apollonie a été un centre universitaire où venaient faire leurs études les jeunes de l'aristocratie romaine.

S'étendant dans une zone où manque la pierre de construction, le mur d'enceinte de cette ville a été l'objet d'une rapine systématique, et cela pendant une longue période de temps; ce qui explique le nombre restreint de tronçons qu'ou a pu mettre à jour dans ses environs. Une partie du mur découvert à proximité de l'Acropole est de briques assises sur un socle de pierres. C'est ici que l'archéologue H. Ceka a distingué trois périodes de construction. Dans la première phase les briques sont liées avec de la glaise et dans la dernière avec du mortier de chaux. Tout le mur repose sur un socle de pierres travaillées à angle droit. Les briques de la première phase, liées avec une couche fine de glaise, ont une dimension de 0,38 x 0,38 x 0,08 m. Puis sur le prolongement de ce mur, et au-dessus du même socle, vient une deuxième phase de construction qui s'étend sur une longueur de 54 m; la forme des briques n'est plus la même, elles ont une dimension de 0,46 x 0,46 x 0,08 m et sont liées avec un mortier faible (glaise mélangée légèrement à du mortier de chaux, mais dans certaines parties du mur on relève un usage abondant de mortier de chaux).

Même une tour à angle droit d'une dimension de 6,10 x x 3,50 m, conservée actuellement jusqu'à 4,30 m, comporte des murs de briques liées avec du mortier.

Quant aux trois phases de construction dont il a été question plus haut, H. Ceka les attribue respectivement au IVe siècle av. n.è. (la Ière période), à la fin du IIIe siècle ou le début du IIe siècle av. n.è. (IIème période) et au Ier siècle av. n.è. (IIIème période). Les deux principaux arguments avancés par H. Ceka, quant à la datation du mur en briques de la première période de construction à Apollonie au IVe siècle av. n.è., consistent dans le format des briques 0,38 x 0,38 x 0,07 — 0,08 qui est typiquement hellénistique et l'usage du mortier de glaise et non de la chaux et tant que liant. Quant au mortier de glaise, il est largement employé dans les habitations de la période romaine et le cas le plus typique est celui de la fortification de Lis datant la moitié du Ier siècle av. n.è. En Grèce de même le mortier de chaux, en tant que liant, a été employé de la fin du IIe siècle au commencement du Ier siècle av. n.è. dans les maisons de Délos et de Theras, alors qu'avant cette période, à l'exception des habitations en contact avec l'eau, on ne se servait que de la glaise sans chaux en tant que liant. Maintenant examinons la question de l'usage des briques à Apollonie. Des briques, ayant un format analogue à celui du mur d'Apollonie, ont été mises au jour pendant les fouilles archéologiques dans les tombeaux de cette cité aussi. Elles appartiennent à la période hellénistique, alors qu'on continuait à se servir encore du pisé, ce qui montre que les briques cuites n'étaient pas encore devenues un matériau de construction habituel. Par ailleurs, à Apollonie on a mis au jour un mur construit de briques ayant un format de 0,38 x 0,38 x 0,07 et datant, selon les matériaux archéologiques, les IIe-Xe s. av. n.è. Ce fait confirme la possibilité d'emploi de ce type de briques même au cours de cette période relativement récente. Dans le monde antique aussi l'usage de la brique cuite ne connaît une diffusion massive que dans les derniers temps. En Grèce les premières constructions de briques cuites n'apparaissent qu'après l'époque hellénistique, en Italie après le IIe s. av. n.è.. L'usage des briques cuites ne devient habituel que pendant le règne de Jules César. A Apollonie notamment, si nous nous rapportons à la construction de ses tombeaux, on ne retrouve les premiers exemplaires de constructions en briques cuites que vers la fin du IIIe siècle ou le début du IIe siècle av. n.è.

Compte tenu de la grande ressemblance des murs d'Apollonie avec ceux de Lis et des autres exemples de l'usage des briques dans le monde antique et à Apollonie même, nous serions enclins à attribuer les murs d'enceinte de cette ville à une période encore plus récente, allant depuis la fin du IIIe siècle à la moitié du Ier siècle av. n.è. quant à la première période de construction, la moitié du Ier s. av. n.è. pour la IIème période et la deuxième moitié du Ier s. av. n.è. — le commencement du Ier siècle de notre ère pour la IIIème période de construction.

De l'examen des constructions de défense relevant de la première période de l'occupation romaine en Albanie, on peut dégager la conclusion qu'elles étaient numériquement inférieures par rapport aux constructions précédentes, qu'elles consistaient principalemet en des travaux de reconstruction et de réparation des fortifications existantes et que la tradition locale était puissante à l'époque. Celle-ci apparait clairement surtout dans le socle du mur de refend à Lis et dans la formulation de son entrée, qui ne se différencie pas des autres entrées de la ville. Par ailleurs, au cours de cette période on relève des progrès quant à la technique de construction. A noter surtout l'emploi du mortier comme liant pour les pierres des murs ainsi que des briques dans la construction des murs d'enceinte, et cela à un niveau que ceux-ci ne le cèdent en rien par rapport aux constructions contemporaines du monde antique gréco-romain.

DOWNLOAD

DO NOT COPY

Sotir KOSTA

DO NOT COPY

RESTAURIMI I MOZAIKËVE TË MESOPOTAMIT DHE BYLISIT

Të dy mozaikët për të cilët do të flitet në këtë shkrim me pak ndryshime ruajnë ende një histori të heshtur për vehten dhe më gjerë për vendndodhjen në kuadrin e diapazonit arkitektonik të zhvilluar në kohë prej kur u ndërtuan dhe u rindërtuan aqëherë. Njëri bën pjesë në kompleksin ndërtimor monumental të manastirit të Shën Kollit në Mesopotam të rrethit të Sarandës, kisha e të cilit është bërë e njohur mirë dhe zë vend të rëndësishëm në historinë e arkitekturës shqiptare. Tjetri ndërkaq vjen nga Bylisi një truall edhe më i lashtë e i dëgjuar në botën ilire për kulturën dhe veçoritë dalluese të zhvillimit të urbanistikës qytetare, i njohur bashkë me fqinjën më në jugë fare pranë tij Nikaean (Klosin), për ndërtimet e bukura dhe artin e gdhendies në gur dhe derdhjet e holla në bronz, të figurinave e monedhave.

Mozaikët e Mesopotamit dhe të Bylisit tërhoqën vëmendjen tonë për shkallën e dëmtimit që kërkonte ndërhyrje të menjëherëshme dhe sepse ata, sidomos të dy panelet e Mesopotamit, bëjnë pjesë në grupin e mozaikëve me interes të veçantë studimor.

Shkaku i çvendosjes erdhi gjithashtu edhe për arsye të caktimit të tyre për tu ekspozuar në Muzeun e artit mesjetar, Sidoqoftë njëherazi shkaku kryesor mbetet shpëtimi i tyre, por që më tej do të dojë medoemos kërkime në truallin ku gjëndeshin, në ambjentet pranë, gjithashtu duke ç'fletuar historinë për të nxjerrë në dritë fakte të rinj të jetës, zhvillimit të artit të mozaikut bashkë me gjini të tjera njëkohësisht të përhapura dhe aqë shumë të pëlqyera në trevën e lashtë iliro-shqiptare.

Çvendosja dhe transportimi i këtyre mozaikëve për në laboratorin e restaurimit u kryen në kushte jo të zakonshme e të favorshme klimaterike. Ekspeditës i'u desh të provojë çvendosjen e mozaikëve në muajin Nëntor kur temperatura e ambientit nuk i kalonte të 15°. Përpilimi i dokumentacionit për të dy këta raste u



Fig. 1

kryen në përputhje me kriteret e njohura duke rezervuar në çdo rast mundësinë e plotë të rikthimit të mozaikëve në vendndodhjen para çvendosjes.

Mozaiku në Kishën e Manastirit të Shën Kollit në Mesopotam (rrethi i Sarandës).

Pak kilometra më në lindje të Finiqit të lashtë e të dëgjuar në botën e qytetërimit ilir, mbi një kodër të bukur të gjelbëruar që përqafet nga ujët e kulluar të Bistricës (Fig. 1) ish ndërtuar një manastir i fortifikuar qysh në mezin e dytë të shek. VI erës sonë[1]. Brenda këtij rrethimi u ngrit një kishë e cila ish konceptuar të qëndronte ndryshe nga të tjerat (të njohura në Shqipëri), me volume të rënda e të fuqishme, por ndërkaq të hijshme në proporcione si brenda dhe jashtë. Brënda, harqet, qemeret e kollonat

1) A. Meksi – **Arkitektura e kishës së Mesopotamit** «Monumentet» 3/1972, faqe 47-88.



Fig. 2

e gurta me kapitele mbanin mbi vehte katër kupolat, dy nga të cilat, ato të anës lindore, më të larta, duke krijuar mirë e bukur hapësira të mëdha, plot frymëmarje. Hapësira e brendëshme merte dritë nga sipër prej dritaresh të lartuara në grupe tek faqet e kupolave dhe treshe të përngjitura në faqet e mureve anësore. Kësisoj me dritë të kursyer mernin formë sipërfaqet e pikturuara me afreske dhe tërë ornamentika me gur e dru brenda saj. Jashtë, muratura me gurë të ripërdorur, të mëdhenj e të vegjël, tulla vende vende e vënë si e kërkonte dekori keramoplastik karakteristik i kohës, sidomos në dritaret e fundet e çative, krijonte një gjendje qetësie e madhështie, në vetvehte. Sipërfaqet e mëdha të ftohta e të hirta, me atë dekor të improvizuar në gur e tullë të vëna në harmoni me siluetat e mëdha arkitektonike e bëjnë këtë ndërtim të ruajë vlera të veçanta e të rëndësishme. Rindërtimet e herëpasherëshme e kanë sjellë monumentin në një pamje të dyshimtë që të josh për ta çliruar, pastruar me kujdes nga elemente ndërtimorë të vonëshëm për ta parë e kujtuar si të ish në kohën e lulëzimit të saj më të përkryer, që «të imagjinohet madhësia e tij e dikurshme dhe të kuptohet rëndësia e tij jo vetëm për historinë e arkitekturës bizantine tek ne, por edhe për arkitekturën bizantine në përgjithësi»[2]. Nga kjo pikpamje është me rëndësi rimarja e punimeve të restaurimit mbi bazën e sondazheve të hollësishme për ta çliruar në raportin ndërtimor arkitektonik të kohës së vet, me një shtrirje më të gjërë në truallin ku hodhi shtat, dhe një vështrim studimor në thellësi e gjerësi sipas problemeve. Kështuqë bashkë me këto çështje të ndërthurura aqë më tepër kërkojnë spjegime edhe mozaikët, edhe skulptura dekorative e aplikuar sa kohë bëjnë pjesë në tërësinë arkitektonike të këtij manastiri. Ato padyshim po ashtu mbartin vlera të konsiderueshme arti. Është karakteristik bashkëjetimi qoftë i skulpturës dekorative në gur, qoftë i mozaikut e afreskut kur dalëngadalë nga lashtësia në mesjetë përgjithësisht dekori plastik i a lëshon gjithënjë e më shumë vendin mozaikut, afreskut, se pra kalohet gjithnjë e më shumë nga arti që mbush ambientin gjithënjë e më shumë nga arti që mbush ambientin në mënyrë plastike në artin që formon ambientin në planimetri[3]. Siç duket vërejmë tek kjo kishë si dhe tek ndonjë tjetër, praninë e disa gjinive njëherazi qoftë edhe sikur jo në masën e përkryer, të përdoren duke përmbushur në një farë shkalle kërkesat e stilit të kohës brenda fizionomisë së veçantë të krijuar në ruajtjen edhe të aspiratave të mjeshtrave që i krijuan. Mozaiku i kishës së Manastirit të Shën Kollit në Mesopotam gjendet jashtë kishës, në dyshemenë e hajatit, të shtruar me pllaka të mëdha guri (afërsisht 1 m x 1 m), në qoshin veri lindor të tij (Fig. 2).

2) A. Meksi – **vepra e cituar** – faqe 88.
3) **H.P. L'Orange und P.J. Nardhagen** «Mozaik» Von der Antike bis zum Mittelalter – faqe 1.

DO NOT COPY

Në fakt tani kanë mbetur dy panele të veçuara që edhe për nga përmbajtja ndryshojnë. Që të dy duke i vështruar në tërësinë planimetrike të kësaj dyshemeje nuk krijojnë një përfytyrim estetik kompozicional të ndërtuar mbi kritere simetrike të parastudjuara. Nuk mund të përcaktohet tërësia e elementeve zbukurues sa kohë që prania e të shtruarit me pllaka guri në këtë dysheme sidoqoftë nuk është e parë e menduar bashkë me mozaikun, ndryshe do të parapëlqeheshin së toku duke caktuar për seicilin vendin dhe rolin që do të luante. Prandaj edhe lind ideja se mbase të ketë ndodhur më vonë shtrimi me pllaka duke lënë me vetëdije të ekspozuar të dy panelet që janë dashur të qëndrojnë me kishën bashkë me të cilën edhe u krijuan. Ato çfaqen si simbole të njohura të artit bizantin edhe pse të trashëguara që më parë. Kanë mbetur edhe pak fragmente gurësh mozaiku po në këtë dysheme në qoshin perëndimor aqësa na njoftojnë për shtrirjen e dekoracionit në një pjesë të madhe të sipërfaqes në mes, në të tërën, por që sot për sot është krejtësisht e pamundur të rindërtohet ajo dhe mbetet të meremi posaçërisht me dy panelet e ruajtura sigurisht pa ju ndarë lidhjes së tyre në raport me elementet e tjerë të pranishëm e që do të kenë mundësi të dalin nga sondazhet në të ardhmen.

Paneli i mozaikut më në lindje të kishës është ndërtuar në një sipërfaqe rreth 1 mx 0,90 m afërsisht në mesin e gjerësisë së hajatit (portikut). Me të është vizatuar me ngjyra të kursyera gurësh më të mëdhenj nga 1 cm^2 të prerë pakujdes me daltë, me sa duket një skenë e eukaristisë. Katër gjela me një kupë në midis të orientuara veri jugë (Tab. I/a, b). Me gjelat dhe kupën, me këta elementë kompozicionale të kursyera është ndërtuar një skenë tepër dinamike, e freskët dhe e plotë në shpërndarjen e volumeve dhe mjeteve shprehëse dekorative. Me këtë kompozim të thjeshtë ata janë vendosur në katër qoshet e sipërfaqes me lëvizje të matura, të veçuara në dy grupe, lart e poshtë.

Grupi poshtë që mbahet si bazë e kompozimit është në një lëvizje. Dy gjelat janë vizatuar lirshëm, gjithë elegancë e vija të stilizuara me kujdes duke dhënë me një nga këmbët e ngritura një gjendje të shqetësuar. Ndërsa dy të sipërmet drejtohen me kokat e zgjatura për nga kupa, komunikojnë më qetë. Kështu, me mjeshtëri është krijuar një çfaqje e ekuilibruar, figurat kapin thuajse gjithë sipërfaqen e kuadratit të ndërtuara me linja të harkuara e variacion. Mozaiku është ekzekutuar me një teknikë të goditur bukur. Mbi sfondin e kjartë të konceptuar me nuancat e gurëve të bardhë, figurat e gjelave janë modeluar me gurë të zinj që gjithashtu variojnë brenda toneve të erëta. Po me gurë të zinj janë vizatuar thjeshtë krahët, sytë e bishtat, ndërsa kupa është mbajtur me gur rozë e konturuar me të zinj. Vendosja e gurëve ruan një rregullsi saqë vizatohen figurat e mandej në sfond ndjehet një lëvizje më e zhdërvjellët e plot gjallëri formash e ngjyrash më të kjarta.



Fig. 3

Paneli tjetër (Tab. II/a, b) ndodhej pranë atij me gjelat pak më nga perëndimi i hajatit, në një sipërfaqe rreth 1 x 1 m. Që në vështrimin e parë vërehet po ajo ndjenjë interpretimi dhe po ajo teknikë ndërtimi, po ajo gjendje force masash plastike të shpërndara me kujdes në sipërfaqen e kompozimit. Në qendër gjejmë të vizatuar me tone të qarta, në nuanca të ngrohta e të ftohta, figurën e një përbindëshi[4] që ngjan përgjithësisht me njerën nga ato të gdhendur e murosur në absidën e kishës (nga jashtë Fig. 3). Në të duket qartë një figurë mitologjike e stilizuar në vështrim të përgjithshëm. Edhe në këtë mozaik ndjehet ajo dorë mjeshtëri që vizaton me guxim, njohës i mirë i kompozimit, që zgjidh për të përdorur mjete shprehëse e të gjalla, mbi kërkesa rigoroze dinamike. Figura qëndron e fuqishme në profil, në çast ecjeje të rëndë me lëvizje të matura të këmbëve e trupit. Ajo ngjan si një luan me krahë e me kokën që mbase do të tregonte një dragua. Shpërndarja e gurëve nëpër gjithë sipërfaqen është bërë aqëmëtepër këtu, pandonjë rregullsi edhe pse siluetat janë përcaktuar mirë. Vende vende gjejmë të përdoren gurë të madhësive të ndryshme e toneve të ndryshme duke dhënë në një farë mase një frymëmarrje të lirë e shtrirje të gjerë volumesh. Figura e përbindëshit

4) S. Anamali, S. Adhami – **Mosaiques de l'Albanie** (broshurë) Tiranë 1974, faqe 14.

Do not copy

DO NOT COPY



Fig. 4

çfaqet plot dritë në sfondin e gurëve të hirtë të errët, ngjyrë kaf, okër, blu e të blertë, të ndërthurur me harmoni. Si edhe në panelin me gjelat, të dy mozaikët duken tepër piktorikë, të realizuar me mjeshtëri në pikëpamje të kompozimit, vizatimit e ngjyrës. Tek ata ndjehet kompozimi i lirë, i fuqishëm dhe i hijshëm.

Mozaiku i Bylisit (Hekal) rrethi i Fierit

Bylisi këto vitet e fundit ka hyrë në një fazë të rëndësishme kërkimesh. Dalëngadalë fizionomia e dikurshme qytetare ilire po del në dritë dhe shkëlqen që në vështrimin e parë jo vetëm brenda por dhe jashtë mureve të qytetit.

Vëndi ku u zbulua rastësisht mozaiku për të cilin do të flasim në këtë shkrim u gjend në truallin e varrezave të sotme të fshatit Hekal, rreth 300 m në veri të skajit më verior të murit rrethues të qytetit të lashtë në një kuotë paksa më të ulët (Fig. 4). Nga sondazhet e bëra kohët e fundit nga arkeologët aty pranë në këtë zonë, pak më nga jugu i vorrezave të reja, u zbuluan gjurmë varrezash më të vjetra. Aty këtu u gjendën mbeturina në baltë të pjekur (fragmente tullash, enësh dhe tjegullash).

Mozaiku doli rastësisht, gjatë hapjes së themeleve për rrethimin e varrezave të sotme në anën veri perëndimore të tyre. Shtresa e dyshemesë me gjurmët e mozaikut u çfaq fare pranë sipërfaqes së tokës së punuar vite me rradhë. Nga kjo arsye pa u kuptuar, mozaiku nuk mundi të arrijë i plotë, veçse tepër i dëmtuar sa që sot për sot nuk jemi në gjendje të formulojmë saktë ndërtimin e tij, shtrirjen, dekoracionin dhe çfarë ka qënë në kohën e vet, përse ka shërbyer. Punimet kërkimore të ardhëshme do sjellin fakte të rinj për këto çështje e për të tjera që me përmasa kulturore të gjera, larg brigjeve të Adriatikut por domosdo i lidhur me marrëdhënie me qëndrat më të dëgjuara të Apollonisë, Durrësit, Dimalit, Amantias, Olympes etj. Duke vështruar vendndodhjen e mozaikut të Bylisit bindemi se kemi të bëjmë me një ndërtim shoqëror të ngritur mbi një truall të zgjedhur me kujdes. Para tij hapej një pejsazh i gjerë natyral e i bukur qoftë nga perëndimi, veriu apo lindja duke ekspozuar vehten me tërë madhështinë. Edhe pse jashtë mureve të larta e të fuqishme të qytetit kësisoj ky ambient me mozaikë mund të ketë lindur disa shekuj më vonë nga ai duke treguar vazhdimësinë e jetës qytetare.

Gjatë sondazheve para shkuljes, të bëra në të dy anët e kanalit (themeleve) të hapura për rrethimin e varrezave të reja nga lindja dhe perëndimi u zbuluan gjurmë murresh të gurtë me llaç, sidomos më i plotë në këndin verilindor të ambientit. Duke studjuar lidhjen e fakteve të rinj të gjetur mundëm të rindërtojmë një ambient me përmasa 5.20 m x 3.10 m mbrenda të cilit ndodhej mozaiku, pra një dhome me brinjën më të gjatë veri jugë (Fig. 5.) Megjithatë mbetet ende pa e sqaruar ana perëndimore për të krijuar bindjen e plotë të shtrirjes së mozaikut nga ajo anë dhe aqë më tepër shtrirjen planimetrike të gjithë ndërtimit. Por ndërkohë me ato elemente të grumbulluara mund të rikompozohet një pjesë e mirë e shtrojes me mozaikë. Me lehtësi mund të plotësojmë p.sh. motivin e bordurës rreth e qark dhomës, të gjerë rreth 1 m ku vendin kryesor e zë ndërthurja dekorative e motivit të gërshetit i njohur veçanërisht që në mozaikët e kohës së vonë romake. Përgjithësisht për të formuar këtë dysheme janë përdorur gurë kubikë gëlqerorë rreth 1 cm të prerë me kujdes e radhitur bu-

kur duke ndjekur vizatimin e zgjedhur që më parë. Janë përdorur gurë të bardhë, gri të zes me nuanca e të kuq në rozë. Bordura e gërshetit mbyllet anash nga harqe të vegjël paksa të zgjatur drejt bordurës. Pranë murit mozaiku mbaronte thjesht me një fushë rreth 10 cm të gjerë që gjithashtu qarkonte gjithë qylymin e gurtë. Se çfarë ka patur të brëndashkruar, në qendër apo disa emblema të shpërndara e të vendosura proporcionalisht me të tjerë elemente kompozicionale, tani për tani nuk mund të përcaktohet. Veçmas, motive të ngjashëm me të gjejmë edhe në mozaikë të tjerë të vendit tonë, sidomos në Apolloni (Fig. 6). Ndërsa bordurën me harqet që përfundojnë me majë i gjejmë përgjithësisht të ngjashme në bazilikën e Linit (Fig. 7). Kështuqë ka të ngjarë, dyshemeja e mozaikut të Bylisit të ketë qenë ndërtuar rreth shekujve V-VI duke zbukuruar mbase dyshemenë e një ndërtese kulti.

RESTAURIMI

Të dy panelet me mozaikë të kishës së Manastirit të Mesopotamit kishin tërhequr vëmëndjen tonë veç vlerave dhe për gjendjen e tyre. Tek të dy pak a shumë shtroja e gurëve ndodhej prej kohësh e shkëputur nga baza e harasanit dhe veçanërisht në qoshet kish mungesa që edhe vështirësonin riformulimin e figurave në veçanti të gjelave, sipër në panelin e parë. Gjithashtu u vu re se sipërfaqja e gurëve kish filluar të mbulohej nga një shtresë myku e cila me kohë veç dëmit sado të vogël të strukturës së gurëve, vështirësonte vështrimin e pikturimit të figurave. Vendosëm të shkulen që të dy panelat dhe të përpunohen mandej në laboratorin e restaurimeve. Dy probleme shqetësonin grupin e punës. Së pari si do të realizohej shkulja e mozaikut në kushte jo aqë të favorshme klimaterike, kur në hajatin e kishës praktikisht në nëntor nuk binte fare dielli? dhe së dyti si do të mundnim të transportonim panelat e shkulur? Menduam se rruga më e mirë dhe më e mundëshme në këto rrethana do të ishte ngrohja e ambientit me zjarr rreth e qark për të arritur sadopak atë temperaturë, për ngjitjen e merleve mbi sipërfaqen e mozaikut pasi u përgatit dokumentacioni grafik e fotografik. Do të ishte më mirë që larja të bëhej së fundi edhe me alkool, të kontrollohej lagështia në shtresën e tabanit, për të parë sasinë maksimale të lagështirës që absorbon llaçi, të mund të arihej një ngrohje e konsiderueshme deri në 40°C. mbase duke e izoluar ambientin me anë të një çadre[5]. Këto masa bëhen



Fig. 5

të domosdoshme, si edhe forma të tjera për të arritur një siguri sa më të madhe në një fazë kaqë të rëndësishme të restaurimit. Ndodhi që në ndonjë anë gjatë shkuljes si pasojë e mos tharjes sa duhej, të mbeten në vend disa kubike të cilët menjëherë u rregjistruan me shënja të posaçme e u paketuan me kujdes për tu rivendosur gjatë procesit të konservimit përfundimtar në laborator.

Nga këto mozaikë si preçedencë u ndoq ajo që njihej më parë[6], me ndonjë përjashtim të vogël, p.sh. provuam të mos e përdorim në shtresën e parë letrën por vetëm merlen të përforcuar me breza të dy dhe

5) Z. Barov. **Prenasjanje na mozaikata Kalimanica na nova osnova** – Muzei u pamjetnici na kulturata, Sofija, 1974/4 faqe 59-62.

6) S. Kosta. «**Restaurimi i mozaikëve të Tiranës (faza e parë)** «Monumentet» 11/1976 faqe 87-97.

NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

të tre fishtë, duke mos e ndarë panelin, që do të çvendosnim. Në rastet kur gjatë shkuljes nuk u shkëput lehtë shtresa e mozaikut na u desh të hiqej bashkë me harasanin. Kjo sigurisht vështirësonte në një farë mase shkuljen e sidomos lëvizjen prej andej.

Panelat e mozaikut të shkulur u vendosën përmbys (me llaçin harasan sipër) mbi një planshet – kasë, njëri përmbi tjetrin me spesorë nivelues. Në planshetin – kase u hodh rërë në mënyrë që të mund të evitohej ndonjë lëvizje gurësh gjatë transportit. Kështu të dy panelet udhëtuan rreth 300 km pa pësuar asnjë dëmtim dhe tani po përpunohen për të realizuar formimin me shtresë të re llaç-betoni. Gjatë përpunimit në laborator, pastrimit të llaçit harasan u vu re më mirë çrregullsia e gurëve të cilët mund të mendohet të jenë marrë nga shtrati i lumit të Bistricës.

Si edhe në raste të tjera harasani është përgatitur në dy shtresa dhe dukej qartë theksimi i pluhurit të tjegullave.

Restaurimi i mozaikut të Bylisit zuri fill me zbulimin e plotë të tij aqësa njëri nga fragmentet, ai i anës verilindore doli nga përpjekjet për eksplorimin e zonës për të ndjekur planimetrinë e vendndodhjes. Gjatë zbulimit kjo pjesë që në fillim u shfaq në anën lindore të themelit të hapur për rrethimin e varrezës (Fig. 8). Zbulimi u krye me kujdes që të mund të fitohej sa më shumë sipërfaqe gjithnjë me



Fig. 8

DO NOT COPY

shpresë se do të dilte në dritë një pjesë e konsiderueshme e dyshemesë me mozaikë (Fig. 9). Dalja e mbeturinave të mureve e bën mandej të qartë perspektivën e kërkimeve. Kanali kish dëmtuar pjesën më interesante të mozaikut, qëndrën e kompozimit. Nga sondazhet që u bë në strukturën e llaçit të tabanit ku ishin vendosur gurët e mozaikut u vu re se përgjithësisht ruhej raporti 1 me 2 (gëlqere + rërë e pluhur tjegulle). Pra një përmbajtje teknikisht e arritur aqësa e tregojnë lidhja e mirë e gurëve me llaçin harasan. Ai u rezistoi me sukses kushteve atmosferike edhe pse jo i plotë, sidoqë mbulohej vetëm nga një shtresë e hollë dheu. Njëherazi me punimet e pastrimit të sipërfaqes së shtrojes u përgatit një gen-plan dhe materiali grafik e fotografik i nevojshëm si edhe u vendosën piketa në katër vende, nga dy për çdo fragment, në anën e mureve që do të shërbenin si pika orientuese kur mozaiku të rivendosej pas restaurimit[7]. Në rastin konkret menduam të organizojmë shkuljen në fragmente duke ndarë sejcilin në dy pjesë në vija që nuk dëmtonte riprodhimin e tyre. Shkulja u krye me lehtësi në një ditë të ngrohtë të nëntorit. Mbi planshetet e përgatitura që më parë u vendosën njëri mbi tjetrin të katër fragmentet e mozaikut. Në ato raste kur pas shkuljes ishin çvendosur edhe pjesë nga llaçi harasan, u desh që të hiqej dhe mandej u vendosën një mbi një mbi arkën e transportit.

Pastrimi i llaçit poshtë gurëve u bë aqësa të mos eleminohej nga fugaturat, për ta ruajtur si dëshmi të kohës së vet. Pas këtij proçesi u provua të kalohej më tej në kërkesat e restaurimit. Dukej qartë se nga lëvizjet e tokës, nga ndryshimet atmosferike në kohë, kish pësuar çarje shtresa e dyshemesë deri në 2-3 cm. Vendosëm të bëjmë afrimin e shmangies, rikompozimin duke sjellë në gjendjen e parë dekoracionin. Një vizatim i gjendjes para këtyre operacioneve në letër transparente (nga ana e prapme) ndihmoi shumë për të bërë përpjekjet e duhura rikonstruktive. Rruga u bë e mundëshme pasi u ballafaqua vizatimi ishte që të pritej me thikë të mprehtë merlja në konturet e gurëve tek linjat e çarjeve dhe si u hoq diferenca u krye puthitja e copave të prera në atë masë sa të sillej mozaiku thuajse në gjendjen e parë, duke arrirë përputhjen e vijave të ornamentikës. (Tab. III/a, b). Pas kontrollit të këtyre përputhjeve, copat përfundimisht u vendosën në shtrojën ku do të bëhej betonimi mbi një shtresë letër. Mbi ato shtroja u organizuan sipas dokumentacionit që të dy fragmentet e shkulur. Kështu do të formohej paskëtej një pllakë e vetme e betonuar për sejcilin fragment. Fragmenti Nr. 1 nga ana jugperëndimore formonte një pllakë katërkëndëshe 1.78 x 0.45 m. dhe fragmenti Nr. 2 nga veri lindja 1.68 x 0.90 m. Pllakat me mozaikun do të kenë si gjithënjë armaturën metalike me një rrjet kuadratik me hekur 6 mm seksion dhe në katër vende brenda kësaj armature u vendosën katër unaza hekuri që do të shërbenin për montimin e mozaikut po qe se mendohet të ekspozohet në ambientet e ndonjë muzeu. Në të kundërt, ai ruan të gjitha mundësitë të rivendoset pa asnjë vështirësi në çdo kohë në vendndodhjen e tij origjinale.



Fig. 9

Për të dy rastet që përshkruam në mënyrë të veçantë do të luajë rol të veçantë përpunimi përfundimtar i gjithë sipërfaqes me mozaike dhe i çdo guri, pastrimi nga kripërat dhe papastërti të tjera e sidomos për të arritur forcimin dhe hidrofobizimin e tyre më të mirë[8]. Për të aritur një ekspozim të kënaqëshëm të fragmenteve u pa në kompleks vlera e tyre me një angazhim forcash në përmasa të atilla që rifreskojnë e rigjallërojnë vlerat estetike duke lënë për tu gjurmuar e studjuar të tjera çështje që pa dyshim do të ndriçojnë mendimin kritik-estetik mbi zhvillimin e artit të mozaikut në raport gjithënjë me artet e tjera dhe arkitekturën. Studimi i mëtejshëm do të kontribojë në njohjen dhe përcaktimin e vendit që ze arti i mozaikut në kohë të ndryshme, në truallin shqiptar[9].

7) Dokumentacioni dhe shkulja u kryen nga U. Çikopano, Gj. Varfi dhe I. Zaloshnja.
8) Z. Barov. artikull i cituar — faqe 64.
9) S. Anamali, vepër e cituar — faqe 14.

BOTOPY

DO NOT COPY



a

MESOPOTAM

PAMJE E PANELIT TE MOZAIKUT ME KATER GJELAT



b



a

MESOPOTAM

PAMJE E PANELIT TE MOZAIKUT ME FIGUREN E NJE PERBINDESHI



b

Bylis – SKICE E KORIGJIMIT TE SHMANGIEVE NE FRAGMENTIN Nr. 2 TE MOZAIKUT



a



b

DO NOT COPY

Sotir KOSTA

DO NOT COPY

RESTAURATION DES MOSAIQUES DE MESOPOTAM ET DE BYLIS

RESUME

Les mosaïques de Mesopotam et de Bylis ont attiré notre attention du fait que non seulement leur état de détérioration exigeait une intervention immédiate, mais aussi parce que les deux panneaux de Mesopotam font part d'un groupe de mosaïques de grand intérêt scientifique.

Le déplacement et le transport de ces mosaïques au laboratoire des restauration ont été effectués dans des conditions peu habituelles et non favorables. La préparation des documents relatifs a été accomplie selon les critères connus, en prévoyant dans chaque cas la possibilité de remettre en place les mosaïques déplacées.

La mosaïque de l'Eglise du Monastère de Shen Koll à Mesopotam, district de Sarande

Quelques kilomètres à l'est de l'ancien Finiq, cité de renom dans le monde de la civilisation illyrienne, au sommet d'une jolie colline verdoyante, baignée par les eaux cristallines de la Bistrice, se dressait un monastère fortifié depuis la deuxième moitié du VIe s. de n. è. C'est à l'intérieur de ce milieu clos qu'a été érigée une église, conçue de manière différente des autres, églises du pays, avec des volumes lourds et puissants, mais bien proportionnés soit à l'intérieur qu'à l'extérieur.

Les grandes surfaces froides et grisâtres, garnies d'un décor improvisé de pierres et de briques disposées harmonieusement par rapport aux énormes silhouettes architectoniques, confèrent à cet édifice un grand intérêt. Les reconstructions successives lui ont attribué un aspect incertain qui vous incite à le libérer, à le nettoyer avec soin des éléments de construction qui y ont été ajoutés plus tard, pour pourvoir l'observer et admirer dans son ancienne splendeur. C'est là un témoignage d'intérêt non seulement de l'histoire de l'architecture byzantine chez nous, mais encore de l'architecture byzantine en général. Sous cet angle, il importe avant tout de reprendre les travaux de restauration à partir de sondages effectués avec soin pour procéder à la libération de ce monument dans le cadre architectonique de l'époque où il a été érigé, voire même sur une territoire plus vaste, afin de pouvoir examiner à fond tous les problèmes qui s'y rattachent.

Apparemment, dans cette église, comme dans quelques autres, on relève la présence de plusieurs genres, bien que sous des formes incomplètes, afin de satisfaire dans une certaine mesure à la fois les exigences stylistiques de l'époque et la physionomie particulière qu'ont voulu leur conférer les maîtres constructeurs du pays. La mosaïque de l'église du Monastère de Shën Koll à Mesopotam se trouve hors de l'édifice de l'église; il couvre en partie le plancher du hayat, *revêtu de grandes plaques de pierre (1 x 1 m.) et situé à l'angle oriental de cette cour. Actuellement, il n'en reste que deux panneaux différents l'un de l'autre et d'un contenu non identique. Envisagés dans la planimétrie de ce plancher dans son ensemble, de ces deux panneaux ne se dégage pas une représentation de composition esthétique élaborée selon des critères symétriques préétablis. Il n'est pas possible de déterminer l'ensemble des éléments décoratifs, et cela du fait surtout que le revêtement de ce plancher avec des plaques n'a pas été réalisé en ayant présentes à l'esprit les mosaïques. S'il en était ainsi, nous aurions pu définir la place et le rôle de chacune d'elles dans cet ensemble. Dans ces conditions, il se peut fort bien que le revêtement avec des plaques appartienne à une époque plus récente, en laissant intentionnellement les deux panneaux qui ont fait part de cette église depuis sa fondation. Les mosaïques sont des symboles connus de l'art byzantin, bien que leur usage soit de date beaucoup plus ancienne.*

Le panneau de mosaïques à l'est de l'église couvre une surface d'environ de 1 x 1 m. presque au milieu de la largeur du portique. A ce qu'il paraît, il reproduit une scène de l'eucharistie avec des pierres d'une dimension plus grande de 1 cm², finement ciselées et en peu de couleurs. Le dessin comporte quatre coqs avec une coupe au milieu, le tout orienté en direction nord-est (Tab. I, a, b). Avec ces coqs et ces couleurs, en faisant un usage parcimonieux des éléments de composition, ses auteurs ont construit une scène plein de dynamisme, fraîche et complète dans la répartition des volumes et des moyens expressifs décoratifs. A travers cette composition, ils sont placés à chacun des angles de cette surface et dénotent des mouvements pondérés, constituant de la sorte deux groupes séparés l'un de l'autre, en haut et en bas.

Le groupe d'en bas, qui constitue la base de la composition, se caractérise par un mouvement analogue. Les deux coqs sont reproduits librement, avec élégance et par des lignes stylisées avec soin; un d'eux a levé une de ses pattes, ce qui indique un état de d'inquiétude. En ce qui concerne les deux

coqs supérieurs, ils ont allongé leur tête vers la coupe et sont plus communicatifs. C'est ainsi que les auteurs ont su reproduire une scène équilibrée. L'exécution de la mosaïque est d'une facture remarquable. Sur le fond clair conçu avec des nuances de petites pierres blanches, les figures géométriques sont modelées avec des petites pierres noires nuancées. Le dessin simple des ailes, des yeux et des queues également comporte des petites pierres noires, alors que la coupe est émaillée de petites pierres couleur rose entourées de pierres noires.

En ce qui concerne l'autre panneau (Tab. II/a, b), il se trouve à côté du précédent, mais un plus à l'ouest du hayat, et couvre une surface d'environ 1 x 1 m. Dès le premier regard, on relève un sentiment analogue d'interprétation et la même technique de construction, des masses plastiques d'une force identique et réparties soigneusement sur la surface de composition. Sur le fond se détache les dessin d'un monstre, ressemblant en général à celui gravé et emmuré dans l'église à côté de l'abside (dans sa partie extérieure, Fig. 3); il est reproduit avec des tons clairs et des nuances à la fois chaudes et froides. Par endroits, on relève des pierres de dimensions et de tons différents, ce qui confère aux volumes plus d'ampleur et de liberté de mouvement. La figure du monstre apparaît plein de lumière sur le fond des pierres de coloration grise, brune, ocre, bleue et verte, entremêlées harmonieusement entre elles.

La mosaïque de Bylis (Hekal), district de Fieri

Les fouilles entreprises à Bylis sont entrées ces dernières années dans une phase importante. Petit à petit l'ancienne physionomie de cette cité illyrienne se manifeste à la lumière du jour et resplendit dès le premier regard non seulement à l'intérieur mais aussi hors des murs d'enceinte de cette ville.

L'endroit où a été fortuitement découverte la mosaïque, dont il est question dans cet article, se situe dans le cimetière actuel du village de Hekal à environ 300 m., en direction nord, de l'extrémité septentrionale du mur d'enceinte de l'ancienne ville à une cote légèrement plus basse (Fig. 4). Les sondages effectués récemment par nos archéologues à proximité de cette zone, quelque peu plus à sud du cimetière actuel, ont porté à la lumière des traces de tombes plus anciennes. Ci et là ont été récupérés des restes de récipients, de tuiles et de briques.

La mosaïque a été découverte fortuitement, alors qu'on creusait les fondations du mur d'enceinte du cimetière actuel en direction nord-ouest. La couche du plancher de mosaïque se trouvait à proximité de la surface de la terre, que les gens du pays travaillent depuis longtemps. De ce fait elle n'est pas complète, elle se trouve dans un état très endommagé au point qu'à l'heure actuelle nous ne sommes pas en mesure de formuler une opinion exacte sur sa construction, sur son extension, sa décoration et sur ce qu'elle a été à son époque. Bien que située hors des murs hauts et puissants de cette ville, la surface couverte de mosaïques a du être construite quelques siècles plus tard et indique la continuité de la vie urbaine.

En étudiant la liaison existant entre les faits récemments mis à jour, il a été possible de reconstruire une pièce d'une dimension 5.20 x 3.10 m., à l'intérieur de laquelle se trouvait la mosaïque, donc une chambre dont le côté plus long est celui nord-sud (Fig. 5).

En général pour la reconstitution de ce plancher nous avons employe des petites pierres cubiques calcarées de dimension environ 1 cm., taillées soigneusement et alignées esthétiquement, en suivant le dessin choisi d'avance. A cette fin, nous nous sommes servi de petites pierres de coloration blanche, grise foncée à nuances et rouge tirant sur le rose. La bordure de la tresse se termine latéralement par de petits arcs légèrement allongés vers la bordure. A proximité du mur, cette mosaïque se terminait simplement par un champ d'environ 10 cm. de largeur qui, à son tour, entourait tout le tapis de petites pierres. Pour le moment il est difficile de savoir ce qu'elle comportait sur son champ, au centre, s'il y avait des emblèmes dispersées et disposées proportionnellement avec d'autres éléments faisant partie de la composition. En ce qui concerne certains motifs isolés, on les retouve dans d'autres mosaïques de chez nous, surtout à Apollonie (Tab. III/a, b,). Quant à la bordure avec des arcs pointus, nous la retrouvons en général d'une facture identique à la basilique de Lin (Tab. III/a, b,). De ces faits il ressort, selon toute vraisemblance, que la mosaïque de Bylis ait été construite vers les Ve-VIe siècles et revêtait le plancher d'un édifice de culte.

La restauration

Les deux panneaux de mosaïques de l'église du Monastère de Mesopotam avaient attiré notre attention, en dehors des valeurs qu'ils représentaient, en raison de l'état dans lequel ils se trouvaient. Dans ces deux mosaïques, les petites pierres s'étaient plus ou moins détachées du ciment qui les retenaient à leur base; en plus, plusieurs d'entre elles manquaient aux angles des panneaux ce qui entravaient la formulation des figures, et particulièrement des coqs, dans la partie supérieure du premier panneau. Par ailleurs, une couche de moisissure avait commencé à couvrir la surface des petites pierres, ce qui empêchait de regarder la peinture des figures. C'est pourquoi il fut décidé d'enlever les deux panneaux et de les envoyer au laboratoire des restauration. Deux problèmes inquiétants se posaient au groupe de travail. Premièrement, il s'agissait de détacher les petites pierres dans des conditions atmosphériques peu favorables, alors que les rayons du soleil ne pénétrent point dans le hayat de l'églies au mois de novembre. Et deuxièmement, comment on allait s'y prendre transporter les panneaux détachés. C'est à cette fin qu'il fut décidé de chauffer le milieu pour obtenir la température requise au collage du merlé sur la surface du mosaïque, après avoir préparé la documentation graphique et photographique.

Du nombre de ces mosaïques la précédence a été donnée à celle que nous connaissions d'avance, sauf dans quelque cas

PROTOKOL

rare, nous avons essayé de ne pas employer dans la première couche du papier, mais seulement du merlé renforcé par deux ou trois bandes, afin de ne pas séparer le panneau qui allait être détaché.

Pendant les travaux effectués au laboratoire, entre autres le nettoyage du mortier de crépi, nous avons pu relever la forme irrégulières des pierres qui vraisemblablement ont du être prélevées du fleuve Bistrica.

La restauration du mosaïque de Bylis a commencé par sa découverte complète, alors qu'un de ses deux fragments, celui du côté nord-est, a été mis à jour à la suite des efforts accomplis pour l'exploration de la zone concernée afin de suivre la planimétrie de son emplacement. La mise à jour des restes des murs ont éclairci davantage la perspective des recherches. Le canal avait endommagé la partie plus intéressante du mosaïque, le centre de la composition. Les sondages effectués dans la structure de mortier du soubassement, où avaient été fixées les petites pierres, ont montré que le rapport 1:2 (chaux sable et poudre de tuile) était en général conservé. En l'occurance nous avons pensé de procéder au décollage des pierres par fragments, en divisant chacun de ceux-ci en deux parties par une ligne, ce qui n'affecte aucunement leur reproduction.

Le nettoyage du mortier au-dessous des pierres a été effectué de manière à ne pas éliminer les joints, afin de les conserver en tant que témoignage de l'époque. Par la suite nous avons entamé les autres procédés de restauration. A cause des mouvements de la terre, des changements atmosphériques survenus dans le temps, la couche du plancher présentait des fissures d'une dimension de 2 à 3 cm. Il a été décidé de procéder au rapprochement de ces déviations. Le dessin de l'état de cette mosaïque sur papier transparent (par derrière), avant la mise en oeuvre de ces opérations, a facilité beaucoup l'exécution des autres opérations. Après avoir contrôlé ces concordances, les morceaux ont été définitivement posés sur la couche qui allait être bétonné. De la sorte celle mosaïque peut être remise, sans aucune difficulté et dans n'importe quel temps, à l'endroit d'où elle a été prélevée.

Pour obtenir une exposition satisfaisante des fragments, la valeur de chacun d'eux a été envisagée dans leur ensemble en y engageant des forces qui fussent en mesure de rafraîchir et de revivifier leurs valeurs esthétiques, tout en conservant les traces nécessaires au dépistage et à l'étude des facteurs qui contribueront à éclaircir sans doute la pensée critique-esthétique sur le développement de l'art de la mosaïque par rapport toujours aux autres arts et à l'architecture. Une étude plus poussée contribuera à la connaissance et à la définition de la place que l'art de la mosaïque a occupé à différentes époques dans le domaine albanais.

DO NOT COPY

Stilian ADHAMI

DO NOT COPY

MARRËDHËNIET EKONOMIKE, SHOQËRORE DHE KULTURORE MIDIS VITHKUQIT DHE VOSKOPOJËS NË SHEKULLIN E LULËZIMIT TË TYRE

Janë të rrallë qytetet mesjetarë si Vithkuqi dhe Voskopoja, që në ecurinë e tyre qindravjeçare kanë shumë gjëra të përbashkëta, si në jetën ekonomiko-shoqërore ashtu edhe atë kulturore-arsimore. Marrëdhëniet midis këtyre dy qyteteve të afërt, që nuk i ndajnë veçse 18 km., marrin tipare thuajse të një binomi, që në rrjedhën e shekujve i nënshtrohen të njëjtëve faktorë në zhvillimin e tyre të gjithanshëm, ashtu sikundër shkaqe e rrethana pak a shumë të ngjashme përcaktojnë të tatëpjetën e tyre deri në humbjen e fizionomisë qytetare.

Në këtë studim i kemi vënë për detyrë vehtes të nxjerrim në pah disa nga fijet e lidhjeve, që vërehen nëpërmjet burimeve të ndryshme, në marrëdhëniet midis këtyre dy qendrave në fushën ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

Në kronikat dhe mbishkrimet e faltoreve, si Voskopoja ashtu edhe Vithkuqi përmenden si «politie» dmth qytete me shtëpi e banorë të shumtë, në një kohë (sh. XVIII) kur qytetet fqinjë Korçë e Kostur nuk kanë patur veçse nga 300-400 shtëpi[1]. Por, pavarësisht nga tepërimet që mund të kenë burimet dokumentare në dhënien e numrit të shtëpive e banorëve të të dy qyteteve, duhet pranuar se shifrat që jepen janë jehonë e përmasave të mëdha për kohën, që arritën këta vëndbanime.

Po nga këto burime, bibliografia shumë e pasur, si edhe nga vetë kultura materiale e shpirtërore e tyre, gërmadhat e shumta, krojet e rrugët e shtruara me kalldrëm etj., del se këto qendra kanë arritur një zhvillim të mirë ekonomik e kulturor, në mënyrë të veçantë gjatë shek. XVIII, duke pasur lagje të shumta, esnafe zejtarësh të ndryshëm, veprimtari të gjerë tregëtare etj. Nga ana tjetër sa arkitektura e banesave dhe ndërtimeve të kultit, aq edhe lëvizja e madhe mendore, kulturore e arsimore, zbukurimi i faltoreve dhe veprat e tjera artistike, krahas zhvillimit të vrullshëm të tregëtisë dhe zejtarisë, u dhanë emër të mirë veçanërisht Voskopojës, por edhe Vithkuqit, si qytete me nivel të zhvilluar në shekullin XVIII.

Tipare të përbashkëta dhe rrugë të përafërta zhvillimi midis këtyre dy qendrave, duke ruajtur sigurisht përpjestimet, vërejmë në fusha të ndryshme të ekonomisë, në sferën e prodhimit, në atë të shkëmbimit dhe të qarkullimit të mallrave. Banorët e këtyre trevave me kullota të pasura, me blegtori të zhvilluar, merreshin në shkallë të gjerë me përpunimin e leshit, lëkurëve dhe bulmetit. Këta artikuj kanë qënë të kërkuar jo vetëm në tregun e Korçës dhe në qytetet e tjerë, por edhe në tregjet e përtej detit, të përcjellur me karvanë, më fort në Durrës dhe së andejmi me lundra ulqinake e venedikase në Itali, Austri e gjetkë në Evropë, ku gjëndeshin me shumicë tregëtonjës korçarë, voskopojarë e vithkuqarë[2].

Në kushtet e regjimit feudal ushtarak otoman, për të mënjanuar konkurencën e lirë, për t'u bërë më të fuqishëm në mbrojtjen kundër sulmeve të huaja, si edhe për të organizuar më mirë prodhimin dhe shitjen, lindën esnafët ose rufetet. Si organizata ekonomiko-shoqërore të zejtarëve, tregëtarëve dhe profesionistëve të një ose më shumë veprimtarive ekonomike, të lindura nga nevojat e shoqërisë feudale në rritje, ato gjetën përhapje e zhvillim për disa shekuj me rradhë gati në të gjitha krahinat e perandorisë, duke u për-

1) I.M. Qafëzezi, **Historia e qytetit Voskopojë apo Vockëpojë.** Korçë 1952-1958 (drsh). f. 4.

2) I.M. Qafëzezi, **vep. cit.** f. 29.

krahur nga shteti feudal ushtarak osman, si dhe nga institucionet fetare të kohës. Këto organizata kanë qënë mjaft të fuqishme, më tepër në Voskopojë e pastaj në Vithkuq, për t'u bërë ballë edhe mjerimeve që rrithnin nga trazirat dhe keqbërësitë e bejlerëve dhe derebejve të Plasës, Frashërit, Zavalanit, Radovickës, Koprençkës, Staraveckës etj. Ndër zejtaritë e ndryshme të zhvilluara në këta dy qytete kanë qënë të dëgjuara sidomos ato të metaleve. Le të përmëndim këtu esnafin mjaft të pasur të bakërpunuesve të Voskopojës apo lagjen e dikurshme të Vithkuqit me emrin «Kovaças».

Është jashtë çdo dyshimi që të dy këta qytete fqinjë zhvillonin tregëti me njëri-tjetrin dhe me Korçën fqinjë. Sipas të dhënave të kodikëve kishtarë, në gjysmën e parë të shekullit XVIII, këta qytete kishin marrë tiparet e qendrave ekonomike me rëndësi zejtaro-tregëtare, kishin pasur tregje të plotësuar me dyqane e me hane për pazarakët e krahinave e për karvanet që kalonin përmes kësaj treve. Në pazaret javore të këtyre qyteteve shiteshin prodhime bujqësore e blegtorale dhe bakallëke të ndryshme[3].

Me rritjen e fuqisë ekonomike të tyre ata arritën t'i shtrijnë marrëdhëniet tregëtare, jo vetëm me Shkodrën, Durrësin, Kosturin, Manastirin, etj., por edhe me qendra të rëndësishme tregëtare të Ballkanit dhe të Evropës, që janë të njohura nga historiografia jonë. Në korespondencën me Venedikun një pjesë e mirë e tregëtarëve të quajtur «mercanti albanesi» (tregëtarë shqiptarë) janë voskopojarë e vithkuqarë, sikundër del nga dokumentat që flasin për vatrën tregëtare më të madhe voskopojare, Jirasit (Gjirasit, Hirasit) e më pas Sinasit, vithkuqarë të hedhur në Voskopojë.

Rritja e nivelit ekonomik të këtyre qyteteve solli si rrjedhim një zhvillim të shënuar në lëmin e arsimit, të artit e të kulturës, në të njëjtën kohë, veçanërisht në Voskopojë, po merrte jetë një lëvizje iluministe kulturore, që po zhvillohej në frymën e kulturës shqiptare e ballkanike.

Nga të dhëna të ndryshme dokumentohet se banorët e të dy këtyre qyteteve kanë qënë arsimdashës, të etshëm për kulturën përparimtare në përgjithësi dhe për shkrimin e gjuhës shqipe në veçanti. Përveç kontributit masiv të voskopojarëve për ngrehinat shkollore, është me interes të përmëndet se, sipas një raporti të vitit 1699, në shkollën e Himarës, ku mësohej edhe shkrimi i shqipes nga mësues bazilianë të ardhur nga Italia, mësonin edhe nxënës vithkuqarë[4].



Fig. 1



Fig. 2

Lëvizja mendore, kulturore e arsimore, që zuri rrënjë e hodhi shtat në qytetin mesjetar të Voskopojës në shekullin XVIII të lulëzimit të vet, gjeti përhapje të gjerë veçanërisht në trevat që e rrethonin këtë qytet.

Me veprimtarinë botuese të shtypëshkronjës, me themelimin e kolegjit «Akademia e re» dhe të insti-

3) P. Pepo. **Kuadër historik i Korçës nga shek. XIII gjer në fund të shek. XIX,** në «Zëri i Rinisë» d. 23.X.1965.

4) Dh. S. Shuteriqi. **Shkrimi i shqipes dhe shkolla në bregdetin e Himarës gjatë shek. XVII-XVIII,** në «Mësuesi» d. 28 qershor dhe 5 korrik 1963.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

tucioneve të tjera social-kulturore, Voskopoja u shndërrua në një vatër të madhe qytetërimi e kulture që rrezatoi tejendanë dhe që ushtroi ndikim të madh në mbarë vëndin. Nga kjo vatër dolën burra të mësuar, që u shquan në fusha të ndryshme të kulturës, arsimit, shkencës dhe ekonomisë, qoftë në këtë qytet apo gjetkë, ashtu edhe jashtë kufijve të vëndit. Të shumta janë figurat e shquara, voskopojare apo të ardhur aty, që vepruan në fusha të ndryshme në këtë qytet. Të shumtë kanë qënë edhe vithkuqarët që kanë mësuar dhe punuar në Voskopojë.

Është për t'u theksuar se thuajse në të njëjtën periudhë të lulëzimit të Voskopojës shënon një zhvillim të dukshëm edhe qyteti fqinj i Vithkuqit, me popullatë thjesht vëndase. Kështu afërsisht në të njëjtën kohë, në shekujt XVII-XVIII, me ndihma të mbledhura në vënd e jashtë shtetit, u krijuan mundësitë e ndërtimit të faltoreve madhështore në Voskopojë dhe në Vithkuq, numuri i të cilave ishte më shumë se 20 në Voskopojë dhe jo më pak se 12 në Vithkuq. Si në faltoret e Voskopojës, ashtu edhe në ato të Vithkuqit, në një pjesë të të cilave janë po ata artistë të talentuar vëndas që kanë ekzekutuar pikturat e tyre murale, vërejmë se vetëm në një farë mase u binden urdhërit të pushtuesve turq, që kërkonin të mos dalloheshin me asnjë mënyrë nga shtëpitë e thjeshta, as për materialet e përdorura, as edhe për arkitekturën e tyre dhe zbukurimet nga jashtë. Në të vërtetë shohim se manastiri i Shën Prodhromit të Voskopojës (Fig. 1) rivalizon me atë të Shën Pjetrit në Vithkuq, (Fig. 2) që të dy manastire të mëdhenj. Po kështu e ngjashme nga ana arkitekturale dhe rivale nga përmasat është bazilika e Shën Mëhillit në Vithkuq (Fig. 3) dhe bazilikat e Voskopojës, (Fig. 4). duke konkuruar nga mjeshtëria e të ndërtuarit dhe zbukurimi i brendësisë së tyre[5]. Këto flasin për fuqinë ekonomike, shtimin e popullatës, zhvillimin e forcave prodhuese dhe me to edhe të krijimtarisë artistike në këta qytete.

Vlen të nënvizohet se kultura e qytetit mesjetar të Voskopojës nuk duhet parë si një kulturë e shkëputur nga kultura në tërësi e truallit shqiptar, në të cilin lindën dhe u zhvilluan qytete e qyteza mesjetare për rreth saj, si Vithkuqi, Niça, Llënga, Grabova, Nikolica, etj., po si një kulturë në zhvillimin e së cilës marrin pjesë aktivisht banorët vëndas të gjithë këtyre trevave. Ndërkaq nuk është pa interes të vëmë në pah edhe zhvillimin që kishin marrë qendrat e tjera kryesore kulturore të Shqipërisë së Mesme e të Jugut, siç qenë Elbasani, Berati e Janina, të cilat u bënë edhe vatra të shkrimit shqip në shek.

5 «... Të kemi parasysh se aqë voskopojarët sa edhe vithkuqarët kanë rahur kurbet së bashku në të njëjtët vënde të Evropës: në Hungari, në Lehi (Poloni), Rusi etj; të gjithë kanë qënë burra aktivë si tregtarë dhe zanatqarë dhe kanë bërë fitime të mira. E kështu voskopojarët dhe vithkuqarët kur janë kthyer kamës nga kurbeti kanë ngrënë sedër që kur ndërtohej një kishë në Voskopojë nuk mbetej më pas edhe Vithkuqi, me të ndërtuar dhe atje një të tillë...» (I.M. Qafëzezi, vep. e cit. f. 48).

PO NOT COPY

XVIII e në fillim të shek. XIX. Nga ana tjetër, nuk duhet harruar lëvizja mendore e trekëndëshit Korçë-Elbasan-Gjirokastër. Të gjitha këto janë të lidhura me ndryshimet që shënon gjendja ekonomike dhe shoqërore e vëndit tonë, kur një klasë e re shoqërore po dilte në dukje, borgjezia e zanateve dhe tregëtisë. Pra, ky zhvillim i njëkohshëm i mjaft qyteteve në vëndin tonë, me ta edhe ai i Vithkuqit, në të cilët nuk kanë munguar së ushtruari ndikime të dyanëshme në zhvillimin e ri të forcave prodhuese, nuk u jep të drejtë atyre autorëve të huaj, të cilët jo pa qëllim e cilësojnë Voskopojën si «oaz në shkretëtirë».

Vithkuqi, një nga qytetet më në zë n'atë kohë dhe më t'afërt me Voskopojën, ka qenë përherë në kontakt me të, ka marrë e ka dhënë reciprokisht edhe në fushë të kulturës dhe arsimit. Mjafton të përmëndim këtu kontributin e botimeve të ndryshme voskopojare, të fjaloreve tregjuhësh e katërgjuhësh të Theodor Kavaliotit dhe Dhanil Haxhiut dhe sidomos veprimtarinë arsimore-edukative që zhvillonte kolegji «Akademia e re» dhe institucionet e tjera arsimore kulturore, gjë që pati rëndësi jashtëzakonisht të madhe për shkollimin e shqiptarëve dhe njëherit për shpejtimin e hapjes së shkollave të reja në vënde të ndryshme[6]. Mjaft të rinj vithkuqarë, jo vetëm kanë ndjekur këto shkolla dhe kanë përfituar nga kjo zjarrishte e kohës në malësi të Oparit, por të edukuar me frymën e «Akademisë së re» u muarrën edhe me lëvrimin e shkrimit të shqipes dhe u bënë burim kuadrosh për atë qytet, pikërisht në një kohë kur vithkuqari i madh Naum Veqilharxhi ishte ende i ri. Fëmijët e vithkuqarëve jo vetëm që shfrytëzonin institucionet arsimore të Voskopojës, por përfitonin edhe nga institucionet e tjera shoqërore e kulturore të saj, si jetimoret, biblioteka, libraria, spitali etj.

Nëqoftëse do t'i besohet ndonjë burimi bibliografik vlen të përmëndet se edhe shkolla e parë në këta dy qytete shumë të ngjashëm me njeri-tjetrin është ngritur në të njëjtën kohë dhe daton nga fillimi i shek. XVIII (1710)[7]. Ngritja e funksionimi i shkollave në gjuhën greke si në Voskopojë ashtu edhe në Vithkuq gjatë shek. XVIII ka shpjegimet e veta. N'atë kohë vetëm të tilla shkolla mund të funksiononin në krahina, të cilat ndodheshin nën autoritetin kishëtar e klerikal të Patrikanës greko-bizantine të Stambollit për më tepër vetëm nga të tilla shkolla mund të pregatiteshin nxënës për të vazhduar studimet në «Akademinë e re» të Voskopojës, e cila ndodhej nën ndikimin e kulturës iluministe, por të praktikuar në gjuhën greke, që n'atë kohë ishte gjuha kishtare dhe kulturore e pjesës më të madhe të krishterëve të Ballkanit, e njohur zyrtarisht edhe nga qeverit turke[8].

Le të kujtojmë këtu disa nga përfaqësuesit më të dëgjuar të inteligjencies së atëhershme vithkuqare pregatitja arsimore dhe jeta e të cilëve është e lidhur ngushtë me institucionet voskopojare. Ndër më të shquarit vlen të përmëndet Jano Strati, i mbiquajtur Evstrat Vithkuqari, i cili jo vetëm që është një ndë ata që studjoi në Voskopojë, por edhe shërbeu s drejtor i shkollës së këtij qyteti pas vdekjes së Kavaliotit deri para vitit 1800. Sepse, megjithë shkatërrimin e parë të Voskopojës (v. 1769), lëvizja arsimore shoqërore dhe ekonomike nuk duket të ketë marrë aqë shumë të tatëpjetën, përkundrazi tani e tutje (1770-1802) jemi në atë periudhë kur si politikë e program arsimor voskopojarët, më drejt pedagog Kavalioti dhe pas këtij Jano Strati Vithkuqari dhe Dhanil Haxhiu, ndjekin sistemin didaktik të mësimit të gjuhës shqipe pranë greqishtes «... për lehtësirë të nxënësve», sikundër tingëllojnë fjalët e Dhanilit tek parathënia e katërgjuhëshit të tij[9].

Është me interes të dihet se edhe pas shëmbjes së vatrës kulturore voskopojare nga rrebeshi i anarkisë feudale, kur nga fundi i shek. XVIII lindi në Përme inisiativa për ta zëvendësuar atë me një vatër të re kulturore, shkolla plotore e atjeshme, e cila për një farë periudhe pati si pedagog edhe Jano Strati Vithkuqarin, e fshiu «oktoihon» kishtare dhe nuk ndoqi binarët e Ballanianit, por shkoi pas trasesë së Akademisë voskopojare[10]. Nuk duhet harruar edhe se Evstra-

6) Më 1742 është botuar në Shtypshkronjën e Voskopojës, si punim origjinal i Grigor Voskopojarit, akoluthia e Shën Nikodem Vithkuqarit, martirizuar në Berat më 1 Korrik 1709.

7) E. Kurilla, në shënimin e f. 104 të botimit të vet «Grigor Gjirokastriti etj. dhe historia e Voskopojës dhe qytetërimi i saj» thotë se «egzistonte edhe në Vithkuq një shkollë e lulëzuar që ushtronte aktivitetin e saj paralelisht me atë të Voskopojës». Kurse, sipas K. Skënderit (**«Historia e Voskopojës së vjetër e të re.** Athinë 1928, f. 55), «Vithkuqi në kohën e lulëzimit kishte një shkollë të famëshme. Është atdheu i të ndjerit mësues dhe predikonjës i fesë i Janinës, Efstratit, i cili në Gjirokastër kishte shkruar shumë kodike».

8) Dh. S. Shuteriqi, **vep. e cit.** M. Islami. **Naum Panajot Bredhi Veqilharxhi** Tiranë 1967, f. 19.

9) I. M. Qafëzezi, **vep. e cit.** f. 6.

10) K. Frashëri, **Kostandin Duka, iluminist shqiptar i shekullit XVIII-XIX,** në «Mësuesi» d. 11.9.1971.

ti, që i dha mësime të gjuhës shqipe konsullit englez Lik dhe bashkëpunoi me të për hartimin e fjalorit shqip-anglisht-greqisht, u mbështet për këtë në veprën e Dhanil Haxhi Voskopojarit[11].

Një figurë tjetër vithkuqare, që mori mësime në Voskopojë dhe që u muarr me lëvrimin e shkrimit të gjuhës shqipe, duke shkruar kronika historike e copëza kishëtare në gjuhën shqipe, ka qënë dhaskal Kostë Cepi, autori i një manuali didaktik[12], i njohur dhe për kronikën e shkruar në një mur të kishës së Shën Mëhillit të Vithkuqit në lidhje me shkatërrimin e qytetit. Kosta kishte marrë mësim nga nxënësi i Kavaliotit, i quajturi Sava Jeromonaku, një vithkuqar tjetër ky i studjuar në Voskopojë dhe që njihet si heroelegjist i Gramatikës së Kavaliotit, botuar në Voskopojë më 1760. Sava ka qënë një nga të parët që dha mësime në shkollën e Vithkuqit[13].

Sikundër Theodor Haxhifilipi (Dhaskal Todhri) nga Elbasani, që kreu studimet në shkollën e Voskopojës, duke qënë nxënës i Theodor Kavaliotit, i frymëzuar pa dyshim edhe nga voskopojarët që n'atë kohë treguan interes për gjuhën shqipe dhe nga edukata që mori n'atë qytet, iu përvesh përkthimit të librave fetare duke krijuar një alfabet të posaçëm, ashtu është deri diku për t'u besuar se edhe orvatjet e mëvonshme të Kostë Beratasit apo dhe të Naum Veqilharxhit etj. për përdorimin e shkrimit shqip, nuk duhen marrë të shkëputura edhe nga përpjekjet e ndikimi në një farë mase i voskopojarëve në këtë fushë. Madje, për të kuptuar thellë dobitë, ndikimet dhe rrezatimet e vatrës kulturore të Voskopojës dhe prodhimtarisë mendore të saj në të mirë të zgjimit të vetëdijes kombëtare dhe shkrimit të gjuhës shqipe, nuk është pa domethënie fakti se brënda një periudhe 50-60 vjeçare (1770-1827), që nga Kavalioti e deri tek Grigor Gjirokastriti, letërsia jonë është pasuruar me më shumë shkrime se sa kanë qënë shkruar brënda 377 vjetëve që nga koha e Skënderbeut. Le të kuitojmë dhe hartimin e 6 alfabeteve, duke përfshirë dhe atë të Vithkuqarit Naum Veqilharxhi.

Mbresat e freskëta, që kishte lënë në trevën e Korçës e gjetkë shtypëshkronja voskopojare, i shohim edhe në ato fije të lidhjeve shpirtërore me Voskopojën që duhet të ketë pasur përpjekja e mëvonshme, rreth mesit të shek. XIX, e Naum Veqilharxhit, i cili me sa duket, kishte menduar edhe për hapjen e një shtypëshkronje për librat shqipe, me shumë gjasë në qytetin e Korçës. Pavarësisht nga luhatjet dhe kundërthëniet që pati në ecurinë kulturore e mendore të Voskopojës, të cilat kanë qënë të pashmangëshme për rrethanat e kohës, nuk është pa vënd të shohim dhe një farë riperkusioni të lëvizjes mendore të Voskopojës tek rilindasi i shquar vithkuqar, që bëri thirrjen e parë për bashkimin e shqiptarëve pa dallim feje e krahine.

Naum Veqilharxhi duket se e ndiqte literaturën e kohës. Nga parathënia dhe abetarja del se e ka njohur librin e shtypur më 1797 në Vienë nga Kostandin Ukuta me origjinë nga Voskopoja, me titull «Pedagogjia e re» (abetare e lehtë për t'u mësuar nga të rinjtë arumunë), nga e cila mund të jetë ndikuar[14]. Në preceptet nga të cilat udhëhiqej Naumi kur thoshte se «një komb pa dituri u përngjet skllevërve», apo «kultura fitohet me anën e gjuhës amtare», nuk mund të mos ndihet edhe jehona e frymës së «akademikëve» të Voskopojës dhe dishepujve të tyre. Nga ana tjetër duhet marrë në konsideratë edhe fakti që, si në Voskopojë edhe në qytetin e Vithkuqit në shek. XVIII u krijua një lëvizje letrare shumë e gjallë[15]. Iluministët e dalë nga Voskopoja, po ashtu si edhe rilindasi i mëvonshëm vithkuqar Naum Veqilharxhi, kontribuan edhe për rilindjen kombëtare të popujve të tjerë ballkanas, duke qenë të frymëzuar nga idetë e vëllazërimit ndërballkanik.

Disa paralele midis këtyre dy qyteteve vërehen edhe në fushën e artit. Është për t'u shënuar se piktorët korçarë, vëllezërit Kostandin e Athanas, të cilët kanë zhvilluar një veprimtari të dëndur gjatë periudhës 1720-1783 brënda e jashtë vëndit tonë, kanë lënë gjurmë të krijimtarisë artistike, përveç të tjerave, në pikturat murale si të faltoreve të Voskopojës ashtu edhe të Vithkuqit[16]. Edhe ikonografi Kostandin

11) **Historia e letërsisë shqipe.** I. Tiranë 1959, f. 248.

12) P. Pepo. **Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit.** drsh. f. 645.

13) Sava Jeromonaku ka qënë mitropolit në Malin e Zi ku «gëzonte famë për dituri dhe virtyte... «Më vonë ka qënë mësues në Vithkuq. Katër fletë, të tëra të Gramatikës së Kavaliotit zënë 12 epigramet që i kushtohen prej 12 nxënësve mësuesit savant. Një ndër këta nxënës ësh ë dhe Sava Jeromonaku (Krh: E. Kurilla, **vep. cit.**).

14) M. Islami **Vep. cit.** f. 52.

15) Les Grece, **Les Valaques, les Albanais et l'Empire Ottomane, par un valaque du Pinde.** Bruxelles 1886, f. 70.

16) «Asht ndërtue prej themeli... dhe asht pikturue me dorën e Kostandin dhe Athanasit vllezër nga Korça në vjetin 1764» (mbishkrim mbi portën veriore përbrënda kishës së Shën Pjetrit në Vithkuq; (I.H.Gj. H. 1 10 (G.I. 9 g. 11), Shih edhe mbishkrimin e pikturuar mbi portën përbrënda në Qimiterin e Shën Pjetrit, në Vithkuq.

BOTIMOR

Shpataraku ka punuar në të dy qytetet[17]. Bie në sy në të dy këta qytete një dëshirë e madhe për të ndërtuar e pikturuar tempuj, për t'i bërë ata të hijshëm dhe të bukur. Monumentaliteti, veshja e brëndëshme, i dallojnë të gjitha faltoret e Voskopojës dhe disa të Vithkuqit, nga shumë faltore të vëndit, të mjeshtërve shqiptarë. Për këto flet edhe thadrimi i pasur në dru i shekujve XVII-XVIII. Thuajse të njëjtin zhvillim vërejmë edhe në gdhëndjen në dru të ekzekutuar në ikonostaset etj. nëpër bazilikat e të dy këtyre qyteteve[18].

Jo pa domethënie është dhe fakti që nga rreth 10 qyteza të shkretuara të rrethit të Korçës pas zaptimit turk, si Mborja, Barçi, Plasa, Piluri, Cvezda, Pojani, Shipcka, Nikolica, vetëm Voskopojës dhe Vithkuqit, që të dy vendbanime të bukur sa njeri dhe tjetri, u kanë ngelur deri në ditët tona më tepër gjurmë të kulturës materiale të qytetërimit dhe lulëzimit të dikurshëm, me gjithë valët shkatërrimtare që kanë pas përshkuar për disa herë me rradhë këto dy qendra.

Duke krahasuar analet e vjetra të Korçës, Voskopojës etj. del se të gjitha inisiativat e mëdha me karakter shoqëror e kulturor, që kanë të bëjnë si me Voskopojën ashtu edhe me Vithkuqin, kryesisht janë marrë në Korçë, në fronin mitropolitan të këtij qyteti, prej të cilit ata vareshin në të gjitha kohët[19].

Mjerisht përparimi i gjithanshëm i këtyre dy qyteteve ndërpritej nga politika social-ekonomike e feudalëve turq, e bazuar kryesisht në parimin e çveshjes së masave fshatare dhe qytetare me anën e detyrimeve të ndryshme e të taksave të shumta, Lulëzimi ekonomik e kulturor, si ai i Voskopojës ashtu edhe i Vithkuqit, nuk mund të mos joshnin lakminë e bejlerëve dhe derebejve rreth e rrotull tyre. Si pasojë e trazirave të shkaktuara nga anarkia feudale, që mbretëronte gjithandej, i plaçkitjeve që bëheshin nga ana e bejlerëve, agallarëve dhe derebejve dhe, rrjedhimisht, i emigrimit të vazhdueshëm të popullatës së tyre, që të dy këto qendra të lulëzuara pësuan të njëjtin fat për të njëjtët faktorë, duke u kthyer në gërmadha. Tre shkretime me rradhë pësoi Voskopoja brënda njëzet vjetëve, që prej vitit 1769 e deri më 1789. Po aqë rrënime pësoi dhe Vithkuqi që prej vitit 1781 e deri në shkatërrimin e tretë të 25 tetorit 1823[20].

Banorët e këtyre qyteteve të plaçkitur, djegur e rrënuar, u detyruan atëhere nga paniku i shkaktuar prej anarkisë feudale të lënë shkretë qytetet e tyre dhe të marrin rrugën e mërgimit, duke u shpërndarë ku mundën ndër vënde e qytete të ndryshme të Shqipërisë, Ballkanit dhe Evropës, me të cilët kishin krijuar deri diku lidhje nëpërmjet marrëdhënieve tregëtare; dhe kudo që vanë, që të dy palët lanë emër të mirë[21]. Edhe qendrat ku kanë mërguar voskopojarë e vithkuqarë janë thuajse po ato.

17) M. Domi. **Lëvizja kulturore e Voskopojës në shek. XVIII,** në «Shqipëria e Re» N. 4 – 1971 f. 25; Dh. S. Shuteriqi. **Shënime rreth jetës dhe veprës së Kostandin Shpatarakut,** në «Ylli» N. 12-1962, f. 33; **Piktor Kostandini nga Shpati,** në Bul. Inst. Shk. Seria shk. shoq. IX, n. 4 Tiranë 1955. Në një ikonë të Qimiterit të Manastirit të Shën Pjetrit në Vithkuq, që mban firmën e Kostandinit prej Shpati, lexohet viti 1748.

18) **Historia e letërsisë shqipe.** I, Tiranë 1959, f. 244.

19) Nga disa mbishkrime rezulton se esnafi i bakajve të Korçës pagoi më 1767 shpenzimet për pikturimin e ikonave të Vithkuqit. Në Korçë ndodhet një ndërtim me interes i bërë në v. 1848, që mban emrin Metoq, i cili ka qënë rezidenca e peshkopëve të Vithkuqit. Kurse më 1754, duke qënë si igumen Methodh Llazari nga Krekasi u ndërtua metoqi në Voskopojë, në lagjen e Skamnelit, në kishën e Apostujve të shënjtë, me shpenzimet e etërve të manastirit dhe të krishterëve (Krh. E. Kurilla. Vep. e cit. f. 101). Dokumenta përmëndin dhe një mbledhje që është bërë më 24 qershor 1728 në Mitropoli të Korçës, në ditët e Joasafit të I-rë në lidhje me një grindje që kishte lindur midis vithkuqarëve e vakëfliinjve me voskopojarët.

20) a. «Më 1781 pësoi shkatërrimin e tij të parë (P. Pepo, **Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit.** drsh., f. 334. Dok. 197).

b. «...Kurse një të dytë të tillë e pësoi më 1819... Qysh atëhere banorët e Vithkuqit u shpërndanë ndër vënde dhe qytete të ndryshme, në të cilat dhe u vendosën dhe ku akoma janë ruajtur shumë familje me origjinë vithkuqare» (P. Pepo. **Po aty**).

ç. Në shënimin që Kostë Cepi ka bërë në murin e hajatit të kishës së Shën Mëqytet ishte shkatërruar më 25 tetor 1823». (P. Pepo. Po aty, f. 645, dok. 197; (I.H. Gj. G. 1. 10.I.9; f. 29).

ç Në shënimin që Kostë Cepi ka bërë në murin e hajatit të kishës së Shën Mëhillit në Vithkuq, lexohet: «Më 1828 Gusht 18, unë Dhaskal Kostandin Cepi erdha nga Berati dhe e gjeta vëndin të prishur shtëpitë të shkretuara dhe të prishura» (Dh. S. Shuteriqi. **Bibliografia e letërsisë së vjetër shqipe,** në Bul. shk. shoq. 3 (1962) f. 117).

d. Thimi Mitko në një artikull të botuar në rev. «Pandhora» më 1860 shkruante: «Një prishje e madhe është bërë më 1823, se Vithkuqarët bashkë me korçarët erdhë në Greqi dhe ndihmuan në luftën për liri. Aristokracia turke... për dëmin e shkatërroi krejtësisht Vithkuqin, kurse Varoshin e Korçës e plaçkitën».

21) N.D.N. **Korça dhe fshatrat për qark.** Sofje 1901, f. 52.

DO NOT COPY

Sipas rrethanave dhe periudhave Vithkuqi ka qënë edhe burim forcash e mjetesh për popullzimin e fuqizimin e qytetit fqinj të Voskopojës, por ka qenë edhe strehues i voskopojarëve në rastet e shkretimeve të saj. Ka mundësi që një pjesë e botimeve më me vlerë dhe e dorëshkrimeve me prishjen e parë të Voskopojës më 1769 dhe gjëndjen e pasigurt të krijuar atje të jetë shpënë për ruajtje më të sigurtë edhe në qytetin më të afërt në Vithkuq. Në bibliotekën e pasur të manastirit të Shën Pjetrit të Vithkuqit kanë qënë deri vonë, ndërmjet të tjerave, edhe disa dorëshkrime të akademikëvet të Voskopojës, ndër të cilët shquhej nga bukurshkrimi në dy ngjyra, kuq e zi, vepra e rëndësishme e Theodor Kavaliotit me titull «Traktati logjik», Sipas Ilo Mitkë Qafëzezit, edhe ungjijtë latinisht e greqisht të shtypur në Venedik, që janë ndodhur në manastirin e sipërmë, janë shpënë atje prej bibliotekës së Voskopojës. Po aty në Vithkuq Ilo Mitka ka pas gjetur edhe një kopje shumë të rallë të fletës së ilustruar mbi Shën Janin botuar në Vjenë më 1741 me ndihmën e voskopojarëve të mërgimit dhe që përmban gravurat më të hershme të qyteteve Voskopojë, Elbasan e Berat[22], një numur të madh librash të shtypura në Shtypëshkronjën e Voskopojës, midis tyre rreth 150-200 copë të një akoluthie (shërbese fetare) të vitit 1744, një kopje të vetme të botimit «Mbi formulat e letravet dhe mbi hartime të retorikës të fort të mënçurit Theofil Koridhallojit» dhe 11 botime të tjera të Voskopojës[23].

Në Kodikun e manastirit të Shën Pjetrit të Vithkuqit, nga fundi i shek. XVIII dhe gjysma e parë e shek. XIX figurojnë mjaft voskopojarë si dhuruësa të hollash në atë manastir me rastet e panaireve fetare që zhvilloheshin aty çdo vit, sikundër figurojnë dhuruësa edhe vithkuqarë të hedhur në Voskopojë. Nga këto shënime mund të nxirret si përfundim, përveç të tjerave, se në Voskopojë është ndjerë një farë rimëkëmbje edhe pas rrebesheve që pësoi herë pas here dhe se aty gjejnë strehim edhe vithkuqarë pas prishjes së qendrës së tyre. Pra, marrëdhëniet midis këtyre dy qendrave vazhduan edhe kur ato u rrudhën në fshat-qytet-komopolis).

Me origjinë vithkuqare ka qënë, përveç të tjerëve, edhe familja e dëgjuar voskopojare e Sina-ve, që me veprimtarinë e vet ekonomike në botën e jashtme ka bërë emër. Për bibliotekën e Voskopojës, vendosur në lokalet e «Akademis së re», përmenden shumë dhurues dhe në mes tyre edhe stërgjyshi i familjes Sina, të ardhur aty nga Vithkuqi. Madje me emrin e kësaj familjeje ishte pagëzuar edhe një shoqëri e miqve të arsimit formuar më 1875 në Voskopojë[24].

Krahas edhe faktorëve të tjerë social-ekonomikë që ndikuan në zhvillimin e gjithanshëm të qyteteve të ndryshme të vëndit, pra edhe të Vithkuqit, kontributi i dhënë nga qendra e zhvilluar mesjetare e Voskopojës, zë një vënd të veçantë, si në fushën ekonomiko-shoqërore ashtu edhe në atë kulturoro-arsimore[25]. Megjithëkëto, vetëm në ndonjë dukuri duhet pohuar se vërehen edhe dallime midis këtyre dy qyteteve dhe kjo përsa i përket përbërjes etnike të popullatës së tyre. Ndërsa Voskopoja kur u themelua e ka patur popullsinë thjesht shqiptare dhe vllehët u vendosën më pas, ndryshe ndodh me Vithkuqin, i cili popullatën e ka patur krejt shqiptarë[26].

Një dallim tjetër i karakterizonte këta dy qytete në pamjen urbanistike, duke qënë Voskopoja e përqëndruar me lagjet e saj, ndërsa lagjet e Vithkuqit, ndonse në vet-vete të përqëndruara, ishin në distanca të largëta me njëra-tjetrën. Dhe teksa në Voskopojë një pjesë e lagjeve janë quajtur me emrat e patronit të kishës që ka ngritur e futur secila (lagja e shën Mërisë, e shën Kollit etj.), përkundrazi Vithkuqi, qytet që ka pas ngritur thuajse gjith aqë faltore sa dhe

22) Dh. S. Shuteriqi, **Vep. e cit.** f. 34.

23) I. M. Qafëzezi thotë se ka pasur në dorë 11 botime voskopojare, duke filluar nga botimi më i vjetër i vitit 1731 (akoluthia e Shën Theodhorës), të cilat ishin pronë e Manastirit të Shën Pjetrit të Vithkuqit (I. M. Qafëzezi, Vep. cit. f. 55).

24) I. M. Qafëzezi, **Fshati Vithkuq,** art. Në Gazetën e Korçës, v. XIV, N. 1489, shtator 1932.

25) Më 1759 igumeni Tarazi, i biri i Gjika Bukës nga lagja Qiru e qytetit Vithkuq rindërtoi nga themelet kishën e apostujve të shënjtë me narteksin dhe megjithë bukurinë siç shihet sot me shpenzime pesëqindmijë aspra, të cilat i solli nga Hungaria (E. Kurilla, vep. e cit. f. 101). «Gjatë vitit 1761 u ndërtua dhe u gdhënt e gjithë templua me shpenzimet e voskopojarëve që tregtojnë në Lehi, sasia e të cilëve është gjashtëqind groshë. Më 1763 u pikturua e gjithë kisha me duart e vëllezërve piktorë z. Kostandin e z. Athanas nga Korça kundrejt 700 groshëve, të cilat i solli përsëri nga Hungaria Igumeni Tarazi (shkurtimisht nga rev. «Eklissiastiqi Alithia» vol. XX, v. 1900, f. 518-319). Cituar nga E. Kurilla, vep. e cit. f. 101.

26) I. M. Qafëzezi, **Voskopoja e vjetërë edhe rrebeshimi i parë 1738-1769,** në «Minerva» N. 17-16 janar 1934.

DOKUMENT COPY

Voskopoja, nuk ka pasur asnjë lagje me emrat e kishave, por me emra të përveçëm, si Saraçi, Dukasi, Krekasi, Liasi, Borizhdë, Bredhasi, Rusasi, etj.

Ndërsa Voskopoja, në vazhdim të një tradite të kaluar të disa komuniteteve vllahofone, gëzonte një farë vetqeverisjeje në organizimin e vet në vartësi të drejtpërdrejtë të Valide Sulltanës (nënës mbretëreshë) dhe pra ishte me një farë pozite të privilegjuar, duke gëzuar edhe të drejtën që në këtë qytet të mos vendosej as edhe një musulman, një gjë e tillë nuk ndodhte me Vithkuqin.

Por pavarësisht nga këto dhe dallime të tjera jo të një rëndësie të dorës së parë, në drejtimet kryesore, në ecurinë e këtyre dy qyteteve të zhvilluar të mesjetës së vonë, spikatin gjërat e përbashkëta dhe ndikimet reciproke midis tyre. Faktorët dhe të dhënat që parashtruam në këtë shkrim mendojmë se janë treguesa të mjaftueshëm për të provuar marrëdhëniet dhe lidhjet e ngushta ekonomiko-kulturore midis këtyre dy qendrave fqinjë me strukturë ekonomiko-shoqërore e fizionomi arkitektonike gati të përafërt. Që të dy këto qendra dhe zonat përreth gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare u kthyen në vatra të zjarrta të qëndresës me armë kundër pushtuesve fashistë e nazistë. Në Vithkuq e në Voskopojë u krijuan formacione partizane nga më të rëndësishmet. Tanimë është i njohur kontributi i gjithanshëm i vithkuqarëve dhe voskopojarëve në këtë luftë vigane, gjatë së cilës edhe këto dy qendra u dogjën krejtësisht prej fashistëve. Por, si gjithë vëndi i rindërtuar e përtëritur edhe të dy këta vëndbanime po marrin frymë lirisht në atmosferën e epokës së socializmit, duke ecur përkrah popullit tonë në rrugën e ndritur ku na udhëheq me vendosmëri e largpamësi Partia e jonë e Punës.

DO NOT COPY

Stilian ADHAMI

DO NOT COPY

LES RAPPORTS ECONOMIQUES, SOCIAUX ET CULTURELS ENTRE VITHKUQ ET VOSKOPOJE PENDANT LA PERIODE DE LEUR EPANOUISSEMENT

RESUME

Vithkuq et Voskopoje, qui ont avancé ensemble sur la voie du progrès pendant un siècle, ont plusieurs éléments en commun. Les rapports entre ces deux villes moyenâgeuses voisines, séparées l'une de l'autre rien que de 18 km de distance, assument presque les traits d'un binome, qui, au cours des siècles, ont subi l'influence de facteurs analogues dans leur développement multilatéral, tout comme des motifs et des circonstances plus ou moins analogues ont provoqué leur déclin jusqu'à la perte de leur physionomie urbaine.

L'auteur du présent article s'appuyant sur la culture matérielle de ces deux villes (désormais réduites à des villages) ainsi que sur d'autres sources, met en évidence certaines caractéristiques des rapports qui ont existé entre ces deux centres dans différents domaines.

Selon les chroniques et les inscriptions des temples, aussi bien Voskopoje que Vithkuq sont citées comme «politie», soit des villes ayant des maisons et une population nombreuse, et cela à une époque (le XVIIIe siècle) que les villes voisines de Korça et de Kostur n'avaient que 300-400 maisons. C'est au XVIIIe siècle surtout que ces centres ont connu leur plus grand développement économique et culturel, chacune d'elles disposant de plusieurs quartiers, des corporations d'artisans et déployant une vaste activité commerciale. Par ailleurs, Vithkuq comme Voskopoje se firent un renom à l'époque en tant que villes connaissant un niveau de développement élevé caractérisé par l'architecture avancée des maisons et des édifices de culte, par le vaste mouvement culturel et d'instruction, par la décoration des temples et des autres ouvrages artistiques, sans mentionner le développement impétueux du commerce et de l'artisanat.

Les habitants de ces contrées, disposant de riches pâturages et d'un élevage développé, s'occupaient surtout du travail de la laine, des peaux et des produits laitiers. Ces produits étaient recherchés non seulement sur le marché intérieur, mais aussi sur celui extérieur, où opéraient plusieurs commerçants originaires de Korça, Voskopoja et Vithkuq.

Les corporations, ces organisations économico-sociales englobant des artisans, des commerçants et d'autres personnes déployant une ou plusieurs activités économiques, furent dans le temps assez puissantes d'abord à Voskopoje puis à Vithkuq aussi.

Parmi les métiers connaissant une plus grande diffusion dans ces deux villes, il convient de mentionner la corporation des artisans qui s'occupaient du travail des métaux. Une place à part occupe la corporation des chaudronniers à Voskopoje et à Vithkuq, où un quartier de cette ville s'appelait «Kovaças».

Disposant de marchés, de magasins et d'auberges pour les gens aisés des régions environnantes, ces deux villes voisines commerçaient entre elles et avec Korça qui n'était pas distante. A un jour fixe de la semaine les gens du pays vendaient au marché leurs productions végétales, animales et des produits d'épicerie. Par suite de leur consolidation économique, ces deux centres étendirent leurs rapports économiques avec d'autres centres importants des Balkans et d'Europe. Dans la correspondance commerciale échangée à l'époque avec Venise, une bonne part des commerçants dénommés «mercanti albanesi» sont originaires de Voskopoje et de Vithkuq.

La consolidation économique de ces deux villes entraîna un développement sensible dans le domaine de l'instruction, des arts et de la culture. Les habitants de ces contrées ont toujours consacré un grand intérêt à l'instruction, à la culture progressiste en général et à l'écriture de la langue albanaise en particulier. Le mouvement idéel, culturel et d'instruction, qui s'amorça et se développa dans la ville moyenâgeuse de Voskopoje au XVIIIe siècle, fut largement soutenu par les populations des contrées voisines. Par suite de l'installation d'une imprimerie, de la fondation du collège dénommé «Nouvelle Académie» et d'autres établissements socio-culturels, Voskopoje se transforma en un important foyer de civilisation et de culture qui exerça une influence puissante dans tout le pays. Nombreux sont les habitants de Vithkuq qui ont fait leurs études et travaillé à Voskopoje.

C'est au cours de cette même période de temps, pendant les XVIIe-XVIIIe siècles, que Vithkuq aussi, avec une population presque autochtone, emprunte la voie du progrès tout comme Voskopoje. C'est grâce aux subsides recueillis dans le pays et aux aides fournies par leurs habitants émigrés à l'étranger qu'il

DO NOT COPY

fut possible de construire des édifices de culte majestueux à Voskopoje et à Vithkuq, dont le nombre était de 20 dans la première ville et non moins de 12 dans la deuxième. Dans certains de ces temples ce sont les mêmes artistes de talent du pays qui y ont exécuté les peintures murales. Le monastère de Shën Prodhom à Voskopoje rivalise avec celui de Shën Pjetër à Vithkuq, tout comme sont semblables par leur architecture, leur ornementation et leurs dimensions la basilique de Shën Mëhill à Vithkuq et les basiliques de Voskopoje.

La culture de Voskopoje ne doit être aucunement envisagée comme détachée de la culture en général du domaine albanais, du fait que dans la zone avoisinante virent le jour et se développèrent des cités et des citadelles moyenâgeuses, entre autres Vithkuq, Niça, Llënga, Grabova, Nikolica. Aussi doit-on la considérer comme une culture au développement de laquelle ont activement contribué les habitants de ces contrées.

Le développent simultané de plusieurs villes dans l'Albanie centrale et méridionale, comme Elbasan, Berat et Janina, qui devinrent aussi des foyers de communication en langue albanaise pendant le XVIIIe siècle et le début du XIXe, ainsi que le mouvement idéel du triangle Korça-Elbasan-Gjirokastra, tous ces facteurs considérés en relation avec les transformations que connut la situation économique et sociale de tout le pays, alors qu'une nouvelle classe sociale, la bourgeoisie artisanale et commerçante, était en train de faire son apparition, montrent combien fausse est l'interprétation des auteurs étrangers qualifiant Voskopoje d'«oasis dans un désert».

Vithkuq a de tout temps entretenu des rapports avec Voskopoje dans le domaine du commerce, de la culture et de l'instruction, et elles ont procédé entre elles à des échanges réciproques. A cet égard, l'auteur du présent article rappelle la contribution apportée par les livres publiés à Voskopoja et notamment l'activité d'instruction et d'éducation déployée par le collège «la Nouvelle Académie» et par les autres établissements d'enseignement et culturels. Nombre de jeunes de Vithkuq ont non seulement fréquenté les établissements scolaires de Voskopoje, mais, éduqués dans leur esprit, ils ont contribué aussi à la diffusion de la langue et de l'écriture albanaises, précisément à l'époque où le grand Naum Veqilharxhi était encore jeune. A ce point l'auteur de cet article mentionne les représentants les plus en vue de l'intelligentsia de Vithkuq, dont la formation culturelle se rattache étroitement aux établissements scolaires de Voskopoje. De leur nombre le plus illustre est Jano Strati, surnommé Eustrat Vithkuqari, qui a non seulement fait ses études à Voskopoje mais exercé aussi les fonctions de directeur de l'école de cette ville jusqu'en 1880 après la mort de Kavalioti.

Rappelons à ce propos que Eustrat Vithkuqari, qui a appris la langue albanaise au consul anglais W. Leake et collabora avec lui à la rédaction du dictionnaire albanais-anglais-grec, s'est inspiré à cet égard de l'oeuvre de Dhanil Haxhi Voskopojari.

Une autre figure éminente originaire de Vithkuq, qui a fait ses études à Voskopoje et s'est occupé de l'enseignement de la langue albanaise, en écrivant des chroniques historiques et ecclésiastiques en albanais, est Maître Koste Cepi auteur d'un manuel didactique et de la chronique écrite sur le mur de l'église de Shën Mëhill à Vithkuq en relation à la destruction de cette ville. Kosta fut l'élève de Sava Jeromonaku, à son tour élève de Kavalioti, un autre habitant originaire de Vithkuq qui avait fait ses études à Voskopoje et avait collaboré à la rédaction de la «Grammaire» de Teodor Kavalioti, publiée en 1760 à Voskopoje. Sava fut un des premiers à donner des leçons à l'école de Vithkuq.

Par ailleurs, même l'activité déployée par Theodhor Haxhifilipi (Dhaskal Todhri) à Elbasan, et plus tard les tentatives entreprises par Koste Beratasi ou Naum Veqilharxhi pour la diffusion de l'écriture albanaise, ne peuvent être aucunement détachées des efforts et de l'influence des personnalités voskopojares dans ce domaine.

Les traces ineffaçables que l'imprimerie de Voskopoje avaient laissées dans la contrée de Korçe et ailleurs, nous les retrouvons aussi dans les liens spirituels qui se rattachent aux efforts entrepris plus tard, vers la moitié du XIXe siècle, par Naum Veqilharxhi, qui avaient envisagé la possibilité d'ouvrir une imprimerie, selon toute probabilité à Korçe, dans le but de pourvoir à la diffusion du livre albanais.

Selon toute vraisemblance, Naum Veqilharxhi était au courant de la littérature de l'époque. Son abécédaire et la préface de celui-ci indiquent qu'il avait lu la «Pédagogie nouvelle», publiée à Vienne par Kostandin Ukuta, originaire de Voskopoja. et qu'il se soit inspiré à cet ouvrage. Les préceptes sur lesquelles se guidaient Naum Veqilharxhi, lorsqu'il disait qu'«une nation sans lumières ressemble à des esclaves» ou que «la culture s'acquiert à travers la langue maternelle», reflètent l'esprit des «académiciens» de Voskopoje et de leurs disciples. Par ailleurs, il convient de relever que pendant le XVIIIe siècle tant Voskopoje que Vithkuq ont été le siège d'un mouvement littéraire très animé. Les illuministes de Voskopoje, tout comme l'illustre personnalité de notre Renaissance nationale Naum Veqilharxhi, originaire de Vithkuq, ont contribué à la renaissance nationale des autres peuples balkaniques, étant inspirés par les idées de fraternité interbalkanique.

On observe certains parallèles entre ces deux villes dans le domaine des arts aussi. Il convient de relever que les frères Kostandin et Athanas Korçari, éminents peintres ont déployé, pendant la période allant de 1720 à 1783, dans le pays et à l'étranger une activité intense dont les traces se retrouvent particulièrement dans les peintures murales des églises de Voskopoje et de Vithkuq. L'iconographe Kostandin Shpataraku, lui aussi, a travaillé dans ces deux villes. Leur aspect monumental, la décoration de leur intérieur sont précisément les traits qui distinguent toutes les églises de Voskopoja et certaines de Vithkuq des autres édifices de culte du pays. En témoigne aussi le travail soigné du bois notamment dans les iconostases, etc., caractéristique celle-ci des maîtres albanais.

Significatif aussi est le fait que des 10 cités réduites en ruine après l'occupation ottomane, entre autres Mborja, Barç,

Plasa, Zvezda, Pojan, Shipcka, Nikolica, seulement Voskopoje et Vithkuq, deux agglomérations urbains l'une plus belle que l'autre, conservent à ce jour encore plus de traces de la culture murale de la civilisation et de l'épanouissement d'antan, malgré les vagues destructrices qui se sont abattues sur ces deux villes.

En confrontant les anciennes annales de Korçe, de Voskopoje et d'autres villes, il ressort que toutes les grandes initiatives de caractère social et culturel, se rapportant à Voskopoje et à Vithkuq, ont été prises à Korçe par le métropolite de cette ville de laquelle relevaient ces deux cités.

L'essor économique et culturel de ces deux villes ne pouvait pas ne pas attirer les convoitises des beys des régions avoisinnantes. Conséquemment aux troubles provoquées par l'anarchie féodale, au pillage dont ils étaient constamment l'objet et à l'émigration de leurs habitants, ces deux centres florissants ont subi le même sort et finirent par tomber en ruine. Pendant l'intervalle de vingt ans, de 1769 à 1789, Voskopoje a été l'objet de trois destructions successives. Le même sort fut réservé à Vithkuq depuis 1781 au 25 octobre 1823, date à laquelle elle fut détruite pour la troisième fois.

Les habitants de ces villes, saccagées, brûlées et réduites en ruine par les ennemis, furent contraints d'emprunter la voie de l'émigration pour échapper à l'anarchie féodale; ils se rendirent dans différentes autres villes d'Albanie, des Balkans et d'Europe, avec lesquelles ils avaient entretenu des relations de commerce. Partout ils ont travaillé avec diligence et se sont faits un renom. Les habitants de Voskopoje et de Vithkuq ont émigré aussi presque dans les mêmes centres.

Ensuite l'auteur du présent article montre par certains exemple que dans des circonstances données et dans des périodes déterminées Vithkuq a été non seulement une source de force et de moyens pour le peuplement et le renforcement de la ville voisine de Voskopoje, mais qu'elle a servi aussi d'abri aux habitants de celle-ci dans les cas de dévastation. Les rapports entre ces deux agglomérations urbaines se sont poursuivis même lorsque celles-ci se sont réduites à une comopolis.

Par ailleurs, l'auteur relève aussi certains phénomènes caractérisant les différences qui existent entre ces deux villes quant à la composition ethnique de leur population. Alors que Voskopoje avait à sa fondation une population entièrement albanaise et que les valaques qui s'y établirent par la suite constituèrent plus tard la plus grande partie de sa population urbaine, les choses se passent différemment avec Vithkuq qui avait une population entièrement albanaise.

Un autre trait distinctif entre ces deux villes est le fait que les quartiers de Voskopoje, du point de vue urbanistique, se trouvaient l'un près de l'autre, alors qu'à Vithkuq ils sont distants l'un de l'autre. Par ailleurs, à Voskopoje chaque quartier porte le nom du patron à qui est dédiée l'église qui s'y trouve, tandis qu'à Vithkuq les différents quartiers ont un nom propre.

Enfin l'auteur de cet article souligne que ces deux villes et les zones environnantes se sont transformés pendant la Lutte antifasciste de libération nationale en des foyers de la résistance armée contre les occupants fascistes et nazis. C'est à Vithkuq et à Voskopoje que furent créées d'importantes formations de partisans. Désormais c'est un fait connu que les habitants de ces deux cités ont apporté une contribution importante à cette lutte gigantesque, et que celles-ci ont été entièrement incendiées par les fascistes. Mais comme le reste de notre pays, qui a été reconstruit et renouvelé, ces deux agglomérations urbaines aussi mènent à présent une vie libre dans l'atmosphère de l'époque du socialisme, en avançant aux côtés de notre peuple, sur la voie lumineuse que nous indique notre Parti du Travail avec fermeté et clairvoyance.

BOOK COPY

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

RESTAURIMI I DY BANJAVE MESJETARE NË VENDIN TONË

Ndërmjet ndërtimeve shoqërore të qyteteve tona mesjetare, banjat (hamamet) zinin një vend të rëndësishëm, por faktori kohë dhe transformimet e vazhdueshme të qëndrave të banuara kanë bërë që deri në ditët tona të arrijë një numur i vogël i tyre, në raport me përhapjen e gjerë që ka pasur kjo gjini e ndërtimeve shoqërore tek ne. Banjat e ruajtura i takojmë në Elbasan (2), Durrës, Shkodër, Krujë, Gjirokastër, Çorovodë (Sllatinjë) dhe Lezhë, disa prej të cilave ruhen në gjëndje të mirë dhe disa të tjera të rrënuara. Kufijtë kohorë të ndërtimit të këtyre banjave në vendin tonë shkojnë nga shekulli XV e deri në shekullin XIX. Duke kaluar nëpër Shqipëri në shekullin XVII, udhëtari turk Çelebi që më 1672 përmend dy banjat e Elbasanit, që egzistojnë edhe sot, dy banja në Berat (sot të shkatërruara), banjën në lagjen Meçite të Gjirokastrës si dhe shumë banja familjare në Berat, Kavajë, Elbasan, etj.[1]

Në këtë artikull do të bëjmë fjalë për restaurimin e dy banjave tona mesjetare, të banjës së vjetër të pazarit në Elbasan dhe të banjës së vogël në lagjen Parrucë të Shkodrës.

Banja e Vjetër e Pazarit — Elbasan
Gjendja para restaurimit

Gjatë shekullit XVI Elbasani ka qënë një nga qendrat më të rëndësishme administrative dhe ekonomike të vendit tonë. Nga burimet historike rezulton se në mezin e shekullit XVII, ai kishte mbi 20 lagje me rreth 4000 shtëpi[2] dhe një pazar të zhvilluar me një numur të madh dyqanesh[3].

Banja (hamami) e Pazarit është ndërtuar në qendër të qytetit ngjitur me xhaminë e Agajt, nga gjysma e dytë e shekullit XVI. Në dokumentat historike thuhet se në vitin 1606 në godinën e madhe të hamamit të Elbasanit, qiraja shkonte deri në 1300 akçe në vit d.m.th. gati 5 akçe në ditë[4]. Kështu hamami ishte si sipërmarrje në dorën e ndonjë pronari, i cili i paguante qiranë administratës shtetërore. Kjo banjë publike, që në unitet me xhaminë formonte një kompleks arkitektonik tipik për kohën, ka skemë të plotë funksjonale dhe ka funksjonuar deri në vitet 40 të shekullit tonë. Ajo është çfrytëzuar si tek hamam, pra vetëm për një seks. Një herë në javë, të enjteve, funksjononte vetëm për gratë.

Nga pikpamja arkitektonike banja e pazarit, në gjysmën e volumit të saj, mbulesa e çatisë është realizuar prej disa kupolash të vogla, të cilat të ndërtuara me lartësira të vogla e bëjnë të larmishme siluetën horizontale arkitektonike të banjës dhe thyejnë atë monotoni që krijohet nga sipërfaqet e mbyllura (pa dritare) masive të mureve. Variacioni dhe loja e disa lloj kupolave, në harmoni midis tyre, tipike për banjat (hamamet) publike spikasin dhe në hamamin e Elbasanit, ku si në çdo banjë tjetër për arsye funksjonale hapje dritaresh vërehen vetëm në volumin e ambjentit të çveshjes (hyrjes) ku nuk kryhet procesi i larjes.

Në vija të përgjithëshme hamami i Elbasanit përbëhet prej dy volumesh kryesorë, (fig. 1) nga volumi

1) E. Çelebiu, **Shqipëria para dy shekujsh,** Tiranë 1930, 10, 8, 64, 34, 94, 105.
2) Z. Shkodra, **Esnafët Shqiptarë,** Tiranë 1973, 46
3) E. Çelebiu, **vep. cit.,** 107.
4) Z. Shkodra, **vep. cit.** 74.



Fig. 1

që krijon ambjenti i çveshjes (hyrjes) me përmasa në planimetri 11,3 x 12,4 m mbuluar me çati druri dhe nga volumi ku përfshihen ambjentet e larjes, të mbuluara me kupola, me përmasa 13,5 x 13,6 m. Sipas rradhës funksjonale ambjentet që përbëjnë hamamin janë:

1 – Ambjenti i çveshjes (hyrjes) ku qëndronin klientët para e pas banjës për çaj e biseda dhe ku kryhej çveshja e pjesëshme dhe paisja e tyre me inventarin e nevojshëm për larjen, si nallane, peshqire, etj; (fig. 2).

2 – Ambjenti ndërmjetës, ku në një sofat të ngritur nga dyshemeja klienti përgatitej për banjën. Ky ambjent shërbente dhe për adaptimin e klientit, që kalonte nga temperatura e zakonshme e ambjentit të hyrjes në temperaturën e lartë të ambjenteve të larjes si dhe anasjelltas.

3 – Nyja sanitare.

4 – Ambjenti i pastrimit. Të dy këto ambjente lidhen direkt me ambjentin ndërmjetës.

5 – Ambjenti kryesor i djersitjes e i larjes, ku nëpër vaska kryhej larja. Dy rubineta, derdhin ujin e ftohtë e të nxehtë në vaskë ku klienti ulur mbi fron pasi e përgatiste e hidhte me tas mbi trup.

6 e 7 – Në shpinë të ambjentit të sipërm ndodhen dy ambjente të veçanta për larje të paisura me nga dy vaska secila.

8 – Ambjenti i fundit i banjës është depozita e ujit (stera) me gjerësi sa ajo e hamamit. Banja e p zarit i ruan dhe gjithë elementet e ngrohjes e të f nizimit me ujë si furrën nga prapa për ngrohjen e të depozitës, kanalet e nëndyshemesë për ngrohjen ambjenteve me gazet e furrës, (hipokausti), tubat ar sore vertikale prej qeramike (oxhaqet) nëpër mu për daljen e tymrave të furrës pas qarkullimit nën sheme, tubacionet e qeramikës për furnizimin me të vaskave, etj.

Nga pikpamja teknike banja ruhej mjaft e dë tuar. Mbulesa me tjegulla kishte shumë pjesë të dë tuara, suvatimet e jashtme të mureve ishin në gjën shumë të keqe, gjithashtu dhe ambjenti rrethues i sistemuar influenconte mjaft në pamjen e monume tit (fig. 3).

Nga ana konstruktive muret me llaç balte të p sës së hyrjes kishin plasaritje ndërsa çatia e drur e saj kishte kalbëzime. Pjesë të kalbura kishte dhe elementet e drunjtë të ambjentit të hyrjes si në ta nin me dërrasa dhe në llozhën e ngritur në një qo të ambjentit për klientët e privilegjuar. Ambjente banjës ruheshin në gjëndje të mirë, me dëmtime vogla në suvatimin me llaç shamot. Qemeri cilin që mbulon sterën e ujit kishte një plasje aksiale kyç.

Në këto kushte lindte domosdoshmëria e ndërhyrjeje restauruese me qëllim që monumenti kthehej në një gjëndje të mirë teknike si dhe që

DO NOT COPY

ana e jashtme ai të fitonte një pamje sa më estetike dhe në brendësi të mund të sigurohej vizitueshmëria e gjithë ambjenteve përbërës. Në këtë mënyrë monumenti do të qëndronte shumë më mirë në zgjidhjen e re urbanistike të qendrës së qytetit të Elbasanit, duke u lidhur me hotelin dhe me sipërfaqen e gjelbëruar e rrugët rreth vetes.

Punimet e restaurimit

Banja e vjetër e pazarit në Elbasan pati problematikën e saj lidhur me restaurimin, e cila konsistonte në trojtimin arkitektonik të jashtëm e të brendshëm që do të merrte ambjenti i hyrjes, që përbën dhe volumin e veçantë më të madh të banjës. Në fazën para restaurimit ky ambjent përbënte një volum kubik një katësh me hyrje nga perëndimi, i mbuluar me çati druri me katër kullime uji. Ambjenti merrte dritë nëpërmjet nëntë dritareve formë sopraluçe, të hapura nga tre në çdo mur perimetral pikërisht nën nivelin e strehës së çatisë. Në qoshen jug-lindore ambjenti kishte një derë të vonë, prej nga merrej prushi i furrës për vend-zjarrin ku përgatitej çaji për klientët (fig. 2).

Për të sqaruar fazat e ndërtimit të këtij ambjenti si dhe lidhjen në kohë të tij me volumin e pasëm të banjës të mbuluar me kupola të gurta, në të ndërmorëm disa sondazhe.

Në fillim çveshëm suvanë e brendshëme në pjesët e mureve që lidhin të dy pjesët e banjës, pjesën me çati druri me atë me kupola. Gjatë sondazhit vumë re se nga pjesa me kupola, në një vijë me muret e pjesës së hyrjes, nisnin dy mure që për arsye prishjeje ndërpriten rreth 30 cm pas daljes për tu li-



Fig. 2

DO NOT COPY



Fig. 3

dhur me murin e ri në vazhdim të ambjentit të hyrjes. Vërejtëm se këto dy zgjatime lidheshin organikisht me murin ballor nga veriu të pjesës me kupolë prej nga dhe dalin. Gjithashtu dalluam në qoshen e skuadruar të lidhjes së dy mureve atij të volumit me kupola dhe murit të zgjatuar deri në 30 cm në drejtim të murit të ambjentit të hyrjes, të njëjtën suva, llaç shamot me pluhur të kuq. Fragmentet e zgjatura deri në 30 cm që dalin si vazhdim nga muri ballor verior i pjesës me kupola (fig. 2) janë mure guri me llaç gëlqere, ndërsa më tej muri i lidhur me to i ambjentit të hyrjes (më i vonë) vijon me llaç balte. Që këtej del se si volum ambjenti i hyrjes ka egzistuar njëkohësisht me volumin me kupola, por rezulton gjithashtu se në gjëndjen e sotme pjesa me çati druri përbën një rindërtim me teknikë tjetër nga ajo e fazës origjinale të saj. Në qoshen juglindore të ambjentit të hyrjes nga jashtë mundëm të bëjmë një krahasim të themeleve të të dy pjesëve. Themeli i pjesës me kupola është ndërtuar me gurë të mëdhenj lumi të rrumbullakët e të mëdhenj të lidhur me llaç gëlqere. Ai i volumit të hyrjes në qoshen e lidhjes me të vjetrin është po me gurë lumi të rrumbullakët të mëdhenj por të lidhur me baltë. Më tej nën murin e ri me llaç balte të këtij ambjenti ndodhet një themel me gurë të rrumbullakët të vegjël i lidhur me llaç balte, me fuga të mbushura me guriçka e copa tjegullash. Duke u bazuar në teknikën e themeleve konkludojmë se ndërtimi i ambjentit të hyrjes ka kaluar nëpër dy faza. Në fazën e parë, që lidhet në kohë me pjesën me kupola, themeli i pjesës së hyrjes është ndërtuar me po atë lloj e madhësi guri si dhe pjesa me kupola, ndërsa lidhësi këtu është llaç balte e jo gëlqereje si tek ambjentet e banjës. Në një fazë të dytë të ndërtimit të pjesës së hyrjes themeli i vonë është me gurë të vegjël të lidhur me llaç balte.

Fakti që lidhësi i themelit më të vjetër të ambjentit të hyrjes është llaç balte e jo gëlqereje të bën të mendosh se ambjent hyrjeje nuk ka patur që në fillim, por po të bazohemi tek lidhja organike e mureve të të dy pjesëve në qoshet, siç e argumentuam më sipër si dhe në një farë mase tek vetë lloji dhe madhësia e gurëve të themelit me baltë, të ngjashëm me themelin me gëlqere, ahere përsëri konkludojmë se ambjenti i hyrjes ka egzistuar njëkohësisht me pjesën me kupola, por ai është ndërtuar me themel me lidhës balte për arsye të ngarkesave jo të mëdha statike të mbulesës (çati druri e jo kupola) siç do ta argumentojmë më poshtë e ndoshta edhe për arsye ekonomike.

Megjithatë na mbetet një pikë e pasqaruar mirë. Rezulton se muri i vjetër me llaç gëlqereje i pjesës hyrjes (zgjatimi 30 cm nga muri i pjesës me kupola) është i ngritur mbi themele me llaç balte. Në se ka qënë i tillë që në fillim apo dhe në themel është vënë dorë disa herë, pikërisht këtu kemi një paqartësi, sidoqoftë shumë i qartë është fakti që hamami i pazarit ka qënë i ndërtuar që në fillim me ambjent hyrje për çlodhjen e klientëve.

Problemi kryesor që lindi gjatë studimit të këtij objekti ishte se si ka qënë zgjidhur konstruksioni i mbulesës së çatisë nën ambjentin e hyrjes. Në gjëndjen e sotme ky ambjent mbulohej me çati druri me katër kullime uji, konstruksion ky i vonë (fig. 3). Sipas thënieve të vendasve që kanë shërbyer në këtë banjë shumë vite më parë ky ambjent ka qënë me dy kate dhe mbulohej po me çati druri.

Në se ka qënë e mbuluar me çati druri apo me kupola faza fillestare e ambjentit të hyrjes, për këtë nuk mund të japim një mendim të prerë aq më tepër që muratura e saj e sotme është e re, me llaç balte e breza druri. Në pjesën e çatisë ku lidhen ambjenti i hyrjes me atë me kupola, nuk shihet ndonjë gjurmë tamburi kupole. Duke u nisur nga kjo si dhe nga egzistenca e themelit të vjetër me llaç balte nën ambjentin e hyrjes, në se do ta mendojmë këtë themel të tillë që në fillim, i cili nuk mund të përballojë ngarkesat statike të një sistemi të rëndë konstruktiv të një mbulese me qemere e kupola, mendojmë se ka më tepër mundësi që çatia e ambjentit në fjalë të ketë qënë me konstruksion druri që në fillim, sigurisht i riparuar herë pas here deri në ditët e sotme.

Për sqarimin e funksionit të ambjentit të hyrjes si dhe të ambjenteve të larjes, kryem disa sondazhe në to. Pjesa e hyrjes në brendësi poshtë gjatë mureve ka një sofat të gurtë me gjerësi 1,5 m dhe lartësi

DO NOT COPY

70 cm nga niveli i dyshemesë, vend-ndenje mbi rrogoza gjatë funksjonimit të banjës. Balli i sofasë paraqiste një faqe të suvatuar vonë me llaç çimento. Pas sondazheve doli se në ballët e sofasë kanë qënë hapur disa kamare, ku vendoseshin sende të inventarit të banjës (nallanet) (fig. 2).

Vërejtëm se këto kamare si dhe ballët e sofasë kanë qënë të suvatuara me llaç shamot (me tjegull të pluhurosur). Në mezin e sofasë nga muri lindor (ana e hotelit) vërejtëm një ndërprerje të saj, ku është një shteg kalimi, që lidhej me egzistencën e një dere në mezin e murit lindor, gjurmët e së cilës dollën qartë pas çveshjes së suvasë së murit (fig. 2). Nga brënda dera mbulohej me arkitra druri ndërsa nga jashtë nuk ruheshin gjurmë të arkitraut. Në dysheme në drejtim të linjës ku ndërpriteshin dy llojet e themeleve të ambjentit të hyrjes, themeli me gurë të mëdhenj nga ai me gurë të vegjël, kryem një sondazh për të gjetur ndonjë kthesë themeli që do të shënonte kufizimin verior të ambjentit të hyrjes, por nuk konstatuam diçka të tillë, pra ambjenti i hyrjes që në fillim duhet të ketë pasur shtrirjen planimetrike që ka sot.

Punimet e restaurimit në këtë monument u kryen me faza dhe filluan në tremujorin e IV-të të vitit 1973 e mbaruan në tremujorin e parë të vitit 1975. Në fillim u kryen punime në pjesën e pasme me kupola. Për evidentimin e teknikës së mureve dhe për një vlerësim më estetik të monumentit çveshëm muret e jashtme nga suvatimi, që ishte i vonë dhe mjaft i dëmtuar. Në këtë aspekt u trajtuan me kujdes si gurët ashtu dhe fugat në mënyrë që mos të mbetej asnjë mbeturinë suvaje dhe teknika të dilte e qartë (fig. 4). U riparua krejtësisht mbulesa me tjegulla e kupolave, ku dhe u vendosën globet e xhamit në vrimat e kupolave që ndriçojnë ambjentet, ku dritaret mungojnë krejtësisht. Duke u bazuar në gjurmët egzistuese u suvatuan tamburet e kupolave me llaç shamot me përbërje: një masë e gjysëm tjegull e shtypur (e bluar), një masë brumë gëlqere dhe rreth çerek mase me çimento të bardhë (fig. 5). U konsolidua me beton të imët plasja aksiale e kyçit të qemerit cilindrik të depozitës së ujit. Gjatë mbulimit me tjegulla të sterës u riformuluan me kujdes strehët anësore (tërthore) të saj me rrasa guri shtufi sipas teknikës origjinale (djathtas) e me tjegulla (majtas). Në fasadën e pasme të banjës u riparua me tulla qemeri i furrës si dhe oxhaku mbi të (fig. 4). Gjatë riparimit të çatisë u rivendosën në vëndet ku mungonin tubat vertikale të qeramikës, që ngrihen paksa mbi nivelin e tjegullave dhe që shërbenin si oxhaqe për daljen e tymit të hipokaustit (nëndyshemesë), i cili niste nga furra, qarkullonte nën dysheme për ngrohjen e saj dhe dilte në hapsirë me anën e tubave të maskuar nën suvanë e mureve. Për këtë qëllim zëvëndësuam gjashtë tuba-



Fig. 4



Fig. 5

-oxhak të thyera në mbulesën e sterës me tuba identike me origjinalet të prodhuara nga qeramika e Kavajës si dhe njëzet copë të tjera në kanalet e çatisë midis kupolave (fig. 5). Ambjenti i madh i djersitjes mbulohet me një kupol sferike më të madhe se të tjerat, ku në majën e saj koncentrike me të ngrihet një tjetër kupol e vogël. Suvatimi i jashtëm i këtyre kupolave u krye me llaç izolues shamot.

Në brendi të pjesës me kupola u kryen disa punime të vogla; u kruajtën muret nga sherbeti i gëlqeres, u riparuan pjesë të suvatimit me shamot në ambjentin ndërmjetës si dhe u mbyll me rrasa guri një pjesë e hapur e dyshemesë po në këtë ambjent. Në ambjentin e majtë të larjes mbi njerën nga vaskat kryem një sondazh në mur duke zbuluar dy tubat e qeramikës që furnizonin vaskat, i sipërmi për ujin e ftohtë me diametër 110 mm dhe i poshtmi për ujin e nxehtë me diametër 120 mm, të cilat i lamë në gjën-

PO KOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

dje të ekspozueshme. Këto ishin punimet e fazës së parë që e vlerësuan mjaft pjesën me kupola të hamamit. Nga përshkrimi që kemi bërë më sipër në artikull delte se problemet më të mëdha për restaurim i paraqiste ambjenti i hyrjes, i mbuluar me çati druri dhe i transformuar e i dëmtuar në kohë[5]. Muret e këtij ambjenti ishin të dëmtuara nga ana konstruktive, me plasje dhe mufatje nga brënda në pjesë të ndryshme të tyre. Gjatë riparimit të mureve duke pasur paraysh se në gjëndjen e sotme ato janë të një



Fig. 8

faze të vonë (me llaç balte), përdorëm llaç gëlqere për të siguruar një lidhje më të mirë të tyre. Riparuam gjysmën e brëndëshme të trashësisë së murit verior me lartësi nga sofati deri në tavan dhe shtrirje rreth 3 m, i cili kishte mufatje nga brënda. Gjatë punimit në mur bëmë dhe zëvëndësimin e brezave të drurit të kalbur si dhe një brez antisizmik betoni në kreun e murit. Mbyllëm me mur derën e hapur vonë në qoshen jug-lindore të ambjentit, prej nga vinte prushi i furrës për vatrën e improvizuar në atë qosh, e cila qe kapur në mënyrë të tillë që e dëmtonte mjaft pamjen e jashtme të ambjentit nga kjo anë. Duke u bazuar në gjurmët egzistuese, të evidentuara pas sqarimit të formës së sofatit në interjer, hapëm derën në mezin e murit lindor, që nga brënda e mbuluam me arkitra druri sikurse dhe ishte, ndërsa mbulesën nga jashtë e zgjidhëm me hark guri si dhe dera egzistuese nga perëndimi. Të dy dyert e ambjentit të hyrjes i paisëm me kanate të reja me hapje dy flegërshe me nga tre zemra e me gozhdë kovaçi në fashaturat ndarëse, teknikë kjo e njohur tek dyert e vjetra.

Dritaret egzistuese të ambjentit të hyrjes, formë sopraluçe rrëzë strehës, ishin të vona pasi i takonin murit me llaç balte të fazës së dytë (fig. 6). Vendosëm që dritaret e ambjentit ti trajtonim ndryshe nga ato që gjetëm, sa i takon formës, madhësisë, lartësisë së vendosjes dhe numurit të tyre duke u bazuar së pari në kërkesat funksjonale të vetë këtij ambjenti si dhe në krahasim tipologjik. Pasi në ambjentet e hyrjes së banjës, shpesh herë kryhej dhe procesi i çveshjes dhe veshjes së klientave, duhej që këto ambjente të

5) Për res'aurimin e këtij ambienti falenderoj shokët Gani Strazimiri dhe Latif Lazimi që ndihmuan me mendimet e tyre në zgjidhjen volumore dhe arkitektonike të variantit të zbatuar të ambjentit të hyrjes.



Fig. 9



Fig. 10

mos ishin të ftohta pra të mos kishin shumë sipërfaqe komunikuese me ambjentin e jashtëm, njëkohësisht fanatizmi i kohës diktonte që nga jashtë të mos mund të shihej në brëndësi, prandaj dhe ato mbuloheshin me kafazlije nga jashtë. Duke u nisur nga këto menduam që dritaret ti bënim jo shumë të mëdha e të ngritura në lartësi.

Në faqen veriore hapëm tre dritare me madhësi të njëjtë e një më të vogël në veriperëndim për ndriçimin e llozhës (qoshkut) së rezervuar në interjer (fig. 7). Po për këtë qëllim hapëm dhe dy dritare të vogla në murin perëndimor. Nga muri lindor hapëm vetëm një dritare në qoshen ku ambjenti hyrjes lidhet me pjesën me kupola. Si kompozim dritaret i trajtuam me hark guri nga sipër dhe me pragun e poshtëm me pjerësi nga brënda për një shpërndarje më të mirë të ndriçimit natyral në interjer. Kanatat e dritareve i vendosëm të pahapshme e të mbuluara nga jashtë me kafazlije gjatë gjysëm lartësisë së poshtme. Në mungesë të gjurmëve origjinale, një trajtim i tillë i dritareve me elemente arkitektonikë tipikë për kohën kur u ndërtua hamami, sigurisht që do ti afrohej më tepër realitetit. Sa i takon zgjidhjes së formulimit të çatisë u nisëm nga disa faktorë. Duke e parë problemin në aspektin e kritereve të restaurimit, çatia e ambjentit të hyrjes ishte e një faze të vonë kështu që mungesa e gjurmëve origjinale nuk na krijoi mundësinë e një restaurimi të mirëfilltë të formës dhe konstruksionit të saj. Në këtë mënyrë mund të bëjmë një zgjidhje të tillë të çatisë ku përveç zgjidhjes llogjike teknike të kompozimit e të konstruksionit të saj, ti përgjigjemi në një farë mase edhe anës funksionale të ambjentit të hyrjes në veçanti si dhe vlerësimit estetik të objektit në pamjen e tij të përgjithëshme.

Duke qënë me përmasa të mëdha çatia ngrihej mjaft në kulm duke mos lejuar kështu një soditje të mirë të çatisë së paisur me kupcla, që është dhe zgjidhja konstruktive më karakteristike e banjave dhe do të thoshim dhe nga vlerat kryesore arkitektonike të banjave. Duke e kthyer çatinë nga një zgjidhje me katër kullime uji në një zgjidhje me tetë kullime, ulet mjaft lartësia qëndrore e çatisë. Veç kësaj mbulesa e çatisë së vogël në qendër të planit të çatisë së përgjithëshme e realizuar me plastikë (ondaluks) i jep mjaft ndriçim volumit të ambjentit të hyrjes (fig. 1). Ujrat që mblidhen në çatinë qëndrore i organizuam me anën e një tubacioni prej eterniti, që nis nga ulluku i çatisë së vogël dhe duke kaluar nëpër konstruksion të çatisë futet brënda murit verior ku zbret vertikalisht për tu shkarkuar jashtë në fundin e këtij muri. Konstruksioni i drunjtë i çatisë së madhe pasi është i kalbur u rindërtua pothuaj krejt i ri duke çfrytëzuar nga materiali rikupero vetëm disa trarë (zinxhira) kryesorë mbajtës. Zgjidhja konstruktive – çati vendi me mahi, kulme, ura e baballëk të gjithë të skuadruar (fig. 8). Tjegullat u vendosën me spango duke krijuar kështu rrjeshta të rregullt. Konstruksioni i çatisë së vogël në qendër u realizua me profile metalike formë «L»-je me brinjë 35 mm. Suvatimi i pjesës së hyrjes që mjaft i dëmtuar, kështu që ai u bë i tëri i ri. Veç suvatimit të mureve, në brendësi të ambjentit të hyrjes u bënë dhe punime të tjera. Kamaret e nallaneve si dhe ballët e sofateve u suvatuan me llaç shamot sipas teknikës egzistuese. Rampa e betonit brënda derës perëndimore u prish dhe u zëvendësua me shkallë guri. Tavani i kalbur i ambjentit u zëvendësua me tavan të ri sipas formës së parë, me çibukë të thjeshtë në fugat.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

Duke u detajuar një për një elementet përbërës u restaurua krejtësisht konstruksioni i kalbur i lozhës (mafilit), qoshk për pushimin e personave të privilegjuar pas banjës. Nga jashtë rreth ambjentit të hyrjes u ndërtua një trotuar me gurë lumi mbi beton me një kanal tip lunete në planin e kullimit të ujrave të strehës së çatisë.

Përshkruam kështu punimet e restaurimit të kryera në hamamin e pazarit në Elbasan, punime që e përtërinë mjaft gjëndjen teknike të këtij objekti dhe e evidentuan mjaft atë. Pas punimeve të restaurimit ky monument e justifikon akoma më tepër qënien e



Fig. 13

tij dhe lidhet mirë me ambjentin rrethues si një dokument i traditës së ndërtimit në qytetin e Elbasanit.

Banja e Vogël e Parrucës — Shkodër
Gjendja para restaurimit

Banja e Vogël e Shkodrës ndodhet në lagjen Parrucë (sot 29 Nëntori). Ajo është ndërtuar në janar 1739[6] dhe përfaqëson banjën publike me skemë të plotë funksjonale, ku në planimetri ambjentet janë vendosur simetrikisht ndaj një aksi gjatësor (fig. 9). Volumi i përgjithshëm i banjës përbëhet nga tre pjesë të ndërtuara në faza të ndryshme. (fig. 10). Volumi me kupola me përmasa planimetrike 11,85 x 14.6 cm përbën fazën e parë më të hershme të banjës, e ndërtuar më 1739 (fig. 11). Në një fazë të dytë pjesës së vjetër me kupola i është shtuar nga përpara një volum përdhes me mure guri i përbërë nga dy pjesë. Pjesa në ballë e hyrjes me përmasa 10,9 x 4,5 m e përbërë nga dy ambjente të ndarë prej një koridori në mes ka shërbyer si administratë e banjës. Në një fazë të tretë kësaj pjese të banjës ju shtua një kat sipër me mur tulle me po atë planimetri të katit përdhe. Pjesa e vonë e ballit që përshkruam lidhet me volumin e vjetër me kupola me anën e një volumi përdhes me një ambjent me përmasa 6,6 x 11,85 m që përbën pjesën e pasme të fazës së dytë, që ka shërbyer si vend ndenje ose çaji për klientët. Theksojmë se duke krahasuar teknikën e mureve, faza e dytë e banjës nuk duhet të jetë ndërtuar shumë kohë pas fazës së parë, por është e afërt me të si kohë ndërtimi. Në gjendjen e sotme konstruksioni i drunjtë i

6) V. Shtylla, **Banjat e Mesjetës në Shqipëri,** Monumentet 7-8, 1973, 124.



Fig. 14



Fig. 16



Fig. 15



Fig. 17

çatisë me dy kullime uji i ambjentit të pushimit (çajit) është i ndryshuar në përbërje dhe nivel, gjithashtu dhe hapjet dyer-dritare të këtij ambjenti, ashtu siç i shohim sot, nuk janë origjinale.

Pjesa kryesore e banjës, me vlera funksjonale-arkitektonike është ajo e fazës së parë, me kupola (fig. 9), që përbëhet nga këto ambjente:

1 – Ambjenti ndërmjetës me një sofat guri maj-

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 19

tas, ku çvisheshin klientët. Ky ambjent djathtas lidhesh me nyjen sanitare që nuk egziston më.

2 – Prej këtij ambjenti kalohet në ambjentin kryesor të djersitjes me një sofat poligonal në mes. Në këtë ambjent formë T-je janë vendosur disa vaska për larje (fig. 12 e 13).

3 – Në qoshet fundore të banjës ndodhen dy ambjente të veçanta për larje të paisura me vaska.

4 – Si zakonisht në pjesën e prapme të banjës ndodhet depozita e ujit e mbuluar me qemer cilindrik, nën të cilën është ndërtuar furra. Edhe në hamamin e Shkodrës ruhen gjithë elementet e ngrohjes apo hidraulike si hipokausti nën dysheme, tubat-oxhak prej qeramike që nxjerrin tymin e hipokaustit në çati, tubat e qeramikës për qarkullimin e ujit, vaskat prej guri, etj. (fig. 14).

Në kohë të ndryshme, në këtë pjesë të objektit janë kryer disa punime. Në vitet 1892-93 u riparua furra dhe njera nga kupolat ndërsa në 1919 bashkia e qytetit ka bërë shumë riparime në brëndësi të banjës. Pas riparimit të banjës, ajo u dha në sipërmarrje por pas disa vjetësh u mbyll përsëri pasi nuk përballonte shpenzimet[7].



Fig. 20

7) V. Shtylla, po aty. 124.

DO NOT COPY

Në ditët tona objekti kish nevojë për ndërhyrje restauruese, që do të vlerësonin mjaft këtë monument si nga ana e jashtme ashtu edhe së brendëshmi. Mbulesa me tjegulla e kupolave ishte mjaft e dëmtuar, vrimat e ndriçimit në kupolat qenë të hapura dhe ujët e shiut hynte i tëri në ambjentet (fig. 15). Boshllëqet (kanalet) ndërmjet kupolave ishin të bllokuara me dhera. (fig. 16). Në murin e pasmë të banjës qenë të dëmtuara një pjesë e qemerit me tulla të furrës si dhe oxhaku mbi të (fig. 17). Ambjenti rreth banjës kish mjaft mbushje dheu. Në interjer objekti ruhej në një gjëndje krejt të pa vizitueshme. Dyshemeja në mezin e ambjentit të djersitjes qe e dëmtuar dhe dukej hipokausti. Pothuaj i gjithë suvatimi i poshtëm me shamot i ambjenteve, qe i dëmtuar. Në një gjëndje të tillë ishin dhe vaskat e ujit me dekoracionet mbi to.

Punimet e restaurimit

Punimet e restaurimit në banjën e Shkodrës u kryen në fund të vitit 1974 dhe në fillim të 1975-ës. Volumi me kupola ruhej në trajtë origjinale, në dallim nga dy pjesët e tjera të banjës, të cilat duke qenë të banuara nga familje, ishin shumë të transformuara si në anën funksjonale ashtu dhe në formulimin arkitektonik. Menduam që gjatë restaurimit të trajtojmë vetëm pjesën e vjetër me kupola, që dori në ditët e sotme ka ardhur e pa transformuar. Së pari prekëm çatinë. Pas pastrimit të kanaleve të kullimit të ujrave në boshllëqet midis kupolave, nga barërat e ferrat, u shtruan ato me llaç çimento. Me heqjen e tjegullave nëpër kupolat, mbi konstruksionet e pjerrta të kupolave shtruam një shtresë llaçi për ngjitjen e mbulesës me tjegulla, të cilat u vendosën në mënyrë radiale nga qendra (kyçi) drejt strehës, me rrjeshta rrethorë koncentrikë duke lënë të hapura vrimat e ndriçimit të ambjenteve në kupolat, që i mbuluam me xhama vendosur mbi llaç. (fig. 18). Veç kupolave u riparuan dhe mbulesa me tjegulla me një kullim e depozitës së ujit (fig. 19). Në faqen e pasme të banjës u krye restaurimi i qemerit me tulla të furrës, me tulla me gjerësi 30 cm e trashësi 5 cm të prodhuara sipas modelit egzistues në fabrikën e tullave të Shkodrës (fig. 20). U riparua me mur guri pjesa e dëmtuar e oxhakut si dhe tymari mbi oxhakun e furrës, që në bazë të një fotografie të vjetër u ndërtua sipas formës origjinale. Pasi ambjenti rreth banjës kishte mbushje dheu, kryem një zbankim dhe sistemim të terrenit. Punime restaurimi kryem dhe në interjerin e pjesës me kupola të banjës. U riparuan dy kollona të hipokaustit në ambjentin e mezit fundor duke i ngritur ato me gurë me seksion rrethor. Dyshemenë e dëmtuar të hapur mbi to e mbyllëm me soletë (shtresa e poshtme) për ta shtruar nga sipër me gurë pllakë sipas teknikës egzistuese. Në këtë pjesë të dyshemesë lamë një copë këndrejtë të hapshme për të krijuar mundësinë e shikimit të hipokaustit. Riparuam dhe dyshemenë qëndrore të ambjentit të djersitjes. Veç këtyre riparuam dhe gjithë suvanë me shamot në nivelin e poshtëm të ambjenteve. Suvatimin e kryem me dy duar, dora e parë më e ashpër dhe dora e dytë me llaç fino të dyja me llaç të përbërë nga gëlqere, çimento të bardhë dhe pluhur i imët i shtypur i tjegullës në rolin e mbushësit. Së fundi u krye lyerja me gëlqere e gjithë ambjenteve, mbi nivelin e suvatimit me shamot. Gjatë këtij viti po merren masa për restaurimin e elementeve dekorativë si vaskat e gurit dhe ornamentet dekorative bimore mbi to.

Punimet e restaurimit në këto dy monumente, të parat punime restaurimi të kryera në objekte të kësaj gjinie, i vlerësuan së tepërmi këto monumente duke i kthyer ato në gjëndje të vizitueshme. Pas punimeve hamamet në Elbasan dhe Shkodër jetojnë akoma më mirë me ambjentin rrethues dhe flasin qartë për trajtimin funksjonal të tyre.

ZOTI PDF

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

RESTAURATION DE DEUX HAMMAMS MOYENAGEUX

RESUME

Les hammams occupent une place importante parmi les constructions de caractère social de nos villes moyenâgeuses, mais à la suite des transformations que nos centres habités ont connues avec le temps le nombre de ces établissements qui existent encore est relativement petit par rapport à leur difussion de naguère.

Les hammams moyenâgeux nous les retrouvons à Elbasan (2), Durrës, Shkodër, Krujë, Gjirokastër, Çorovode et Lezhe, dont quelques-uns dans un état de conservation relativement satisfaisant et d'autres en ruine.

Dans cet article il est question de la restauration de deux hammams moyenâgeux, et précisément des anciens bains publics situés dans le parc de la ville d'Elbasan et du petit établissement de bains se trouvant dans le quartier Paruce de Shkodër.

L'ancien hammam du Bazar à Elbasan
Son état avant la restauration

Des sources historiques il ressort que vers la fin du XVIIe siècle Elbasan avait 20 quartiers avec 4.000 maisons et un marché florissant avec beaucoup de magasins. Le Hammam du Bazar s'érige au milieu de la ville, à proximité de la mosquée d'Agaj; il a été construit vers la deuxième moitié du XVIe siècle. Le hammam du Bazar, constituant en unité avec la mosquée un complexe architectonique typique pour l'époque, se caractérise par un schéma fonctionnel complet et il a fonctionné jusqu'aux années '40 en tant que hammam unisexe. Une fois par semaine, le jeudi seulement, il était fréquenté par les femmes. Il comporte deux volumes principaux: le volume du vestiaire (l'entrée) couvert d'un toit de bois et le volume proprement dit des bains qui est couvert d'une coupole. Selon l'ordre fonctionnel, les pièces du hammam sont:

1) Le vestiaire (l'entrée);
2) la pièce intermédiaire;
3) les noeuds sanitaires;
4) les pièces des bains;
5) la pièce principale des bains de vapeur et de lavage;
6 et 7) les cabines particulières;
8) la citerne.

Du point de vue technique, cet établissement était suffisamment endommagé. En témoigne l'état de la couverture de tuiles, du crépissage des murs, du milieu environnant, etc. Du point de vue de la construction, les murs crépis de glaise de l'entrée étaient crevassés, alors que le toit de bois avait des éléments pourris. Il en était de même du plafond et le loge à l'angle de la pièce.

Dans ces conditions il était indispensable d'intervenir afin de ramener ce monument à un état technique satisfaisant, de lui faire acquérir un aspect extérieur esthétique et de rendre son intérieur apte à être visité.

Les travaux de restauration

L'établissement de bains du Bazar, quant à sa restauration, présentait nombre de problèmes concernant le traitement extérieur et intérieur de ses différentes pièces et de son entrée. Il fallait éclaircir les phases de construction du milieu ainsi que la liaison dans le temps avec le volume postérieur de bains couvert d'une coupole de pierre. Des sondages effectuées, il ressort que l'entrée existait dès le commencement, tout comme la partie surmontée de coupoles, et qu'elle était couverte d'un toit de bois qui avait été l'objet de différentes réparations jusqu'à nos jours.

Les travaux de restauration furent entamés pendant le quatrième trimestre de 1973 et achevés pendant le premier trimestre de 1975. Dans la partie couverte de coupoles, la reconstruction de la technique des murs fut effectuée en procédant au décrépissage du crépi extérieur d'origine récente et quit était très endommagé. On procéda à la réparation de la couverture de tuiles de la coupole, où furent placés des globes de verre dans les endroits qui illuminent le milieu. Partant de traces existantes, il a été procédé au crépissage des tambours des coupoles avec du mortier réfractaire. Par ailleurs, on a consolidé avec du béton léger les fissures axiales et les entrées des cintres de la citerne. En ce qui concerne la façade postérieure, il a été procédé à la réparation de la voûte de brique du four et de la cheminée. Pendant la réparation du toit, on a été complétés les tuyaux verticaux de céramique, qui servaient à l'évacuation de la fumée de la cheminée.

En ce qui concere l'entrée couverte d'un toit de bois, on a procédé à la réparation de la moitié de l'intérieur du mur septentrional, qui présentait des signes de dilatation. Une bande de béton antisismique a été placée dans la partie supérieure de la maçonnerie de l'entrée. La porte ouverte récemment à l'angle S,-E. a été boucée, puis sur la base des traces existantes nous avons percé une autre porte au milieu du mur oriental. Du fait que les fenêtres existantes étaient défoncées, on a ouvert des fenêtres nouvelles en conservant les éléments architectonique de l'époque de construction du hammam.

En l'absence de traces originales, le toit de bois de l'entrée a été refait en lui apportant une solution de construction logique répondant aux nécessités fonctionnelles de cette pièce et à l'aspect esthétique du monument en général. Il a été procédé au crépissage des parements de l'entrée. En ce qui concerne l'intérieur du hammam, nous avons restauré sa loge de bois pour les personnes de haut rang ainsi que son plafond de bois. Les bancs des salles ont été crépis avec de l'argile réfractaire selon la technique originale. Hors de l'établissement des bains, on a construit un trottoir avec de la pierraille fluviatile sur béton.

Les travaux de restauration effectués à l'hammam du Bazar ont amélioré sensiblement son état technique et permettent de le mettre mieux en évidence.

Le petit hammam de Parruce, Shkoder
Son état avant la restauration

Cet hammam se situe au quartier Parruce (aujourd'hui «29 Novembre»), il a été construit en 1793 et constitue le type de bains ayant un schéma fonctionnel complet. Le volume général de cet établissement comporte trois parties construites à des phases différentes. Le volume couvert d'une coupole représente sa première phase. Au cours de la deuxième phase, quelque temps après la première, à la partie ancienne a été ajoutée un volume à rez-de-chaussée en murs de pierres et comportant deux pièces communicantes. Au cours de la troisième phase, à la partie frontale de la deuxième phase a été ajoutée un étage de briques. La partie principale de cet établissement, celle de la première phase, comporte les pièces suivantes:

1. La pièce intermédiaire;

2. La pièce principale destinée à la vapeur et comportant des bancs de forme polygonale au milieu;

3. Les pièces particulières avec des baignoires;

4. La citerne couverte d'un cintre cylindrique.

Les travaux de restauration

Les travaux de restauration, entamés vers la fin de l'année 1975, ont été achevés pendant le premier trimestre de 1975. L'ancien volume couvert d'une coupole était conservée à son état original, à la différence des autres parties de cet établissement qui avaient enregistré des modifications tant du point de vue fonctionnel que de leur formulation.

Nous avons décidé de restaurer seulement la partie couverte de coupole, qui conserve de nos jours encore son état original. A cette fin, nous avons réparé la couverture de tuiles des coupoles, en n'obstruant pas les trous d'illumination qui furent garnis de vitres plats, ainsi que la couverture à une pente de la citerne. Sur la façade postérieure de l'établissement de bains, ont été réparés avec des briques le cintre du four et la cheminée de celle-ci. Par ailleurs, ont été réparés le plancher du volume à coupole qui avait été partiellement endommagé et crépis avec du mortier réfractaire les parties inférieures de la maçonnerie des différentes pièces.

Les travaux de restauration effectués dans ces monuments, les premiers entrepris dans un ouvrage de ce genre, en ont accru la valeur et les ont converti en des objets accessibles aux visiteurs. A la suite de ces travaux, les hammams d'Elbasan et de Shkoder s'adaptent mieux au milieu environnant et témoignent clairement de leur traitement fonctionnel.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Emin RIZA

ARKITEKTURA E VENDBANIMIT – RRËNOJË TË KARDHIQIT*)

DO NOT COPY

Për historinë e arkitekturës së banesës shqiptare, një vend me rëndësi zënë dhe ndërtimet rrënojë, sepse ato krijojnë mundësinë e njohjes së kësaj kategorie ndërtimore përtej shekullit XIX, për të cilën të dhënat janë pak a shumë të plota. Ndjekja e zhvillimit dhe e karakterit të arkitekturës së banesës shqiptare në rrjedhje të kohës, gjen në rrënojat e këtyre ndërtimeve vlera të rëndësishme autentike. Studimi dhe interpretimi i këtyre vlerave jep mundësinë për krijimin e një kuadri sa më të plotë dhe të bazuar të ecurisë në kohë të banesës shqiptare. Gjurmimet e derisotme kanë treguar se në truallin tonë ruhen një numër i madh qëndrash banimi, kryesisht fshatare, të cilat për një arsye apo tjetrën janë braktisur në kohë të ndryshme, duke filluar që prej periudhës para pushtimit osman. Deri më sot një numër i vogël prej këtyre fshatrave është bërë objekt studimesh fillestare[1], duke dhënë një material me vlerë për tipologjinë dhe karakterin e banesës fshatare të Shqipërisë së Jugut për shekujt XIV-XVI. Rënojat e qëndrës së banuar të Kardhiqit, vijnë të plotësojnë një hallkë të rëndësishme në historinë e zhvillimit të banesës shqiptare, pikërisht për një periudhë me të dhëna relativisht të pakta siç është shekulli i XVIII. Studimi i rrënojave të Kardhiqit jep mundësinë që të krijohet një ide e mirë e zhvillimit të banesës shqiptare gjatë dy shekujve, duke e krahasuar atë me rrënojat e Borshit dhe Kamenicës. Përveç kësaj, ndërtimet e Kardhiqit lejojnë që të hidhen mendime më të bazuara mbi proçesin e rëndësishëm të raportit ndërmjet banesës fshatare dhe asaj qytetare. Duke pasur pranë një qendër të rëndësishme si Gjirokastra, Kardhiqi i shekullit XVIII ofron të dhëna me rëndësi mbi kahun e drejtimit të huazimeve dhe ndikimeve në përgjithësi. Në dekadat e para pas pushtimit osman, i cili qe veçanërisht shkatërrimtar për qëndrat e banuara qytetare, banesa fshatare ndikoi mjaft në banesën qytetare, kryesisht për shkak të rritjes së popullsisë qytetare me banorë të ardhur nga fshati. Fundi i shekullit XVI, dhe veçanërisht shekujt e mëvonshëm, sjellin krahas rritjes dhe fuqizimit të qyteteve dhe diferencimin e banesës qytetare nga ajo fshatare dhe për pasojë vënjen e së parës në pozita dhënëse karshi banesës fshatare. Rasti i Kardhiqit lejon që të konkretizohet më mirë shkalla e këtyre ndikimeve reciproke, megjithëse, siç do të përmendim dhe më poshtë, Kardhiqi duhet mbajtur si një qëndër e zhvilluar fshatare e cila në disa drejtime i afrohej karakterit të qytetit të Gjirokastrës.

Qendra e banuar mbi trojet e Kardhiqit, ka një fillesë të lashtë, për vetë kushtet e përshtatshme ekonomike dhe strategjike të cilat kushtëzuan lindjen e një qendre të fortifikuar që në antikitet[2]. Më vonë në mesjetë në shekujt XIII-XIV ngrihet kështjella e Kardhiqit[3]. Siç duket rreth kësaj periudhe lind dhe fshati i Kardhiqit, i cili sipas regjistrit fiskal të viteve 1431-32[4], figuron me 28 shtëpi me kryefamiljarë, 2 shtëpi me vejusha dhe 4 shtëpi beqarësh, pra një qen-

*) Rilevimet janë të autorit, S. Terezit, E. Bejlerit dhe Gj. Varfit. Vizatimet të B. Penxhës, ndërsa fotot të autorit.

1) A. Meksi – E. Riza, **Ndërtimet në fshatin rrënojë të Kamenicës,** «Monumentet» 7-8, 1974. E. Riza, **Banesa e hershme fshatare në Shqipërinë e Jugut». «Tradita në arkitekturë dhe art»** Tiranë 1979.

2) A. Baçe, **Kalaja e Kardhiqit dhe e Delvinës,** «Monumentet» 13, 1977. 55.

3) A. Baçe, **Ar. cit.** 62.

4) **Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë,** Vëllimi II, Tiranë, 1962, 241.



Fig. 1

dër relativisht e vogël. Të dhëna me interes për kështjellën dhe qendrën e banuar jep E. Çelebiu, i cili shkruan se në kështjellë është dizdari me 100 ushtarë, ndërsa përmend qenjen e 150 banesave të varfëra mbuluar me tjegulla, dhe disa me kashtë[5]. Në një dokument të vitit 1692[6], dmth pakë vite pas njoftimeve të Çelebiut, lihet të kuptohet se brenda kalasë, krahas garnizonit, jetonin dhe banorë të zakonshëm. Këto të dhëna si dhe pasazhi i Çelebiut se «Qyteti i Kardhiqit është një fortesë buzë lumit të Janicës (Jenixhes) me njëqind e pesëdhjet shtëpi...»[7], e lënë të hapur problemin, nëse qendra e banuar përfshihej së pari brenda mureve rrethues, e pastaj u shtri dhe jashtë rrethimit, e nëse ka qenë kështu kur filloi ky proces. Cilësimi, qytet nga ana e Çelebiut sigurisht lidhet me qenjen e kështjellës, dhe nuk i përgjigjet kritereve mbi cilësimin fshat apo qytet të një qendre të banuar, duke u bazuar në natyrën ekonomike të saj. Shekulli XVIII e gjen Kardhiqin një qendër të zhvilluar, e cila siç provojnë rrënimet e ndërtimeve, kishte arritur në një shkallë relativisht të lartë zhvillimi, që në disa drejtime afrohej me qëndrat qytetare të kohës. Fillimi i shekullit XIX, shënon ngjarje fatale për qëndrën e banuar të Kardhiqit. Ali Pashë Tepelena në përpjekjet e tij për zgjerimin e pashallëkut të Janinës, me kohë krahas qytetit të Gjirokastrës, synonte të nënshtronte edhe Kardhiqin. Në Dhjetorin e vitit 1810, ai arriti të sulmojë dhe nënshtrojë Gjirokastrën. Pas dy muajsh u dorëzua dhe Kardhiqi[8]. Ali Pashë Tepelena urdhëroi masakrimin e një numëri të madh kardhiqiotësh, me të cilët kishte armiqësi të vjetra. Vjen kështu fundi i kësaj qëndre të rëndësishme të krahinës së Labërisë. Më tej Kardhiqi nuk arriti të rimarrë veten, e aq më pak të arrijë realizime më të zhvilluara se ato që kishte arritur në prag të rrënimit, pra në fillim të shekullit XIX. Njohja e saktë e datës së rrënimit të Kardhiqit lejon që mbeturinat e ndërtimeve që ruhen ende sot, të vendosen me siguri në shekullin e XVIII.

Kardhiqi (fig. 1) ngrihej në veri-perendim të Gjirokastrës, mbi një lartësi që sundon ultësirën në verilindje, e cila përshkohet nga lumi i Kardhiqit, degë e Drinosit. Trualli mbi të cilin ngrihen ndërtimet ka një pjerrësi jo të madhe, ai është shkëmbor me bimësi fare të pakët. Pozita e fshatit flet qartë lidhur me përkujdesjen për mbrojtje që ka udhëhequr themeluesit e kësaj qëndre të banuar, e cila zinte një pozitë kyçe në luginën e Kardhiqit, linjë e rëndësishme komunikimi, e njohur që në antikitet, që lidhte trevën e Gjirokastrës me pellgun e Delvinës[9]. Pjerrësitë e rrëpirta, praktikisht me vështirësi të ngjitshme, siguronin fshatin nga jugu dhe lindja. Kalaja siguronte mbrojtjen prej sulmeve të mundëshme nga veriu. Drejtimi më i përshtatshëm për mësymje mbetej krahu perendimor. Pikërisht duke kuptuar këtë dobësi, përveç drejtimit nga ky orientim të numërit më të madh të frengjive të banesave, kardhiqiotët kanë ndërtuar një lloj fortifikimi, i cili ndjek lartësinë mbi fshat nga ana jugore dhe jug-perëndimore. Ky fortifikim në gjendjen e sotme është thuajse krejtësisht i rrënuar, por traseja e tij mund të ndiqet (fig. 2) nga gjurmët. Nga vrojtimi i tij mund të mendohet se kemi të bëjmë me një mur të thjeshtë mbrojtës, për teknikën dhe trashësinë e të cilit nuk mund të nxiren përfundime pa bërë punime pastrimi. Gjatë murit duken gjurmët e dy kullave, (fig. 3) njëra prej të cilave në kuotën më të lartë, aty ku muri mbrojtës merr kthesë në drejtim të veriut. Ndërtimi i këtij fortifikimi është vështirë të vendoset në kohë, duke u nisur nga veçantitë teknike të tij. Më shumë gjasë, ai duhet ti përkasë fundit të shekullit XVIII, apo fillimit të shekullit XIX, lidhur me konfliktin me Ali Pashë Tepelenën e fuqishëm. Shembulli i Kardhiqit paraqet një prej rasteve më të skajmë të përkujdesjes për mbrojtje, e cila përbënte një nga shtytësit kryesor në zgje-

5) E. Çelebi **«Shqipnia para dy shekujsh»** (përkthim shqip), Tiranë, 19, 28, 29.
6) **Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shek. XVI deri në fillim të shek. XVIII.** Tiranë 1978, dk. 175.
7) E. Çelebi, **Vep. cit.** 28.
8) **Historia e Shqipërisë,** V. I, Pjesa III, f. 157, Maket, Tiranë 1972.
9) A. Baçe, **Art. cit.** 55.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 4

dhjen e vendbanimit në mesjetë. Këtu është ndërthurur në mënyrë shumë të arritur mbrojtja natyrale me fortifikimin kolektiv dhe atë, të themi familjar, nëpërmjet banesave të fortifikuara. Dorëzimi karshi pashait të Janinës, vetëm pas rënjes së Gjirokastrës, flet qartë për sigurinë e madhe që ndjenin banorët e kësaj qëndre, trimëria e të cilëve ishte bashkuar me një mbrojtje të fuqishme aktive, të krijuar nga vetë ata.



Fig. 3

Siç përmendëm vendbanimi ngrihej mbi një pjerrësi jo të fortë duke u shtrirë në drejtim lindje-perëndim. Qëndra e Kardhiqit duket se ka qënë pranë xhamisë, prej së cilës sot ruhen rrënojat, ndërsa minareja në gjendje relativisht të mirë, deri në kazan. Minareja shquhet për punimin e pasur me dekoracione të bazamentit të kazanit (fig. 4). Duke gjykuar nga pasazhi i mëposhtëm i E. Çelebiut për Kardhiqin: «... ka një xhami të mbuluar me tjegulla, e cila ka një minare të vogël»[10], mendojmë se këtu nuk është fjala për xhaminë, rrënojat e së cilës ruhen ende sot, e cila rrjedhimisht duhet të jetë ndërtuar në shekullin XVIII. Përveç kësaj nuk ruhen gjurmë ndërtimesh të tjera shoqërore. Dendësia e ndërtimeve nuk është e njëllojtë, duke qënë më e madhe në pjesën qëndrore, ndërsa më e vogël në pjesën periferike. Rrjeti rrugor është vështirë të ndiqet plotësisht megjithatë, shumë të dhëna tregojnë se ai ka qënë i dendur, me rrugë relativisht të ngushta, që kufizo-

10) E. Çelebi, Vep. cit. 29.



Fig. 5



Fig. 7

heshin nga muret rrethues të banesave, apo njërës ose të dy faqeve të tyre. Ato ishin të shtruara me kalldrëm (fig. 5) me gurë kave. Kuneta e largimit të ujrave zinte pjesën qëndrore, duke qënë të dy anët e rrugës me pjerrësi të lehtë drejt saj. Banesat, që formojnë këtë qendër të banuar, i gjejmë me orientim të detyruar nga lindja, si zakonisht në ndërtimet mbi terrene të pjerrta. Ato nuk formojnë ndonjë vendosje të rregullt, përkundrazi kompozimi urbanistik është mjaft i lirë, duke u zhvilluar ndërtimet kryesisht paralel vijave të niveleve, por pa munguar dhe vendosja normal e tyre, kryesisht në banesat e thjeshta.



Fig. 6

Në ndërtimet e Kardhiqit, banesa përbën thuajse llojin e vetëm. Megjithë ngushtësinë e truallit thuajse gjithmonë banesa kishte pranë një oborr të kufizuar me mure rrethues. Ai ishte përgjithësisht me përmasa të vogla dhe rrallë trajtohej me mur teracimi, kur pjerësia ishte e madhe. Në muret rrethues shpesh ndërtoheshin frengji për qitje me armë zjarri, veçanërisht të shpeshta janë këto në muret (fig. 6) nga perendimi. Ngushtësia e truallit ka bërë që shumica e banesave të kufizohej me rrugën me një, dy apo ndonjëherë dhe me tre faqe. Brenda mureve rrethues, shumë rrallë ndeshen ambiente ndihmëse me materiale të qëndrueshme. Një shembull të tillë paraqet banesa Nr. 1 (Tab. I, fig. 7). Ajo është një ndërtim i thjeshtë me kat, përpara së cilës shtrihet një oborr i vogël i rrethuar me mure, jashtë konturit të të cilit, por në vazhdim të tij duken gjurmët e një ambienti ndihmës funksioni i të cilit nuk kuptohet. Natyrisht që ndërtimet ndihmëse me materiale të brishta nuk i kanë qëndruar kohës.

Në gjendjen e sotme rrënojat e Kardhiqit, ruhen relativisht mjaft të dëmtuara. Ka raste kur muret janë të rrënuar pjesërisht deri rrafsh përtokë, por më të shumtët e tyre ruhen deri në nivelin e dyshemesë së katit të parë, ndërsa fragmente dhe në lartësi të katit të parë, madje rrallë dhe ndonjë trakt i katit të dytë, në banesat tre katëshe. Teknika me breza druri ka ndihmuar rrënimin pas kalbjes së tyre. Elementet arkitektonike si dyer, dritare, oxhakë, etj. gjenden mjaft rrallë, qoftë për shkak të kalbjes së arkitrarëve prej druri, qoftë sepse gurët e punuar janë marrë për ndërtime të reja. Vetkuptohet se elementet e drurit nuk kanë lënë thuajse asnjë shënjë, me përjashtim të foleve të trarëve të dyshemesë. Kështuqë në gjendjen e sotme në mjaft raste është vështirë të ndi-

DO NOT COPY

qet me siguri të plotë planimetria e banesave veçanërisht në katet e sipërme. Megjithatë, gjurmët që ruhen lejojnë të krijohet një kuadër thuajse i plotë i tipologjisë së banesës, dhe i shumë karakteristikave të teknikës së ndërtimit, ndërsa mbeten pa u sqaruar sa duhet karakteristikat e trajtimit të brendëshëm të banesës dhe veçanërisht punimi i elementeve prej druri.

Banesat e Kardhiqit janë përgjithësisht dykatëshe, banesa përdhese nuk dallohen në gjendjen e sotme. Krahas banesave dy katëshe nuk janë të rrallë dhe shembujt tre katësh, disa prej të cilëve me kompozim mjaft të zhvilluar. Për klasifikimin tipologjik të banesave të Kardhiqit, ashtu si zakonisht, do të marrim për bazë tiparet kompozicionale. Sipas këtij kriteri dallojmë këto variante të banesës kardhiqote: variantin me gjysmëkat perpendikular, atë me një krah, me dy krahë dhe variantin prizmatik. Përveç kësaj tipologjie kryesore ndeshen dhe raste të veçanta.

Në të gjitha variantet e banesës kardhiqote, ku më shumë e ku më pakë, sipas truallit mbi të cilin ngrihet banesa shihet ndikimi i këtij të fundit mbi kompozimin volumor të banesës, duke qënë relativisht i përhapur koncepti i gjysmëkatit[11].

Varianti me gjysmëkat është relativisht i përhapur në Kardhiq, ashtu si në mbarë Labërinë[12]. Një shembull tipik i kësaj zgjidhje është banesa Nr. 2, (Tab. II, fig. 8). Ajo shtrihet në pjesën periferike të Kardhiqit. Rrënimet tregojnë gjurmë të murit rrethues, prej të cilit ruhen pak trakte. Banesa ndiqet relativisht mirë në planimetrinë e saj. Në kompozimin volumor të kësaj banese një ndikim të dukshëm ka terreni i pjerrët, i cili ka sygjeruar ndërtimin e thyer në volum, duke qenë kati i sipërm më i shtyrë prapa. Në plan banesa ka formën e një katërkëndëshi këndrejtë, vendosur normal vijave të niveleve. Anash këtij konturi del nga një anë blloku i ambienteve sanitare. Thuajse simetrikisht me të ngrihet një masiv murature, i cili sigurisht ka shërbyer si bazament për shkallët e jashtme, që e çonin në katin e banuar. Katoi nuk ruan portën, e cila duket se ka qenë pranë fillimit të shkallëve. Në katua gjënden dy kamare në murin fundor, si dhe një hapësirë ndriçimi në formë frengjije. Kati i banuar, kuptohet se formohej nga dy ambiente secili me ambiente sanitare të veçanta. Ambienti fundor ishte shtëpia e zjarrit. Ai është me sipërfaqe relativisht të vogël, sa gjysma e ambientit ballor. Elementi më me rëndësi i këtij ambienti është vatra me kamaren pranë (fig. 9). e cila mbulohet me qemer të rremë. Anash saj janë dy kamaret, që shoqërojnë gjithmonë vendin e zjarrit përbri njërit prej mureve.



Fig. 8

Gjëndja e sotme e rrënojave nuk të lejon të saktësosh nëse të dy ambientet kanë pasur hyrje të veçanta, siç të shtyn të mendosh dispozicioni planimetrik. Oda nuk ruan asnjë element përveç një kamareje, duke lënë kështu në pikpyetje qënjen e vendit të zjarrit i cili duke gjykuar nga ndërtimet e tjera nuk duhet t'i ketë munguar këtij ambienti. Me interes është një shembull i thjeshtë, i cili mund të futet në



Fig. 9

11) E. Riza, **Banesa me gjysmëkat perpendikulare,** «Monumentet» 7-8, 1974.
12) E. Riza, **Banesa popullore në Kurveleshin e Sipërm** «Monumentet» 9, 1975. E. Riza, **Banesa popullore e rrethit të Vlorës,** «Monumentet 15-16, 1978.

PHOTOCOPY



Fig. 10

këtë variant, meqë shtëpia e zjarrit në kat vazhdon të mbetet mbi shtresa të padjegshme, nën të cilën është ndërtuar stera e ujit, mbuluar me qemer. Kështu volumin e katit përdhe në pjesën më të madhe e zë stera, ndërsa përpara saj mbetet katoi. Koncepti kompozicional i kësaj banese është i njejtë me atë të banesës Nr. 2, veçse në vend të volumit të mbushur, në katin e poshtëm, është ndërtuar stera.

Varianti më i përhapur i banesës kardhiqiote është ai me një krah, i cili në zhvillimin planimetrik të kujton shkronjën L të madhe. Ky variant ndeshet dy katsh.

Shëmbujt e këtij varianti i gjejmë më të përha-



Fig. 11

pur në pjesën qëndrore dhe lindore të Kardhiqit. Banesa Nr. 3 (Tab. I, fig. 10) është një shembull i ruajtur relativisht mirë i këtij varianti. Një oborr i vogël shtrihet në pjesën veriore të banesës. Kompozimi i ngjeshur i saj formulohet nga dy blloqe të lidhur normalisht me njëri tjetrin. Lidhja gjenetike me variantin e parë shihet qartë në këtë shembull, të cilit i është shtuar krahu verior. Ky zhvillim i variantit fillestar, në rastin e dhënë e ka çvendosur shtëpinë e zjarrit nga vendi i saj tradicional, në njërin nga ambientet e krahëve. Ambienti ndërmjet dy krahëve, në katin e banuar është nyje sanitare, ndërsa volumi në nivelin e katit përdhe është i mbushur. Kështu banesa ka dy katoj në katin përdhe, ndërsa dy ambiente sipër tyre në katin e banuar. Rrënimet nuk lejojnë që të gjurmohen shkallët, të cilat sigurisht janë të jashtme prej guri, gjithashtu nuk mund të përcaktohet numëri i hyrjeve për në katin e banuar. Banesa dallohet për frëngjitë e shumta, të cilat nuk mungojnë në të tri faqet e jashtme, duke qënë më të shumta në katin e banuar. Të dy ambientet e banimit kanë në faqet ballore vendet e zjarrit.

Në faqen ballore të ambientit lindor, ruhet hapësira e një dritareje origjinale mbuluar së jashtmi e së brendshmi me dy harqe guri në plane paralele.

Një shembull më të zhvilluar dhe njëherazi me planimetri të një koncepti më të lirë kompozicional, paraqet banesa Nr. 4 (Tab. II, fig. 10). Ajo ngrihet në pjesën e poshtëme të Kardhiqit. Rreth saj nuk shihen gjurmë muresh rrethues. Kompozimi jo aq i pastër, siç duket shpjegohet në kufizimin e truallit, për shkak të një shkëmbi përngjitur ambientit të krahut lindor, i cili ka detyruar zgjerimin e mureve anësore, duke mos ndjekur, si zakonisht drejtimin e mureve të bllokut fundor. Në dallim nga banesa Nr. 3, në këtë shembull ambienti që formohet në këndin e kompozimit, ka zhvillim të plotë dhe ruan funksionet e shtëpisë së zjarrit, duke qënë i mbushur volumi nën të. Kështu në katin përdhe banesa ka dy katoj, por nuk përjashtohet mundësia që të ketë qenë një i vetëm në krahun fundor. Shkallët e jashtme prej guri të çonin në një platformë prej së cilës ka më shumë mundësi të kalojë në dy ambientet e krahëve me hyrje të veçanta. Shtëpia e zjarrit me siguri ka pasur ndërlidhje me ambientin nga jugu, ndërsa ndërlidhja e drejtpërdrejtë me atë nga lindja është e dyfishtë. Ambientet sanitare dalin anash si volum më vete, duke qënë me shumë gjasë dy të tilla, një për secilin ambient përbri. Shtëpia e zjarrit ka vendin e zjarrit, me kamaren pranë mbuluar me një lloj çerek kupole. Përkundrazi ambienti nga jugu ka pranë vatrës kanalin e tymit të zhvilluar (fig. 12) me mbylljen në krye, në formë trekëndëshi. Bashkëqëndrimi i këtyre dy formave të vendit të zjarrit në të njëjtën banesë

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13



Fig. 14

ndeshet dhe në shembuj të tjerë të banesave të Kardhiqit. Kjo bashkëjetesë e formave të ndryshme të vendit të zjarrit, që paraqesin etapa në rrugën e zhvillimit të këtij elementi ndeshen dhe në banesën qytetare shqiptare të të katër tipave që lidhen me formacionin feudal të shoqërisë. Banesa Nr. 4 ruan dhe një sqoll (fig. 13), përveç frengjive në faqen perëndimore të katit të banuar. Me rëndësi është të shënojmë qenjen e një dritareje të vogël dhe mjaft të lartë në ambientin përbri shkallëve, në faqen fundore të tij, e cila është e vetmja e këtij ambienti. Përmasat dhe vendi i saj flasin qartë lidhur me përkujdesjen e theksuar për mbrojtje.

Variantin më të zhvilluar të banesës kardhiqiote e përbën ai me dy krahë. Ky variant ndeshet në shembuj të pakët në numër. Ai realizohet dy dhe tre katësh, duke treguar kështu qartë për nivelin relativisht të lartë që arriti banesa në këtë qendër të banuar. Në rrënojat e Kardhiqit banesa Nr. 5 dhe Nr. 6 e para dykatëshe dhe e dyta tre katëshe, shquajnë në mes të tjerave, për kompozimin e zhvilluar dhe pasurinë e elementeve arkitektonikë.

Banesa Nr. 5 (Tab. II, fig. 14) paraqet shembullin me zhvillim më të plotë planimetrik. Ajo rrethohet me mure, që kufizojnë një oborr në pjesën e prapme, një oborr, tjetër ka qënë dhe në pjesën e përparme, por traseja e murit nuk ndiqet dot plotësisht. Në skemën planimetrike, banesa është e variantit me dy krahë, duke pasuar ambientet formues me zhvillim simetrik. Kati përdhe ka shtrirje më të vogël se kati i banuar, për shkak se ambientet sanitare dhe dy ambientet fundore të krahëve ngrihen mbi volume të mbushura. Në ballin e pjesës qendrore të planimetrisë zhvillohen shkallët monumentale dy rampshe, zgjidhje kjo unikale në rrënojat që ruhen. Nën harkun qëndror të



Fig. 15



Fig. 16



Fig. 17

tyre, kalohet në hajat prej të cilit në tre katojt. Pranë katoit të bllokut qëndror, është ndërtuar stera e ujit, mbuluar me qemer cilindrik (fig. 15). Zhvillimi planimetrik presupozon qenjen e shkallëve të brendshme që ndërlidhin hajatin me divanin e katit të banuar. Ato sigurisht janë zhvilluar përbri murit që kufizon sterën dhe katoin përbri. Mungesa e gjurmëve, të bën të mendosh se ato duhet të kenë qenë prej druri. Kati i banuar ka një zhvillim më të madh. Ashtu si hajati, në katin përdhe, në atë të banuarin bërthama kompozicionale mbetet ambienti qëndror, divani, i cili duke gjykuar nga karakteri i banesës kardhiqiote duhet të ketë qënë i mbyllur. Nga gjurmët e sotme të muraturës në këtë kat, përcaktohen qartë tre ambientet djathtas dhe prapa divanit, ndërsa mbetet i dyshimtë numëri i ambienteve në krahun e majtë. Për analogji me krahun tjetër dhe shtrirjen relativisht të madhe gjatësore të ambienteve sanitare, mund të mendohet se edhe në këtë krah ka pasur dy ambiente. Në se ka qënë kështu atëhere hyrja për në të dy ambientet e qosheve duhet të ketë qënë nëpërmjet ambientit qëndror, paralel me divanin. Kjo nuk përjashton ndërlidhjen e secilit prej tyre me ambientet respektive të krahëve. Ambienti qëndror, përbri divanit, si nga vendi në kompozim ashtu dhe nga vendi i zjarrit me kamare, (fig. 16) duhet të ketë qënë shtëpia e zjarrit. Në ndërlidhje me këtë ambient, si rast shumë i rrallë ndeshet një volum përngjitur, jashtë linjës së murit fundor. Ai është katror në plan, mbuluar me kupol, siç tregojnë gjurmët, dhe duket se ka qënë banjë. Ambienti djathtas shtëpisë së zjarrit ka pasur gjithashtu vend zjarri me kamare, përkundrazi ambienti ballor i këtij krahu ka vend zjarri me kanal që përfundon me mbylljen në formë kalemi. Banesës nuk i mungojnë frengjitë në murin jugor të saj, ato në katin e banuar si rast i rallë zënë fill nga kamaret (fig. 17) anash vendit të zjarrit me kanal.

Banesa Nr. 6, (Tab. III, fig. 18) megjithëse e të njëjtit variant me banesën Nr. 5, ka dallime jo të papërfillshme nga ajo. Së pari këto shfaqen në kompozimin më pak të arritur, në të cilin mungon koncepti i qartë i banesës Nr. 5. Së dyti banesa Nr. 6, siç tregojnë pak gjurmë në bllokun fundor ka qënë tre katëshe. Veçanti duhet mbajtur dhe një hyrje e dytë me shkallë të jashtme guri që të çon në ambientin e katit të parë të krahut të djathtë. Kjo e fundit tregon se oda e miqve duhet të ketë qenë pikërisht nga ky krah.

Kati përdhe i kësaj banese paraqet disa veçanti të rralla. Shkallët prej guri zhvillohen si zakonisht, me dy rampa, për shkak të ngushticës së vendit, duke pasur nën sheshpushimin përfundimtar qemer cilindrik, nën të cilin kalohej në katin fundor. Këtu shohim si rast shumë të rrallë në Kardhiq ndërtimin e dy

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 19



Fig. 20

DO NOT COPY

volumeve paralele, mbuluar me qemere cilindrike, njeri prej të cilëve ka qenë stera e ujit, ndërsa tjetri më i gjërë qilari i zahiresë. Zgjidhje e pazakontë, është dhe ajo e krahut të djathtë, e ndarë në dy pjesë. Pjesa ballore ndërlidhet me hajatin me një hapësirë të gjërë mbuluar me hark, ndërsa pjesa fundore me qemer cilindrik. Zhvillimi planimetrik i katit të banuar paraqet paqartësi në pjesën fundore. Nga sa të lenë të gjykosh rrënojat në gjëndjen e sotme, ky kat përveç divanit duket se ka pasur katër ambiente, dy në krahët dhe dy në bllokun fundor. Një çështje e paqartë mbetet dhe zhvillimi i katit të tretë, prej të cilit ruhen shumë pak gjurmë (fig. 19) nuk përjashtohet mundësia që ai të ketë qenë i pjesshëm, madje dhe në formë kulle. Banesës i ndiqet deri diku me lehtësi muri rrethues i oborit që zhvillohet në krahun verior. Për tu shënuar në këtë oborr janë një sërë prej katër kamaresh, si dhe një lloj tyneli që zhvillohet dhe përtej mureve rrethuese të oborrit, për funksionimin e të cilit rezervohemi të japim mendim.

Një variant më vete i banesës kardhiqiote duhen mbajtur dhe disa shembuj tre katësh me zhvillim të theksuar prizmatik, me bazë katërkëndëshe kënddrejtë, krejtësisht të mbyllur. Emërtimin konvencional, prizmatik për këtë variant e gjejmë më të pranueshëm sepse kështu ai mund të dallohet nga një tipar i rëndësishëm në kompozimin volumor nga banesa e fortifikuar kardhiqiote. Emërtimi banesë e fortifikuar e tipit kullë, gjithashtu pasqyron mirë tiparet e kësaj banese, por i konsideruar brenda tipologjisë së banesës kardhiqiote ky emërtim mund të krijojë konfuzion.

Tipar themelor kompozicional i këtij varianti me karakteristika tepër të theksuara mbrojtëse është zhvillimi i banesës brenda një volumi të tnjeshtë prizmatik. Shembujt e këtij varianti janë jo te shpeshte. Tipike është banesa Nr. 7 (Tab. IV, fig. 20). Ajo ka një zhvillim tepër të përzgjatur në plan, në formën e katërkëndësnit këndrejte me brinjën gjatësore pothuajse tre here më të madhe se ajo terthore. Në katin perdhe ruhen mirë gjurmët e dy sterave paralele, në rundin e krahut jugor, të cilat janë të ndërlidhura me tub, rast ky unikal sa kemi vrejtur. Nuk duket asnjë shenjë shkallesn në katin e ndermjemë, duke lënë të kuptonet se ndërlidhja sigurohej me shkallë druri. Nga kati i ndërmjemë dhe aq me pak nga mbeturinat e pakta të katit të dytë nuk mund të përcaktohet asgjë mbi zhvillimin planimetrik të ketyre sipërfaqeve, ndarja e të cilave nëse ka ekzistuar ka qënë me materiale të lehta. Ambienti i vetëm sanitar i katit të ndërmjemë zhvillohej mbi njërin prej sterave duke marrë nga trashësia e murit një hapesirë në formë cilindrike, zgjidhje që ndeshet dhe në një ndërtim tjetër të këtij varianti. Ambienti sanitar i katit të banuar del në formë kulle. Të vetmit elementë, që ruhen, janë disa kamare, gjurmët e tubacionit qeramik për në sterë, dhe numeri shumë i madh i frengjive për armë zjarri, në të katër faqet e ndërtesës.

Një shembull i të njëjtit lloj, ruhet në gjendje relativisht të mirë, pranë ndërtesës së përshkuar më



Fig. 21

lartë. Ai (fig. 21) ruan qartë oborrin përpara saj përbri faqes lindore. Në dallim nga banesa Nr. 7, stera është me një volum, dhe me formuese të qemerit, paralel me brinjën më të shkurtër. Duken qartë gjurmët e tubit furnizues qeramik brenda trashësisë së murit. Ambientet sanitare, në të dy katet e sipërm, fitojnë një pjesë të volumit të tyre në kurriz të trashësisë së murit perimetral. Për tu shënuar është ndërtimi i dy vendeve të zjarrit me kanal në formë kalemi, në faqen veriore. Ata janë të vendosur mbi njëri tjetrin



Fig. 23

(fig. 22). Ashtu si banesa Nr. 7 dhe kjo dallohet për numërin e madh të frengjive.

Duke gjykuar nga pozicioni i këtyre dy ndërtimeve në pjesën më lindore të Kardhiqit dhe për më tepër nga karakteri thellësisht mbrojtës, që shihet si në kompozimin e saj, hedhjen në lartësi dhe frengjitë e shumta, nuk përjashtohet mundësia, madje është e pranueshme që këtu të jemi përpara dy kullave mbrojtëse, pra jo banesave të fortifikuara. Shkëputja pak a shumë e qartë nga morfologjia e banesës kardhi-



Fig. 22

qiote, në anë tjetër përkujdesja e theksuar për mbrojtje e bëjnë këtë hipotezë të pranueshme.

Krahas shembujve që mund të përfshihen në katër variantet e paraqitur më sipër, në Kardhiq ndeshen dhe banesa të tjera, të cilat përbëjnë zgjidhje disi të veçanta kompozicionale, natyrisht brenda repertorit tradicional të ambienteve formuese dhe elementeve arkitektonike.

Banesa Nr. 8 (Tab. IV, fig. 23), paraqet disa veçanti në kompozimin e saj. Ajo dallohet për kompaktësinë e madhe të ndërtimit, i cili përmbledh në më-

DO NOT COPY

nyrë shumë organike vetë banesën me oborrin e vogël. Ky i fundit, pjesërisht është nën një ambient banimi të katit të sipërm, duke paraqitur një rast unikal në rrënojat e banesave që ruhen. Gjithashtu rast mjaft i rrallë është qenja e dy hyrjeve për në oborr, duke qenë ajo kryesorja nga jugu, relativisht mjaft e madhe, mbuluar me hark rrethor.

Në katin përdhe banesa është e variantit me një krah me shkallë të jashtme. Ajo ka tre ambiente ndihmës në këtë kat, hyrjet për në të cilin nuk dallohen. Shkallë të jashtme guri të çonin në katin e banuar. Në të nuk përcaktohet dot numëri i ambienteve, por nga gjurmët e pakta dhe në analogji me shembujt e tjerë banesa duhet të ketë pasur tre ambiente banimi, me përjashtim të atij që ngrihet mbi pjesën jugore të oborrit. Ambientet sanitare të krahut verior dalin në formë kulle. Ambienti mbi oborr duhet të ketë pasur ndërlidhje me atë në krahun perëndimor.

Balli i faqes jugore ruhet thuajse në lartësi origjinale. Në ambientin mbi oborr ruhen mirë dy dritare mbuluar me hark, me thellimin karakteristik, si dhe një element unikal, një lloj kanali i pjerrët, i cili përfundon mbi portë me një dalje prej dy gurësh, që mbajnë një pllakë sipër tyre (fig. 24).

Ambienti përbri ruan një trakt të daljes së tymarit mbi çati. Në faqen e jashtme, ndërmjet të dy ambienteve të krahut jugor dallohet një fugë, që fillon prej këmbës së harkut të portës dhe deri në nivelin e dyshemesë. Kjo na le të dyshojmë se ambienti mbi oborr mund të jetë i mëvonshëm. Në këtë rast do të kishim të bënim me një banesë të zakonshme të variantit me një krah. Në rast të kundërt kjo zgjidhje gjen paralele në disa banesa qytetare, veçanërisht në zona ku trualli është i pakët, duke qenë kalimi për në oborr nën ujë, apo më shumë ambiente banimi.

Teknika e ndërtimit dhe elementet arkitektonikë. Elementët kryesorë ndërtimorë të këtyre banesave janë guri dhe druri. I pari është guri gëlqeror i nxjerrë nga kavot pranë fshatit. Ai nuk është shtresor dhe ka përmasa mesatare. Nga elementet e drurit nuk ruhet asnjë shënjë, përveç gjurmëve që presupozojnë përdorimin e gjërë të tij.

Terreni i fortë shkëmbor, thuajse ka mënjanuar ndërtimin e themeleve të thella. Shpesh pas pastrimit nga shtresa e hollë e dheut ndërtohet rreshti i parë i muraturës. Në disa raste muratura ngrihet drejtpërdrejt mbi shkëmb (fig. 23, 25). Muratura lidhet gjithmonë me llaç gëlqereje. Për forcimin e saj në muret e banesës vendosen breza druri (fig. 10, 12, 18) rreth çdo 70 cm. Ata vendosen çift, duke u lidhur rreth 70 cm me binarë tërthorë. Përgjithësisht brezi i brendëshëm del në faqen e muraturës ndërsa i jashtmi maskohet për tu ruajtur nga lagështia (fig. 8, 11), por ka dhe raste kur brezi i jashtëm nuk futet në mu-



Fig. 24



Fig. 25



Fig. 26

BOOT COPY

raturë (fig. 26). Gurët janë të latuar trashë, vendosja e tyre përpiqet të ruaj rreshta horizontalë. Në nivelin e çdo çifti brezash druri, bëhet rrafshimi i muraturës. Muret e avllisë nuk përforcohen me breza druri, duke qenë të pambrojtur nga rreshjet. Në disa raste haset dhe përdorimi i copave të tjegullave në muraturë. Trashësia e mureve luhat rreth 60-70 cm. Zakonisht duke kaluar në katin e sipërm, muratura ngushtohet rreth 5 cm. Qoshet janë të latuara (fig. 23) ashtu si dhe shpatullat e dyerve dhe dritareve, gurët ballorë të harqeve, mbulesat e kamareve etj.

Shkallët prej guri, janë mjaft të përhapura në Kardhiq. Ato janë një rampëshe prej një blloku të vetëm murature (fig. 11), gjithmonë ky i shkëputur nga muratura e banesës, si dhe një rampëshe me qemer nën nivelin e sheshpushimit përfundimtar, nën të cilin zakonisht është hyrja për në katua. Ndeshen dhe zgjidhja me dy rampa kur nuk e lejon vendi (Tab. III). Shkallët më të arritura janë ato të dyfishta, që zhvillohen simetrikisht kundrejt qemerit qëndror (fig. 14), zgjidhje kjo që takohet vetëm në një rast në gjendjen e sotme të rrënojave. Nga shtresa e shkallëve, nuk ruhet asnjë gjurmë.

Sterat gjithashtu janë relativisht të përhapura në Kardhiq. Ato përsërisin formën dhe teknikën e njohur për këto ndërtime[13]. Mbulesa e tyre realizohet me qemer cilindrik, i cili përforcohet me tiranta druri. Së brendshmi, deri në nivelin maksimal të ujrave, stera (fig. 15) suvatohet me llaç të papërshkrushëm nga uji me përzierje pluhur tullash dhe gëlqereje. Furnizimi i sterës bëhej me tuba qeramike, të vendosur brenda trashësisë së muraturës. Në një rast të vetëm, në të njëjtën ndërtesë ndeshen dy stera simetrike, pranë njera tjetrës (Banesa Nr. 7).

Nga konstruksioni i çative nuk ruhet asnjë gjurmë, por sigurisht ai ka qënë me material druri. Gjithashtu nuk ruhet asnjë gjurmë kornize. Ashtu si në Gjirokastër në disa banesa ruhen gjurmë të kornizës me dhëmbëzime në ballin e krahut kryesor, në nivelin e dyshemesë (fig. 26). Copat e tjegullave në muraturë tregojnë se krahas rrasave të gurit, duhet të jenë përdorur dhe tjegullat, përdorimi i të cilave përmëndet që në shekullin XVII, për mbulimin e një xhamie dhe disa banesave. I njëjti njoftim[14] tregon se krahas banesave të mbuluara me tjegulla kishte të tjera, të mbuluara me kashtë.

Dyshemetë, në shumicën e tyre kanë qënë prej druri, siç tregojnë shënjat e foleve të trarëve në muraturë. Vendosje e tyre relativisht afër, çdo 50-60 cm, tregon se lënda ka qënë me seksion të vogël. Krahas dyshemeve të drurit, mjaft të përhapura kanë qënë ato përdheset, sigurisht shtruar me rrasa guri, mbi mbushje dheu ose mbi qemer. Vetkuptohet se nuk ruhet asnjë gjurmë që të provojë qenjen e tavaneve, rrjedhimisht të formulimit të tyre.

Nga dyert, ruhen vetëm rrënojat e hapësirave, ndërsa shumë pak prej tyre ruajnë paturën. Një shembull i vetëm i ruajtur, (fig. 23) provon se ndërtoheshin dhe dyer të mbuluara, në faqen e jashtme me hark, ndërsa brenda me arkitra druri.

Dritaret janë një element që ruhet relativisht më mirë se dyert. Katojt ndriçohen nga hapësira të vogla në formë frengjije (fig. 8). Në katin e banuar, zakonisht në pjesën e prapme ndërtohen hapësira të vogla dritaresh mbuluar me arkitra guri. Në ambientet ballore, ndërtohen zakonisht dritare të mbuluara me hark në pjesën e jashtme (fig. 23) dhe arkitra guri së brendshmi, por ndeshen dhe mbulesa me hark guri dhe në pjesën e brendëshme (fig. 27). Numëri i vogël i dritareve dhe përmasat e tyre të vogla në ambientet fundore të lenë të kuptosh se baxhat duhet të kenë qënë të përhapura.

Vendet e zjarrit përbëjnë një element me rëndësi në banesën kardhiqiote. Siç kemi përmendur këto janë me kamare pranë vatrës (fig. 9, 16), si dhe me kanal tymi në formë kalemi (fig. 12). Shenjat tregojnë për vazhdimin e kanalit deri në tymarin mbi çati (fig. 23). Nuk ka shenja mbi qenjen e tamburit. Në të njëjtën banesë takohen të dy llojet e vendeve të zjarrit. Kamaret janë mjaft të përhapura në ambientet e ndryshme të banesave, madje dhe në muret rrethues (banesa Nr. 6). Krahas kamareve, më rrallë ruhen dhe gjurmë të dollapeve në mur (fig. 18), ndërsa sqolli ndërtohet shumë rrallë.

Siç kemi përmendur frengjija për armë zjarri është tepër e përhapur, duke filluar prej mureve rrethues e deri te ambientet e banimit. Ato i kemi hasur gjithmonë teke, në formë pyke, duke pasur hapësirën e jashtme në aksin e frengjisë (fig. 28) ose të çvendosur në njërin apo tjetrin krah.

Banesat nuk suvatohen nga jashtë, ndërsa nga brenda suvatohen vetëm ambientet e banimit. Suvatimi (fig. 13) është realizuar me llaç gëlqereje.

* * *

Banesat e Kardhiqit shquajnë për një tipologj relativisht të larme dhe të zhvilluar në krahasim me banesën fshatare të Labërisë gjatë shekullit XIX, për të cilën të dhënat janë të shumta. Të tre variantet kryesore të banesës kardhiqiote, ai me gjysmëkat per-

13) E. Riza, **Banesa e fortifikuar gjirokastrite,** Monumente: 1, 1971.
14) E. Çelebi, **Vep. cit.** 29.

PROTOTIPI

pendikular, me një krah dhe me dy krahë, i bashkon një lidhje e qartë në konceptimin e tyre, gjithë duke u dalluar një variant prej tjetrit, jo vetëm nga ana sasiore por dhe cilësore. Disi veças qëndron varianti i katërt, i cili paraqet tipare të ndryshme kompozicionale me banesën e fortifikuar të tipit kullë, por dallohet nga ai për mungesën e çikmave që dalin përtej volumit prizmativ të kullave. Banesat e Kardhiqit shquajnë për kompozimin e ngjeshur dhe sipërfaqet e vogla ndërlidhëse. Shpesh ndeshen kompozime me kalime nga një ambient në tjetrin. Në përgjithësi tipologjija zbatohet relativisht lirë, duke pasur brënda të njëjtit variant diferencime pak a shumë të dalluara. Në të tre variantet kryesore, shkallët janë të jashtme, por krahas tyre, në banesat e zhvilluara, duket se ka pasur dhe ndërlidhje të brendshme. Në Kardhiq nuk kemi ndeshur banesa përdhese. Kjo natyrisht nuk përjashton qënjen e tyre, por sidoqoftë mund të thuhet me siguri se dhe nëse ka pasur të tilla, ato kanë qenë të rralla. Kati përdhe i banesave kardhiqiote është gjithmon i pa banuar dhe ka funksione ndihmëse.

Banesat e Kardhiqit shquajnë, ashtu si mbarë banesat shqiptare ngritur mbi troje të pjerrët, për lidhjen e përsosur me truallin duke pasur kompozimi me gjysmëkat një përhapje mjaft të gjërë në të gjitha variantet.

Një prej tipave thelbësore të banesës së Kardhiqit, është karakteri i theksuar mbrojtës i saj. Ky tipar shikohet qartë në karakterin e mbyllur të banesës, hapësirat minimale të ndriçimit, vendit të tyre në ambient, kompozimit të hedhur në lartësi, shpesh në tre kate, muret e fuqishëm prej guri, dhe së fundi në përhapjen mjaft të gjërë të frengjisë për qitje me pushkë. Këto të fundit ndeshen që në muret rrethuese, e deri në ambientet e banimit, duke qënë vazhdimisht të shumta në faqen perëndimore dhe kur ajo e kishte pamjen të kufizuar nga banesa të tjera prapa saj. Ky fakt nuk ka si shpjegohet me armiqësi të brendshme, sepse përsërisim, frengjitë përgjithësisht drejtohen nga perëndimi, pika më e dobët e kësaj qëndre të fortifikuar, pra presupozohet qëndresa në çdo banesë. Me interes është pohimi i F. Pukëvilit, i cili duke përshkuar marrjen e Kardhiqit nga sundimtari i Janinës, shkruan «..... një qytet i vendosur tërësisht në mal, i përbërë nga shtëpi të ndërtuara të forta e prej guri, të nozulluara mirë dhe të mbrojtura me burra të vendosur, do të mund ta dëbonin, sepse ato ishin si fortesa të vogla, që duheshin rrethuar njëra pas tjetrës»[15].



Fig. 27



Fig. 28

15) **Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë,** Vëllimi III, 294 Tiranë 1962.

DO NOT COPY

Banesat e Kardhiqit me pamjen e tyre të jashtme, shquajnë për karakterin e ashpër monumental, ku mbisundojnë volumet punuar me muratura guri, që thyhen aty këtu nga elementë të pakët arkitektonikë. Dendësia e banesave dhe hedhja në lartësi, rrisin karakterin monumental të ndërtimeve. Banesat, duke gjykuar nga niveli i mirë i ndërtimit, kuptohet se janë vepër e mjeshtrave profesionistë, që tradicionalisht ndërtonin në këto zona.

Siç përmendëm me që banesat e Kardhiqit i përkasin shekullit XVIII, ato përbëjnë një dëshmi tepër të rëndësishme për ndjekjen e ecurisë së banesës shqiptare, duke pasur parasysh banesat rrënojë të Borshit dhe Kamenicës[16], të cilat i përkasin periudhës ndërmjet shekujve XIV-XVI.

Duke krahasuar banesat e këtyre qëndrave me ato të Kardhiqit vihet re menjëherë një ndryshim i rëndësishëm, ndërmjet banesave relativisht të thjeshta të Borshit e Kamenicës me ato të varianteve të zhvilluara të Kardhiqit. Ndërsa në Kamenicë, ku ruhet dhe një numër relativisht i madh banesash, mbisundon varianti me gjysmëkat perpendikular, i cili në shumë raste dyfishohet apo trefishohet me anë shtesash, në Kardhiq gjithë duke krijuar këtë bazë të rëndësishme formuese, arrihen realizime të zhvilluara kompozicionale, që dallojnë thellësisht nga shembujt shumëkthinësh të Kamenicës, ku më fort shihet një shumim mekanik i njësive bazë kompozicionale. Pra brenda rreth dy shekujsh banesa e zonës së Labërisë kishte arritur në disa realizime të rëndësishme për kohën. Por varianti i thjeshtë me gjysmëkat vazhdon ti qëndrojë kohës, jo vetëm gjatë shekullit XVIII, por dhe një shekull më vonë, siç tregojnë shembujt e shumtë në krahinën e Labërisë, dhe në shumë të tjera. Por, megjithëse nga ana e kompozimit kjo banesë ruan pothuajse të pandryshuar skemën, ajo pasurohet mjaft me elemente të ndryshëm arkitektonikë. Në banesat e Borshit dhe Kamenicës, ndeshim vendin e zjarrit me vatër e kamare, dritaret e vogla dhe dyert mbuluar me arkitra, kamaret, rrallë sqollin dhe sterat e vogla. Në banesat e Kardhiqit repertori i elementeve arkitektonikë vjen e shtohet ndjishëm me hapësirat e dyerve dhe dritareve mbuluar, përveç rasteve me arkitra dhe me hark guri në pamjen e jashtme, oxhaku me tymar përhapet shumë, përdorim të gjërë marin dollapet e murit, harku dhe qemeri, ky i fundit kryesisht për mbulimin e sterave, rrallë ndërtohen dhe korniza guri, si dhe shkallë një dhe dy fishe, pjesërisht mbi qemer cilindrik. Një element që zë vënd mirë në banesat e Kardhiqit është frengjia për pushkë, e cila të paktën duket se ka hyrë në këto banesa që në fillim të shekullit XVIII. Të gjitha këto tregojnë se gjatë një periudhe rreth dyshekullore banesa e zonës së Labërisë kishte njohur një rritje të dukshme, pa humbur lidhjet gjenetike me banesat paraardhëse, por duke u zhvilluar natyrshëm në përputhje me ecurinë e përgjithshme të mënyrës së jetesës, si pasqyrim i kushteve ekonomiko-shoqërore.

Rrënojat e banesave të Kardhiqit fitojnë interes të veçantë dhe lidhur me raportin e banesës qytetare me atë fshatare. Por në këtë krahasim, i cili me rastin konkret duhet bërë për arsye të kuptueshme me Gjirokastrën duhet pasur parasysh vendi i veçantë që zinte Kardhiqi si qendër e banuar gjatë shekullit XVIII. Duke pasur për bazë kriterin e njohur të natyrës ekonomike të një qendre të banuar del e qartë se Kardhiqi nuk bart tiparet e një qendre qytetare. Mungesa e plotë e ndërtimeve të tilla si pazari apo atyre shoqërore është mjaft domethënëse në këtë drejtim. Është me interes të përmendim pohimin e E. Çelebiut për Kardhiqin e çerekut të tretë të shekullit XVII: «Treg, han e banjë ska fare. Populli plotëson nevojat e tij në Gjirokastër»[17]. Por në anë tjetër, Kardhiqi ka qënë gjatë shekullit XVIII, një qendër e zhvilluar, siç flasin qartë rrënojat e banesave, të cilat presupozojnë grumbullimin e pasurive nga një pjesë familjesh, nëpërmjet shfrytëzimit dhe grabitjeve në kushtet e diferencimit përherë e më të madh të shoqërisë së kohës.

Qëndrimi i vendosur i Kardhiqit karshi Ali Pashë Tepelenës strehimi i feudalëve çamë e delvinjotë, kundërshtarë të vendosur të tij, në një periudhë kur pashai i Janinës ishte mjaft i fuqishëm, tregojnë se Kardhiqi në disa tipare afrohej me Gjirokastrën[18]. Prandaj edhe banesa kardhiqiote, të cilën pa hezitim do ta quajmë fshatare, me përjashtim të varianteve të thjeshtë nuk gjeti një përhapje të gjërë në Labëri. Megjithë këto konsiderata, raporti i banesës gjirokastrite dhe asaj kardhiqiote të shekullit XVIII paraqet interes jo vetëm në raportin banesë fshatare – ba-

16) A. Meksi, E. Riza. **Art. Cit.** E. Riza, **Banesa e herëshme fshatare në Shqipërinë e Jugut,** në «**Tradita në arkitekturë dhe art**» Tiranë 1979.

17) E. Çelebi, **Vep. cit.** 29.

18) E. Riza, **Banesa e fortifikuar gjirokastrite,** Monumentet, 1/1971. **Historia e Shqipërisë,** Vëllimi I, pjesa III, f. 157, Maket, Tiranë 1972.

DO NOT COPY

nesë qytetare, por dhe në atë të shtrirjes territoriale të banesës gjirokastrite.

Variantet e zhvilluar të banesës gjirokastrite ai me një dhe dy krahë kanë paralele të qarta me shembujt e të njëjtit lloj në banesat e Kardhiqit. Por banesa gjirokastrite është më e zhvilluar veçanërisht në ambientet ndërlidhës, të cilët njëkohësisht ruajnë në disa pjesë të tyre funksione qëndrimi. Mjaft të përmendim këtu çardaqet, të cilët nuk kanë gjurmë në gërmadhat e Kardhiqit. Trajtimi arkitektonik i banesave të hershme të Gjirokastrës gjithashtu është më i pasur, ndërsa për brendësinë nuk mund të bëhet asnjë krahasim për mungesë të dhënash. Por të dhënat e tërthorta si përmasat më të vogla të ambienteve të banimit etj. të shtyjnë të mendosh se këtu dallimet duhet të kenë qënë më të qarta. Përhapja relativisht e rrallë e variantit me një krah dhe dy krahë në fshatrat e tjera të Labërisë, gjatë shekullit XIX, tregon se në rastin e Kardhiqit ndikimi i banesës gjirokastrite është i qartë. Karakteri disi i veçantë i Kardhiqit si një qendër fshatare me peshë në jetën e kësaj zone[19] diferencimi i theksuar klasor, krijoi kushtet për të zënë vend në këtë qëndër një banesë e zhvilluar, e cila gjenetikisht i kishte rrënjët në këto troje.

DO NOT COPY

19) Cilësimet e Kardhiqit qytet nga E. Çelebiu, Pukëvili, dhe A. Baçe, mendojmë se nuk i përgjigjen së vërtetës, për vetë mungesën e gjurmëve sado të pakta të ekonomisë qytetare, që për kohën do të ishte zejtaria.

TAB. I



DO NOT COPY



DO NOT COPY

TAB. III



DO NOT COPY

DO NOT COPY

BANESA Nº8



BANESA Nº7



KATI PERDHE



KATI PERDHE



KATI I



KATI -I-



Emin RIZA

L'ARCHITECTURE DE L'AGGLOMERATION URBAINE EN RUINE DE KARDHIQ

DO NOT COPY

RESUME

En ce qui concerne l'histoire de l'architecture de l'habitation albanaise, une place importante occupent aussi les constructions en ruine du fait qu'elles nous permettent de connaître cette catégorie de construction au-delà du XIXe siècle, à propos de laquelle nous disposons des données plus ou moins complètes. Les vestiges de ces constructions comportent des valeurs authentiques, et de ce fait facilitent l'étude de l'évolution et du caractère de l'architecture de l'habitation albanaise dans le cours des temps. L'étude et l'interprétation de ces valeurs nous permettent, par ailleurs, de brosser un tableau plus exhaustif et plus fondé de l'évolution dans le temps de l'habitation albanaise. Les fouilles effectuées à ce jour sur le territoire albanais ont montré qu'il conserve bon nombre d'agglomérations urbaines, principalement rurales, qui, pour une raison ou une autre, ont été abandonnées à des époques différentes, depuis la période précédent l'occupation ottomane. Jusqu'à ce jour infime est le nombre des villages qui ont été l'objet d'études préliminaires, malgré cela on a pu réunir un matériel intéressant sur la typologie et le caractère de l'habitation paysanne dans l'Albanie du Sud pendant les XIVe-XVIe siècles. Les ruines de l'agglomération urbaine de Kardhiq viennent à compléter un important maillon dans l'histoire de l'évolution de l'habitation albanaise, précisément pour une période comme l'est le XVIIIe siècle à propos de laquelle nous ne disposons relativement que peu de données.

Le centre habité de Kardhiq est d'origine ancienne, du fait même des conditions économiques et stratégiques qui ont conditionné sa naissance en tant que centre fortifié pendant l'antiquité. C'est plus tard, au Moyen âge, pendant les XIIIe-XIVe s. qu'a été érigée la forteresse de Kardhiq. A ce qu'il paraît, c'est au cours de cette même période de temps, qu'a été fondé le village de Kardhiq.

En effet, selon le Registre fiscal ottoman des années 1431-32, il ressort qu'il avait à l'époque 34 maisons. Le voyageur turc E. Celebi, qui a visité notre pays vers le troisième quart du XVIIe siècle, affirme qu'il y avait à Kardhiq 150 habitations mentionnées par le Registre fiscal ou par Celebi se trouvaient à l'intérieur de la forteresse, hors de celle-ci, ou à la fois à l'intérieur et hors de ses enceintes, comme cela ressort du moins pour la fin du XVIIe siècle selon un document daté de 1692.

niveau où commence l'arc du voûte. Le toit à deux pentes du puits est couvert d'une couche de mortier puis viennent des dalles de pierre, dont celles placées dans l'auvent s'appuient sur une corniche comportant une seule rangée de dalles. Le nettoyage du puits se faisait en été, alors que diminuait la quantité d'eau venant de la source. A cette fin quelqu'un descendait avec une corde dans le puits et, après avoir provisoirement bouché le tube de céramique, il procédait à son nettoyage avec un seau. Le volume maximal de ce réservoir est d'une capacité de 40 000 litres. Le premier réservoir n'étant pas en mesure de satisfaire les besoins de la population en croissance, on construisit deux autres réservoirs (Fig. 1). Mais cette fois il a fallu capter l'eau en direction sud-est à un niveau environ de 4 m plus profond que la première source, ce qui a conditionné la différenciation de niveau des planchers du puits (Tab. I, 3). Le mur commun réalisé par degrés constitue une solution juste du point de vue statique, compte tenu de l'augmentation de la pression. La partie ajoutée se caractérise par une composition et une facture meilleures par rapport au réservoir initial. Sa façade principale se trouve sur un même plan que celle de l'ancien réservoir, solution imposée par des motifs d'ordre architectoniques et fonctionnel. Tandis que la partie postérieure des deux puits comporte deux plans différenciés (Fig. 2). Afin d'affronter la pression de la terre, qui ne peut être contrecarrée par la pression de l'eau, au milieu de la partie ajoutée on a construit un mur (Tab. I, 4), en formant de la sorte deux bassins. Puisque l'eau de la source coule dans le premier bassin, le mur en question a une ouverture dans sa partie centrale de manière à ce que l'eau, après avoir atteint le niveau maxima de 0.60 m, se déverse dans le deuxième bassin. Le mur du milieu remplit un rôle positif en ce qu'il soutient aussi la voûte cylindrique en pierres ciselées sur toutes leurs faces (Tab. I, 6). C'est à travers les degrés du mur mentionné plus haut que l'on descend dans le premier puits pour effectuer son nettoyage (c'est à cette fin qu'on a construit un palier aussi). Du point de vue fonctionnel, la technique de construction de la partie ajoutée est analogue à celle de la partie ancienne. Des quatre faces du puits, la principale est celle orientée en direction nord-ouest. On distingue immédiatement la première partie de celle ajoutée plus tard. Ici la partie plate de la maçonnerie en pierres est brisée dans une mesure considérable par l'ouverture des fenêtres arquées, lesquelles, selon le témoignage des gens du pays, servaient à y poser des lumignons quand ils venaient puiser l'eau pendant la nuit. Alors que la partie supérieure de cette façade est limitée par une corniche en plaques de pierres de l'auvent, qui comporte trois rangées de plaques dont celle centrale échelonnée (Fig. 3). Cette face est précédée par un plancher revêtu de dalles à 0.6 m du niveau du sol. On accède à sa partie supérieure à travers un escalier de pierre aménagé en son milieu. Des deux côtés du plancher il y a deux genres de cuvier pour faire boire les animaux. Le volume maximal du réservoir ajouté a une capacité de 170.000 litres d'eau.

A environ 15 m du premier puits, on en a construit un autre 20 ans après (Fig. 4). Le choix de cet endroit est conditionné à la présence d'une source souterraine. Ce puits-réservoir appartient à la variante plus simple (Tab. II, 1, 2, 3, 4, 5); il est couvert d'une voûte cylindrique (Tab. II, Fig. 5).

Comme on le voit, sa composition et sa technique de construction sont analogues à celles de l'aspect initial du premier puits. Dans ce cas le tube de céramique servant à conduire l'eau dans le puits se trouve à 0.8 m du niveau du plancher, dans le mur sud-est. Les arcs des fenêtres servant à puiser l'eau sont surmontés par deux autres arcs, dont celui moins épais sert d'appui à l'arc de la voûte. Les arcs sont des éléments de construction, mais ils influent aussi positivement et augmentent la valeur architectonique des deux façades. La capacité de ce puits est de 42 000 litres, le rapport entre le volume de la construciton en surface et celui de la construction au-dessous du niveau du sol est de 1:1.5. La source qui approvisionnait d'eau le puits s'étant épuisé avec le temps, les gens du pays décidèrent d'exploiter la source qui approvisionnait la partie ancienne du puits-réservoir. dont il a été question au début. C'est à cette fin que furent créées les liaisons nécessaires à travers des tubes de céramique installés en profondeur. Dans le deuxième cas, la partie initiale du premier puits a servi de réservoir au deuxième puits, ce qui nous rappelle le réservoir et la citerne du monastère de Vaniste (Fig. 6). Outre le mode d'approvisionnement en eau du réservoir à travers des tubes de céramique, ces puits n'ont aucun autre trait commun surtout du point de vue fonctionnel, celui-ci étant aussi le plus important dans les puits-réservoir, car le réservoir de Vaniste recueille les eaux superficielles et, en deuxième lieu, la prise de l'eau de la citerne se fait de l'extérieur à travers un bec installé à environ 0,5 m du niveau du plancher de la citerne.

Dans le Bas Dhrovjan il y a bon nombre de puits-réservoir, tout comme dans le haut Dhrovjan, du fait que sa population y était plus nombreuse. La dégradation des puits-réservoir a obligé les gens du pays a en construire d'autres, dont la plupart ont été mis en place au même endroit ou à proximité des anciens puits. En ce qui concerne leur datation, les nouveaux puits-réservoir sont beaucoup plus récents que les puits-réservoir anciens. Quant à leur composition, à de rares exceptions près, elle est analogue à celle des puits que nous avons décrit plus haut et des anciens puits en ruine du Bas Dhrovjan, mais ils diffèrent de ces derniers quant à la technique de construction de leurs façades et au traitement de certains éléments de construction.

Commençons la description des puits-réservoir du Bas Dhrovjan par une de leur variante le plus simple qui a été construite en 1876 (Fig. 7). Le contour extérieur de ce puits est de forme carrée, sa section intérieure circulaire a un diamètre d'environ 2 m. Ces deux caractérisitques le distinguent des autres puits de la variante simple: il est profond 6 m. La source souterraine se trouve du côté nord, le tube de céramique est installé à 0,8 m du niveau de son plancher. L'eau est captée à travers deux fenêtres arquées aménagées sur les faces sud et ouest. Cet exemplaire, montre clairement la tendance technique à construire sur les parements de la maçonnerie, ce

Proof

que l'on n'observe pas dans les puits mentionnés plus haut. Dans ce cas les pierres placées aux angles sont de coloration blanche, bien équarries et finement ciselées (Fig. 8). Le volume de la construction au-dessous du niveau du sol nous rappelle les puits de Dhropull, qui sont également de section circulaire et de dimensions presque égales. Mais le facteur principal qui les réunit dans le même groupe consiste dans le fait que ces puits aussi sont approvisionnés par des sources souterraines.

Quant à l'autre puits, il a été construit en 1904 (Fig. 9) face aux ruines d'un ancien puits. Son schéma planimétrique et le développement de son volume indiquent qu'il appartient à la variante plus évoluée et présente des ressemblances avec la partie ajoutée du puits (Fig. 1) du Haut Dhrovjan. Toutefois il convient de relever les différences quant au traitement technique des façades, notamment de la façade principale dont la maçonnerie des angles est travaillée avec plus de soin. La maçonnerie des parements est en pierres équarries de forme rectangulaire disposées en rangées régulières. Des études effectuées à ce jour, il ressort que le dernier puits-réservoir mis en place au Bas Dhrovjan est celui qui a été construit à proximité des ruines de l'église de Sainte-Marie. Cet exemplaire représente le puits de la variante composée (Fig. 10). La partie ancienne de ce puits comporte un bassin qui ne fonctionne pas et dont on ne connaît pas la date de construction, mais des données techniques et des témoignages des personnes âgées du pays il ressort que cet élément a été construit en même temps que la partie ancienne du puits N° 1 du Haut Dhrovjan. Quant à la nouvelle partie du puits ajoutée à l'ancienne, elle a été construite en 1927 comme cela ressort de l'inscription figurant sur une plaque de pierre placée sur la façade principale du puits. Les sources souterraines fournissent de l'eau à ce puits par derrière, l'une d'elles servaient à l'approvisionnement de l'ancienne partie et les deux autres de la construction ajoutée plus tard. Dans ce cas aussi on relève la similitude avec l'exemplaire cité plus haut quant au mode de composition et de traitement des éléments de construction et fonctionnels ainsi qu'à leur technique de construction. Par ailleurs, au Bas Dhrovjan aussi la capacité maximale du puits, le rapport entre le volume de construction en surface et celui au-dessous du niveau du sol, sont presque identiques à ceux des variantes respectives mises en place au Haut Dhrovjan. Les deux exemplaires que nous mentionnerons plus bas confirment ce que nous avons dit au début, à savoir, que ces puits-réservoir constituent un cas rare mais ils ne sont pas uniques dans leur genre. Le premier exemplaire a été mis en place dans la périphérie de la ville musée de Gjirokastra sur un terrain ouvert. L'eau était tirée du puits à travers sa margelle qui se trouve à 0.90 m du niveau du sol. Outre la margelle, on n'observe actuellement aucune autre trace de construction. Etant donné que ce réservoir est toujours plein d'eau, il est certainement approvisionné par la nappe d'eau souterraine. Quant au deuxième exemplaire, d'un aspect non clair comme le premier, il a été construit vers 1460 dans la forteresse de Drisht. Ce puits-réservoir, d'une dimension de 8 x 10 m, a son bord seulement à la surface comme l'exemplaire précédent. Selon les données existantes, il résulte que ce réservoir recueillait les eaux pluviales à travers un système de tubes. Le fait qu'il est utilisé de nos jours mêmes, et que l'eau s'y trouve pendant toute l'année au même niveau, nous induisent à supposer qu'il est approvisionné par les nappes d'eau souterraines. Selon les témoignages des habitants âgés de Haut et Bas Dhrovjan, il ressort que ces puits-réservoir ont été construits par les maîtres bâtisseurs de Kolonje, district de Korçe, qui, comme dans tous les autres ouvrages relevant de l'architecture populaire, ont fait preuve de talent et d'aptitude en apportant des solutions rationnelles à la composition simple mais efficace de ces puits, en procédant avec une logique puissante du point de vue de la construction, des proportions et des autres traits architectoniques.

DO NOT COPY

Shpresa PRIFTI

RESTAURIMI I NJË BANESE ME ÇARDAK NË SHKODRËN E VJETËR*)

DO NOT COPY

Burime të shumta historike provojnë se qëndra e vjetër e banuar e qytetit të Shkodrës, shtrihej aty nga mesi i shek. XVIII kryesisht në anën lindore të kalasë deri te lumi i Kirit duke përfshirë lagjet Ajazëm, Qafë, Tabak e Tepe. Në gjendjen e sotme ato pak banesa që kanë mbetur në pjesën kodrinore të lagjeve të përmëndura, na hedhin dritë mbi llojet e banesave të ndërtuara në qëndrën e vjetër.

Krahas banesave të tipit me gjysmëkat perpendikular me dy ose më shumë ambiente në kat, tip ky i njohur kryesisht në qëndrën e vjetër[1] është i njohur dhe tipi i banesës së hapur me çardak, tip i cili në masë të gjerë u përhap dhe pati zhvillim mjaft të madh në qëndrën e re gjatë shek. XVIII-XIX.

Banesa të cilën do ta trajtojmë, është një nga të paktat të tipit me çardak që ruhet ende në Shkodrën e vjetër, në lagjen Qafë[2] (fig. 1). Ajo spikat për kompozimin volumor dhe trajtimin e jashtëm arkitektonik, karakteristika këto që e shkëpusin qartazi nga masa e ndërtimeve përreth duke bartur në vetvete karakteristika të njohura të banesave të tipit me çardak.



Fig. 1

Ajo është e vendosur në fushë karshi Xhamisë së Plumbit, e ngritur paksa në kodrën në pjesën e prapme të saj, rrëzë rrugës që zbret nga ura me hark guri që të çon për në Ajazëm. Në krahun lindor banesa është e mbështetur në murin e avllisë, i cili përfundon me portën e vetme të banesës, në anën jugore e pjesërisht perëndimore është e rrethuar me mure jo të lartë mbi të cilat është hapur gjelbërimi kacavjerës i rrugës ndërsa në anën veriore ajo del drejtpërsëdrejti në rrugë. Territori që përfshin banesa ndodhet në dy oborre, në atë para banesës, relativisht i vogël ku ndodhet pusi e govata prej guri si dhe porta e hyrjes dhe në atë në krah perëndimor të saj që ka një shtrirje mjaft të gjerë i vendosur pjesërisht në fushë e pjesërisht në kodër.

Porta e banesës është dy flegërshe prej druri me dërrasa të afruara vertikale, rrethuar e ndarë me fashaturë të gdhëndura mbërthyer me gozhda e pafta kovaçi (fig. 2). Flegrat rrotullohen mbi binarë druri që përbëjnë një trup më vete me derën. Prapa porta sigurohet me llozë metalikë. Në të dy krahët e saj jashtazi, janë ndërtuar dy mure tërthor me atë rrethuesin. Të dy këta mure që shohin në rrugë kanë të vendosur nga një kamare të ulët mbuluar me qemer

*) Rilevimet janë kryer nga B. Penxha, K. Qatipi. Vizatimet janë të autores, fotot të autores e Xh. Haverit.

1) E. Riza. **Banesa popullore në Shkodër gjatë shek. XVIII-XIX,** Monumentet Nr. 4.

2) Banesa është ajo e Myfti Plakut. Ndodhet në lagjen 17 Nëntori Rr. Xh. Plumbit Nr. 27.



Fig. 2

guri (fig. 3). Po ashtu dhe vetë muret anash portës lidhen rreth mesit të tyre me një hark guri. Duke qënë një pjesë e jashtëme dhe kryesore e banesës, asaj gjithmonë i është kushtuar një kujdes i veçantë.

Banesa në fjalë është një ndërtim dy katësh me formë të çrregullt planimetrie katërkëndëshi jo këndrejtë (Fig. 4). Është me çardak të hapur në njërin krah me ambient të dalë në krahun lindor. Mbas çardakut rradhazi, ka të vendosur tre ambiente duke qënë në mes shtëpia e zjarrit, ndërsa mbas tyre, gjatë gjithë gjatësisë vjen qilari në formë të çrregullt.

Kati përdhe është i përbërë nga hajati dhe dy ahret ku ai i daluri në krahun lindor duket se ka shërbyer më vonë si ambient qëndrimi-sobë. Pjesa nën qilarin është e pa çfrytëzuar për arsye se terreni në këtë pjesë vjen i ngritur. Në hajat ndodhen dy kollona masive guri 75 x 80 cm të gjera ndërprerë çdo 1.10 m nga breza druri. Shkallët e vetme të banesës, mbështetura mbi kollonat e gurit vijnë me pesë këmbët e para prej guri në plan në formë gjysmë hark dhe të tjerat prej druri. Në pjesën tek shkalla hajati është i shtruar me kalldrëm që formon figura gjeometrike. Në faqen perëndimore e jugore të tij hajati ka të ndërtuar vonë dy mure nga të cilët ai perëndimori lartësohet deri tek çatia.

Hyrja në ahrin 1, bëhet nga dera një flegërshe druri e mbuluar nga jashtë me hark gjysëm rrethor më të thelluar se muratura e ngritur nga hajati dy këmbëshkallë guri. Në faqen përballë hyrjes ndodhen gjashtë kamare të vendosura në lartësi të ndryshme nga dyshemeja e ahrit e shtruar kjo pjesërisht me dhe e pjesërisht me terren shkëmbor. Ndriçimi realizohet nga një dritare e vogël e ndodhur kjo në krah të djathtë të derës. Ahri 2, është një i tërë i vetëm. Në faqen e tij jugore të ndodhur në ballë janë dy dritare të vogla për ndriçim dhe në skaj të djathtë, dera e vetme e hyrjes, e hapur kjo më vonë. Hyrja e saj fillestare ka qënë dera e mbuluar me hark guri (fig. 5), sot e mbyllur, gjurmët e së cilës duken mjaft qartë.

Çardaku është i hapur në ballë me dy rradhë shtyllash druri që përfundojnë lart me jastek të daltuar. Në të dy anët vjen i mbyllur. Në krahun lindor, bri ambientit të dalë ka një qoshk të mbyllur ndërtim i mëvonshëm i ngritur dy këmbë shkallë nga dyshemeja e çardakut. Ai ndriçohet nga tre dritare të larta të cilat i japin atij ndriçim të bollshëm. Përbri tij në vazhdim të kafazit të shkallëve në të njejtin nivel është sajuar vonë një qoshk, i vogël, i hapur, rrethuar me parmakë të thjeshtë.



Fig. 3

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

Shtëpia e zjarrit me përmasa të vogla ruhet deri diku mirë. Ajo është pa tavan e nuk ka trapazan. Është me dysheme dërrase dhe ruan pjesërisht vetëm në pjesën e poshtëme, vendin e prushit të një vend zjarri mjaft me interes. Anash ka dy kamare të ulta, dy të tilla në lartësi më të madhe nga dyshemeja ndodhen në dy faqe të tjera. Brendësinë e këtij ambienti të varfër e primitiv e pasurojnë dy raftet e murit, nga të cilët ai në krah të djathtë të oxhakut është i mëvonshëm, si dhe sergjia pjesërisht e dëmtuar. Këtë ambient e ndriçon vetëm një dritare në faqen nga çardaku, në krah të djathtë të derës që hyn në ambient. Dy porta të tjera, karshi njera tjetrës, nga të cilat ajo në krah të majtë të oxhakut është e hapur më vonë, sigurojnë lidhjen me ambientin e prapëm, qilerin si dhe odat e tjera të banesës. Shtëpia e zjarrit duke u ndodhur në qendër të ambienteve të katit me lidhje të drejtpërdrejtë me çardakun luan dhe rolin ndërlidhës të katit, si e tillë ajo e justifikon plotësisht qënien e saj si bërthamë e banesës.

Oda e miqve dallohet menjëherë që nga çardaku sepse dera (fig. 6) e saj është e përpunuar më me kujdes nga ajo e ambienteve të tjerë. Ky ambient me përmasa jo të mëdha, është i lartë dhe me tavan të thjeshtë dërrase të punuar me ngjyra të errta, ku fusha është e ndarë me çibukë të vendosur paralelisht rrethohet me katër korniza të thjeshta. Volumi karakteristik trapazan-musandër, në pjesën e sipërme trajtohet i hapur, me pesë hapsira të gdhendura, në formë ballkoni ku mungojnë parmakët e ulët. Pjesa e poshtëme ruan skemën e zakonëshme, rradhazi vjen açik rafti i gdhendur, dera e hyrjes në odë që nga tamburi i ulët, vendi i arkës së nuses, musandra me kapak të thjeshtë si dhe dera që të lidh me qilerin dhe shtëpinë e zjarrit. Si musandra ashtu dhe dyert e saj dhe ato të hyrjes janë të pikturuara me motive

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

primitive gjeometrike e floreale. Ndriçimi i odës sigurohet nga tre dritare të ndodhura në faqen karshi trapazanit. Mbi nivelin e sipërm të tyre dhe të raftit të gdhendur i ndodhur në faqen nga qileri, kalon sergjia e cila në gjendjen para restaurimit ishte mjaft e dëmtuar.

Dy ambientet e krahut lindor kanë një hyrje të përbashkët nga çardaku. Dera e hyrjes së tyre ka një teknikë tjetër punimi dhe trajtim dekorativ më të përpunuar, nga ato të dy ambienteve të sipërpërmëndur. Ambienti në krah të djathtë të shtëpisë së zjarrit megjithëse jo i njëkohshëm me të por përsëri mjaft i hershëm ruan mjaft mirë skemën e tij origjinale, me ndryshime të vogla jo të rëndësishme (Fig. 7). Nga ana e kompozimit arkitektonik dhe trajtimit të jashtëm të dritareve të saj faqja lindore trajtohet e veçantë, deri sot nuk kemi takuar një rast të tillë kompozimi, me gjashtë dritare të grupuara çift në lartësi nga të cilat tre të sipërmet janë me kafaz druri të gdhendur ndërsa tre të poshtëmet janë persiane me kafaz të kryqëzuar, të vendosura këto për arsye të pashpjeguar në lartësi të ndryshme nga dyshemeja e ambientit. Volumi trapazan-musandër në pjesën e poshtëme ka të kompozuar vetëm krahun e djathtë. Vendin e arkës së nuses dhe musandrën në qoshe të punuara këto mjaft thjeshtë. Pjesa e sipërme ka të njëjtën skemë me atë të odës së miqve, këtu ballkonet në pjesën e sipërme vijnë të harkuara dhe plotësuar me parmakë të gdhëndur. Faqja nga qileri ka në mes të ndërtuar tani vonë një oxhak, anash tij janë dy kamare të ulta si dhe sergjia që nuk vazhdon në pjesën e mezit por ndërpritet për arsye të qënies të oxhakut. Sergjia vjen në të katër faqet e odës. Ambienti i dalë në çardak është me përmasa të mëdha e relativisht i lartë. Ky ambient ka një zgjidhje të veçantë planimetrije, të pjesës së poshtëme, musandrës si dhe një trajtim të ndryshëm të trapazanit nga ai i dy ambienteve të përshkruar. Vjen i mbyllur me mur çatmaje i ndarë në pesë hapsira me pilastra të dala dhe mbi suva pikturuar peisazhe të ndryshme. Trapazani sipër është një ambient mjaft i gjerë dhe i ulët, i ndriçuar nga dy dritare të paisura këto me kapakë nga brënda. Njera del në çardak mbi derën e hyrjes dhe tjetra në faqen lindore të banesës, e punuar me kafaz druri të gdhendur njëlloj me ato të sipërmet të odës përbri. Të dy trapazanet e këtyre odave kanë komunikim ndërmjet tyre, që sigurohet nga deriçka e vogël e ndodhur në pjesën e vendtakimit të tyre. Ndën këtë gjerësi të trapazanit ndodhet musandra si dhe dy anekset e shërbimit sanitar që u rrijnë tërthor atyre të parëve me ballë nga faqja lindore e banesës. Musandra e vendi i arkës së nuses janë të mbështetur tek faqja jugore e ambientit përbri, duke lënë kështu një rruginë të ulët ka-

DO NOT COPY

limi me perden e odës në mesin e së cilës ndodhet porta e odës. Ndriçimi i ambientit është mjaft i bollshëm, ai sigurohet nga katër dritare të larta tre të vendosura në faqen jugore dhe njera në atë lindore. Rafti i murit ndodhet në faqen nga çardaku. Tavani vjen pothuaj i njejtë nga ana e konfiguracionit të dërrasave me atë të odës së miqve. Ai është më i përpunuar, në qoshe ka të pikturuara motive floreale, kapakët anësore janë të gdhendur. Ornamentika e dekorit të raftit e derës janë të njejtë për nga trajtimi në atë të portës së hyrjes nga çardaku. Ndërtimi në pjesën e prapme vjen i ndarë në mes me mur guri, në krahun e majtë ndodhen dy ambiente të vogla shërbimi, ku tek ai i dyti ndodhet një derickë e vogël e cila për arsye të terrenit mjaft të ngritur të nxjerr direkt e në rrugë. Në krahun e djathtë ndodhet qileri në fundin e të cilit është furra e vjetër origjinale. Qileri është i shtruar i gjithi me rasa të mëdha guri, është pa tavan dhe jo i suvatuar.

Muratura e banesës në katin përdhe dhe pjesërisht në katin e parë është me gurë kave të lidhur me llaç gëlqereje. Gjerësia e tyre shkon 60 – 65 cm. Faqja lindore si dhe ato të ahrit 2 dhe ato të shtuarat më vonë në hajat e kanë të përdorur llaçin me sasira të mëdha dhe muratura duket sikur është e suvatuar. Në katin e sipërm takojmë mure me teknikë të ndryshme. Muri ballor i ambientit të dalë si dhe ai jugori i ambientit përbri tij, janë mure me skelet druri, shtylla të vendosura vertikalisht çdo 50-60 cm mbërthyer në dy anë me paretka të holla suvatuar në dy faqe. Në muret e shtëpisë së zjarrit takojmë një teknikë shumë të herëshme e primitive. Perdja ndarëse me odën e miqve është e ndërtuar me një gardh thuprash të lidhura mbi shtylla druri me ∅ 8-10 cm të vendosura larg 60-70 cm e suvatuar vetëm në faqen nga oda e miqve. Suvatimet i gjejmë të teknikave të ndryshme. Në ambientin në krah të djathtë të shtëpisë të zjarrit gjatë sondazheve të bëra u gjëndën dy shtresa suvaje. E vona ajo ekzistuesja me llaç të zakonshëm, ndërsa ajo origjinalja, dora e parë rërë e ashpër me gëlqere ndërsa dora e dytë përfundimtare, shtresë e hollë patinimi e formuar nga përzierja e gëlqeres të stazhionuar përzier me fije kashte. Mbas patinimit akoma të njomë, është vendosur shtampa e parapregatitur nga mjeshtri me dru ose plumb me motiv floreal. Të gjitha faqet e odës me përjashtim të asaj të trapazanit janë modeluar me këtë shtampë (fig. 8) simbas dëshirës së paraqitur me disa kritere kompozimi si p.sh. rreth e rrotull kamareve, rrëzë sergjive e anës shpatullave të dritareve duke e pasuruar mjaft dekorin e këtij ambienti. Në ambientet qëndrore suvatimet i gjejmë me një përzierje gëlqere me lesh dhije duke krijuar sipërfaqe mjaft të lëmuar. Dyert janë të gjitha një flegërshe prej druri. Ato të hyrjes në ambientet qendrore si dhe ajo e odës në krah të djathtë të shtëpisë së zjarrit në pjesën e sipërme vijnë të harkuara e daltuar me modele të ndryshme. Teknika e punimit të musandrës të odës së miqve, ajo e tre dyerve të saj si dhe asaj të hyrjes në shtëpinë e zjarrit, paraqet një interes të veçantë për vetë faktin se mënyra e punimit të saj është një teknikë mjaft e herëshme. Dërrasa e punuar me zdrukth vende-vende e daltuar është punuar në stuk reliev (allçi dhe tutkall). Mbi të mjeshtri ka pikturuar motive floreale e gjeometrike. Nga sondazhet bërë shtresës së llumit që në kohë ka veshur dërrasën, dolën ngjyra mjaft të gjalla e të forta. Çatia e banesës për sipërfaqen e madhe që mbulon është mjaft e shtrirë. Madhësinë e saj e shtojnë shumë strehët e gjera. Në pamjen ballore, jugore, ato dalin nga muratura 1.80 m ndërsa në pamjen lindore e pjesërisht perëndimore 1.40 m. Në pjesën e prapme, për arsye të terrenit mjaft të ngritur streha me rrasa guri del rreth 8 cm. Në krahët ku terreni fillon e bie ajo fillon e zgjerohet dhe del rreth 35 cm. E gjithë çatia është e ndërtuar me dru pishe e lisi me nyje të kllaposura mbuluar me tjegulla vendi.

Pamjet e banesës me përjashtim të saj veriores dhe pjesërisht perendimores janë mjaft të gjalla e të larmishme. Pamja kryesore dallohet për transparencën dhe larminë e saj që kushtëzohet nga hajati i futur brenda, çardaku i hapur në ballë dhe ambienti i dalë. Dritaret e larta rrethuar me fashatura të daltuara druri krijojnë një kontrast të bukur e të ngushtë me sipërfaqen e suvatuar ndërsa strehët e gjera po ashtu, krijojnë dritë hije të theksuar që lehtësojnë përceptimin voluminoz të banesës. Monotonia e muraturës së gurtë thyhet mjaft mirë dhe gjallërohet në pamjen lindore nga larmia e elementeve të saj si: dritaret e grupuara çift në lartësi (fig. 9) me kombinim të bukur të kafazeve të tyre prej druri, rrethuar me fashatura të daltuara, oxhaku i dalë pak nga plani i murit si dhe dritarja e lartë me fashaturë trekëndëshe të daltuar (Fig. 10).

Ndryshimet që ka pësuar banesa në kohë

Duke e vrojtuar me kujdes banesën dhe duke e krahasuar atë për nga kompozimi planimetrik me banesat e tjera të këtij tipi duket qartë se ajo ka pësuar ndryshime në kohë. Për këtë na ndihmon mjaft dhe dekoracioni i brendësisë së ambienteve të dy krahëve i cili krijon mundësi për një shpjegim e lidhje të fazave edhe me arkitekturën e banesës.

Për të zgjidhur disa probleme që kanë lindur para hartimit të projektit të restaurimit është e nevojëshme të përcaktojmë në se kemi të bëjmë me një banesë të vetme që në fazën fillestare me çar-

Fig. 8



Fig. 9



Fig. 10



dak në ballë, apo me një banesë me ambient të dalë në njerin krah. Gjithashtu duhej përcaktuar konfiguracioni planimetrik që ka patur ndërtimi: ai qëndror me ate në krah të djathtë dhe në çraport kohor qëndrojnë këto dy pjesë ndërtimi, si dhe ndryshimet e tjera të bëra në kohë.

Sondazhet e bëra në dy vendtakimet e mureve anësore të ahrit 2 ndaj ahrit 1, treguan se ato të parat i bashkëngjiten të dytit, teknika e punimit të muraturës së tyre është e ndryshme. Tek vendi i derës që të fut në ahrin 2, sot (fig. 11) i mbyllur, duken qartë gjurmët e gurëve të hequr nga qoshja ekzistuese e ahrit 1, me qëllim për të krijuar paturën e re të derës së hapur më vonë. Vrojtimi tregoi se dhe teknika e ndërtimit të dy dyerve nuk është e njejtë. Për të përforcuar raportin e krijuar midis dy ndërtimeve, si jo të njëkohëshme, sondazhe u bënë dhe në katin e parë, kryesisht në faqen lindore të shtëpisë së zjarrit që del në rruginë. U konstatua nga gjurmët, se të dy dyert ajo që të lidh me qilerin si dhe ajo, sot e mbyllur e sajuar si raft muri në fazën fillestare kanë qënë dritare që shihnin jashtë (fig. 12) që u përforcua dhe nga krahasimi i tyre me dritaren sot ekzistuese. Të gjitha këto fakte tregojnë qartë, se të dy ndërtimet nuk janë të njëkohëshme dhe se ndërtimi në krahun lindor i është bashkëngjitur në kohë atij qendrorit. Për këtë mbas sqarimit të këtij problemi thelbësor, raportit kohor të dy pjesëve kryesore të banesës lindte pyetja:

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12



Fig. 13

DO NOT COPY

ndërtimi i prapëm (qileri), cilës fazë i takon, dhe a është i njëkohshëm me ndërtimin e dytë? Meqenëse muri i prapëm i qilerit ka vazhdimësi gjatë gjithë gjatësisë së tij dhe teknikë të njejtë punimi të muraturës, iu bënë sondazhe në tre vendtakimet e mureve të tij me ato të ambienteve mbështetës. Në të tre rastet u konstatua fuga (fig. 13), po ashtu ndryshimi i teknikës së muraturës (fig. 14) në qoshen e faqes lindore të banesës duke vërtetuar se kjo pjesë e banesës është bërë në një fazë tjetër të mëvonshme e lindur nga kërkesa e plotësimit të nevojave në rritje të familjes. Po ashtu ndërtime jo të fazës fillestare, njëkohësisht jo të njëkohëshme ndërmjet tyre, janë dhe dy muret në hajat, ai perendimor që lartësohet deri tek çatia si dhe ai përbri shkallës. Kjo del nga fuga që shihet mjaft qartë në vendtakimin e murit të parë në muret e pjesës qëndrore (fig. 15). Në murin e dytë duken shtyllat e drurit të murosura të shkallës (fig. 16) po ashtu ndërmjet tyre ato kanë fugë. Arsyeja e ndërtimit të këtyre dy mureve ka lindur me kohë duke u kthyer në një domosdoshmëri jetike. Duke qënë banesa në një vend të hapur, nën vërshimin e erërave të drejtimeve të ndryshme, ajo e kishte të nevojëshme të mbrohej për të krijuar ambiente sa më të mbrojtura e relativisht të ngrohta. Kështu në kohë banesës i ndërtohet muri pritës në krah, më vonë futen dhe shkallët brenda. Si «shtëpia e zjarrit» ashtu dhe oda e miqve në fazën fillestare kanë patur oxhak në mesin e faqes anësore. Oxhaku i shtëpisë së zjarrit është një vend zjarri mjaft interesant. Nga gjurmët gjatë punimeve të restaurimit doli dhe tymari me majë konike (fig. 17). Qënia e oxhakut në odën e miqve vërtetohet nga gjurmët e tij ekzistuese të ndodhura mbi dritaren e mesit. Me mbylljen e oxhakut dhe ndërtimin e vendin e tij të dritares, këto të fundit rriten në madhësi. Kjo duket



Fig. 14



Fig. 15

nga gjurmët e sergjisë ku del se dritarja e parë ka qenë me gjerësi 85 cm. Disa fakte e gjurmë të tjera na bëjnë të mendojmë se ky ambient në fazën fillestare, kur ka ekzistuar oxhaku ka pasë një kompozim tjetër. Për këtë shërbeu sergjia ekzistuese e cila megjithëse dritaret e vetme janë të dytat sipas gjurmëve të saj, ajo nuk ka shërbyer në fazën e parë mbasi nuk vjen e ndërprerë te vendi i oxhakut. Për këtë na ndihmojnë dhe gjurmët e dy dritareve që dalin në çardak të cilat nga proporcioni dhe dimensionet që kanë, të larta e të gjera nuk korespondojnë me ato të dy fazave të përmendura dhe janë ndërtuar më herët se ato. Ky arsyetim na ndihmon për kompozimin e faqes së oxhakut i cili ka patur në të dy anët e tij dritare të tilla. Fakte të tjerë si gjurmët e lartësive të shtuara të këtij ambienti dhe të njëjta me ato të shtëpisë së zjarrit, shenjat e fashaturave të pjesës së poshtëme të trapazanit, tregojnë se gjendja e sotme e këtij ambienti është një rikonstruksion i fazës së dytë.

Një problem i ndërlikuar për tu zgjidhur për mungesë faktesh e gjurmësh të plota si dhe thëniesh gojore, është përcaktimi i konfiguracionit fillestar dhe atij të fazës së dytë të ndërtimit të krahut lindor i përbërë nga dy ambientet, e veçanërisht të ambientit të dalë në çardak. Nga vrojtimi i kujdesshëm i bë-



Fig. 16



Fig. 17

DO NOT COPY

DO NOT COPY

së kësaj pjese të banesës, rezulton se gjurmët më të mëdha i gjejmë tek muri lindor i banesës.

Mund të themi me bindje se pjesa e ambientit të odës bri çardakut që del, jashtë konfiguracionit të ahrit e mbështetur në dy kollonat e gurit dhe një të drurit, është ndërtim i vonë. Këtë e vërteton së pari, teknika mjaft e re dhe e ndryshme e kollonave të gurit me atë të muraturës së ahrit, së dyti, gjurmët e qoshes origjinale të faqes lindore të murit, që korespondon dhe me drejtimin e faqes së dritares të ndërtuar në këtë pjesë muri, së treti gjatë punimeve të restaurimit doli se kjo pjesë e muraturës në faqen nga çardaku për arsye të mos pasjes të një baze të shëndoshë në katin përdhe, është ndërtuar me material të lehtë, perde me skelet druri në dy anët e gjerësisë së murit dhe së katërti, streha mjaft e ngushtuar në ballin e këtij ambienti.

Me ndërtimin e shtesës së lartë përmëndur nga gjurmët në murin lindor mund të krijojmë një ide të ndërtimit arkitektonik të kësaj faqeje pa patur të drejtë të vendosim dhe për faqet e tjera si dhe për kompozimin e brendëshëm të këtij ambienti. Gjurmët tregojnë se kjo faqe ka patur (fig. 18) oxhak në mes gjë që vërtetohet nga e dalura e tij në formë harku si dhe sipër anash tij dy dritare relativisht të mëdha me skelet allçije fiksuar në të dy faqet. Për ambientin përbri, mundësitë e ndryshimit të strukturës së tij planimetrike dhe ndërtimit arkitektonik të faqeve të dhomës, me përjashtim të asaj veriores ku nga gjurmët në suva dhe oxhaku i dalë në formë pilastre në qiler, bindemi se në mes të kamareve ka patur një oxhak të dekoruar në stuk reliev themi të dekoruar mbasi niveli i tij duhet ti përgjigjet nivelit të dekoracionit të pjesëve përbërëse të odës, të tjerët kanë ndryshime të rendësishme. Vjetërsinë e këtij ambienti lidhur ky me mos ndryshimin në kohë të tij e vërtetojnë: tavani shumë i hershëm e mjaft i thjeshtë, gozhdat e kovaçit të dyshemesë, suvaja origjinale e dekoruar, po ashtu dhe dritaret në lartësi të punuara me kafaz druri të gdhëndur. Megjithëse kjo mbetet një hipotezë e lidhur dhe me faktin se në një kohë të vonë, kur është rindërtuar, ambienti i dalë, gjithë faqja lindore ka pësuar rindërtim për shkaqe që nuk dihen. Po ashtu, dritaret e poshtme të vendosura në lartësi të ndryshme nga dyshemeja dhe sergjia në faqen e dritareve me disa gjurmë të vjetra e mbështesin këtë hipotezë.

Lidhur me ambientet e ndodhura në çardak mund të themi se ato janë ndërtime të mëvonshme, jo të fazës fillestare të tij. Me ndërtimin e ambientit në krah të çardakut ndërtohet dhe qoshku i hapur bri tij. Gjurmët e trarëve të gdhëndur të dyshemeve të dalë rreth 30-35 cm nga qoshja e odës (fig. 19) qoshja e pa shtuar, ruhen mjaft mirë deri në ditët



Fig. 18



Fig. 19

tona. Me ndërtimin e shtesës së ambientit të rindërtimit të saj, qoshku rritet në drejtim gjatësor rrafsh me faqen ekzistuese të ambientit të dalë, mbyllet me perde të hollë konstruksion druri dhe në faqet e tij ndërtohen tri dritare të larta. Improvizimin e këtij qoshku në gjendjen e sotme, e vërtetojnë dhe dy shtyllat e drurit në jastekët e daltuar të murosur në mur (fig. 20). Gjatë punimeve të restaurimit dolën në pjesën e shtuar nga oda përbri një raft, ndërsa në faqen nga shkallët një dritare identike me ato



Fig. 20



Fig. 21

ekzistueset. Me mbylljen e qoshkut, duke pasë përsëri sipërfaqe të lirë dhe për nevojat e lindura në familje është sajuar dhe qoshku i vogël i hapur që qëndron sot përbri tij.

Si konkluzion i gjurmëve të nxjerra e fakteve të dala, mund të themi se monumenti në kohë ka pësuar një serë transformimesh të cilat mund të grupohen në katër faza të vendosura në kronollogji relative; përveç ndryshimeve që kanë prekur elemente të veçantë të saj për nevojat e lindura në kohë funksionale apo imediate.

Faza e parë i përgjigjet ndërtimit qëndror, me shtëpinë e zjarrit dhe odën e miqve, që qëndrojnë si njësi më vete pa ndërtimet bashkëngjitur, me çardak në ballë të hapur në tre drejtimet. Mendojmë se në anallogji dhe me banesat e tjera të këtij lloji, ambienti sanitar ka qënë në pjesën e prapme të dy ambienteve, në gjerësinë e trapazanit dhe dera që del sot në qiler ka shërbyer për të hyrë këtu. Këtë e vërteton dhe vjetërsia e derës ekzistuese. Në këtë fazë çardaku mbështetej në katin përdhe krahas kollonave të gurit dhe në shtyllat e drurit. (Tab. I).

Në fazën e dytë njësia i bashkëngjitet ndërtimit në krahun lindor i përbërë nga dy ambientet. I njëkohshëm me këtë fazë duhet të jetë dhe muri perendimor i ndërtuar në hajat, mbasi teknika e punimit të tij është e njejtë me atë të ahrit 2. Për ambientin në krah të shtëpisë së zjarrit mund të hedhim ide mbi gjendjen fillestare me arsyetimet e bëra më lart, ndërsa për ambientin e dalë në çardak për mungesë të plotë gjurmësh e faktesh ai mbetet i pa qartësuar. Me ndërtimin e krahut lindor shtëpia e zjarrit pëson transformime. Dritarja në krah të djathtë të oxhakut shndrohet në derë për komunikim të brendëshëm me ambientet e rinj të krijuar. I kësaj faze është dhe ndërtimi i qoshkut të hapur si dhe rritja e lartësisë së dy ambienteve qëndrorë e shpjeguar kjo llogjikisht me rindërtimin e çatisë fillestare për arsye të çatisë së re ngjitur saj.

Faza e tretë është vendimtare për banesën në studim. Ajo lidhet me gjendjen e sotme të tij me disa ndryshime të vogla. Ndryshim pësoi balli i ambientit të dalë në çardak. Faqja e tij lindore trajtohet me çardak në mes e dy dritare sipër. I kësaj faze

DO NOT COPY

mendojmë se është dhe ndërtimi i qilerit gjatë gjithë gjatësisë së banesës, po ashtu dhe muri mbrojtës te shkalla. Transformime pësoi dhe ahri 2. Mbyllet porta me hark guri si dhe dritarja në këtë faqe dhe dritarja e cepit jugor shndrohet në derë. Kjo lëvizje e portës nga të thënat gojore bëhet për mos kalimin e bagëtisë nëpër hajat dhe futjen e tij direkte nga oborri.

Faza e katërt lidhet me rikonstruksionin e bërë odës së dalë në çardak, qoshkut dhe ahrit 2. Rikonstruksion pësojnë faqet jugore dhe ajo lindorja që i përgjigjen gjendjes së sotme. Mendojmë se i kësaj faze duhet të jetë dhe rindërtimi komplet i faqes lindore dhe të banesës. Për mungesë të dhënash për qoshkun mund të hedhim dy mendime: ose ka kaluar direkt në gjendjen e sotme duke mbyllur gjendjen e tij fillestare, ose faqet e tij kanë pësuar një rikonstruksion në këtë fazë, mbasi trajtimi i dritareve të tija është identik me ato të odës përbri. Pjesa e përparme e ahrit 2 ndahet me material të lehtë, suvatohet e kthehet në ambient qëndrimi.

Restaurimi

Restaurimi i këtij monumenti shtronte disa probleme të karakterit metodik, zgjidhja e të cilave do të kushtëzonte hartimin e projektit të restaurimit. Shtrohej problemi, a duhej të kthehej monumenti në fazën e tij fillestare apo të ruhej së bashku me strukturat e bashkëngjitura aty në kohë, njëkohësisht ç'qëndrim duhej mbajtur karshi elementeve të veçantë që mungonin.

Në gjendjen e sotme ndërtimi ka fituar vlera të reja si në planin kompozicional ashtu dhe në atë arkitektoniko-dekorativ. Është një rast tipik i ecurisë së zhvillimit të banesës shkodrane nga varianti më i thjeshtë me dy ambiente në çdo kat dhe me çardak në ballë, në variantin me katër ambiente në çdo kat e çardak në njerin krah. Ndryshimet e bëra nuk janë vetëm sasiore por bartin në vetvete kërkesa e koncepte të reja për banesën të para këto në raport kohor me periudha të caktuara historike në të cilat ato u ndërtuan.

Për vlerat e fituara në kohë, u vendos të ruhej struktura e sotme planimetrike, mbasi çdo shtesë e bërë ishte e lidhur organikisht me banesën dhe plotësonte nevojat imediate të saj. Rikonstruksioni i pjesëve munguese u zbatua në bazë të gjurmëve origjinale e dokumentacionit përkatës, kështu u veprua me oxhakun e «shtëpisë së zjarrit», po ashtu u bë ristampimi i dekorit origjinal të faqeve të odës. Punime me karakter rindërtimi u kryen në strukturat e mureve kryesore si dhe pjesërisht në suvatimet e ambienteve. Gjithashtu u bë rindërtimi i çatisë (fig. 21). Lidhur me strehët u rindërtua ajo origjinalja për të gjitha faqet e banesës. U bë rindërtimi i tavanit të odës në krah të djathtë të shtëpisë së zjarrit. Kujdes i veçantë iu kushtua restaurimit të trapazanit të dy odave qendrore (fig. 22). Rikonstruksion pësoi dhe balli jugor i ambientit të dalë në çardak[3].



Fig. 22

Banesa duhet të jetë ndërtuar nga fundi i shek. XVIII. Para afro një shekulli, mbas vitit 1874, nga dokumentat e të dhënat gojore, kjo banesë u ble nga një pronar, pjesëtarët e së cilës e trashëguan atë deri në ditët tona[4], në gjendjen e dy ndërtimeve të bashkëngjitura. Kjo gjendje i përgjigjet pak a shumë fazës së tretë të banesës. Ekzistenca dhe konkluzionet e dala me studimin e bërë banesës së ndodhur në qendrën e vjetër si banesë e hapur me çardak, e zhvilluar në variantet e saj, dëshmon për zhvillimin në masë të kësaj banese në qendrën e vjetër, sepse vetëm një familjarizim i gjatë i saj mund të sillte një përhapje aq të gjerë. Banesa të tilla të këtij tipi të zhvilluara në qendrën e vjetër u bënë pikënisje për përhapjen e saj dhe në qendrën e re. Karakteristikë kjo e përgjithëshme e ndërtimeve popullore që shpjegohet qoftë me një qëndrueshmëri relative të kushteve ekonomiko-shoqërore, qoftë me një farë konservatorizmi në ruajtjen e formave e tipave të ndryshme, si dhe me kohën relativisht të shkurtër të ndërtimeve në qendrën e re.

3) Punime restaurimi u kryen nga Ateljeja e Shkodrës në vitin 1973, të cilat patën kryesisht karakter konservimi dhe për së dyti në vitin 1978.

4) Shkodra 1961, fq. 96 (ruhet në bibliotekën lokale).
I. Kastrati. **Faqe të ndritura të Rilindjes kombëtare Shkodër** 1963, fq. 125.

NOT FOR SALE

TAB. I



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE
(FAZA FILLESTARE)



PLANIMETRIA E KATIT I
(FAZA FILLESTARE)



PRERJE TERTHORE
(GJENDJA EKZISTUESE)



PAMJE KRYESORE
(FAZA FILLESTARE)

DO NOT COPY

Shpresa PRIFTI

DO NOT COPY

RESTAURATION D'UNE HABITATION A TCHARDAK DANS LA VIEILLE SHKODER

RESUME

De nombreuses sources historiques montrent que l'ancien centre habité de la ville de Shkoder s'étendait, vers la moitié du XVIIIe siècle, surtout du côté oriental de la Forteresse jusqu'au fleuve Kir en englobant les quartiers d'Ajazm, Qafe, Tabak et Tepe. A leur état actuel le peu d'habitations, qui sont restées dans la partie mamelonnée de ces quartiers, font la lumière sur les divers types de maisons construites dans cet ancien centre.

Outre les habitations relevant du type à démi-étage perpendiculaire et avec deux pièces ou plus à chaque étage, on y trouve aussi l'habitation ouverte à tchardak, *qui a connu sa plus grande diffusion et son plus grand développement dans le nouveau centre de Shkoder pendant les XVIIIe-XIXe siècles.*

L'habitaton que traite l'auteur du présent article est l'un des exemplaires désormais rare du type d'habitation à tchardak *conservée de nos jours encore dans la vieille Shkoder, dans le quartier Qafe. Elle se fait remarquer par sa composition volumétrique et par le traitement architectonique de son extérieur, caractéristiques qui la distinguent clairement des autres habitations avoisinantes. Cette maison a les traits particuliers au type d'habitation à* tchardak.

Elle se dresse sur le terrain situé vis-à-vis de la Mosquée de Plumbi, qui s'érige sur la partie postérieure de la colline, et longe la route débouchant du pont à arc de pierre et se dirigeant vers Ajazm.

Il s'agit d'une construction à deux étages ayant une planimétrie quadrangulaire irrégulière, non à angle droit, avec un tchardak *ouvert sur une de ses ailes et une pièce en saillie sur son aile orientale. Immédiatement après le* tchardak *viennent l'une après l'autre trois pièces, avec la maison du feu au milieu, puis dans toute sa longueur nous avons la cave qui est de forme irrégulière.*

Les modifications que cette maison a subies dans le temps

En l'observant attentivement et en la comparant du point de vue de sa composition planimétrique avec les autres habitations de même type, il apparaît clairement qu'elle a enregistré des modifications dans le temps. Une importante contribution dans ce sens nous est fournie aussi par la décoration de l'intérieur des pièces situées des deux côtés, ce qui nous permet de donner une explication à la liaison existant entre les différentes phases architecturales de cette habitation.

Afin d'apporter la solution requise aux problèmes qui sont apparus pendant l'élaboration du projet de restauration, l'auteur du présent article a retenu nécessaire de définir si nous avions affaire à une habitation unique à tchardak *dans sa partie frontale dès sa phase initiale, ou à une habitation ayant une pièce en saillie sur une de ses ailes. Il fallait aussi déterminer la configuration planimétrique de cette construction par rapport à celle centrale située sur l'aile droite, les rapports chronologiques existant entre ces deux constructions ainsi que les autres modifications enregistrées dans le temps.*

Sur la base des traces récupérées et des faits découverts, il ressort que ce monument a enregistré maintes modifications que l'on peut regrouper en quatre phases ayant une chronologie relative; par ailleurs, d'autres modifications concernant des éléments particuliers de cette maison sont dues à des motifs d'ordre fonctionnel ou immédiats.

La première phase concerne la construction centrale, «la maison du feu» – la chambre des amis, qui constitue une unité à soi distincte des constructions contiguës, avec un tchardak *frontal ouvert en trois directions. Par analogie aux autres habitations de même type, à notre avis, le cabinet d'aisances se trouvait dans la partie postérieure des deux pièces longeant la largeur du* trapazan *et la porte qui conduit aujourd'hui au* qiler *servait de communication à ces pièces à l'époque. En témoigne aussi l'ancienneté de cette porte. Durant cette phase le* tchardak *s'appuyait sur l'étage à rez-de-chaussée, sur des colonnes de pierre et bois.*

C'est durant cette phase que cette unité s'est jointe à la construction située sur l'aile gauche et comportant deux pièces. A cette même phase appartient aussi, à notre avis, le mur septentrional construit dans le hayat, *car sa technique de construction correspond à celle de l'étable N° 2. Quant à la pièce située du côté de la maison du feu, nous pouvons supposer qu'il s'agit d'une construction initiale en raison des motifs exposés plus haut, alors que nous ne sommes pas en état de nous prononcer à propos de la pièce faisant saillie du* tchardak. *Par suite de la construction de l'aile droite, la mai-*

son du feu subit des modifications. La fenêtre ouverte sur le côté droit de la cheminée se transforme en porte pour assurer la communication intérieure avec les pièces nouvellement construites. C'est à cette phase qu'appartient aussi la construction du qoshk ouvert ainsi que des deux pièces centrales à un niveau plus élevé, ce qui s'explique logiquement par la reconstruction du toit initial en raison du nouveau toit adjacent.

La troisième phase est d'une importance décisive pour l'habitation que nous sommes en train d'examiner. Elle se rattache à son état actuel, à quelque différence près. La partie frontale de la pièce faisant saillie du tchardak subit des modifications. Sa face orientale est traitée en forme de tchardak au milieu et avec deux fenêtres dans sa partie supérieure. C'est à cette phase que l'on doit attribuer, à notre sens, la construction du qiler longeant toute la longueur de l'habitation ainsi que du mur de protection élevé à proximité de l'escalier. L'étable N° 2 aussi subit des modifications. On procède au murage de la porte à arc de pierre et de la fenêtre ouverte sur cette face, et la fenêtre de l'angle méridional est converti en porte. Ce déplacement de la porte, selon le témoignage des gens du pays, s'explique par la nécessité d'éviter le passage des animaux à travers le hayat et de les faire entrer directement par la cour.

La quatrième phase se rattache à la reconstruction de la pièce faisant saillie du tchardak, ainsi que du qoshk et de l'étable N° 2. Par ailleurs, les faces méridionale et orientale ont été reconstruites et correspondant à leur état actuel. Nous pensons qu'à cette phase aussi appartient la reconstruction complète de la maison dans son ensemble et de sa façade orientale. En l'absence de données sur le qoshk, nous pouvons avancer deux opinions: ou il est passé à son état actuel fermé depuis sa phase initiale ouverte, ou bien ses faces ont été reconstruites pendant cette phase du fait que ses fenêtres ont un traitement identique à celui des fenêtres de la chambre contiguë. La partie antérieure de l'étable N° 2 est divisée avec du matériel léger et, après son crépissage, devient une chambre de séjour.

La restauration

La restauration de ce monument posait certains problèmes de caractère méthodique, dont la solution allait conditionner l'élaboration du projet de restauration. Il s'agissait de savoir si le monument devait être reconverti à sa phase initiale ou s'il fallait préserver aussi les constructions qui lui avaient été ajoutées; par ailleurs, il s'agissait de savoir quelle attitude fallait-il adopter à l'égard des éléments qui manquaient.

A son état actuel, ce monument a gagné des valeurs nouvelles sur le plan de la composition et du point de vue architectonique-décoratif. Nous sommes en présence d'un cas typique d'évolution de l'habitation shkodrane, de sa variante la plus simple à deux pièces par étage et à tchardak sur sa partie frontale à sa variante à quatre pièces par étage et à tchardak sur une de ses ailes. Les modifications effectuées ne sont pas seulement d'ordre quantitatif, mais comportent en soi les nouvelles exigences et conceptions à l'égard de l'habitation envisagées sur le plan chronologique avec les périodes historiques durant lesquelles ces modifications ont été mises en oeuvre.

En ce qui concerne les valeurs acquises avec le temps, il a été décidé de conserver sa structure planimétrique présente, du fait que chaque adjonction faite se rattachait organiquement à l'habitation et satisfaisait ses besoins immédiats. La reconstruction des éléments qui manquaient a été effectuée selon les traces originales et la documentation relative. C'est ainsi qu'a été reconstruite la cheminée de la «maison du feu» et qu'a été refaite la décoration originale des parements de la chambre des mais. On a procédé de même à la reconstruction des structures des murs principaux et au crépissage partiel des pièces. Le toit a été reconstruit dans son ensemble. Quant aux auvents, en partant de l'original existant ont été reconstruits les auvents de toutes les façades de l'habitation. Il en a été de même pour le plafond de la chambre située sur le côté droit de la «maison du feu». Un soin particulier, a été consacré à la restauration du trapazan des deux pièces centrales. La face méridionale de la pièce en saillie du tchardak a été également reconstruite.

A ce qu'il semble, cette maison a été construite vers la fin du XVIIIe siècle. Il y a presque un siècle, après 1874 selon les documents et le témoignage des gens du pays, elle a été achetée par une personne dont les héritiers la possèdent encore à son état acuel de deux édifices contigus. Cet état correspond plus ou moins à la troisième phase de cette habitation. L'existence de cette maison dans l'ancien centre de la ville, en tant qu'habitation à tchardak ouvert ayant évolué dans ses différentes variantes, nous permet d'aboutir à la conclusion que la diffusion en masse de ce type de maison ne peut s'exliquer que par le fait de son utilisation pendant une longue période de temps. L'existence de ces types d'habitation dans le centre ancien de la ville est à l'origine de leur diffusion dans le nouveau centre aussi. C'est là une caractéristique générale des constructions populaires qui s'explique tant par la stabilité relative des conditions économiques et sociales que par l'esprit de conservatisme consistant à préserver les différents types et formes, ainsi que par le temps relativement bref des constructions dans le nouveau centre.

NOT COPY

Aleksandër MEKSI — Leonard SULI

PUNIMET KONSERVUESE DHE ARKITEKTURA E XHAMISË SË ALLAJBEGISË NË BURIM TË DIBRËS

Xhamia e Allajbegisë ndodhet e veçuar në fushë, pranë fshatit Burim të rrethit të Dibrës. Duke marë parasysh gjëndjen e xhamisë pas dëmtimeve të pësuara nga tërmeti që goditi rrethin e Dibrës në Dhjetor 1967 si dhe nevojën për riparimin e mbulesave, në vitin 1973 u ndërmorën një serë punimesh konservuese, pjesë e ndërhyrjeve të ardhshme restauruese.[1]

Xhamia përbëhet nga salla e lutjeve, me vëllim kubik, e mbuluar me kupol, minarja nga e cila sot ruhet vetëm bazamenti dhe themelet e hajatit të dikurshëm të shëmbur nga tërmeti në fjalë (Tab. I). Salla e lutjeve ka përmasa 6,40 x 6,27 m. Në të hyet nga një portë në anën veriore, pranë bazamentit të minares, pra në mënyrë asimetrike. Porta mbulohet me arkitra të rrafshët, mbi të cilin gjëndet një hark i shkallëzuar i mprehtë që afron me ata në formë fund lundre. Fusha që formohet në mes të dyve paraqet një nike të cekët të ndërtuar me tulla. Po me tulla është ndërtuar dhe harku i mprehtë. Mbi të nëpërmjet një rreshti tullash është vizatuar një drejtkëndësh që e bën akoma më të plotë ngjashmërinë me portalet tradicionale të xhamive. Në murin jugor të sallës ndodhet nikja e mihrabit si dhe gjurmët e mimbarit të dikurshëm, ndërtuar me elementa të drunjtë. Po kështu në anën veriore gjënden gjurmët e mafilit me struktura druri, në të cilin, në anën perëndimore, ndodhet porta e ulët që të çonte në minare. Salla e lutjeve mbulohet me kupol sferike. Kalimi nga planimetria katrore e sallës tek baza rrethore e kupolës bëhet me trompa të vendosura në qoshet, pjesa në dukje e të cilave ka profilin e një harku të mprehtë në pjesën e poshtëme dhe hark fund lundre në anën e sipërme. Salla është e ndriçuar në mënyrë të mjaftueshme nëpërmjet dhjetë dritareve. Këto janë të vendosura nga tre në dy radhë në faqet perëndimore, jugore dhe lindore dhe një në atë veriore. Shmangja nga vendosja tradicionale me pesë dritare në tre radhë për çdo faqe muri, e cila takohet në xhamitë e këtij tipi të vendit tonë[2] duket se vjen nga përmasat më të vogla të xhamisë së Allajbegisë. Të njëjtën zgjidhje ka dhe xhamia Glavica në Livnë të Jugosllavisë (v. 1587-8)[3].

Dritaret e poshtëme, që fillojnë pak mbi tokë janë drejtkëndëshe, të qarkuara me korniza guri (fig. 1). Mbi arkitraun prej guri kemi një hark shkarkues prej tullash në formë fund lundre. Fusha që formohet ndërmjet tyre, është një nike e ndërtuar vetëm me tulla. Dallohet ndër to dritarja në anën veriore, e cila sipër ka një nike që mbulohet me tulla të vendosura në formë stalaktitesh, në rolin e një mihrabi të dytë në hajat.

Dritaret e sipërme janë më të thjeshta dhe mbulohen me hark të mprehtë të shkallëzuar ndërtuar me tulla të vendosura sipas rasës, të rrethuara nga një kornizë tullash të vendosura përgjatë harkut.

Në anën e jashtme xhamia përbëhet prej vëllimit kubik të sallës së lutjeve dhe kupolës mbi tambur. Vëllimi kubik përfundon me çati me trekëndësha të ulur në qoshet dhe mbi të me një ngushtim të lehtë, ngrihet tamburi i ulët tetëfaqësh i ndërtuar në pjesën e kupolës, pra jo tambur i mirfilltë. Në këndin

1) Rilevimet janë të autorëve, vizatimet të A. Qyshkës dhe B. Penxhës. Punimet restauruese u kryen nga A'eljeja e Tiranës nën drejtimin e autorëve.

2) A. Meksi **Ndërtimet e kultit mysliman në Shqipëri,** Studime historike 3) (në shtyp).

3) H. Redzic, **Restauratorsko — konservatorski radovi na «Glavici» Dzamiji u Livnu,** Naše Starine, 1965, f. 99.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

DO NOT COPY

veriperëndimor, si zakonisht, ndodhet minarja. Prej saj ruhet bazamenti shumë faqësh ndërtuar me gurë të skuadruar dhe pjesa piramidale që e lidhte dikur me trupin e minares. Në kontaktin e të dyjave shihet një kornizë e profiluar me kalime të lakuara, e cila qarkon pjesën e lirë të minares. Muratura e minares lidhet nëpërmjet futjes së gurëve në muret e xhamisë, veprim që është kryer njëherazi me ndërtimin e mureve. Për këtë dëshmon dhe vendosja e dritares së poshtme pranë minares në faqen perëndimore, që nuk i përmbahet simetrisë për ti lënë vënd bazamentit të minares (fig. 2). Të njëjtin spostim kemi dhe në anën lindore, për t'ju përmbajtur simetrisë në brendësi.

Muret e xhamisë janë ndërtuar me gurë e tulla sipas teknikës së kluasonazhit. Gurët e përdorur janë kryesisht gëlqeror ndërsa tullat janë vendosur në dy rradhë horizontale me dy tulla të vendosura vertikalisht ndërmjet gurëve. Të tillë janë muri jugor, perëndimor dhe lindor. Muri verior (Tab. II), nga është dhe hyrja për në sallën e lutjeve dhe ku veçohen për nga trajtimi si portali ashtu edhe dritarja e vetme në të, nuk është i ndërtuar me teknikën e mësipërme. I tillë është vetëm një fragment në pjesën e sipërme të këndit verilindor dhe muratura e këtij këndi, që është vijimi i asaj të faqes lindore. Ky fakt së bashku me vrimat që ruhen në të na shpie në përfundimin se në këtë anë të xhamisë që me ndërtimin e saj ka patur një portik me konstruksion të drunjtë. Të tillë portikë në vendin tonë kemi takuar në xha-

mitë e Ballies (v. 1605) dhe atë të Nazireshës (v. 1599) në Elbasan dhe më vonë në Peqin (sh. XIX) Kavajë (v. 1736) dhe Tiranë (v. 1794-1821)[4]. Duke gjykuar nga mbeturinat e themeleve të portikut jemi të prirur të mendojmë se portiku do të ketë qenë mbi shtylla druri. Portikët e parë që takohen në xhamitë e vendit tonë janë mbuluar me kupola mbi shtylla guri, si në xhaminë e Ilias Bej Mirahorit në Korçë (v. 1496) dhe xhaminë e Plumbit në Berat (v. 1553-54)[5]. Me sa duket nga gjysma e dytë e shekullit të XVI, me shtimin e popullsisë myslimane të qëndrave të banuara, portikët bëhen me çati druri për të marë përmasa më të mëdha, për të zënë brënda tyre një numur më të madh besimtarësh.

Për njohjen e traditave tona në fushën e ndërtimeve, evidentimi i teknikës së ndërtimit të mureve të xhamive me gurë e tulla përbën një element të rëndësishëm. Teknika e mureve kluasonazh, është një teknikë e cila është në përdorim të gjërë gjatë shekujve XIII-XIV në vendin tonë kryesisht në ndërtimet e kultit. Kjo teknikë, ndërkohë, në (shek. XV-XVI) nuk përdorej nga arkitektura turke, gjë që tregon se monumentet tona janë ndërtuar nga mjeshtër vendas. Sigurisht që kjo teknikë ju përshtat kërkesave dhe nivelit të ri të ndërtimeve, duke ju përmbajtur formës që e takojmë dhe në këtë xhami. Në të njëjtën kohë përdorimi i gurit dhe tullës bashkërisht është dëshmi e një shije arkitekturale që dallohet nga monokronia e xhamive turke të kohës[6]. Në rastin tonë, xhamia e Allajbegisë përbën shëmbullin më në veri të vendit tonë ku takohet teknika e kluasonazhit.

Duke vrojtuar pjesët e sipërme të mureve, të cilat përfundojnë me korniza prej tullash të vendosura në formë dhëmbësh share, dallojmë që pjesët e këndeve, me çati trekëndëshe të ulur në qoshet, nuk janë me muraturë të rregullt (Tab. II). Ato ose imitojnë keq kluasonazhin ose janë me muraturë të ndërtuar me gurë. Kështu këndi juglindor përbëhet prej gurësh të vendosur në mënyrë të parregullt, këndi jug-lindor imiton kluasonazhin, ndërsa ai verilindor është punuar me muraturë të parregullt. Në këtë rast të fundit ruhet dhe fuga vertikale e kontaktit të pjesës së vjetër me muret e reja. Kjo na shtyn të mendojmë se kishim të bënim me plotësime të mëvonshme të pjesëve të këndeve mbi trompat në qoshet. Këtë zgjidhje në vendin tonë e takojmë më vonë në xhaminë e Velabishtit pranë Beratit ndërtuar në vitin 1760[7].

Duke marë parasysh gjëndjen e përgjithshme të mbulesave të xhamisë që ishin mjaft të dëmtuara nga koha dhe agjentët atmosferikë, u mendua që në këtë monument të ndërmereshin punime konservuese. Të tilla do të ishin rindërtimi i mbulesave me tjegulla, plotësimi i kornizave si dhe trajtimi në vija të përgjithshme i kluasonazht (plotësimi i fugave në vendet e dëmtuara dhe pastrimi nga ngjyrosja me gëlqere).

Punimet filluan me rindërtimin e mbulesave. Për këtë fillimisht u ndërmorën sondazhe në pjesët këndore për të përcaktuar formën e tyre fillestare. Sondazhin e parë e bëmë në qoshen verilindore. Filluam atje sepse si pamë dhe më lart në të ruhej fuga vertikale që ndante kornizën me dy rradhë tullash të vendosura në formë dhëmbësh share nga muratura e re, ashtu edhe pse pikërisht nën të ndodhej fragmenti me kluasonazh në dukje, mbi çatinë e dikurshme të hajatit. Me pastrimin e mbushjeve nën çati dolën në pah mure me trashësi 40-50 cm, si vijim i mureve anësor të xhamisë, mbi të cilët ishte krijuar çatia e re trekëndëshe (Tab. III). Këto mure ishin punuar me faqe të rregullt vetëm në anën e jashtëme. Gjithashtu rezultoi i ndërtuar me kluasonazh muri që lidhte me kënd 45° faqen veriore me atë lindore, duke krijuar në këtë mënyrë, në nivel më të ulët, çatinë e pjesës këndore. Mbi këtë mur ruheshin gjurmët e kornizës së dikurshme me tulla të vendosura në formë dhëmbësh share. Të njëjtin sondazh e bëmë dhe në qoshen juglindore dhe patëm të njëjtin rezultat. Ndërsa në qoshen jugperëndimore nuk ruheshin gjurmë të kornizave mbi murin e vjetër.

Gjatë shqyrtimit të ndërtimit të faqeve të jashtme të mureve patëm vërejtur se në faqen veriore korniza me të cilin përfundonin muret ishte e ndërtuar me dy rradhë tullash të vendosura në formë dhëmbësh share, ndërsa kjo kornizë ishte në një rradhë tullash të vendosura në formë dhëmbësh share. Për të sqaruar këtë problem pamë me vëmëndje kornizat në pjesën këndore dhe rezultoi se nga niveli i fillimit të kornizës e deri në nivelin ku fillonte kluasonazhi i tamburit, kishte vend për dy rradhë me tulla të vendosura në formë dhëmbë share, duke llogaritur këtu edhe mbulesën me tjegulla mbi kornizë.

Pra duke rikonstruktuar pjesët e sipërme të xhamisë, si dhe e patëm supozuar doli se kemi të bëjmë me një ndërtim ku vëllimi kubik i sallës së lutjeve përfundon në këndet së pari me një pjesë të mbuluar me çati trekëndëshe në nivel më të ulët, ndërsa më lart, pas një ngushtimi mbuluar me tjegulla, ngrihet

4) Për këto ndërtime shih A. Meksi, **vep. cit.**
5) **Po aty.**
6) U. Vogt-Goknil, **L'architettura ottomana,** Milano, 1962, f. 181.
7) A. Meksi, **vep. cit.**

BOTIMOR

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

tamburi tetëfaqësh (fig. 3), si e përmendëm dhe më lart këtë zgjidhje në vendin tonë e gjejmë vetëm në xhaminë e Velabishtit pranë Beratit.

Me sqarimin e këtij problemi nëpërmjet sondazheve, duke mos dashur të riformojnë kornizat e dyfishta nën çatitë, ruajtëm gjëndjen e deriatëhershme, duke lënë për një kohë të dytë kthimin në gjëndjen fillestare, kthim i cili nuk bie ndëshas me parimet tona për restaurimin e monumenteve të arkitekturës. Gjithashtu për të mënjanuar efektin e keq të uniformitetit kromatik pastruam mekanikisht ngjyrosjen me sherbet gëlqereje të muraturës duke i dhënë asaj pamjen karakteristike dy ngjyrëshe, të tullave me fugat e llaçit dhe të gurëve (fig. 4).

Tipologjikisht xhamia e Allajbegisë bën pjesë në grupin e xhamive me kupol. Xhamitë e këtij tipi janë ndërtime ku kërkesat e porositësit janë më të mëdha në drejtim të monumentalitetit dhe vlerës së materialeve të përdorura. Tipar dallues i tyre është salla e lutjeve me planimetri katrore, ndërtimi vëllimor i të cilës përbëhet prej një kubi të mbuluar me kupolë sferike. Gati gjithnjë në pjesën e përparme këto xhami kanë një portik ku ndodhet dhe hyrja për në xhami. Ndërsa ndërtimi i xhamive të tipit sallë mbuluar me çati druri fillon me stabilizimin relativ të gjëndjes në tokat e pushtuara, për vetë faktin se ato ndërtohen me lehtësi, ndërtimi i xhamive të tipit sallë me kupol fillon gjerësisht në mesin e sh. XVI me fillimin e mëkëmbjes ekonomike të vendit dhe me shtimin e popullsisë së qyteteve krahas ritjes së ritmeve të islamizimit të saj, i cili asnjëherë nuk ndëroi karakterin kombëtar të saj.

Shembujt më të vjetër të këtij tipi në sferën e ndërtimeve turke janë xhamia e Alaedinit në Bursë (v. 1335)[8], Jeshil Xhamia në Iznik (v. 1349)[9] dhe xhamia e Iliaz Beut në Balat (v. 1404)[10]. Karakteristikë e këtyre ndërtimeve të para është vëllimi i ulët i pjesës me kupolë. Këto ndërtime fillojnë të ndërtohen rallë në Stamboll në periudhën klasike të arkitekturës turko-osmane (sh. XV-XVII).

Në vendin tonë shembullin më të vjetër e përbën xhamia e Iliaz Bej Mirahorit në Korçë, ndërtuar në vitin 1496[11]. Xhamia me ndërtim karakteristik të fundit të sh. XV, përbëhet nga salla e lutjeve, portiku me tre hapsira dhe minarja. Shënja dalluese të saj nga ndërtimet turko-osmane të kohës janë kryesisht dy. Së pari përfundimi i vëllimit kubik me pjesë më të ulta me çati trekëndëshe në qoshet dhe së dyti teknika e ndërtimit me kluasonazh e mureve. Xhamitë turko-osmane tek ne kanë vëllim kubik të qartë që përfundon në pjesën e sipërme me korniza të drejtë horizontale. Me sa duket kjo do të jetë influencuar nga monumentet e arkitekturës bizantine të vendit tonë, me një ndërtim piramidal në anën e jashtme të ndërtesës. Përsa i përket përdorimit të tullave dhe gurëve me teknikën e kluasonazhit në muraturën, shembujt e parë në xhamitë i takojmë rreth vitit 1492. Nga to ruhet e plotë xhamia Mbret e Elbasanit[12] e tipit sallë me çati druri e tjegulla. Që nga ky shembull i parë vërehen rrënjët e thella të kësaj teknike në traditën ndërtimore të vëndit tonë si dhe fakti që ndërtuesit e këtyre monumenteve janë mjeshtra vendas.

Me xhaminë e Mirahorit ky tip fillon rrugën e zhvillimit të tij në vendin tonë. Mbetet për të hetuar me studime të mëtejshme se në çfarë mase ky monument shërbeu si prototip për ndërtimet pasuese të këtij tipi. Dy ndërtime të tjera me rëndësi të mezit shek. XVI janë xhamia e Muradies në Vlorë (v. 1542?)[13] dhe xhamia e Izgurliut në Berat (v. 1553-54)[14], të cilat janë vepra të arritura të arkitekturës sonë të këtij shekulli. Xhamia e Muradies është e ndërtuar me rreshta gurësh dhe tullash që të kujtojnë ndërtimet e kësaj kohe të arkitekt Sinanit në Stamboll. Ajo shquhet për ndërtimin e mirë të mureve, për punën e rregullt të kornizave, dritareve dhe portalit të hyrjes. Dikur ka patur dhe një portik, nga i cili sot ruhen vetëm gjurmët në murin verior dhe bazamenti me dyshemenë. Shënjë tjetër dalluese e kësaj xhamie është tamburi dymbëdhjetëfaqësh. Xhamia e Izgurliut në Berat (xhamia e Plumbit) fikson akoma më tepër tiparet dalluese të xhamive të vëndit tonë, si teknikën e ndërtimit të mureve me kluasonazh dhe çatitë e ulta trekëndëshe në qoshe. Gjithashtu këtu ndryshe nga dy xhamitë e mësipërme, faqja e jashtme e mureve vazhdon edhe për tamburin e ulët tetëfaqësh pa ndonjë kornizë apo ngushtim. Portiku i saj i sotëm trepjesësh dhe i mbyllur është një ndërtim i vonë. Dikur, siç na njofton Çelebiu, xhamia kishte një portik me shtatë hapësira. Karakteristikë për këtë xhami është vendosja e dritareve në tre radhë, nga të cilat të poshtëmet janë kuadratike. Këtë zgjidhje e marin më vonë gati tërë xhamitë e vendit tonë.

Tre xhami të këtij tipi ruhen në qytetin e Elbasanit; xhamia e Nazireshës në periferi, xhamia e Ballies dhe xhamia e Agait në pazar, xhamia e Nazireshës (v. 1599)[15], përbëhet nga salla e lutjeve mbuluar me kupolë mbi trompa në qoshet dhe minarja që është e dëmtuar në pjesën e sipërme. Dikur ka patur dhe një portik me struktura druri, për sa gjykohet nga gjurmët në murin verior. Muret e xhamisë janë ndërtuar me teknikën e kluasonazhit me dy radhë tullash horizontale dhe më shpesh një se sa dy tulla të vendosura vertikalisht në mes gurëve. Si dhe tek xhamia e Muradies në tamburin dallohen dy pjesë njëra me të njëjtën teknikë të mureve dhe një pjesë e dytë me muraturë të çrregullt. Me sa duket duhet të kemi të bëjmë me një rindërtim. Minarja është e ulët dhe e ndërtuar me një resht tullash dhe tre rreshta gurësh, ndërsa kazani ka qënë ndërtuar me tulla.

Xhamia e Ballies (v. 1605)[16], përbëhet nga portiku i vonë në anën veriore, salla e lutjeve dhe minarja. Muret janë ndërtuar me gurë të çrregullt dhe përfundojnë me korniza të dyfishta prej dhëmbësh share. Ndryshe nga xhamia e Nazireshës që shquhet

8) K. Aptullah, **Basic Space and Form Concept in Early Ottoman mosque architecture** në «Atti del secondo Congresso Internazionale di Arte Turca», Napoli, 1965, 181, fig. 1-2.
9) S.K. Yetkin **L'architecture turque en Turquie,** Paris, 1962 f. 66, shën. 1
10) **po aty** f. 77-79.
11) P. Pepo **Dy dokumenta mesjetare mbi Shqipërinë** — Berati i **Sulltan Bajazitit të** II dhe **Vakëfnameja e Mirahor Iliaz Beut**, B.SH.SH. 3, 1956, 289. A. Meksi, **vep. cit.**
12) A. Meksi **vep. cit.**
13) **Po aty.**
14) V. Buharaja **Mbishkrimet Turko-Arabe të vëndit tonë si dëshmi historike,** Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike, II, Tiranë, 1969, f. 83. A. Meksi, **vep. cit.**
15) **po aty,** 83, A. Meksi, **vep. cit.**
16) V. Buharaja, **vep. cit.** 83, A. Meksi, **vep. cit.**

ISTOK

për proporcione të hedhura në drejtim vertikal dhe që përbën një tendencë që zhvillohet më tej në xhamitë e tjera të Shqipërisë së Mesme, xhamia e Ballies është e ulët.

Pranë banjës së pazarit ndodhej xhamia e Agait[17] që e kemi identifikuar me xhaminë e Agait të Biçakçi Zadesë që përmënd Çelebiu[18]. Si dhe xhamia e Ballies kjo është ndërtuar me gurë çka do të thotë se teknika e kluasonazhit nuk përdoret më duke u zëvendësuar me muraturën e gurit e cila është më e lehtë në ndërtim, për këtë duhet të kenë influencuar dhe kërkesa estetike.

Një xhami tjetër është xhamia e Gjin Aleksit në Rusanj të Sarandës, dikur lagje e Delvinës. Ajo përbëhet nga salla e lutjeve mbuluar me kupol, portiku me çati druri mbi arkada të gurta me hark të mprehët dhe minarja. Në formulimin e vëllimit të jashtëm ky monument gjason me ato të Mirahorit dhe Muradies për prezencën në anën e jashtme të një ngushtimi të lehtë e të një kornize në të. Për nga teknika e ndërtimit vetëm me gurë dhe ndërtimi vëllimor e kemi datuar këtë xhami si të fundit sh. XVII, gjysmës parë të sh. XVIII[19].

E ngjashme me këtë xhami është dhe xhamia e Pazarit në Gjirokastër (v. 1757)[20]. Ndërtimi i saj në teren të pjerët ka përcaktuar formën me gjysëm kat, për këtë hipja në këtë xhami bëhet me një shkallë dy krahëshe ku në pjesën e poshtëme mbuluar me qemere është lënë një rrugë kalimi e ngushtë me dyqane. Salla e lutjeve, e ulët dhe mbuluar me kupol qarkohet në krahët veriore dhe lindore me një portik të hapur në pjesën e përparme.

Xhamia e Velabishtit, që si e përmëndëm më lart, ka një paralele me xhaminë e Allajbegisë në ndërtimin e pjesës së sipërme të vëllimit kubik të sallës lutjeve, është e ndërtuar me gurë të rafshtë. Karakteristike për këtë xhami janë proporcionet e hedhura. Dikur ka patur dhe një portik në anën veriore, nga i cili, ruheshin vetëm gjurmët e çatisë në murin verior.

Tiparet karakteristike që formohen sidomos me xhaminë e Izgurliut në Berat, vijojnë dhe në xhamitë që ndërtohen në sh. XVIII-XIX në Shqipërinë e Mesme. Ndër to është xhamia e Kavajës e cila ndërtohet në vitin 1736[21]. Për këtë monument është karakteristikë portiku i dytë i ndërtuar rreth portikut të vet xhamisë i përbërë nga një arkadë mbi kolona guri e mbuluar me çati druri me tjegulla, që zinte një pjesë të madhe përpara xhamisë. Salla e lutjeve katrore në plan mbulonte edhe këtu me kupol mbi trompa në qoshet. Vëllimi kubik edhe në këtë xhami përfundon me një kornizë dhe në pjesët këndore me çati trekëndëshe të ulura në qoshet. Muret janë të suvatuara në anën e jashtme, ndërsa minarja relativisht e ulët është ndërtuar me gurë të gdhëndur. Edhe në këtë xhami dritaret janë pesë për çdo faqe të vendosura në tre rradhë. Portiku i vetë xhamisë është me çati druri mbi një arkadë tre pjesëshe mbi kolona guri.

Një ndër monumentet më të arritur të arkitekturës islamike të vendit tonë është xhamia e Haxhi Ethem Beut në Tiranë filluar së ndërtuari në vitin 1794 dhe përfunduar në vitin 1821[22]. Ajo përbëhet nga salla e lutjeve, portiku i hapur dhe minarja. Vëllimi qëndror kubik i sallës që mbulohet me kupolë është ndërtuar me gurë lumi dhe për këtë arsye muret janë të suvatuara. Vëllimi kubik i sallës përfundon me kornizë prej rasash guri duke i patur çatitë e ulura trekëndëshe në qoshet. Mbi të me një ngushtim është tamburi tetëfaqësh me kupolën e mbuluar me fletë plumbi.

Salla qarkohet nga veriu dhe lindja nga portiku me arkada mbi kolona. Ai është i mbyllur në anën jugore ku ndodhet një mihrab i dytë. Ndërtimi i portikut si dhe shtrirja e tij jo e vogël kanë bërë që ai të lozë një rol mjaft të rëndësishëm në formulimin arkitekturor të godinës. Gjithashtu me mjaft vlerë është minarja e hollë dhe e lartë ndërtuar me gurë të gdhendur. Xhamia e Haxhi Ethem Beut në një sërë aspektesh mbyll rrugën që ndjekin xhamit e tipit sallë me kupolë në vendin tonë. Ajo i takon atij grupi ndërtimesh të vona në të cilat afrimi me arkitekturën popullore është i madh dhe shihet në mjaft element të përbashkët.

Xhamia e Peqinit (shek. XIX)[23] përbën një tjetër shembull të këtij tipi. Ajo është e tëra e ndërtuar me gurë të gdhëndur. Në ndërtimin vëllimor e planimetrik

17) **Po aty.**
18) E. Çelebiu, **vep. cit.** 106.
19) A. Meksi, **vep. cit.**
20) E. Riza, **Qyteti muze i Gjirokastrës,** Tiranë 1977, Disertacion, f. 34, fig. 39, 40.
21) N. Mele **Disa rezultate nga puna e sektorit të arteve të mesjetës dhe arkitekturës gjatë v. 1955,** B.SH.SH. 2, 1956, 153, A. Meksi, **vep. cit.**
22) K. Frashëri, **Vështrim mbi zhvillimin shoqëror, arsimor e kultural në Tiranë deri në mes të sh. XIX,** Arësimi Popullor, 4, 1964, A. Meksi, Gj. Frashëri, **Arkitektura dhe restaurimi i xhamisë së Haxhi Ethem Beut në Tiranë,** Monumentet 14, 1977.
23) A. Meksi, **vep. e cit.**

DOKUMENTOVA

paraqitet e veçantë sepse ka të ndërtuar në një trup me të edhe kullën e sahatit, të vendosur simetrikisht ndaj minares. Gjithashtu ndryshe nga xhamitë e mësipërme, muret përfundojnë me korniza horizontale. Portiku që ndodhet në anën veriore është me arkada nga dy në anët lindore dhe perëndimore dhe pesë në atë veriore. Ashtu si te portiku i Xhamisë së Haxhi Ethem Beut në Tiranë kemi të mbyllur një hapësirë këtu atë qëndroren për të krijuar portën.

Përdorimi i këtij tipi bëhej në ato raste ku kërkohej një ndërtesë më monumentale dhe më e qëndrueshme në kohë dhe për këtë u përdor në periudhën e fundit edhe në ndërtime të tjera të kultit mysliman si në teqet.

* *
*

Xhamia e Allajbegisë, objekt i këtij studimi vendoset qartë ndër këto monumente që i takojnë tipit sallë me kupolë. Ajo i takon grupit të xhamive me mure ndërtuar me teknikën e kluasonazhit, që si pamë përdoret gjatë gjithë shekullit të XVI. Me interes është të vërejmë se këtë teknikë e takojmë në zona në të cilat deri më sot nuk janë gjetur gjurmë më të hershme të saja. Në se do të analizonim format arkitekturale të monumentit do të shohim se monumenti nuk shquhet për proporcione të hedhura e për vertikalitet, së paku duke u nisur nga përmasat e brendësisë. Kjo përbën një të dhënë tjetër, krahas teknikës së mureve për ndërtimin e monumentit gjatë periudhës së parë të arkitekturës islamike në vendin tonë. Në aspektin arkitekturor edhe pse përmasat janë të vogla xhamia ka të arritura tiparet karakteristike të ndërtimeve të kultit mysliman me kupolë. Në brendësi, hapësira është unike dhe përftohet njëherësh nga ana e vizitorit. Ndërtimi vëllimor i brendshëm pasqyrohet tërësisht në pamjen e jashtme, në sajë të skemës së thjeshtë strukturale. Përdorimi i gurit e tullës bashkërisht në gjithë anët e jashtme të mureve, jo vetëm që gjallëron pamjet e ndërtesës, por dhe me kontrastin e tyre e tonet e ngrohta të tullës dhe llaçit e bën më piktoreske ndërtesën. Tulla është përdorur në harqet e dritareve, në niket e dritareve të poshtëme dhe mbi portën në anën veriore, për të vlerësuar më tepër në tërësinë e murit këto elemente.

Duke i analizuar xhamitë e këtij tipi për nga zgjidhja e pjesës së sipërme dallojmë dy grupe. Së pari ato ndërtime ku kalimi për në tambur bëhet me element këndor me çati trekëndëshe, mbi të cilët ngrihet menjëherë tamburi shumëfaqësh. Së dyti ato ndërtime ku kalimi për në tambur bëhet nëpërmjet formimit në dy shkallë të tij. Si pamë në grupin e parë bëjnë pjesë gati gjithë xhamitë e vendit tonë me përjashtim të xhamisë së Allajbegisë dhe asaj të Velabishtit që i takojnë grupit të dytë. Një pjesë e ndërtimeve e fillojnë tamburin drejtpërdrejt nga faqet e mureve anësore (xhamia e Izgurliut, e Muradies, e Nazireshës, e Gjin Aleksit) pjesa tjetër mbas një ngushtimi dhe kornize (e Mirahorit, e Ballies, e Kavajës, e Ethem Beut). Zgjidhja relativisht e rallë që ne takojmë në Allajbegi duket të jetë kushtëzuar si për arsye estetike, një fragmentim më i mirë i vëllimit, ashtu edhe për arsye konstruktive, një ballancim më i sigurt i peshave nga lart poshtë. Për mendimin tonë në rastin e xhamisë së Allajbegisë, ku për shkak të vëllimit relativisht të vogël xhamia rezulton e ulët, shkallëzimi i çatisë në këndet e bën me proporcione më të hedhura ndërtesën. Po ta analizojmë në aspektin struktural, për vet trashësinë e mureve, përballimi i shtytjeve të kupolës bëhet më lehtësi.

Problem tjetër që paraqet interes është ai i porositësit të xhamisë së Allajbegisë. Nga studimi i monumenteve të kultit mysliman rezulton se ato në periudhën e parë janë të porositura nga vetë pushteti qëndror ose sundimtarë vëndas. Më kohë shtohen ndërtimet që porositen nga sundimtarë vendas ose me origjinë vendase, nga esnafët apo dhe nga bashkësitë fetare. Në rastin tonë kuptohet që porositësi duhet të ketë qënë vendas që kthehet në kohën e fundit të jetës së tij në vendin e origjinës[24].

Lidhur me datimin e monumentit, në mungesë të të dhënave burimore apo atyre historike, duke u nisur nga teknika e ndërtimit që nuk e takojmë më gjatë sh. XVII si dhe nga trajtimi arkitektonik mendojmë se xhamia e Allajbegisë duhet të jetë ndërtuar gjatë shekullit të XVI.

24) Emri Allajbegi vjen nga grada e komandantit të regjimentit të trupave turke – miriallajbeg, shih M. de Hammer, **Histoire de l'Empire ottoman,** Paris 1841, vol. 17, 188, 189.

DO NOT COPY

TAB. I



Premje a-a



Premje b-b



Planimetria

0 1 2 3m

DO NOT COPY



1



2



3



4

DO NOT COPY



Pamje nga perëndimi



Pamje nga lindja



Pamje nga jugu





DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI – Leonard SULI

LES TRAVAUX DE CONSERVATION ET L'ARCHITECTURE DE LA MOSQUEE D'ALLAJBEGISE DANS LE VILLAGE DE BURIM, DISTRICT DE DIBER

RESUME

La mosquée d'Allajbegise se dresse dans une zone plate à proximité du village de Burim, district de Diber. Vu l'état de cette mosquée après les dégâts provoqués par le tremblement de terre du 7 décembre 1967 qui a touché le district de Diber et la nécessité de réparer les couvertures de cet édifice, en 1973 ont été effectués des travaux de conservation, en tant que partie intégrante des interventions futures de restauration.

Cette mosquée comporte la salle des prières, couverte d'une coupole et de volume cubique, le minaret dont on ne conserve que le soubassement et les fondations du hayat qui sont tombées en ruine par suite du tremblement de terre. La salle des prières a enregistré 6,40 x 6,27 m.

On y accède par une porte située du côté nord, à proximité du soubassement du minaret, donc de façon asymétrique. Cette porte est couverte d'une architrave plate, qui est surmontée d'un arc échelonné aigu dont le fond est en forme de bac. Le champ qui se forme entre ces deux éléments constitue une niche peu profonde de briques. L'arc aigu aussi est construit de briques. Il est surmonté d'une rangée de briques reproduisant un angle droit, ce qui rend encore plus complète la ressemblance avec les portails traditionnels des mosquées. Sur le mur sud de la salle se trouvent la niche du mihrab ainsi que les traces du mimbar, dont les structures sont de bois. De même sur le côté nord on relève les traces du matil, dont les structures sont de bois et au-dessous duquel, sur le côté ouest, se trouvait la porte peu élevée qui conduisait au minaret. La salle des prières était couverte d'une coupole sphérique. Le passage de la planimétrie carrée de la salle à la base circulaire de la coupole se fait par des trompes disposées aux angles, dont les parties visibles ont la configuration d'un arc aigu dans la partie inférieure et d'un arc à fond de bac dans la partie supérieure. Cette salle est suffisamment bien éclairée par dix fenêtres. Celles-ci sont disposées en groupe de trois en deux rangées sur les faces occidentale, méridionale et orientale et une fenêtre sur la face septentrionale.

Les fenêtres inférieures, qui commencent un peu au-dessus du niveau du sol, sont à angle droit et contournées par des corniches de pierre. L'architrave de pierre est surmontée d'un arc de décharge de briques en forme à fond de bac. Le champ qui se forme entre ces deux éléments constitue une niche construite seulement de briques. On y relève entre autres la fenêtre du côté nord, au-dessus de laquelle se trouve une niche couverte de briques disposées en forme de stalactites, exerçant la fonction d'un deuxième mihrab dans le hayat.

Les fenêtres supérieures sont plus simples et couvertes par un arc aigu échelonné construit de briques, qui sont disposées en longueur et contournées par une corniche de briques placées le long de l'arc.

En ce qui concerne son aspect extérieur, cette mosquée comporte la salle des prières de forme cubique et le tambour à coupole. Ce volume cubique se termine par un toit avec des triangles peu élevés aux angles, au-dessus duquel à travers un retrécissement léger s'élève un tambour peu élevé à huit faces faisant part de la coupole. Nous sommes donc en présence d'un tambour authentique. Sur le côté nord-ouest, comme d'habitude, se trouve le minaret. On n'y conserve actuellement que le soubassement à plusieurs faces, qui est construit de pierres équarries, et la partie pyramidale qui la reliait autrefois au corps du minaret. Au point de contact de ces deux éléments on relève une corniche comportant des passages courbés et cernant la partie libre du minaret.

Les murs de la mosquée sont construits de pierres et de briques selon la technique du cloisonnage. Ces pierres sont calcaires, les briques sont disposées en deux rangées horizontales avec deux briques placées verticalement entre les pierres. Tels sont les murs sud, ouest et est. Le mur nord, où se trouve aussi l'entrée à la salle des prières et où se distinguent par leur traitement le portail et la seule fenêtre qui s'y trouve, n'est pas construit selon la technique susmentionnée. Tel est seulement un fragment dans la partie supérieure de l'angle nord-est et la maçonnerie de cet angle, qui est un prolongement de la face orientale. Ce fait ainsi que les trous qui y sont conservés actuellement nous font aboutir à la conclusion que de ce côté de la mosquée il y avait un portail avec des éléments de bois dès sa construction. Nous avons rencontré de tels portails chez nous dans la mosquée de Ballie (1605) et de Naziresh (1599) à Elbasan et plus tard à Peqin (XIX s.), à Kavaje (1736) et à Tirana (1794-1821).

DO NOT COPY

En ce qui concerne nos traditions dans le domaine des constructions, la technique de construction des murs des mosquées avec des pierres et des briques en constitue un élément de première importance. La technique de cloisonnage des murs est une technique qui a connu une grande diffusion pendant les XIIIe-XIVe s. dans notre pays, surtout en ce qui concerne les édifices de culte. Entre-temps (XVe-XVIe siècles) cette technique n'était pas employée par l'architecture turque, ce qui montre que nos monuments ont été construits par des maîtres constructeurs du pays. Certes cette technique, s'adaptant aux exigences et au niveau nouveau des constructions, conserve la forme que nous rencontrons dans cette mosquée aussi.

En observant les parties supérieures des murs, qui se terminent avec des corniches de briques disposées à dents de scie, on relève que les parties angulaires, à toits triangulaires abaissés aux angles, n'ont pas une maçonnerie régulière. Ils représentent ou une mauvaise imitation du cloisonnage, ou bien comportent une maçonnerie de pierres. Ainsi l'angle sud-est a une maçonnerie de pierres disposées irrégulièrement, l'angle sud-est est une imitation du cloisonnage et l'angle nord-est se caractérise par une maçonnerie irrégulière. Dans ce dernier cas on peut relever encore le joint vértical qui établissait le contact entre la partie ancienne et les murs de date plus récente. Ce qui nous induit à penser que nous avons affaire à des adjonctions ultérieures dans les parties angulaires sur les trompes des coins. Cette même solution se rencontre chez nous plus tard dans la mosquée de Velabisht à proximité de Berat (1860).

Considérant l'état général des couvertures de cette mosquée, qui avaient été endommagées par le temps et les agents atmosférîques, nous avons jugé utile d'y intervenir par des travaux de conservation. Mentionnons de leur nombre la reconstruction des couvertures de tuiles, le complètement des corniches et le traitement en grandes lignes du cloisonnage (le complètement des joints aux endroits qu'ils étaient endommagés et le nettoyage du badigeonnage).

On a commencé par reconstruire les couvertures. A cette fin ont été effectués des sondages dans les parties angulaires pour définir leurs formes initiales. Le premier sondage a été effectué au coin nord-est. Nous avons choisi ce point parce qu'ici existait, comme nous l'avons dit plus haut, le joint vertical qui séparait le corniche à deux rangées de briques disposées en dents de scie de la maçonnerie nouvelle, mais aussi en raison du fait qu'au-dessous de la maçonnerie se trouvait le fragment en cloisonnage surmontant l'ancien toit du hayat. *Après avoir nettoyé les remplissages se trouvant au-dessous du toit sont venus à la lumière des murs d'une épaisseur de 40 à 50 cm., en tant que prolongement des murs latéraux de la mosquée, et au-dessus desquels avait été construit le nouveau toit triangulaire. Ces murs avait des faces régulières extérieures. Nous avons constaté de même que le mur reliant entre elles les faces nord et est en formant un angle de 45° était en cloisonnage et que de la sorte il créait, à un niveau plus bas, le toit de la partie angulaire. Ce mur comportait encore les traces de l'ancienne corniche de briques disposées à dents de scie. Un sondage analogue a été effectué au coin sud-est et les résultats ont été identiques. Toutefois nous n'avons pas relevé des traces de la corniche sur l'ancien mur à l'angle sud-ouest.*

De l'examen de la construction des parements des murs nous avions observé que sur la face nord la corniche par laquelle se terminaient les murs comportaient deux rangées de briques disposées en dents de scie, alors que cette corniche n'avait qu'une seule rangeé de briques placées en dents de scie. Afin d'apporter une solution à ce problème nous avons observé attentivement les corniches de la partie angulaire et il en est résulté que du niveau où commençait la corniche et jusqu'au niveau où commençait le cloisonnage du tambour il y avait de la place pour deux rangées de briques placées en dents de scie, en calculant à cette fin la couverture en tuiles de la corniche aussi.

En reconstruisant donc les partie supérieures de la mosquée, il en est résulté, comme nous l'avions d'ailleurs supposé, que nous avons affaire à une construction dont le volume cubique de la salle des prières se termine aux angles d'abord avec un élément couvert d'un toit triangulaire à un niveau plus bas, alors que plus haut, après un retrécissement couvert de tuiles, se dresse le tambour à huit faces. Cette solution nous la retrouvons chez nous, comme nous l'avons dit plus haut, dans la mosquée de Velabisht à proximité de Berat.

Après avoir éclairci ce problème à travers des sondages et en ne voulant pas reconstituer les corniches doubles se trouvant sous le toit, nous avons conservé l'état existant, en laissant à une deuxième phase de travaux le retour à l'état initial, retour qui n'est pas contraire à nos principes de restauration des monuments d'architecture. Par ailleurs, afin d'éliminer le mauvais effet produit par l'uniformité chromatique, nous avons nettoyé mécaniquement le badigeonnage de la maçonnerie en lui donant l'aspect caractéristique à deux couleurs, celles des briques avec des joints de mortier et des pierres.

La mosquée d'Allajbegise, qui est l'objet de cette étude, fait part des monuments qui appartiennent au type de salle à coupole. Elle appartient au groupe de mosquées dont les murs sont construits selon la technique du cloisonnage, qui, comme nous l'avons vu, a connu une grande diffusion pendant le XVIe siècle. Il convient de relever que cette technique nous la relevons dans des zones où nous n'avons pas rencontré des traces plus anciennes de celle-ci. Il suffit d'analyser les formes architecturales de ce monument, pour voir qu'il ne se distingue pas par des proportions élancées et des traits de verticalité, au moins sur la base de ses dimensions intérieures.

En ce qui concerne la datation de ce monument, en l'absence de données écrites ou historiques, en tenant compte de sa technique de construction que l'on ne rencontre plus au XVIIe siècle ainsi que de son traitement architectonique la mosquée d'Allajbegise doit avoir été construite au XVIe siècle.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Tirazhi: 1500 kopje Formati 70 x 100/12 Stazh: 2204/72

Shtypur: Kombinati Poligrafik Shtypshkronja «Mihal Duri» 1979

DO NOT COPY

DO NOT COPY

NDREQJE GABIMESH

Faqe	shënim, kollonë	rreshti	si është	si duhet të jetë
76 76	shën. 19 shën 20 ç	4	Mehodh	Methodh Në një shënim të ungjillit në kishën e shën Mëhillit të Vithkuqit thuhet se ky qytet ishte shkatëruar më 25 Tetor 1823.
76	shën 20 a	3	dëmin	dënim
80	koll. I	46	1880	1800
98	Shën. 5		19,28	1928
101	1	40	që e	që të
102	2	5	formulohet	formohet
102	2	28	fig. 10	fig. 11
107	1	35	ujë	një

DO NOT COPY

Çmimi 10 lekë